

BIBLIOTEKA
SHTETIT

+7.5
11



MEXHIT
KOKALARI

**Trimë
të kryengritjeve
popullore**

94 P. 65

K 81.

MEXHIT KOKALARI

TRIMA
TE KRYENGRITJEVE
POPULLORE

(Në fillim të Rilindjes sonë Kombëtare)



22500

SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»

Tirazhi 7.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1979

P A R A T H È N I E

Libri që po i paraqesim sot lexuesit bën fjalë për kryengritjet e mëdha fshatare në shekullin e XIX, të cilat janë pjesë përbërëse e lëvizjes sonë kombëtare. Edhe ato përbëjnë bazën themelore të armatosur, mbi të cilën u mbështetën udhëheqësit politikë dhe kulturorë të borgjezisë kombëtare në luftën për autonominë dhe pavarësinë e atdheut tonë dhe për përmbysjen e rendit të vjetër feudal.

Fryma antifeudale e Rilindjes sonë Kombëtare është shfaqur nëpërmjet formave të shumanshme të luftës kundër rendit të vjetër, në lëvizjet popullore të armatosura, jo vetëm në fshatra po edhe në qytete, në lëvizjen e «hajdutëve» (kaçakëve), në lëvizjen për zhvillimin e gjuhës e të kulturës kombëtare, në lëvizjen për autonominë e pavarësinë e Shqipërisë, që filluan të shfaqen që nga fundi i shekullit XVIII. Edhe pas rënies së shtetpashallëqeve shqiptare autonome të Janinës dhe të Shkodrës (1822-1831), pushteti osman në tokat shqiptare nuk u përforcua. Reformat centralizuese turke të ndërmarra nga sulltanët Selim III dhe Mahmud II, kundër të cilëve kishin luftuar si Ali pashë Tepelena në Jug ashtu dhe Mustafa pashë Bushatliu në Veri të Shqipërisë, vazhdonin të kundërshtoheshin në forma të ndryshme, kryesisht me armë në dorë nga ana e popullsisë shqiptare.

Në krye të kësaj lëvizjeje të qëndresës së armatosur qenë vënë elementë feudalë që ishin kundërshtarë të pushtuesve osmanë (kryesisht elementë që kishin qënë mbështetja shoqërore dhe politike e Ali pashë Tepelenës)¹⁾

1) Ligor Mile. «Rreth lëvizjes kryengritëse shqiptare në çerekun e dytë të shek. XIX e sidomos rrreth kryengritjes së Kosovës së vitit 1844». Studime historike, nr. 2, 1966, fq. 105.

Gjatë periudhës të treçerekshekullit të Bushatllijve dhe asaj tridhjetëvjeçare të Ali pashë Tepelenës ishte siguruar de fakt o vëtëqeverisja e tokave shqiptare nga ana e sundimtarëve vendës të lartpërmendur. Kjo ndihmoi objektivisht në bashkimin e mëtejshëm politik të shqiptarëve, duke i dhënë grushte vdekjeprurëse anarkisë feudale, kur po shthurej rendi feudal dhe po lindte ideologjia borgjeze e qërrimit kombëtar.

Gjatë kësaj kohe, në gjirin e klasës feudale shqiptare sa vinte dhe po kristalizoheshin dy krahë: krahë autonominist dhe krahë turkoman. Kjo ndarje në gjirin e klasës feudale çifligare shqiptare filloj të shfaqej sidomos që nga koha e formimit të shtetpashallëqeve autonome të Janinës dhe të Shkodrës. Lidhur me përcaktimin e forcave kryesore lëvizëse të luftës së armatosur antiturke në tokat shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XIX, studimi konkret historik i asaj periudhe të shpie drejt këtij përfundimi: ndërsa masat fshatare dhe më pak ato qytetare po hidheshin në një lëvizje spontane dhe të paorganizuar kundër politikës së re shtypëse pas Reformave të Tanzimatit, krahë autonomist i feudalëve (përkatësisht e sistemit të Ali pashës), duke përfituar nga pakënaqësia e përgjithshme popullore (e shkaktuar nga rekrutimi shumëvjeçar ushtarak turk, nga rëndimi i zgjedhës, nga heqja e autonomeve krahinore si ajo e Sulit, e Himarës etj. dhe nga ardhja e qeveritarëve me kombësi turke) u vu në krye të lëvizjes së armatosur.

Sipas këtyre reformave centralizuese osmane, shqiptarët duhej të kryenin pesë vjet shërbim rekrut dhe shtatë vjet shërbim rezervë në skajet më të largëta të Perandorisë Turke si në Jemen e gjetkë.

Një shërbim i tillë kishte pasoja katastrofale, pasi shkatërronte forcat e gjalla prodhuese të vendit, veçanërisht fshatarët. Ata ishin të detyruar të braktisin ekonomitë e tyre shpesh herë, për të mos u kthyer më kurrë. Ardhja e qeveritarëve të rinj turq në vendin tonë dhe vendosja e taksave e vështirësorë edhe më shumë gjendjen në Shqipëri dhe bëri që kudo tek ne të konsiderohej zba-

timi i këtyre reformave si një robërim i ri i Shqipërisë nga ana e osmanllinjve, prandaj populli u ngrit përsëri në këmbë për jetë a për vdekje kundër pushtuesit.

Kryengritjet shqiptare kundër reformave centralizuese turke përfshijnë një periudhë të gjatë dhe përbëjnë një nga fazat e lavdishme të Rilindjes sonë Kombëtare.

Me gjithë orvatjet e Portës së Lartë reformat nuk arritën të zbatoheshin plotësisht në Shqipëri. Stambolli u detyrua të bënte përsëri lëshime jo të vogla, qoftë nga rezistenca e paepur e popullit tonë, qoftë sepse i doli një problem i ri në këto anë të perandorisë.

Shtetet e reja të Ballkanit si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia ishtin ngritur për çlirimin e plotë të tokave të tyre, por më vonë të inkurajuar nga Rusia cariste, bashkë me kërkesa të drejta filluan të ngrejnë edhe kërkesa ekspansioniste. Qeveritë shqiponiste të këtyre vendeve krahas kërkesave për çlirimin e tokave të tyre, këkonin të zgjeronin kufijtë në kurriz të tokave shqiptare të Perandorisë Osmane, duke filluar qysh prej vitit 1852. Në këto rrethana të reja, Turqia, zbatimin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në Shqipëri e shtyu për më vonë. Ajo u kufizua vetëm në disa masa jo të plota në Shqipëri-në e Jugut dhe në atë Verilindore, ndërsa në Veri ua la përsëri malësorëve privilegjet e mëparshme.

Shpjegimet e lartpërmendura i kemi vënë në dukje për të sqaruar lexuesin në lidhje me synimet e studimit tonë pasi pikërisht në ato kohëra aq të errëta për fatet e atdheut tonë jetuan dhe luftuan për të mirën e vendit kapedanët e malësorëve dhe të fshatarësise si Marko Boçari, Çelo Picari, Zyllyftar Poda, Tafil Buzi, Zenel Gjoleka, Rrapo Hekali, Spiro Gjika, Dervish Ali Dukati, Balil Nesha, Janaq Kumiu, Hodo Ali Nivica, Gjikë Thanasi, Çaparenjtë etj. e dhjetra trima të tjerë paraardhës dhe pasardhës të tyre, të cilët do t'i renditim në studimin tonë sipas pjesë-marrjes së tyre në kryengritjet e mëdha popullore kundër pushtuesit osman.

Në kushtet e krijuara, interesat e këtyre udhëheqësve përfaqësonin interesat e shtresave popullore. Këto lëvizje masive, jo vetëm penguan zbatimin e reformave

centralizuese turke dhe hodhën në erë planet shoviniste të shteteve fqinj për aneksimin e tokave shqiptare, por ato zhvilluan ndërgjegjen kombëtare, forcuan unitetin kombëtar dhe përgatitën terrenin për kërkesat që do të shtronte lëvizja nationale e mëvonshme. Udhëheqësit e këtyre kryengritjeve edhe pse u gjendën të vëtmuar përballë dredhive të pushtuesve osmanë, të fqinjëve shovinistë dhe të diplomacisë evropiane, ditën megjithatë t'i dallonin miqtë nga armiqtë e popullit shqiptar.

Për të vlerësuar drejt veprimtarinë atdhedashëse të këtyre kapedanëve të rritur në atmosferën mbytëse të obskurantizmit mesjetar islamik turk, duhet të kemi parasysh botëkuptimet e ndryshme fetare të asaj kohe, ku midis popujve të ndryshëm të Perandorisë Osmane sundonte parulla e pushtuesit: «Përça dhe sundo». Gjithashtu duhet të theksojmë se, pavarësish nga karakteri i tyre popullor e përparimtar, këto kryengritje kanë pasur edhe kufizimet e tyre që nuk kanë qenë të rastit, dhe kanë qeshin kryesish një karakter krahinor, ishin të dobëta nga ana organizative dhe me një platformë politike naivë etj.

Kufizimet e tyre vinin gjithashtu edhe nga udhëheqja që patën. Pavarësish se një pjesë e mirë e këtyre udhëheqësve vinin nga rradhët e fshatarësise që shkrihej me lëvizjen popullore, këta krerë përbënë, në një varg rastesh, një shtresë me interesa të vecanta, si shtresë udhëheqësish ushtarakë, aq më tepër kur këta krerë vinin nga shtresa të tjera jo fshatare. Të gjitha këto shpjegojnë qëndrimin e tyre të lëkundur, largimin nga lufta, rënien në kurthet e armikut etj. Për këto arsyë këto kryengritje nuk kanë qenë dhe nuk mund të ishin në gjendje të zgjidhnin detyrat historike që shtronte koha.

Lind pyetja se a kemi mundur t'i përshkruajmë në këtë punim të vogël të gjithë trimat e kryengritjeve popullore të kësaj periudhe? Jo. Trimat e vegjëlisë shqiptare janë të panumërt. Ndoshëta çdo gjë i ka munguar popullit tonë, vetëm trimat nuk i kanë munguar kurrë. Ata i gjen në Shqipëri kudo dhe në çdo kohë. Popullit shqiptar asnjëherë s'ia ka parë shpinën armiku. Ai armiqtë

i ka parë kurdoherë përmes thepit të pushkës. Nuk janë gérshetuar rastësish këto vargje popullore:

«Shqipëri, flamur direku,
Tu mbi syri tek dyfeku...»

Gjatë gjithë historisë populli shqiptar ka qëndruar vazhdimisht në këmbë, ndoshta i zbathur dhe i xhveshur, por kurdoherë i gatshëm për t'iu hedhur në grykë armikut, pa i peshuar asnjëherë forcat e panumërtë të pushtuesit. Qartë pasqyrohet trimëria shqiptare në përgjigjen që i dha kapedan Çelo Picari i burgosur, valiut të Janinës, i cili donte ta bindte atë se shqiptarët sado trima që të jenë, janë të paktë në numër dhe s'mund të maten kurrë me forcat e shumta turke! Çelua me thjeshtësinë e tij popullore iu përgjigj: «Numrimin, shqiptari e përdor për bagëtinë, nuk e ka për trimërinë».

Kështu ka qenë për shqiptarët në të gjitha kohërat. Me këto tradita ishin brumosur bijtë e Shqipërisë që kur shkonin në luftë, përllesheshin një me dhjetë. Luftërat gjithë jetën shqiptarët i kanë bërë të ashpra si rrallëkush, sepse i kanë bërë në trojet e tyre. Këtu e ka burimin dhe filozofia e tyre se «Kush unj qafën i bien zverkut».

Në patriotizmin e madh të brezit të sotëm, të edukuar nga Partia, që rron, punon dhe gjeson Shqipërinë e re socialiste kanë bërë punën e tyre edhe të parët tanë.

Në punimin tonë, përvèç dokumentacionit dhe bibliografisë historike, u kemi dhënë rëndësi të veçantë edhe këngëve popullore, meqenëse nuk mund ta njohim mirë të kaluarën e lavdishme të popullit tonë pa studiuar më parë folklorin e vendit, këtë botë të madhe shpirtërore të kombit.

Historianët borgjezë e mohojnë rolin vendimtar të masave në histori dhe luftërat e tyre për pavarësi dhe përparim ua veshin klasave në fuqi, mbretërve dhe të ashtuquajturve heronj të tyre, ndërsa heroin e vërtetë, atë që e bën vërtet historinë, «popullin» e injorojnë së bashku me botën e madhe shpirtërore të tij, folklorin.

Dihet se vendin e parë në histori për ndërtimin e

ngjarjeve e ka dokumentacioni vendas, e në mungesë të tij i huaji, por folklori gjëzon shumë veti të domosdoshme, që i mungojnë dokumentit, aq shumë të nevojshme për historiografët tanë, veçanërisht në ato raste ku ky dokumentacion mungon.

Folklori, kjo autobiografi e popullit i pasqyron më qartë se dokumenti i huaj luftërat e klasave dhe luftërat kundër pushtuesit, ngjarjet e ndryshme të kohës, idealet shoqërore të masave, ndjenjat morale dhe psikologjinë e shtresave dhe të klasave në fazë të ndryshme të historisë. Aty gjejmë të pasqyruar qartë marrëdhëni, qëndrimet, pozitat që zënë klasat e shtypura ndaj sunduesve të huaj ose vendës, etj. Konstatimet që jep ky visar i madh i kombit janë në përgjithësi më afër realitetit, pasi ato janë shprehje të mendimeve të masave, mendime të shprehura lirisht dhe jo të diktuar nga lart. Folklori, si mendim i popullit, i kundërvihet herë-herë dhe dokumentit arkival të huaj që ka tendenciozitetin klasor, apo të armikut.

Folklori, ky thesar i paçmuar i popullit, në një varg rastesh i pasqyron më drejt ngjarjet, është më i gjerë dhe më i gjallë, pasi i jep faktet me art, me fabulë, me përshkrime tipash, është më i konkretizuar sesa dokumenti i zakonshëm, veçanërisht nga ai i jashtmi, sepse shpesh herë autori i këngës ka qënë dhe vetë pjesëmarrës direkt në ngjarje, prandaj shprehjet e tij janë me të vërtetë më bindëse sesa studimet e historiografit borgjez, që janë të mbështetura kryesisht në burime arkivale të jashtme, të deformuara dhe të veshura me ideologjinë e klasës që përfaqëson. Rrjedhimisht mund të thuhet se qëndron si duhet në këmbë vetëm ajo histori, që ka parasysh edhe folklorin, këtë mendim të madh të popullit dhe nuk mbështetet vetëm në përbajtjen e dokumenteve historike, të ardhura në shumë raste vetëm nga burime të huaja, dhe që nuk kanë kaluar para gjykimit kritik të masave. Edhe atëhere kur dokumentacioni arkival i huaj (qoftë edhe i regjimeve të së kaluarës) na jep fakte me vlerë për studime historike, prapëserapë ai nuk mund të qëndrojë vetëm, sepse është i thatë dhe nuk

mund t'i pasqyrojë ngjarjet në tërësinë e tyre, nuk mund të vejë në dukje botën e madhe shpirtërore të popullit, pa të cilën shkenca historike mbetet e varfër. Pa i bërë thirrje këtij visari të madh të kombit, nuk mund të gjurmë si duhet jetën dhe veprat e trimave të shumtë të vegjelisë, për të cilët arkivat ose s'kanë shkruar, ose i kanë përmendur pak.

Dihet që dokumentacioni është materiali bazë në shkençat historike për ndërtimin e ngjarjeve, por folklori është një levë e mirë ndihmëse. Ajo e plotëson dokumentin, e saktëson dhe e pastron nga shtrembërimet ideologjike. Dhe në ato periudha kohe që mungon dokumentacioni, folklori e zëvendëson atë.

Ka qënë zakon i vazhdueshëm në Shqipëri që populli, sa delte nga lufta, ose aty për aty në mes të betejës të ngrinte këngën. Shqiptari i futi të gjitha luftërat e tij në këngë për t'i patur ato të ndezura brez pas brezi. Ne qëndrojmë afër këtyre këngëve si pranë një zjarri dhe na ndizet ftyra nga prushi i figurave të tyre. Ne ndjejmë luftërat e pasosura dhe, herë sipër flakëve herë nëpër tym, shohim shëmbëlltyrën e bardhë të lirisë, të cilën populli ynë e ka mbrojtur me fanatizëm të rrallë.

Edhe pse e kemi parasysh specifikën e folklorit, si transformimet që merr kënga gjatë shekujve, duke kaluar gojë më gojë (për derisa janë trashëguar të pashkruara), ndikimet e klasave apo të të huajve, kënga e popullit ka ditur t'i pasqyrojë drejt ngjarjet e periudhave të ndryshme dhe figurat historike që marrin pjesë në to. Dhe duhet thënë se folklori, me kalimin e kohës, pasi e vulosin gjenerata e dekada të tëra, në esencën e vet merr vlerën e dokumentit.

Shumë këngë kanë dalë gjatë shekujve, por rrebeschit të kohës nuk i qëndrojnë të gjitha në këmbë. I rezistojnë kohës vetëm ato këngë që shprehin të vërtetën, aspiratat e popullit. Të tillë këngë nuk zhduken nga kujtesa e masave popullore. Ato nuk humbasin pasi gjatë shekujve janë afirmuar nga vetë populli, që është gjyqtari më i mirë.

Iu futëm këtij studimi, duke patur parasysh fjalët

e urta të udhëheqësit tonë të shquar, shokut Enver Hoxha, i cili gjatë vizitës së tij në fshatin Picar të Kurveleshit, në 27 maj 1969 midis të tjera shka: «. . . . Traditat e mrekullueshme të trimërisë, që populli i Kurveleshit, i Labërisë dhe i gjithë Shqipërisë i ka në gjak, e kemi për detyrë t'ua transmetojmë brez pas brezi djemve e vajzave tona dhe t'i mësojmë të jenë kurdoherë të fortë, ashtu siç ka qenë populli ynë në shekuj, pasi vetëm kështu ai do të mund të rrojë i lirë në truallin e vet». ¹⁾

AUTORI.

1) Gazeta «Zëri i Popullit», 28 maj 1969.

PJESA E PARË

TRIMAT E KRYENGRIJVE POPULLORE NË DITËT E FUNDIT TË ALI PASHË TEPELENËS

PRIJESİ I TALENTUAR MARKO BOÇARI ME SHOKË

«Shqipëri moj ballëlarë,
S'pate dert nga asnje valë,
Të mbeti dora në pallë».

Populli

Viti 1821 e gjeti Shqipérinë e Jugut të përmbytur nga mijëra ushtarë osmanlinj, të cilët kishin marrë urdhër të prerë për të shtrirë përsëri sundimin e sulltanit në shtetpashallëkun shqiptar, autonom të Janinës.

Porta e Lartë kishte dy vjet që e kishte shpallur fermanli (jashtë ligjit) vezirin shqiptar, Ali pashë Tepele-nën, pasi ai, me politikën e tij të pavatur e largonte çdo ditë pashallëkun e tij nga sundimi i sultanit. Për këtë Stambolli kishte dërguar në Shqipëri kundër Aliut trupat më të zgjedhura ushtarës nën drejtimin e gjeneralit të sprovaar Hurshid pashës. Në brigjet e detit Egjé dhe të detit Jon, ishte vendosur një pjesë e madhe e flotës turke. Me mijëra ushtarë kishin zbarkuar dhe marshonin në tokën e djegur të pashallëkut autonom të Janinës. Ali pashë Tepelena, megjithëse ishte tërhequr në kalanë e fortifikuar të Janinës, i braktisur edhe nga djemtë e tij, nuk hoqi dorë nga lufta. Ai, me qëllim që të rindërtonte kështjellat dhe të organizonte kryengritjen, pranoi propozimin e Hurshid pashës për të hyrë në marrëveshje dhe

me zgjuarësinë e tij diti t'i zgjaste bisedimet në favor të tij. Kështu në verën e vitit 1821 filloi kryengritja shqiptare, e cila u shtri që nga Myzeqeja e deri në afërsi të Janinës, duke tronditur rëndë serasqerin Hurshid pashën, që mbante të rrrethuar Janinën.

Ali pasha me bashkëluftëtarët e tij zhvilloi luftime të përgjakshme. Të parët që u hodhën në sulm, ishin bijtë e Sulit me në krye prijesin e tyre të talentuar ushtarak Marko Boçarin. Qartë e pasqyron folklori këtë bir të Sulit të rritur në oborrin e Aliut:

«*Ngrehu o vezir Ali, vure dylbinë ndë sy,
Një djalë, një çilimi, që e kishe ndë avlli. . .
Hidhetë përmbi hordhi, ky ësht' Marko Boçari...»*

Kudo në Shqipérinë e Jugut zhvilloheshin luftime të përgjakshme. Trimi Zylyftar Poda me luftëtarët e Kolonjës e të Leskovikut kishte zënë urën e Ostanicës përmbi Vjosë dhe i kishte prerë pushtuesit qđo lidhje nga ana e veriut. Të njëjtin veprim kishin bërë trimat e Aliut edhe nga lindja. Forcat kryengritëse shkatërruan pozitat e trupave turke. Me një sulm të befasishëm u mor përsëri kalaja e Tepelenës nga trimat e Ali pashës, të udhëhequr nga luftëtarë i ri 22 vjeçar Çelo Picari, të cilat iu besua edhe mbrojtja e kësaj kështjelle. Ja si i pasqyron folklori trimat e Aliut:

«*Kalaja në Tepelenë,
Bir, o bir, o Ali Pasha!
Ç'i mban trimatë levendë,
Gjithë me perçë të prerë.
Kapetan Çelo Picari. . .
Jalla mos të qastë varri.
Levendët e kara Aliut,
I rreh topi i osmanliut. . .»¹⁾*

1) Në këtë vëllim të gjitha vargjet që nuk kanë referencë janë marrë nga Arkivi i Institutit të Folklorit.

Gjatë kësaj kohe, forca të mëdha turke hynë në Shqipërinë e Jugut. Në ditët e para të shtatorit flota turke zbarkoi në Prevezë një forcë prej pesëmijë ushtarësh, me armatime e materiale të shumta, të komanduara nga vezir Hasani. Në Larisa ishin grumbulluar dhjetë mijë ushtarë të tjerë. Krahinat e çliruara s'kishin rezerva të mjaf-tueshme për të mbajtur kryengritësit me bukë. Të mbetur pa ushqime dhe pa strehim në prag të dimrit, kryengritësit shqiptarë filluan tërheqjen për në Veri. Për të thyer rrëthimin nga ana e Artës serasqeri Hurshid pasha organizoi tri kolona me gjashtë mijë ushtarë.

Osmanllinjtë pas shumë përpjekjesh mundën të çanin rrugën edhe nga verilindja. Hurshid pasha grumbulloi në Janinë dyzet mijë ushtarë turq dhe tërë artilerinë. Ai kishte dhënë urdhër të prerë të kapte me çdo kusht Ali pashë Tepelenën.

Megjithë epërsinë në numër të ushtrisë osmane, luftëtarët e paktë të Aliut luftonin me heroizëm të rrallë. Ata shumë herë hapnin dyert e kështjellës dhe hidheshin në sulm të furishëm, duke i ndjekur osmanllinjtë deri në kampin e tyre.

Ushtritë osmane vinin njëra mbas tjetrës si valët e detit. Ato përplaseshin para mureve të kalasë së Janinës. Kryetimi shqiptar Ali pashë Tepelena me bashkatdhetarët e tij besnikë, Marko Boçarin, Çelo Picarin e Veiz Vasjarin me shokë, e kishte organizuar bukur edhe luttën e çetave, të cilat i sulmonin vazhdimisht pas shpine hordhitë turke plot me mercenarë të mbledhur anembanë Perandorisë së madhe Osmane. Legjendare është lufta e Aliut plak në ditët e fundit të jetës së tij:

«Një kala në an' të detit,
I doli karshi dovetit,
Një kala në an' të gjolit,
I ktheu gjoksin Stambollit. . .»

Kryetimi shqiptar, veziri Ali pashë Tepelena edhe pse i moshuar qëndroi deri në fund në këmbë, i paepur

para portës së Lartë dhe u vra me pallë në dorë së bashku me trimat e tij besnikë:

«... Një mij' toskë e dymij' gegë,
Qëndruan me Ali pashanë,
Ata vun' kokën në torvë,
Me kordhë në dorë u vranë...»

Cili ishte qëllimi i këtij njeriu? Krijimi i shtetit shqiptar. Kjo idé konkretizohet në dy vjetët e fundit të jetës së tij. Ky qëllim në këtë kohë del befas në plan të parë dhe bëhet i vetmi flamur, për të cilin lufton dhe vdes Aliu. Ndjenja e kombësisë gjithnjë ka ekzistuar tek Aliu, por ai e lidhte këtë vetëm me triumfin e tij personal, aq sa tek Aliu ato u bënë një sinonim i vetëm. Sidoqoftë karakteri klasor i regjimit dhe rrethanat historike e penguan lëvizjen e Ali pashës të bëhej e përgjithshme dhe si pasojë të gjitha këto u bënë shkaku i dështimit të pashmangshëm të tij.

Me gjithë terrorin e pashebullt osman, edhe mbas vrasjes tradhtisht të Ali pashë Tepelenës më 5 shkurt 1822, dhe me rënien e gjithë pushtetit pashallëk shqiptar autonom të Janinës në duar të turqve, shqiptarët nuk e pushuan luftën kundër pushtuesit; kryengritjet shqiptare vazhduan pér shumë vjet me radhë.

Ekspeditat ndëshkimore osmane, zjarri, hekuri dhe kamxhiku i tyre nuk e nënshtruan dot popullin shqiptar. Stambolli nuk mundi të rrënjoshte kurrë në Shqipëri idenë e pathyeshmërisë të forcave osmane. Luftëtarët heroikë të Kara Mahmud pashë Bushatit dhe ato të Ali pashë Tepelenës kishin dhënë prova të tjera bindëse pér forcën e pamposhtur të kryengritësve shqiptarë. Këto beteja u dhanë përsëri të kuqtojnë shqiptarëve se edhe një popull i vogël, që guxon t'u kundërshtojë agresorëve, mund të fitojë edhe mbi armiq shumë të fortë, t'i luftojë dhe t'i mundë ata, kur lufton pér një çështje të drejtë.

Sa herë ra drapri i pushtuesit mbi udhëheqësit ushtarakë të Aliut, mbi trimat e kryengritjeve popullore! Por Porta e Lartë, nuk mundi t'i kositë dot të gjithë këta

luftëtarë. Mjaft trima i shpëtuan kthetrave të sulltanit. Ata e vazhduan edhe më vonë luftën kundër Stambollit. I tillë ka qenë dhe trimi suliot Marko Boçari.

Suli, që ndodhet në Çamëri, shtrihet në lindje të Paramithisë dhe ndahet në katër krahina: Flamuri, Burgu ose Vuci, Kopaneza dhe Dubliri.¹⁾ Suli është vend malor dhe strategjik prej natyre. Ai mbrohet shumë mirë nga mali i Buburickës. Në këto krahina mund të hyhet vetëm nëpërmjet qafës të Samonivës dhe të Avarikut. Sulin e rrethon anembanë lumi Akeron. Nga fshatrat më të përmendura janë: Shalësi, Kardhiqi etj. Ka edhe vende të pasura sikurse është Fusha e Frarit. Historianët e huaj, si historiani grek A. Th. Gudhan, shpjegojnë se suliotët janë stërnipërit e luftëtarëve të heroit tonë legjendar Skënderbeut. Ata kanë karakteristikat dalluese shqiptare, si trimérinë, besën, krenarinë.²⁾

Suliotët, kjo popullsi shqiptare autoktone që shtrihet gjerësisht në krahinat malore të përmendura më lart, kanë luajtur një rol të rëndësishëm gjatë shekujve për mbrojtjen e lirisë së tyre. Edhe sot ndodhen në Sul mbeturinat e kështjellave të dikurshme, si Tripa, etj., në të cilat thyen kokat pushtuesit e ndryshëm, që shkuan atje valë-valë, për t'u rrëmbyer suliotëve lirinë.

Sipas traditës popullore, thuhet se një nga trimat më të dëgjuar të këtyre anëve ka qenë Gjergj Boçari, stërnipi i Gjon Boçarit (një nga bashkëluftëtarët më besnikë të Skënderbeut).

Gjergj Boçari trashëgoi taktilën luftarake të stërgjyshërvë të vet, të Gjonit dhe të paraardhësve të tjerë luftarakë.

Nga djemptë më të dëgjuar të Gjergjit dhe më i zoti në tërheqjen e shpatës ka qenë Kiço Boçari. Ky luftëtar i udhëhoqi me vjete të tëra trimat e Sulit në mbrojtjen e vendit. Kiçua u martua me një vajzë nga fisi suliot i

1) P. Aravantinoi. «Historia e Ali pashë Tepelenës». Athinë, 1850, fq. 65, 66, 67.

2) Po aty.



Xhavellajve me të cilën lindi Marko Boçarin, aq shumë i përmendur nga historianët vendas e të huaj, për trimërinë dhe atdhedashurinë e tij. Në historinë e lavdishme të Sulit do të mbetet e paharruar rezistenca e bijve të këtij vendi për ruajtjen e autonomisë së tyre krahinore.

Në kushtet historike të fundit të shekullit XVIII dhe të fillimit të shekullit XIX, Perandoria Turke që shkonte drejt dobësimit të saj, nuk kishte më interes të respektonte autonomitë e krahinave të ndryshme shqiptare, veçanërisht të atyre krahinave si Himara, Suli etj, që për arsyepozicioni gjeografik ishin më afër Evropës Perëndimore ku ishin mëkëmbur shtete me potencial ekonomik dhe ushtarak të fortë. Këto oaze pavarësie (sipas Stambollit) nën ndikimin e këtyre shteteve të mëdha, kishin rrezik të ktheheshin në pikë mbështetjeje për të sulmuar Perandorinë Turke.

Kjo dëshirë e Portës së Lartë përputhej në atë kohë plotësisht dhe me aspiratat e sundimtarit të ri Ali pashë Tepelenës, i cili kërkonte me çdo kusht të përqëndronte në duart e tij pushtetin në mbarë pashallëkun. Kështu shpjegohen ekspeditat ndëshkimore të Aliut në Sul, Himarë etj. ku u derdh aq shumë gjak shqiptari nga të dy anët, në vend që të rezervohej për luftë kundër push-tuesit osmanlli. Vjetët kalonin. Ali pasha çdo ditë e forconte dhe e centralizonte edhe më shumë pushtetin në duart e tij. Shumë pashallarë, si ai i Beratit, i Delvinës etj. me pretekst se gjoja ishin vënë në opozitë me Stambollin, u mposhtën nga Aliu. Pashallëku i vezirit të Janinës u zmadhua shumë. Vetë Aliu filloj të hynte në marrëdhënie edhe me shtete të mëdha evropiane. Emri i tij u bë i njohur anembanë Evropës.

Pashai i Janinës e largonte çdo ditë pashallëkun e tij nga Turqia. Ai e shpinte atë drejt shkëputjes nga Perandoria e madhe Osmane.

Ky qëndrim separatist i Aliut e tronditi Portën e Lartë. Sultan Mahmudi i dytë, në pamundësi për ta përbajtur Ali pashë Tepelenën e shpalli atë «fermanlli» (jashtë ligjit) dhe e dënoi me vdekje.

Veziri plak i Janinës, gjatë kësaj kohe, doli hapur

kundër Turqisë dhe ftoi rreth vetes të gjithë ata që ishin në opozitë me Stambollin. Ai u bëri thirrje edhe trimave të Sulit për luftë kundër pushtuesit turk, armikut të tyre të përbashkët. Trimat e Sulit, me gjithë plagët e mëdha që u kishte shkaktuar Ali pashë Tepelena, ditën të mbajnë qëndrim të drejtë. Në kuvendet e tyre, me pjesëmarrjen e miaft përfaqësuesve të krahinave të tjera çame, ata vendosën t'i afrohen Aliut, të bindur se armiku kryesor që turku dhe dëbimi i pushtuesit arrihej vetëm duke qenë shqiptarët të bashkuar.

Tashti trimat e Sulit e kishin të qartë se në kushtet e reja të krijuara, midis Aliut dhe Stambollit nuk mund të bëhej më lidhje. Në këto rrethana suliotët pranuan bashkë-punimin me Aliun për luftë kundër Turqisë. Këtu pas-qyrohet hapur logjika e luftës që i bashkoi shqiptarët, me gjithë interesat e kundërtë të brendshme. Luftëtarët u bindën gjithashtu se emri i Aliut do t'i shërbente «çësh-ties së pavarsisë shqiptare», sepse, në aftë se do të fitonte Ali pashai nuk do të formonte një shtet turk, por një shtet shqiptar. Në krye të këtij shteti do të viheshin shqiptarët dhe qysh atëherë do të përcaktoheshin kufijtë e Shaipërisë.

Nga trimat suliotë që i ndriti më shumë palla nëpër sheshet e luftës ka qenë luftëtar i ri Marko Bocari, i biri i Kiços. Ky trim u vu në krve të luftëtarëve të Sulit, jo vetëm se ishte i zoti dhe luftëtar i sprovuar, por ai dinte ta përdorte gjuhën në arenën politike aq lehtë sa edhe shpatën, kur ishte puna për mbrojtien e atdheut.

Ja cfarë fjalë të ziarrta patriotike i kanë kushtuar arbëreshët e Italisë këtij biri të shtrenjtë të Shaipërisë: «Marko Bocari është heroi shqiptar modern, që në mendimet e veprimet e tij, në shkencën e tij strategjike dhe në ndërmarrjet e vecanta na rikuiton ose më mirë na riprodhon temperamentin e famshëm të paraardhësit të tij aq shumë popullor, të Gjergj Kastriotit, i njohur më shumë Skënderbe ose heroi i madh... Marko Bocari është nga Shaipëria e Jugut. Ai me një guxim që rrallë takohet në analet e betejave, di ta llogaritë më pak numrin se sa trimërinë e kolonës së tij të formuar prej një mijë

shqiptarëve. Markua, si piloti që njihet më mirë në stuhi, shkëlqeu më tepër në virtyt. Virtyti i tij është virtyti i yllit të mirë të shqiptarëve, gjenia ushtarake e Shqipërisë. . .¹⁾

Sipas gojëdhënavë, Markua ishte gojëmbël dhe i dashur, kur flitte të binditte, nuk lejonte kurrë shkelje në çështje themelore; ishte i gjatë, i fortë dhe i pashëm.

Kapedan Marko së bashku me trimat e tjerë të Sulit u hodhën përfundimisht me Ali pashën, kundër pushtuesit osman dhe qëndruan me tepeleñasin deri në fund. Të shumta janë heroizmat e luftëtarëve të Sulit kundër forcave turke të Hurshid pashës. Këta luftëtarë për mbrojtjen e pashallëkut shqiptar treguan sakrifica të mëdha. Edhe mbas vdekjes së Aliut, trimat e Sulit e vazhduan luftën e tyre kundër pushtuesit osman. Siç dihet, udhëheqësit e kryengritjes greke, mbasi u siguruan se Ali pashë Tepelena ishte zhytur thellë në luftën e tij kundër Turqisë dhe të bindur se forcat e Aliut u angazhuan të rësisht në luftë me hordhitë e shumta osmane, gjetën rastin më të përshtatshëm dhe shpallën luftën e tyre kombëtare, për çirimin e Greqisë nga pushtuesi turk.²⁾ Populli grek, në luftën heroike për çirimin e atdheut të tij nga hordhitë turke pati një ndihmë të madhe nga shqiptarët.

1) Odoardo Valio. «Marco Bozzari». (Ceni) Acerra 1897. Revista Italo-shqiptare «Ili i arbëreshëvet». Biblioteka komb. I, 299.

2) Dihen botërisht këngët popullore, që rapsodët e hershëm grekë në shenjë mirënjojje i kanë kushtuar pashait shqiptar Ali pashë Tepelenës:

«O shqiptarë të dëgjuar,
Ku e kini Ali pashën,
Që ishte nga Tepelena...
Krenarinë e shqiptarisë,
Dhe kokën e Rumelisë,
Shqiptarë, o shqiptarë,
Ju lumi të pushka...»

Bijtë e Shqipërisë ishin të bindur së Perandoria osmane ishte armik i përbashkët i grekëve dhe i shqiptarëve. Konkretisht, luftëtarët e Sulit mbas vrasjes së Aliut (më 5 shkurt 1822) u vunë përsëri nën udhëheqjen e kapedan Marko Boçarit, i cili së bashku me këta trima u hodh në pjesën perëndimore të vilajetit të Janinës, forcoi Llakat e Sulit dhe andej u hodh në Pesë Puset. Në këtë kohë një divizion i madh turk doli në vendin e quajtur Pllakë. Ky divizion rrezikonte krejt krahun nga ndodheshin forcat e Sulit. Ishte data 30 qershor 1822. Markua edhe pse kishte forca të pakta, nuk pyeti për hordhitë e shumta osmane, por u hodh në sulm dhe me taktikën e tij tradicionale, të befasishme, natën, duke qëlluar armikun në pikë të ndryshme, e pengoi ushtrinë osmane.¹⁾

Ja himni i Marko Boçarit, që kemi mundur të gjejmë të përkthyer italisht nga patriotët arbëreshë të Italisë:

Himni i Boçarit

Në brez kemi shpatën,
Në dorë pushkën,
Vëllezër bashkim,
Për inat të turkut,
O të lirë, o të shuar...
Duke kënduar luftojmë,
Skënderbeu vështron,
Ç'kërdi po bëjnë,
Bijt e trimave,
Ç'goditje tani japid,
Vështron flamuret,
E turqëve të rrëmbyer...
Në Azi otoman,
Dil jashtë Evropës...»¹⁾

1) Revista «Hylli i dritës». Artikulli «Mark Mboçari». Tiranë, 1939, nr. 8-10, fq. 379-389.

Odoardo Valio. Vep. cit.

Të paharruarë do të mbeten në histori betejat e shumta plot trimëri dhe vetëmohim, që zhvilluan suliotët gjatë vjetëve 1822 dhe 1823, në veçanti ato që lidhen me mbrojtjen e Mesollongjit, ku llogoret e këtyre bijve të Shqipërisë, me plot të drejtë u quajtën nga të huajtë «bastionet e Skënderbeut», mbasi asnje prej tyre nuk lëvizi nga istikami i parë i luftës për mbrojtjen e këtij qyteti. Më kot u mundua gjenerali i sprovuar i ushtrisë turke Musa beu për ta hedhur në dorë Mesollongjin. Sipas një kënge të vjetër popullore:

«... Në Mesollongjë të shkretë,
Vate Musa beu vetë,
Vate Musa beu vate,
U përkul kordha xhelate,
Mbenë taboret në tabje,
N'ato tabje plot pëllëmba,
Luftojn' e s'u tundej këmba.
C'kishin lindur ato nëna,
Kishin pjell' e bërë drëra...»

Dhe me të vërtetë, para trimave shqiptarë të Sulit u përkul kordha e xhelatëve osmanë. Atje luftuan bijtë e nënave suliote, të cilat «kishin pjellë e bërë drëra», për t'ua thyer pallén dhe kokën pushtuesve gjakatarë osmanë, që kërkonin akoma të mbanin në robëri popujt e shumëvajturi të Ballkanit.

Tradita shqiptare tregon se në luftën kundër agresorëve turq kanë luftuar dhe gratë e Sulit. Historianët shpjegojnë se në haremët e sulltanit, gjatë gjithë kohës së ekzistencës së tyre, nuk dihet të ketë patur vajza suliote, aq shumë të përmendura për bukurinë e tyre të rrallë. Edhe sot e kësaj dite përmendet bukuria e tyre e rallë nëpër këngët tona popullore, si ajo e vajzave suliote të fshatit Kardhiq të Sulit:

«... Zura një mike suliote,
Naze-naze puna jote,

Moj leshverdha Kardhiqote, . . .

Me gajtan ja mata mesnë,

Në Janin' ja bleva breznë. . . »

Bijat e Sulit sa trimëresha aq dhe të bukura nuk ishin kanarina që futeshin kollaj në kafazin e sulltanit. Këto sokolesha ishin mësuar të këndonin dhe të vallzonin të lira në ajrin e pastër të malësive të Sulit dhe dinin të vdis-nin me nder kur ishte puna për mbrojtjen e lirisë së tyre. I paharruar ka mbetur vetëmohimi i vajzave suliose të Zallongut, që u hodhën nga shkëmbinjtë për të mos rënë në duar të armikut:

“. . . Vashat tonasuliote,

*S'e lleksën robërinë**

U lidhën dora-dorës,

U hodhën në greminë. . . »

Komanda e udhëheqjes së kryengritjes greke për t'i afruar trimat e Sulit, i dhuroi kapedanit të tyre, Marko Boçarit, diplomën e gjeneralit, por ai në një mbledhje me luftëtarët e tij të Mesollongjës, doli përpara tyre dhe e grisi diplomën duke u dhënë të kuptojnë se ai është shqiptar, dhe se titujt e gradat do t'ia japi vetëm mëmëdheu i tij dhe askush tjetër.¹⁾

Gjatë vitit 1823 sulmet e hordhive osmane u shumë-fishuan. Nga të gjitha anët vinin trupa të freskëta turke. Ja çfarë shkruan luftëtarri Marko Boçari nga Sovollaku më datën 3 gusht 1823: «Armiqtë përparuan. . . pushtuan Aspropotamin dhe Agrafën, robëruan dhe therën shumë prej banorëve. Ata që shpëtuan prej mërisë së tyre u fshehën nëpër thellësirat e Sovollakut, në Zygon dhe në-për viset e tjera. Ne dolëm në pritje dhe kemi qëndruar në viset e Karpeneshit. . . »²⁾

*) S'e lleksën — Nuk e pranuan.

1) Revista «Hylli i drithës». «Mark Mboçari». Art. cit.

2) Po aty.

Nga fundi i muajit korrik 1823 ushtri të shumta osmane u nisën në drejtim të Mesollongjit, ku ishte përqendruar qendra e kryengritjes së këtyre krahinave. Stambolli i kishte dhënë kompetenca të mëdha Mehmet Reshit pashës pér shtypjen e kësaj kryengritjeje. Porta e Lartë në këto ekspedita kishte mobilizuar forca nga të gjitha anët e krahinave të saj perandorake si: thrakas, boshnjakë, etj. të udhëhequr nga Mustafa pashë Bushati, i cili kishte marrë me vete dhe bajraktarët e Mirditës, Prenkë Lleshin dhe Llesh Ziun së bashku me forcat e tyre¹⁾

Më 5 gusht 1823 pararoja turke arriti në afërsi të Karpeneshit. Hordhitë osmane kishin ardhur me urë në dorë. Kudo digjeshin shtëpitë dhe të mbjellat. Komanda osmane e tërbuar nga disfatat e saj të mëparshme, kishte dhënë urdhër të prerë pér pushtimin me çdo kusht të Mesollongjit. Sipas këngëvë popullore sulioje:

*«... Pashai me mirjallanë,
U mblohdhën e bënë divanë, *)
Për ndë Mesollongj' e kanë...
Në Karpenesh vun' bajraknë,
Karaullë në çdo anë...»²⁾*

Këngëtari popullore kalon matanë frontit dhe hidhet në Mesollongjën kryengritëse të rrethuar:

*«... Mesollongja i dëgjon,
Zuri vajin e vajton,
Kapetanëtë kërkon,
Shqipëtarëtë vështron...»³⁾*

1) Revista «Hylli i drithës». «Mark Mboçari». Art. cit.

*) Divan (fjalë turke) kuvend.

2) Arkivi i Institutit të Folklorit. Dosja e Mexhit Kokalarit. Mbledhur nga bibliografi e huaj. Më tutje do të citohet: AIF (Dosja I, M.K.).

3) Po aty.

Mesollongjia në atë kohë ka qenë plot me shqiptarë suliotë, të cilët rapsodi popullor i quan «shahina» (turqisht — skifterë). Nën udhëheqjen e kryetimit të tyre Marko Boçari, ata u ngritën të gjithë në këmbë përmbrojtjen e Mesollongjit. Të shumtë ishin dhe trimat e tjerë që erdhën nga Suli si Kiço Xhavella, Llambro Bejkë etj. Në vazhdim të këngës popullore:

«... Ishin brenda shqipëtarë,
Shahina trima me pallë,
Nga Suli u ngren' e vanë,
Me dyfek me jataganë...»¹⁾

Forcat e shumta turke kishin arritur në vendin e quajtur Kombot. Ato ishin pajisur me armët dhe mjetet më moderne të kohës. Sipas folklorit të Sulit:

«... Kur u hodhën tek Komboti,
I dëgjoj Marko Sulioti,
Dhe thirri Dush Bajraktarë,
Që kish nga trimat e parë...»²⁾

Zbuluesit e Markos vrojtonin vazhdimisht çdo lëvizje të forcave osmane. Ata ditën të futeshin në brendësi të ushtrisë së pushtuesit dhe të merrnin të dhëna të sakta mbi numrin e ushtarëve dhe mbi armatimin:

«... Erdhën Markos dhe i thanë,
— Njëzetmijë gjithë janë.
E thirri Dushin mënjanë:
— Po trimat tanë sa janë?
— Treqind, veçse kapetanë...»³⁾

1) AIF (Dosja I, M.K.).

2) Ilo Mitkë Qafëzezi, «Marko Boçari edhe Lezh Ziu i Mirditës». Gazeta e Korçës, dt. 30 janar 1932 dhe vijues.

3) Po aty.

Sipas historianëve, duke mos llogaritur forcat greke, luftëtarët suliotë ishin rrëth 1700 vëtë, ndërsa ushtria osmane figuronte në 15 mijë veta, kurse në këngët popullore dhe në të dhëna të tjera bibliografike turqit janë mbi njëzet mijë ushtarë. Sidoqoftë, si nga burimet historike, a-shtu edhe nga folklori del se forcat osmane ishin më të mëdha në numër. Ja si u përgjigjet luftëtarëve suliotë trimi i Sulit, Marko Boçari:

«... Vërtet nuk jemi shumë,
Por do bëjmë një punë,
Ju të hidhi anembanë,
Se un' do të vrash pashanë.
Ta dëgjojë dhe sulltani,
C'është Marko Kapetani...»¹⁾

Kapedan Marko, mbasi u përllesh me një pjesë të ushtrisë turke, që kishte dalë në Mandrë, u hodh në Karpenesh të Mesollongjit. Atje, forcat e shumta osmane kishin ngritur çadrat e tyre.

Ishë data 8 gusht 1823. Luftëtari Marko Boçari, sipas taktikës tradicionale suliove, e fillooi sulmin natën. Le t'ja japim fjalën dokumentacionit arkival «Rema» (zari fi 2124. Nr. 3592) ku përshkruhen me hollësi ngjarjet e Karpeneshit:

«Hordhia... arriti në Karpenesh dhe andej përgatitej të sulmonte Mesollongjin. Marko Boçari mori me vete 1700 luftëtarët e tij dhe arriti në urat e Tartarit. Nga mesi i natës u hodh në sulm mbi ata, si Leonidha i dytë (heroi i Spartës së dikurshme — M. K.). Kërdia dhe dëmi që u bëri në të vrarë dhe në të plagosur ishë i madh, i papërshkruar. Dy mijë të vdekur mbetën në fushën e luftës, të plagosurit ishim të panumërt, robër 3500 vëtë, plaçkë lufte: 300 atllarë, 80 mushka ngarkuar me ar, armë, ushqime, peksimadhe dhe miellra të mjaftha. Markua, duke komanduar me trimëri, vraponte si luan i zëmëruar

1) Ilo Mitkë Qafëzezi, «Marko Boçari edhe Lezh Ziu i Mirditës». Gazeta e Korçës, dt. 30 janar 1932 dhe vijues.

dhe hidhej me furi, duke i bërë déme të mëdha armikut. Marko Boçari arriti një fitore të shkëlqyer, të pa dëgjuar ndonjëherë... »¹⁾

Tradita popullore tregon se trimat e Sulit kishin mundur të bisedonin fshehtas edhe me luftëtarët shqiptarë, që ndodheshin matanë frontit, nën komandën turke. Konkretisht kapedan Markua u kishte bërë thirrje shkodranëve dhe mirditorëve, që të mos qëllonin mbi vëllezërit e tyre suliotë, që ishin bashkatdhetarët e tyre, të një gjaku, të një nëne.

Janë mjaft interesante përpjekjet e Marko Boçarit për të ardhur në marrëveshje me kordhëtarët shqiptarë, që turku i kishte radhitur në rreshtat e tij:

«... Ngadale, o kordhëtarë,
Bam mos bëni as mënjanë,
Folni shqip me shqipëtarë,
Se do flas un' me shkodranë...»²⁾

Luftëtarët e Sulit, në pamundësi të arritjes të një marrëveshjeje me forcat e Mustafa pashë Bushatit, vunë në jetë taktilën e tyre tradicionale luftarake. Kapedan Marko Boçari në mbrëmjen e datës 9 gusht 1823, vendosi të goditë në befasi komandën turke.

Sipas këngëve popullore çame, Markua nga treqind luftëtarët suliotë zgjodhi gjashtëdhjetë nga më trimat, dhe bashkë me ata u nis midis errësirës së natës në drejtim të çadrës së pashait:

«... Gjashtëdhjetë eni pranë,
Do zëm' për mjekre pashanë,
T'i ndrojmë din e imanë...»³⁾

Ky udhëheqës i suliotëve së bashku me kapedan Dushin me shokë, arriti në afërsi të çadrave të komandës

1) Revista «Hylli i dritës». «Mark Mboçari». Art. cit.

2) Ilo Mitkë Qafëzezi. Vep. cit.

3) Po aty.

osmane. Ata deshën të vrisnin së pari komandantin e përgjithshëm të hordhive osmane, por atje shqiponjat e Sulit ngatërruan çadrat e pashait. Ja çfarë thotë kënga e vjetër suliose për Markon:

«... *Shkoi Markua si mbret,
Pashanë kërkon e s'flet,
Ndë çadëre nuk e gjet,
Zu për mjekre një lanet,
Duke hequr po bërtet...* »¹⁾

Në këtë kohë luftëtarët e Sulit edhe pse ishin veshur si shkodranë e mirditas, u diktuan nga karaullët (rojet). Përleshja u zhvillua e ashpër. Kudo dëgjohej vringëllima e jataganit dhe e hanxharit, që binte midis errësirës mbi kokat e luftëtarëve. Nga të gjitha anët vinin britmat dhe rënkimet e të plagosurve si dhe «ja-jatë», sokëllimat e zakonshme luftarake të shqiptarëve. Trimat e Sulit, pa marrë parasysh forcën e madhe luftarake të kundërshtarit në armatime dhe në numër, hynë në një luftë të pabarabartë me forcat e sultani. Qartë e pasqyron rapsodi suliot thirrjen luftarake të kapetan Marko Boçarit:

«*O burra, o shqipëtarë,
Trima shahina me pallë,
Vrini karaull' e parë,
Vrini sa shihni me sy,
Bini si ulqët mbi dhi...* »²⁾

Në këtë betejë, brenda në kampin e armikut Markua printe i pari. Me jatagan në dorë dhe me leshra të shpalosura ai brindhte anembanë çadrave të shtabit turk. Të shumtë ishin sejmenët e pashait osmanlli që iu vunë pas trimtit

1) Ilo Mitkë Qafëzezi. Vep. cit.

2) Po aty.

të paepur, por ndjekësit kafshuan tokën me dhëmbë nga jatagani i tij.

Gjatë kësaj kohe e gjithë ushtria osmane ishte ngritur në këmbë. Kudo dëgjoheshin daullet dhe britmat e çjerra plot tmerr në gjuhë të ndryshme të ushtarëve nga kombësítë e shumta të Perandorisë së madhe Osmane.

«... Se ç'u ngritën nëpër gjumë,

Turqit që qenë shumë.

Po qysh do të bëhej halli,

Luftonte palla dhe stralli,

Po goditeshin në kokë,

S'dinin cilët janë shokë...»¹⁾

Në këto luftime të përgjakshme natën, në mes të errësirës, brenda në shtabin e armikut, kapedan Markua u rrethua keqas në kohën që sulmonte nëpër çadrat kryesore të komandës turke. Kjo shqiponjë e paepur e Sulit u qëllua për vdekje në kokë nga roja zezake, besnik i pashait:

«... Një arap me karabinë,

U ul e i shtroi synë,

Goditi bajrak e mirë,

Marko Boçarë shahinë...»²⁾

Me forcë të madhe emocionale pasqyrohet akti i fundit i këtij biri të shtrenjtë të Shqipërisë në revistën «Ili i arbëreshëvet»:

«... Marko Boçari nuk nguroi, kur mori vesh se mundësia e fundit ishte që të siguronte me sakrificën e ekzistencës së vet dafinën e flijimit, që ishte një me lardinë dhe tek kjo masë e fundit u kap. Ai, pa u menduar dy herë, me guxim, si një pasardhës i denjë... i Skënderbeut... pasi e shqetësoi disa herë armikun me sulme, më në fund,... në krye të treqind pasuesve u fut në rradhët

1) Ilo Mitkë Qafëzezi. Vep. cit.

2) AIF, (Dosja I, M.K.)

e turqëve dhe, mbasi i sulmoi, vrau dymijë, me tetë udhë-heqës të tyre. Të tjerët i shtrëngoi të iknin, por ... ndërsa Markua u jepte shenjën të tjerëve për sulmin përfundimtar, atë e goditi një plumb në kokë dhe ra gjysmë i vdekur... »¹⁾

Kapedan Marko Boçari u qëllua përpëra në ballë, «atje ku vritet luani» — siç thotë populli, mbasi shpinën atij nuk ia kishtë parë kurrë armiku. Ky luftëtar ra i plagosur rëndë në krahët e kapedan Dushit. Sipas vargjeve popullore, ja me çfarë fjalësh iu drejtua Marko Boçari shokëve të tij të luftës, në çastet e fundit të jetës:

«... Briti: vëllezër shqipëtarë,
Bini qënet se më vranë,
Mermëni se jam i gjallë,
Më mori plumbi ndë ballë... »²⁾

Rreth trimit të plagosur rëndë, u ngrit një mur i pakapërcyeshëm me gjokset e bùrrave suliotë. Ata u pérleshën fyt më fyt me sejmenët e pashait dhe nuk e lanë trimin e plagosur në duar të pushtuesit osman:

«... Tërë trimat c'u ngulë,
E bënë sa doli ujë,
Djemt' e Sulit me vulë,
Shahinë mbë dor' e prunë,
Mu ndë Mesollongj' e shpunë,
Mesollongja u helmua,
I derdhi lotë si krua... »³⁾

Dihet botërisht kontributi i madh që kanë dhënë përçlirimin e Greqisë trimat e Sulit dhe arbëreshët e Greqisë. Sipas dokumenteve historike të arkivit «Rema» ja si shprehen historianët grekë për këtë kapedan shqiptar:

1) Odoardo Valio. Vep. cit.

2) AIF, (Dosja I, M.K.)

3) Po aty.

«... Marko Boçari u vra në këtë luftë. Ai ishte mburoja e kombit tonë dhe tmerri i armikut»¹⁾

Vdiq gjatë rrugës në krah të shokëve të tij të armëve. Mesonllonga e priti krahëhapët mbrojtësin e saj.

«... Mesollongjë ndaj të thonë,
Ku e ke Marko Sulonë,
Që luftoi si pat' zakonë,
U vra me kordhë në dorë...»²⁾

Në Mesollongjë u shpall zia. Trupi i këtij trimi hyri në qytet i mbajtur në krahë nga 12 komandantë të vjetër suliotë. Rrugët qenë shtruar me dafina dhe lule e në çdo pesë minuta zbrazeshin topa nga kështjella. Trupi i tij u vendos për t'u vizituar në pallatin e ish-qeveritarit turk të Mesollongjit. Atë e rrethuan komandantët dhe ushtarët e tij më besnikë. Edhe sot kujtohen në mbarë Shqipërinë e Jugut vajtimet e nënave suliote për birin e tyre të shtrenjtë, Marko Boçarin. Fjalët më të shtrenjta u shprehën gjatë fjali meve për këtë luftëtar shqiptar nga krahina e Sulit. Ja disa pjesë të shkëputura nga fjalimet e udhëheqësve të kryengritjes greke: «... E gjithë Greqia e njohu Marko Boçarin, «Leonidhën e dytë» dhe u hidhërua tepër nga vdekja e tij... Clodhu, o trim... Të goftë i lehtë dheu, o shqiponjë e Sulit». Ky trim u varros në kishën e Shën Mërisë, që ndodhet në afërsi të kështjellës.³⁾

Mbi varrin e Marko Boçarit, përpëra përfaqësuesve të qytetit u betua lordi Bajron, se do të eci në gjurmët e këtij çlirimtari dhe do të japë dhe jetën po të jetë nevoja në luftë për débimin e pushtuesit osman nga këto vende. Mbi varrin e kësaj shqiponje të Sulit u ngrit edhe një përkujtimore e gdhëndur në mermer nga skulptori i famshëm francez David Ndazer.⁴⁾

1) Revista «Hylli i dritës», «Mark Mboçari», Art. cit.

2) AIF, (Dosja I, M.K.).

3) Revista «Hylli i Dritës» «Mark Mboçari» Art. cit.

4) Po aty.

Marko Boçari është himnizuar nga mjaft poetë dhe shkrimtarë të shqar të shekullit XIX, si nga Viktor Hygoi etj. Artistë të ndryshëm italianë kanë pikturuar tablo mbi betejat dhe vdekjen e këtij trimi. Vlen të theksohet veçanërisht vepra e piktorit francez Delakrua, që me tablonë e tij i ka bërë të pavdekshme heroizmat e kryetrit mit suliot.¹⁾

Ky bir i shtrenjtë i Shqipërisë, dashurinë e tij për popull dhe atdhe nuk e ka treguar vetëm me tehun e shpatës nëpër sheshet e betejave, por edhe me gjuhën e tij të mprehtë. Ai na ka lënë një fjalor shqip, me aq dije sa ka pasur, të cilat i ka përfituar qysh në fëmijëri në Sul, nga mësuesi i fshatit murgu Samuil. Këtë fjalor shqip e ka ruajtur me kujdes konsulli i Napoleonit, Pukvili, që ishte në Janinë në kohën e Ali pashë Tepelenës, i quajtur prej Aliut «qafir Pukovili».²⁾

Në fletën e parë të fjalorit shqip të Marko Boçarit janë shkruar këto tri radhë frëngjisht: «Ce lexique est écrit de la main de Marc Botzaris à Corfou 1809 devant moi. Pouqueville», që do të thotë: «Ky fjalor është shkruar me dorën e Marko Boçarit, në Korfuz 1809 përparrë meje. Pukvil.» — Ky dorëshkrim sot ndodhet në bibliotekën kombëtare të Parisit. I është falur kësaj bibliotike nga vetë Pukvili në mai të vitit 1819.³⁾

Fjalori ka një rëndësi të veçantë për dialektin shqip të Sulit dhe përmbarë dialektin çam. Në fjalor janë vënë në dukje sidomos fjalët më të nevojshme dhe më të përdorshme.

Ky është atdhetari i madh Marko Bocari që bashkë me trimat e tjerë të Sulit, u qëndruan me këllëc në hundë pushtuesve të egër osmanë, që erdhën valë-valë pambarim

1) Revista «Hylli i dritës». «Mark Mboçari». Art. cit.

2) Spiridhon Llambros, Gazeta «Estia», 1895. Shih dhe librin e po këtij autori «Logji kai artha». Athinë, 1878-1902 f. 533-538.

3) Po aty. Shih dhe revistën «Hylli i dritës». «Mark Mboçari». Vep. cit

Lufitëtar shqiptar i shekullit të nentëmbëdhjetë



në vendet tonë. Arbëreshët e Italisë të entuziazmuar nga qëndrimi patriotik i këtyre bijve të Sulit ja çfarë kanë shkruar në revistën e tyre: «Ili i arbëreshëvet»: «... Shqipëria... atdheu i Gjergj Kastriotit, i Boçarit dhe i heronjve të tjerë meriton të rifitojë pavarësinë, mbasi është e denjë për një çmim të tillë nga historia».¹⁾

1) Odoardo Valio. Vep. cit., fq. 62.

**TRIMI TJETËR I VEGJELISË SHQIPTARE I RRITUR
NË OBORRIN E ALI PASHË TEPELENËS,
KORDHËTARI I LABËRISË**

Ç E L O P I C A R I

«Çelo Picari me vulë,
Lufton me sultân Mahmunë,
Që ka topa, gjyle shumë,
Dyzet vjet s'e sos barunë...»


Populli

Sipas dokumentacionit historik dhe të dhënave gjore, Xhelili i njohur me emrin Çelo, lindi në vitin 1801, në fshatin Picar të Kurveleshit. Ai ka patur dy mbiemra: emrin e babës Mehmet dhe emrin e fshatit Picar, ndërsa i ati, xhaxhallarët dhe gjyshi i tij, Seferi, kanë mbajtur mbiemrin Bega.

Çelo Picari vinte nga një familje e varfër fshatare me meshkuj të shumtë në fisin e tij.

Çelua ka patur tetë xhaxhallarë të shquar për trimëri në të gjithë krahinën. Bjtë e kësaj dere, luftëtarët si Veliko Jaçe, Latif Elmazi, Kalo Hadëri etj. shumë herë i kishin hapur telashe pushtuesit turk. Jo më kot gjyshin e Çelos, Seferin për tetë bijtë e tij trima, rapsodi popullor e kishte përgëzuar me këngën:

«... Sefer Bega, Sefer Bega,
Kazani me tetë vega...»



Çelo Picari (Sipas vizatimit të piktorit Duro Guri)

Për luftërat që kanë bërë këta trima kundër armiqvë të jashtëm e të brendshëm edhe sot kanë mbetur emërtime vëndesh për kujtim të tyre, si «Buza e Sefer agait», në afërsi të fshatit Luzat etj.

Celua u rrit, ashtu si u rritën gjithë bijtë e këtyre vendeve të thepisura malore, duke bredhur pas dhive, si era e maleve nëpër shkrepat e qafat e këtyre anëve. Ai u mbiqajt nga shokët e tij të fëmijërisë «Çelo bruci», nga që mbante vazhdimisht në krahë një bruc të vjetër, të shkurtër të babait të tij, që mëmë Xhika ia kishte përshtatur trupit fëminor të Çelos. Thuhet se prindërit e Çelos për të ruajtur birin e tyre të vetëm nga hakmarrjet e trashëguara familjare dhe për t'i dhënë djalit shkollë, e larguan nga fshati dhe e vendosën tek miqtë e tyre, në familjen e Mehmet Topullit në Gjirokastër. Atje e diktuat armiqtë dhe u munduan ta vrishnin, por trimi i ri, me trupin e tij të zhdërvjellët, jo vetëm u shpëtoi plumbave, por shtriu të vdekur përdhe dhe dy prej armiqve të familjes së tij. Edhe sot kujtohet nga pleqtë e këtij qyteti të lashtë hani në pazar, ku u zhvillua kjo ngjarje me trimin e ri, Çelo Picarin.

Kordhëtarë i ri për të shpëtuar nga hakmarrja, mendihmën e bashkëfshatarëve të tij mundi të futej në Obo rrin e Ali pashës në Janinë.

Tregojnë se kur Celua hyri në pallatin e vezirit me pallën e të atit në brez kaloi midis dhjetëra rojeve të armatosura dhe Aliu, për të provuar trimërinë e tij përpogi duart e dha urdhër për ta kapur, por Celua nuk u tremb. Ai me gjakftohtësi nxori pallën dhe mori pozicion për vetëmbrojtje me shpatë të xhveshur në dorë. Atëherë veziri buzëqeshi dhe iu drejtua rojeve që ta lini duke thënë «ky bën për mua». Atje Celua mësoi mirë mjeshterinë e luftës dhe u shqua midis fëmijëve të tjera të Oborrit (shqiptarë si Marko Boçari apo grekë si Odhise Andruco, Thanas Dhiako etj., kapedanë të ardhshëm të Gregisë).

Celua dilte shumë herë fitimtar në lojërat ushtarake, që organizoheshin atje. Lëvizjet e tij të zhdërvjellta dhe dora e sigurtë në përdorimin e shpatës ranë në sytë Ali

pashës, i cili, i entusiazmuar për kurveleshasin e vogël, filloi ta thërriste «Çelo palla». Thuhet se Çelo Picari ishte i thjeshtë, i dashur me shokët, mundohej t'i nderonte dhe shpesh i mbetej mbresë, kur ndonjëri prej tyre largohej i zemëruar prej tij. Ai çmonte më shumë shokët e djallërisë me të cilët kishte bredhur me gjysmë opingë në shkrepat e Kurveleshit. Çelua nuk fliste kurrë për trimëritë e tij; kishte një trup të gjatë dhe të bëshëm, të fortë si lisi, të shkathët dhe ishte gjithnjë i gatshëm për be-teja.

Pas disfatës së Ali pashë Tepelenës (5 shkurt 1822), luftëtarë Çelo Picari së bashku me shokët e tij u kthye në Picar, ku arrestuan veglën e pushtuesit, intrigantin Koçi Gramo dhe pas një gjyqi popullor në «Qafë të xhamisë» e pushkatuan në vendin e quajtur «Sheshi i eshtrave» në kufi me Progonatin.

Turqia, mbas shembjes se shtet-pashallëkut autonom shqiptar të Ali pashë Tepelenës më 5 shkurt 1822, dërgoi në Shqipëri me dhjetëra ekspedita ndëshkimore osmane, për të vënë në jetë reformat e saj centralizuese në administratë dhe në ushtri. Vendi ynë paskëtaj do të qeverisej nga administratorë me kombësi turke. Njëkohësisht Perandoria e madhe e osmanëve, si kurse e theksuam dhe më lart, që tashti shkonte drejt thellimit të shthurjes, nuk kishte më interesa të respektonte në pjesën perëndimore të saj privilegjet e krahinave autonome shqiptare si Himara, Mirdita, Suli etj. Në këtë kohë, në Evropë ishin mëkëmbur shtete të mëdha me potencial ekonomik dhe ushtarak të fortë, dhe, sipas Stambollit, këto oaze autonome krahinore mund të kthehen në të ardhmen në pikë mbështetjeje për shtetet e mëdha evropiane, për të sulmuar Perandorinë Turke.

Gjatë kësaj kohe, në Shqipëri, interesat e shtresave popullore u përputhën me interesat e feudalëve opozitarë vendas përsa i përket luftës kundër pushtuesit turk.

Në këto rrethana, popullsia e krahinave jugore të atdheut vendosi t'i përgjigjej pushtuesit osman me grykën e pushkës.

Me objektivitet e pasqyron historiani grek A. Psal-

lidha vlerësimin e drejtë që i bënë shqiptarët gjendjes së asaj kohe në Evropë:

«Shqiptarët, si njerëz të zhdërvjellët që janë, filluan të diskutojnë rreth ngjarjeve të Evropës... Në këtë kohë mund të themi se me gjithë fanatizmin e fesë dhe me gjithë interesat e kundërta që kishin shqiptarët me njëri-tjetrin, u treguan para gjithë botës se ishin tjetër kombësi. Me zgjuarsinë e tyre hynë menjëherë në kuptimin e ngjarjeve dhe i kuptuan ato në mënyrë të drejtë». ¹⁾

Sundimtar i Janinës qysh prej vitit 1825 ishte cak-tuar Mehmet Reshit pasha, i popullarizuar dhe me emrin Qytahiu, i cili u emërua edhe «serasqer i Rumelisë». Ky pasha, nën maskën e amnistisë, mundi të hedhi në dorë shumë luftëtarë të Ali pashë Tepelenës. Një pjesë të mirë i vrau, i burgosi dhe i internoi nëpër vendet e largëta të Perandorisë së madhe Osmane, kurse luftëtarët e rinj të Aliut si Halit Frashërin ²⁾, Myftar Qafëzezlinë nga Kollonja, Çelo Picarin, Veliko Jaçen nga Picari i Kurveleshit, Asllan e Kapllan Kucën nga Progonati, përsëri nga Kurveleshi etj. së bashku me forcat e tyre, i mori me vete.

Komanda ushtarake turke, ish-luftëtarët e Ali pashë Tepelenës i vinte nën një mbikqyrje të rreptë. Ajo nuk kishte besim tek këta komandanët shqiptarë. Oficerët osmanë e kishin akoma të freskët qëndrimin burrëror të këtyre trimave shqiptarë, që së bashku me kapedanët grekë nën komandën e Ali pashës, u kishin dhënë sa herë dërmën hordhive të shumta osmane para dyerve të kalasë së Janinës.

Stambolli e kishte të qartë se shumë prej trimave të rinj shqiptarë si Çelo Picari me shokë ishin rritur në

1) Revista «O neos kuvaras». Athinë, 1966, fq. 140. Material i përkthyer pranë Arkivit të Institutit të Historisë, (Më tutje do të citohet AIH).

2) Sami Frashëri «Kamus ul alami» (Enciklopedi turke) Stamboll 1891, vëll. III, fq. 2282.

oborrin e Aliut së bashku me ata udhëheqës të kryengritjes greke, që tani mbronin Athinën. Nga ana tjetër, Mehmet Reshit pashës i kishte rënë në dorë edhe thirrja e udhëheqësit të përgjithshëm të kryengritjes greke Dhimitër Ipsilantit që u kishte dërguar më parë këtyre komandantëve shqiptarë si: Ago Vasjarit, Çelo Picarit, Myrto Calit etj. për t'u rreshtuar në luftë të përbashkët kundër Turqisë.¹⁾ Të gjitha këto e vështirësonin qëndrimin e kordhëtarëve shqiptarë në kampin turk.

Porta e Lartë, me gjithë titujt që u kishte dhënë këtyre kordhëtarëve si «Kapuçibashë të dergjahut» (roje nderi të Portës së Lartë), nuk mundi kurrë t'i bëjë me vete. Këta trima, me luftëtarët e shumtë të krahinave të tyre, që ndodheshin tashti jashtë atdheut, nën presionin e mësive popullore shqiptare e shpejtuan edhe më shumë largimin e tyre nga kampi ushtarak turk. Çdo ditë vinin lajme të këqia nga Shqipëria. Atje administrimi i vendit kishte kaluar në duar të pushtuesve, taksat ishin rënduar dhe shumëfishuar edhe më shumë në kurriz të popullsisë së varfër shqiptare. Kordhëtarët shqiptarë si Çelo Picari, Veliko Jaçe, Asllan e Kapllan Kuca, Behlul Toto, Halil Frashëri etj. ishin nga të parët që i kthyen forcat e tyre në Shqipëri, në fillim me pretekst së Mehmet Reshit pasha ishte i huaj dhe nuk respektonte privilegjet tradicionale të luftëtarëve shqiptarë në kohë lufte. Në gazetën ruse «Sjevjernaja pçella», datë 11 gusht 1828 thuhet: «Nga fundi i muajit korrik 1828 me mijëra shqiptarë... braktisën frontin dhe iu drejtuan Shqipërisë së Jugut, duke rënë në konflikt të hapur me komandantët turq. Nga përleshjet midis forcave shqiptare dhe atyre turke, këta të fundit (turqit — M.K.) pësuan disfatë dhe nuk mundën të përmbanin shqiptarët që braktisën fushën e luftës greke».²⁾

1) Joannis Filimon. «Dhoqimion historikon peri tris Eleniqis epanastases» Athinë 1859, vëll. IV, fq. 450-451.

2) Cituar sipas L. Mile. Vep. cit., fq. 63.

KUVENDI I MADH NDËRKRAHINOR I BERATIT DHE ORGANIZATA E FUQISHME POLITIKE

«LIDHJA SHQIPTARE»

Opozita antiturke në Shqipëri i vlerësoi drejt pasojat e dëmshme të reformave centralizuese osmane. Ata u bïndën se po të mos i kundërshtonin politikës së re reformnjëse turke, interesat e tyre viheshin seriozisht në rrezik. Nën këto rrethana të krijuara, feudalët opozitarë të Shqipërisë së Jugut (kryesisht elementë që kishin qënë mbështetja shoqërore dhe politike e Ali pashë Tepele-nës), kapedanët e fshatarësisë dhe të malësorëve e ndjenin më se të nevojshëm bashkimin e tyre për të ruajtur autonomitë e tyre krahinore të cënuara nga reformat centralizuese osmane, autonomi që kishin fituar elemente të reja të ndërgjegjshme kombëtare qysh për sundimit të Ali pashë Tepelenës, (ku ishte siguruar de faktō vetë-geberisja e vendit nga sundimtarët vendas).

Qëndresa e shqiptarëve kundër Stambollit nuk do të kishte sukses në qoftë se këta do të ishin të përqarë midis tyre. Opozita feudale e kishte të qartë se përballë saj qëndronte Perandoria e madhe Osmane, dhe se nuk ishte lehtë t'i kundërviheshe reformave skillavëruese të tyre, intrigave dhe fuqisë së madhe ushtarake të saj. Prandaj udhëheqësit opozitarë antiturkë në Shqipëri e ndjenin të nevojshme të mblidheshin së bashku për të patur unitet mendimi dhe veprimi kundër reformave centralizuese osmane. Për këtë arsyen një sërë krahinash shqiptare: Vlora, Tepelena, Delvina, Çamëria, Mallakastra e Sipërmë dhe e Poshtme, Skrapari, Tomorica, Dëshnica, Kurveloshi i Sipërmë dhe i Poshtëm, Kolonja, Leskoviku etj. dërguan në Berat krerët e tyre, opozitarë me Portën dhe më datën 7 nëntor 1828 organizuan një kuvend të madh

ndërkrahinor nga e cila doli organizata politike «Lidhja Shqiptare»¹⁾ nën kryesinë e Zylyftar Podës, Ismail bez Vlorës dhe Shahin Delvinës, krerë feudalë opozitarë me Stambollin, të dëgjuar dhe me influencë në mbarë vendin tonë.

Drejtuesit e këtij kuvendi të madh ndërkrahinor që kishin arritur qysh më parë (me anën e Shahin Delvinës) në Korfuz dhe një marrëveshje mossulmimi me qeverinë greke të Kapodistrias, morën këto vendime:

- 1) Të mos i japid ushtarë Turqisë.
- 2) Të dëbohen qeveritarët turq nga krahinat e tyre dhe vetë shqiptarët të qeverisin vendin.
- 3) Shqiptarët marrin përsipër t'i mbrojnë vetë tokat e tyre në qoftë se do të sulmohen nga njësitë e forcave greke ose franceze (sipas pretendimeve turke).
- 4) Shqiptarët nuk do t'i ndihmojnë më turqit në qoftë se futen në luftë me kryengritësit grekë, konkretisht në Tërhallë, në Ageos, në Jenisher dhe Mesollongjë.²⁾

Në këtë kuvend ndërkrahinor u vendos që luftëtarët t'i mbante me bukë, me fishekë dhe me duhan sanxhaku i Vlorës dhe i Delvinës.

Serasperi i Rumelisë Mehmet Reshit pasha, i alarmuar nga kjo mbledhje e madhe e shqiptarëve, u orvat të përqante unitetin e tyre. Ai dërgoi në Berat dy nga krerët shqiptarë, që kishte mundur t'i bënte me vete: Suliman bez Konicën dhe Tahir Abazin (nga fshati Dragot i Tepelenës), të cilët u dorëzuan drejtuesve të kuvendit bujurulltitë (ftesat) e serasqerit. Në këto ftesa u bëhej thirrje shqiptarëve që t'i shkonin sa më parë në ndihmë Mehmet Reshit pashës, pasi (sipas tij): «Shqipëria rrezi-

1) Revista «O neos kuvaras». Athinë, 1966, fq. 141 dhe 146 (material i përkthyer pranë AIH).

2) Basbakanlik Arsivi, Istanbul, Fondi Hatt-i Humayun Defter Nr. 1, 3, 12, 24, — 31, vesika 21513-1 (më tej do të citohet BAI, F, H, — H. Def. nr. 1, 2, 12, 12, 24-31, vesika).

kohej nga kryengritësit grekë të kryeministrat Kapodistrias dhe nga qafirët francezë». ¹⁾

Feudalët shqiptarë opozitarë me Portën e Lartë dhe krerët e fshatarësise dhe të malësorëve, që merrnin pjesë në këtë kuvend ndërkrahinor iu përgjigjën kështu serasqerit: «Përgjigjemi ne po të vijnë gjaurët» (forcat greke dhe franceze — M.K.). Më tutje këta krerë opozitarë, anti-turkë, janë shprehur: «Vezirit, (serasqerit) po t'i mbeten duart të lira do të na shkuli zemrën me njerëzit e kombit tonë (me tradhtarët — M.K.) që ka bërë me vete dhe do të na futë në disiplinë, prandaj të dëbohet serasqeri dhe kushdo që do ta zëvendësojë ta detyrojmë të largohet dhe ne t'i marrim frerët». ²⁾

Është shumë interesant raporti sekret i renegatit shqiptar dhe pjesëmarrësit në kuvend, Sulejman bez Zharkanxit, i vënë në shërbim të agjenturës turke. Ja çfarë i raporton ky agjent më datën 13 nëntor 1828 serasqerit të Rumelisë: «Mbledhja e fshehtë e Beratit zgjati tri ditë dhe tre net. Ismail Vlora, Silahdar Iljaz beu (Zylyftar Poda — M.K.) ³⁾ i bënë me vete bejlerët dhe agallarët e grumbulluar. Bisedimet përfunduan të shtunën. Atje u lexua ftesa juaj. U vendos që një mbledhje tjetër të bëhej në shtëpinë e Ismail Vlorës. Atje do të shkojnë përfaqësues nga çdo nahije (krahinë). U vulos një kusht, unë nuk e vulosa...» Ky renegat e përfundon raportin e tij me këto fjalë: «Për Zylyftar Podën, Ismail Vlorën dhe për Shahin Delvinën të mos kini asnjë mëshirë...»

Sulejman bez Zharkanji» ⁴⁾

Të tërheq vëmendjen tmerri që i ka zënë autoritetet turke gjatë kësaj kohe në Shqipëri. Ja një raport i datës

1) Po aty. (Basbakanlik Arsivi....)

2) Po aty. Shih dhe vesika 21513 dt. 11.11.1828:

3) Emri i vërtetë i Zylyftar Podës është Iljaz Poda, i biri i Hysenit nga fshati Podë i Leskovikut, ish-adjuant i Ali pashë Tepelenës me titullin «Silahdar» (mbajtës i armëve).

4) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, 24-31 vesika 21513-J, dt. 13.11. 1828.

27 nëntor 1828 që i drejton Stambollit i plotfuqishmi Mehmet Reshit pasha: «Shqiptarët nuk çajnë kokën pér fe. Ky popull... nuk do të punojë pér din dhe Dovlet... Tani rrëth vetes kam vetëm shqiptarë, mund të më bëjnë atentat, zoti më ruajtë, shteti duhet të vërë dorën... Mua më hiqni këndej dhe emëroni një tjetër». ¹⁾

Qëndrimi i shqiptarëve ndaj Portës së Lartë në këtë kuvend pasqyrohet qartë dhe në raportet e konsujve të huaj, që ndodheshin në Shqipëri në atë kohë. Ja një nga raportet e datës 15 dhjetor 1828, që konsulli anglez Meyer i drejtoi shefit të tij Adam në Stamboll:

«Kongresi i shqiptarëve në Berat mbaroi. Përgjigjja që iu dha serasqerit të Rumelisë ishte e pakënaqshme pér Portën e Lartë. Shumica e komandantëve shqiptarë kanë ruajtur pér veten e tyre një farë pavarësie. Shqiptarët nuk iu përgjigjën thirrjes së serasqerit pér t'i dhënë ushtarë Turqisë...» ²⁾

Fill mbas kuvendit të Beratit, me iniciativën e «Lidhjes shqiptare» u organizuan një sërë mbledhjesh në mbarë Shqipërinë e Jugut. Mbarë popullin e shqetësonte shumë problemi i bashkimit, mbasi pushtuesi osman me anën e intrigave të tij agjenturiale dhe ideologjisë së tij fetare kishte hedhur shumë gurë pér t'i mbajtur të përcara krahinat shqiptare.

Sipas traditës popullore kemi trashëguar një sërë të dhënash rrëth mbledhjeve që janë zhvilluar edhe në Taroninë të Zhulatit, rrëthi i Gjirokastrës, ashtu si ishin mbledhur më parë në Senicë të Delvinës nga mbarë krahinat jugore të atdheut pa dallim feje. ³⁾

1) Po aty, Vesika 21513-G, dt. 27.11.1828. Shih edhe vesikën 21513-F.

2) Revista «O neos kuvaras». Athinë 1966, fq. 141 (Material i përkthyer pranë AIH).

3) AIF. Dosja e dytë e Mexhit Kokalarit. Atje ndodhen dhe personat nga i ka mbledhur autori. Më tutje do të citohet AIF, (Dosja II, M.K.).

Mbledhjet e përmendura më lart, i dëshmojnë dhe këto këngë të hershme popullore:

«Te rrapi në Taroninë,
Se ç'e mblođhi miqësinë...
Gjashtëdhjetë nga Borshi qenë,
Gjithë trima dhe levendë...»

(Shih dhe: Thimi Mitko. «Bleta shqiptare». Vjenë 1924, fq. 113.)

Ja çfarë lexojmë në këtë libër përbledhës të këngëve popullore që flasin për vëllazërim pa dallim krahine e feje:

«E kini dëgjuar,
Apo e kini mësuar,
Kazatë u mbëluadhë,
Po për të pajtsuarë,
Turqit e t'kështerë,
Të gjithë të parëtë,
Bejérat e agallaretë,
Të gjithë bujarëtë,
Kristo Koka në Vuno,
Spiro Gjika Qeparo,
Jani Milua himariot,
Hodo beu i borshiot,
Meledini piqerasiot,
Kusar Aliu lukoviot,
Stefan Prifti shënvasiot,
Edhe Kumiu niviciot,
Dajkua lëkursiot,
Hajdin beu kalasiot,
Dhe Tahiri kopaçiot,
Kallapodhi delvinjot,
Idris agai Zhulat,
Sheh Sejkati në Filat,
Zoto Mahmuti Smokthinë,
Igumeni Katerinë,

*Maza përitet ndë Sinicë *)*
U thotë Idriz agai:
 — *Mbani vesh, o kapedanë,*
Dhe ju bejra o agallarë,
*Të madhe ju bëni rixhanë, **)*
*Ta lidhim mirë ixhanë, ***)*
Se gjithë trimat u vranë...
Vritten shok' e vëllamë,
Gjithë miq edhe fshatarë,
Gjithë fis e gjithë farë».

Për shtrirjen e rrënjeve të «Lidhjes shqiptare» në drejtim të krahinave Juglindore dhe Veriore të atdheut, një rol me rëndësi ka lojtur dhe udhëheqësi i guximshëm i opozitës feudale shqiptare Zylyftar Poda. Sipas histroshët. Zylyftari ishte njeri largpamës dhe shquhej në veprimtarinë politike.¹⁾ Ai ishte përkrahës i orvatjeve që bëheshin për forcimin e aleancës ndërmjet toskërisë dhe Bushatlinje të Shkodrës. Ai ka pasur si krah të fortë dhëndërën e tij, Asllan Kucën nga fshati Progonat i Kurveleshit, i biri i Agos (ish-vulëmbajtësi i Ali pashës). Historiografët francezë dhe anglezë kanë shkruar se «Asllan Kuca ka qënë një djali i pashëm, trim dhe që i pëlgente muzika, vera dhe lufta. Ai kishte trashëguar nga i ati i tij, Agua pothuaj një të katërtën e thesarit të Ali pashës... Asllani donte të sundonte në Shqipëri me shqiptarët e tij. Ai vazhdimiشت i shmangesh disiplinës (turke — M.K.) që e bënte qojele...» Ky kordhëtar i ri, nën

* Mbledhja u bë në Senicë (fshat në afërsi të Delvinës).

**) Lutjen (kërkësen) ta bëjmë të fortë.

***) Ta lidhim mirë pajtimin.

1) Eugene Poujade. «Chretiens et Turcs». Paris 1859, fq. 155. David Urquhart. «The spirit of the East». Londër, 1839, vëll. I, fq. 241.

Cyprien Robert. «La péninsule Greco-Slave et Les Albanais». Paris, 1844, vëll. II, fq. 158.

ndikimin e vjehrrit të tij (Zylyftar Podës), me forcat e tij shumëmijëshe i bënte vazhdimisht presion Stambollit që të hiqte nga Shqipëria reformat e tij skllavëruese.¹⁾

Një kordhëtar tjetër i Labërisë ishte dhe Veliko Jaceja, i biri i Jaçe Mahmudit nga fshati Picar i Kurvelleshit, nga fisi Seferanj (djali i xhaxhait të Çelo Picarit). Ai, në atë kohë, urdhëronte forca të shumta. Historianët e huaj kanë shkruar se Velikoja ka qënë shumë trim, se ai nuk e përfillte jetën dhe dinte t'u dilte punëve ndanë.²⁾

Ky trim gjithnjë përpinqej të shuanë hasmëritë e vjetra, e për këtë qëllim dérgoi si peng në derën e Zylyftar Podës dy djemtë e tij të mitur.

1) E. Poujade. Vep. e cit., f. 156.

2) Po aty, fq. 155.

Shih dhe: Raportin e konsullit francez në Selanik dr. St. Sauveur M. Y. Turquie, vëll. 259, dok. nr. 3, dt. 14.7.1830 (material i përkthyer pranë AIH)

— BAI, F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21513-A, dt. 22.4.1828.

— Po aty, dt. 15.12.1828.

MASAKRAT TURKE TË JANINËS DHE TË MANASTIRIT

(5 janar 1829 — 9 gusht 1830)

Porta e Lartë, e vënë në dijeni për aktivitetin anti-turk të kërëve opozitarë shqiptarë, vendosi t'i zhdukë sa më parë ata. Për këtë qëllim ajo kurdisi një lojë. Shpalli sikur gjoja sulltani nuk ishte i kënaqur nga veprimtaria e Mehmet Reshit pashës, meqenëse ai nuk kishte vepruar sipas udhëzimeve të Stambollit gjatë fushatave të tij në Shqipëri dhe se gjoja Porta e Lartë kishte vendosur që administrimi i krahinave shqiptare t'u kthehej shqiptarëve, duke respektuar përsëri autonominë e tyre të dikurshme. Me qëllim simulimi, sulltani emëroi vali të Janinës Zylyftar Podën, ndërsa sundimtar të Beratit emëroi Ismail Vlorën. Ata u thirrën zyrtarisht të shkonin në Janinë.

Zylyftar Poda dyshoi për kurthin e ngritur, ndaj dhe nuk u paraqit fare në Janinë, ndërsa të deleguarit të serasqerit të Rumelisë Abdullah efendiut dhe suitës së tij, trimi i zgjuar i Podës iu përgjigj se e pranonte me kënaqësi urdhëremërimin e sulttanit, por meqenëse ishte me shumë punë do të shkonte tek Mehmet Reshit pasha disa ditë mbas paraqitjes së Ismail Vlorës në Janinë.¹⁾

Ismail Vlora thuhet se u vu në dijeni për këtë kurth nga Zylyftar Poda, Çelo Picari (Xhelil Mehmeti) dhe Tafil Buzi, por ai duke pasur besim. në trimat e shumtë shoqërues të tij, e pranoi ftesën e serasqerit dhe shkoi në Janinë. Më datën 5 janar 1829, Ismail Vlora, duke hyrë

1) Sipas L. Mile. Vep. cit., fq. 65, 105. E. Poujade. Vep. cit., fq. 155.

në sarajet e serasqerit në Janinë u qëllua tradhtisht nga pas me dy kobure. Së bashku me këtë udhëheqës të opositës antiturke të mbarë krahinës së Vlorës u vranë dhe trimat shoqërues të tij me në krye Halil Hysenin me shokë.¹⁾

«Qaj moj Vlorë, qaj Kaninë,
Ismaili shkoj n'Janinë
I dërguan bujurdinë, *)
Të piqet me Rumelinë, **)
Dolën dervenit të prinë,
Tafil' e Xhelili ynë.
— Malo, mos shko në Janinë,
Mos e beso osmanllinë,
Se të kan' ngritur pusinë.
Zylyftari dërgoi kartë,
Ktheu Ismail bej prapë...
Drekënë në Zharovinë,
Darkën brënda në Janinë.
U dhe selamn' e s'ta prinë,
'Smaili u ngjit në shkallë,
Me pashan' ballë për ballë,
Dy kobure pas ja dhanë.
'Smail be, o 'Smail be
Miqësinë ku e le,
Koka tënde në hejbe,
Pse s'more trima të mirë,
Trima si Halil Hysenë,
U vranë bashkë me bejnë»

Ata u grinë të gjithë me thika duke luftuar trup me trup me rojet e serasqerit brenda në oborrin e pallatit të sundimtarit turk.

Koka e prerë e Ismail Vlorës u dërgua në Stamboll dhe u ekspozua në sheshet e tij. Qartë pasqyrohet vrasja

1) AIF. Dosja II e M. Kokalarit.

*) letërthirje, ftesë.

**) sundimtarit turk i Rumelisë.

e Ismail Vlorës në raportin e konsullit anglez Meyer në Prevezë, që mban datën 15 janar 1829:

«Ekziston informata e rëndësishme se udhëheqësit të madh shqiptar Ismail bezë Vlorës iu pre koka në Janinë rrëth datës 5 të këtij muaji.

Ismail bezë Vlora, së bashku me Zylyftar Podën dhe me udhëheqës të tjerë, ishte udhëheqës i aftë i «Lidhjes së fuqishme shqiptare» që vepronë vazhdimisht në vija që ishin në kundërshtim me pushtuesin...».¹⁾

Gjatë kësaj kohe u vranë tradhtisht dhe krerë të tjerë opozitarë shqiptarë si Izet Gjirokastra, Braho Nepravishta etj.

Shqiptarët qysh në fillim terrorit turk iu përgjigjën me terror. Gjatë kësaj kohe opozita antiturke në mbarë Shqipërinë e Jugut me Tafil Buzin (nga fshati Buz-Kalemaj i Tepelenës) me shokë, në përgjigje të vrasjes tradhtisht të Ismail Vlorës vendosi të zhdukë të besuarin e sultani në ushtrinë osmane, Kaftan aganë. Vendimin e zbatoi djaloshi tetëmbëdhjetë vjeçar Zenel Gjoleka nga fshati Kuç i Kurveleshit. Sipas këngës popullore, Gjoleka në atë kohë «spânuar» (pa i dirsur mustaqej), e vrau Kaftan aganë në çadrën e tij midis ushtarëve të shumtë turq:

«*Dërgon Gjolekë spanoi:
— Tafil Buzit të m'i thoi,
Gjoleka s'e turpëroi,
Kaftanazin e martoi,
Me të dyja ç'e qëlloi,
Çau dyzetmij' e shkoi,
Nxori pallën e shpëtoi,...
T'fala i tha ngu 'Smail Vlora,
I ra filxhani nga dora».*

Kryengritja plasi anembanë në këto krahina jugore të atdheut. Gazeta ruse «Sjevjernaja pçella» më datën 30 prill 1829 shkruante: «Sipas disa njoftimeve të shtv-

1) Revista «O neos kuvaras». Athinë 1966, fq. 146 (Material i përkthyer pranë AIH).

pit të marra nga Korfuzi, kryengritja shqiptare po bëhet sa vjen edhe më e gjerë. Shqiptarët siç sigurojnë janë në lidhje me grekët dhe kërkojnë ashtu si ata pavarësinë.¹⁾

Konkretisht Vlora me gjithë rrëthin e saj u ngrit e gjitha në këmbë nën udhëheqjen e vëllait të Ismail Vlorës, feudalit opozitar antitürk Begir bezë Vlorës dhe e çliruan krejt nga turqit krahinën e tyre bregdetare.²⁾ Zylyftar Poda me forcat e tij të shumta iu vërsul Beratit dhe Korçës dhe i çlroi këto krahina nga pushtuesi osman dhe nga veglat e tyre. Beteja të përgjakshme u zhvilluan përmarrjen e kalasë së Beratit. Atje, forcat kryengritëse të Zylyftar Podës, treguan trimëri të rrallë, i mposhtën forcat mercenare osmane dhe vendase të udhëhequra nga Hasan bezë Vrioni. Vendin e këtij renegati në Berat e zuri i biri i Zylyftarit, Hasan Poda.³⁾

Shahin Delvina, së bashku me kapetanët e Bregdetit, Spiro Gjikën nga Qeparoi etj, kishin çliruar krejt bregdetin dhe rrëthin e Delvinës. Këta luftëtarë i mundën keqas në Delvinë forcat e shumta osmane të udhëhequra nga gjenerali i sprovuar turk Çelepi Mehmet pasha. Ushtria e tij e shpartalluar mezi mundi të kalojë qafën e Muzinës dhe e la vrapin në Janinë, e ndjekur këmba-këmbës nga trimat e Shahin Delvinës, të Spiro Gjikës dhe të Janaq Kumiut nga Nivicë-Bubari i Bregdetit. Kordhëtarë i ri i Labërisë, djaloshi 24 vjeçar Asllan Kuca, i përkrahur nga vjehrri i tij Zylyftar Poda, në krye të gjashtë mijë luftëtarëve, mori Thesalinë dhe u shpall sundimtar i saj. Porta e Lartë e trondit, e shpalli Asllanin «fermanlli» (jashtë ligjit); ndërsa luftëtarë tjetër i Labërisë Veliko Jaçe së bashku me djalin e xhaxhait të tij Çelo picarin me dymbëdhjetëmijë luftëtarë çliruan Janinën dhe e mbajtën të rrëthuar në kala sundimtarin e saj të ri, Emin pashën (të birin e Mehmet Reshit pashës).⁴⁾

1) L. Mile. Vep. cit., fq. 65, 103.

2) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21911, dt. 12.9.1829.

3) Po aty, Vesika 2416, dt. 7.9.1829.

4) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 2416, dt. 7.9.1829.

Luftëtarë Asllan Kuca me forcat e tij të shumëfishtuara ra në marrëveshje me Veliko Jaçen dhe i bashkoi forcat që komandonte ai me ato të Velikos. Këto ngjarje i pasqyrojnë historianët e huaj veçanërisht diplomati anglez David Urquhart, i cili ka asistuar gjatë marrëveshjes që bënë këta krerë opozitarë në një han midis Janinës dhe Mecovës¹). Të shumta janë këngët popullore, që vënë në dukje qëndrimin luftarak të këtyre dy trimave, që me forcat e tyre të shumta, mundoheshin të ruanin autonominë e tokave shqiptare:

«Asllan e Veliu dy,
Bo-bo ç'janë të këqij,
Veten e bëjnë beli,
Luftojnë me një vali.
Me një goxha Rumeli...»²)

Janë shumë interesante vlerësimet që i japid konsujt e huaj në atë kohë lëvizjes kryengritëse në Shqipëri. Ata flasin me simpati për kryengritësit dhe për karakterin qëllimtar të kësaj lëvizjeje. Ja çfarë thuhet midis të tjera rash në raportin e konsullit francez dr. St. Sovër të Selanikut më datën 14 korrik 1830:

«Shqiptarët, me në krye Asllan Kucën... morën Ko-zhanin, u dukën në Vodenë, në Niousta, Jenxhe (7 lega nga Selaniku) dhe nuk bëjnë dëme. Lëvizjet kryengritëse në Shqipëri dhe jashtë saj nga popullsia e armatosur e gjithë kësaj krahine, nuk janë shkaktuar nga disa çeta kusarësh, por janë shfaqje të një plani të gjerë, që ka për qëllim të dëbojë nga Shqipëria reformat e sultani, sidomos ato që janë lidhur me sistemin ushtarak. Popull-

1) D. Urquhart. Vep. e cit., vëll. II, fq. 174, 237, 242.

C. Robert. Vep. cit. vëll. II, fq. 199.

E. Poujade, Vep. cit. fq. 156, 157.

2) Botim i Institutit të Folklorit. «Këngë popullore». Tiranë, nr. 56 fq. 134.

sia turke e Maqedhonisë dhe e Thesalisë i sheh ato me kënaqësi dhe i inkurajon».¹⁾

Një rol me rëndësi për të penguar zbatimin e reformave centralizuese osmane në Shqipëri kanë lojtur në këtë kohë kapedanët e fshatarësissë e të malësorëve shqiptarë si Tafil Buzi me shokë. Raportet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Franceze pasqyrojnë qartë qëndrimin patriotik të këtyre trimave, konkretisht të udhëheqësit të fshatarësissë Tafil Buzit, një nga udhëheqësit ushtarak në shërbim të Ali pashë Tepelenës, i cili në vitet 30 të shek. XIX kishte fituar famën si një kordhëtar trim i Shqipërisë. Ai shpalli botërisht në mesin e viteve 30 se Shqipëria duhej të çlrohej nga zgjedha turke dhe të qeverisej prej shqiptarëve.²⁾ Njëkohësisht dhe konsulli i përgjithshëm francez në Shqipëri, me qëndër në Janinë, njoftonte po në këtë kohë ministrin francez të Punëve të Jashtme se: «Autonomia e Shqipërisë është tema e dashur e shqiptarëve». Të gjitha këto tregojnë se ndërgjegjja kombëtare e popullit tonë po bënte një evolucion të ri, se idea përtë fituar autonominë kombëtare me anën e luftës së armatoshur, kundër sundimit të huaj po përqafiohej nga sa më shumë shqiptarë. Ata po fillonin të luftonin për «një autonomi të plotë» që tashmë po zhvishej dora-dorës nga përmbajtja e vjetër anarkike feudale.³⁾

Sultan Mahmudi II në letrën e tij të datës 21 maj 1830 jep këto vlerësimë për shqiptarët: «Sikurse kam thënë gjithnjë, këta të mallkuar shqiptarë, në asnjë rast nuk mund të janë në dobi të shtetit dhe prej tyre nuk

1) Raport i konsullit francez të Selanikut, dr. St. Sovër. (Material i përkthyer pranë AIH).

2) Archives du ministère des Affaires de Max Rayband au ministère des Affaires Etrangères du 8 juin 1835. Sipas L. Mile. Artikull i cituar. Rev. «Studime historike» Nr. 2, 1966 fq. 10.

3) Po aty, P. Chiara, «L'Epiro, gli Albanesi è la Lega». Palermo, 1880, fq. 103.

mund të pritet asnjë interes i favorshëm. Ata janë dhe do të jenë faktorë të shumë dëmeve. Kjo është një pikë e veçantë dhe e rëndësishme që kërkon të studiohet thellësisht dhe gjithësisht¹⁾. Në një letër tjetër po të këtij viti sulltan Mahmudi II shprehet përsëri: «... Është krejt e ditur se këta shqiptarët nuk kanë asnjë lidhje me dinin dhe me fenë islame... Me të drejtë futja në binarë e kësaj Shqipërie ka një rëndësi të domosdoshme, por sa para bën, tani për tani nuk është koha»²⁾.

Në vitin 1829 Turqia firmosi traktatin me rusët në Adrianopojë. Atje Greqia ligjëroi pavarësinë e saj. Stambolli tashti i kishte duart të lira për të mbytur me gjak revoltat shqiptare për autonomi. Sipas të dhënave që japid historianët e huaj, raportet e emisarëve të lartë turq në Shqipëri si dhe nga këngët popullore, del se gjatë kësaj kohe është formuar një aleancë midis udhëheqësve opozitarë nga mjaft vende të pushtuara nga Turqia. Kjo aleancë shtrihet tani që nga Bosnja e Shqipëria dhe deri në Egjipt dhe Irak, duke përfshirë edhe shtetin e posa-formuar grek, si dhe Kretën, me në krye shqiptarin Mustafa pashë Gjiritlinë. Iniciator i kësaj aleance ka qenë Mehmet Ali pashë Misiri (me origjinë shqiptare), i cili kërkonte sa më shumë aleatë në rradhët e tij për të mposhtur Perandorinë e madhe Osmane.³⁾

Nga përkrahësit më të zellshëm në Shqipëri të kësaj aleance dallohen Bushatlinjtë e Shkodrës, Zyllyftar Poda, Tafil Buzi, Abdyl Koka, Cane Myftari nga Smokthina e

1) BAI, F, H-H, nr. 1, 2, 12, vesika 2164, dt. 21.5.1830.

2) Po aty, Vesika 21554, dt. 1830.

3) Kristo Frashëri, Gazeta «Mësuesi», Tirani, nr. 34, 35, dt. 20.8.1965.

D. Urquhart, Vep, cit. fq. 174, 237, 243.

C. Robert, Vep. cit. fq. 199.

E. Poujade. Vep. cit., fq. 157,

Vlorës etj.¹⁾ Sundimtari i Egjiptit, përveç aleancës lufta-rake me shqiptarët, me Bushatlinjtë e Shkodrës ka pasur edhe marrëveshje tregtare për t'u furnizuar prej tyre me lëndë druri etj.²⁾ Krahinat që administrosheshin faktikisht prej luftëtarëve, që udhëhiqeshin prej Zylyftar Podës tashmë ishin shumëzuar. Këtyre u shtohej dhe Korça e Berati me rrethet e tyre. Stambolli ishte mjaf i shqetësuar nga këto vatra që ekzistonin në Shqipëri. Telashet e mëdha që i krijoi Turqisë Ali pashë Tepelena në këtë krah të Perandorisë ishin akoma të freskëta pranë Portës së Lartë.

Serasqeri i Rumelisë Mehmet Reshit për të justifikuar disfatat e tij para Stambollit ua hidhte fajin feudalëve turkomanë shqiptarë. Ja si përgjigjet serasqeri para kryeinspektoriatit të oborrit të sulltanit me raportin e tij të datës 9 gusht 1830: «Hasan bez Vrioni na shkaktoi

1) Po aty.

BAI, F, H-H, Def nr. 1, 2, 12, vesika 21255-A, vesika 2207. Sipas materialeve historike të trashëgimtarëve të Abdyl Kokës nga Deltina: Abdyl Koka, Tafil Buzi dhe Cane Myftari në fillim kanë qënë në Egjipt. Kur trupat egjiptiane të komanduara nga Mehmet Aliu i ndoqën hordhjtë turke dhe i shpartalluan në Konjë të Anadolit ishin të parët këta trima, që ngritën krye në Shqipëri kundër push-tuesit turk. Sipas këngëve popullore të hershme labe:

«*Ngrehu Cane bukuria,
Se në Konj'u prish hordhia,
E prishi Mehmet Alia...»*

Këtu bëhet fjalë për kryengritjen e rrethit të Vlorës të drejtuar nga Cane Myftari (nga fshati Bashaj i Smokthinës), ish-oficer i Ali pashë Tepelenës) gjatë kohës që ushtritë egjiptiane mposhtën forcën turke në Konjë të Anadolit.

AIF. Dosja e M. Kokalarit.

2) BAI. Letër ku vihet në dukje përfurnizim me lëndë druri nga Shqipëria në Egjipt, datë 1829-30 (fletore dorëshkrimi) fq. 25-2. Letra i drejtohet Mustafa pashë Bushatliut. (Mater. i përkthyer pranë AIH).

dëme të mëdha. Ai në kohën e dorëzimit të kalasë së Beratit krijoi ngatërresa dhe nuk la gjë pa bërë...»¹⁾

Serasqeri nuk la gur pa lëvizur pér të hedhur në dorë opozitarin e shquar shqiptar Zylyftar Podën, i cili gjëzonte autoritet të madh mbi gjithë krerët e tjerë opozitarë, por Mehmet Reshit pasha nuk ia arriti dot qëllimit dhe shqetësimin e tij ia raportoi Portës së Lartë. Lidhur me këtë raport sulltan Mahmudi II më datën 20 maj 1830 jep këtë përgjigje: «Letren e serasqerit të Rumelisë që lidhet me çështjen shqiptare e lexova rrësht pér rrësht, që Podalliu nuk bëhet mik dhe nuk do që të na shërbejë neve»²⁾.

Para kësaj situate të vështirë pér Portën e Lartë, Mehmet Reshit pasha, nën diktatin e Stambollit, organizoi masakrën e Manastirit dhe më vonë atë të Janinës pér të likuiduar udhëheqësit opozitarë shqiptarë. Para këtyre veprimeve tradhëtare, ai shpalli amnistinë dhe më 9 gusht 1830 ftoi në Manastir krerët feudalë autonomistë (partizanët e sistemit të Ali pashë Tepelenës) dhe kapedanët e fshatarësisë dhe të malësorëve, të gjithë në opozitë me Portën e Lartë, gjoja pér të plotësuar të gjitha kërkesat e tyre lidhur me privilegjet e vjetra autonomiste krahinore. Serasqeri (tashti i titulluar Vezir i Madh) prekte në ftesë dhe çështjen e rekrutimit ushtarak pér të bashkë-biseduar me këta krerë opozitarë. Një pjesë e feudalëve autonomistë dhe një pjesë e kapedanëve të fshatarësisë si Asllan Kuca nga Progonati, Veliko Jaçe, Karafil Sinani, Abaz Thana (tre të fundit nga Picari) etj., në kundërshtim me vullnetin e krerëve të tjerë opozitarë, duke patur besim të tepruar në forcat e tyre të shumta, e pranuan ftesën e Mehmet Reshit pashës dhe shkuancës së Manastir, kurse pjesa tjetër si Zylyftar Poda, Çelo Picari, Tafil Buzi, Hodo Nivica, Abdyl Koka etj. të bindur se ky do të ishte një kurth i ngritur nga veziri i madh, nuk u paraqiten në Manastir.³⁾

1) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, Vesika 22002, dt. 9.8.1830.

2) Po aty, Vesika 21645, dt. 20.5.1830.

3) Sipas L. Mile. Vep. cit., fq. 68, 103.

Asllani me Velikon për t'u siguruar mirë kishin marrë me vete shoqërues të shumtë. Ata zgjodhën luftëtarët më trima nga e gjithë ushtria e tyre shumëmësive. Sipas historianëve të huaj, Mehmet Reshit pasha për t'u siguruar, dy lega rreth Manastirit kishte vendosur trupa të rregullta ushtarake, me pretek, gjoja për t'u prerë hovin ushtarëve (që sipas tij) dezertonin çdo ditë.

Më 9 gusht 1830, për ndër të kërëve shqiptarë pashai turk kishte shtruar një drekë dhe kishte organizuar një paradë ushtarake, që do të zhvillohej pasdreke në hipodromin «Anllar yni».

Ushtrimet ushtarake filluan kur arriën forcat shqiptare nën kryesinë e Asllan Kucës dhe Veliko Jaçes. Sipas historianit francez Evzhen Puzhád «... Asllan Kucën e pushtoi dyshimi dhe menjëherë kapi frerin e kalit të Velikos dhe i drejtohet shokut me gjuhën energjike të Orientit (në gjuhën shqip — M.K.): — Na e hodhën!! Veliko Jaçeja buzëqeshi dhe u përgjigj: «Kjo pritje është një rregull i zakonshëm për të nderuar njerëzit. Do të turpërohem i po të zbrapsemi...»¹⁾ «... Kur këta u gjendën përballë rreshtave të ushtarave turq u dha urdhëri «Zjarr!» Të shumtë ishin luftëtarët shqiptarë që ranë në bataret e para. Trimi Veliko Jaçe u vra në vend». Ja sesi e pasqyron folklori këtë kasaphanë të përgjakshme:

«Velikò Veli ku je,
Të ra tabori në dhe,
Dot kumandë nuk u dhe,
Të mbet ati me lele,
Koka tënde në hejbe,
Aferim, o trim të thanë,
Që s'turpërove babanë,
Jaçen me Çelo Picarë».²⁾

1) BAI. Raporti i konsullit francez të Selanikut dr. St. Sauveur, M. Y. Turquie, vëll. 259, dok. nr. 4, dt. 27, Gusht 1830.
(Material i përkthyer, AIH).

E. Poujade, Vep. cit. fq. 158.

2) AIF, Dosja II e M.K.

Ndërsa Asllan Kuca, me gjithëse me kalë të plagosur, iku së bashku me dy krerë të tjerë picariotë: Abaz Thanën dhe Karafil Sinanin, por komandanti i paradës, Ibrahim pasha me suitën e tij i arriti.

Historiografët francezë dhe anglezë flasin me admirim për qëndrimin burrëror të trimit Asllan Kuca, i cili ndonëse mbeti me një sy dhe me kalë të plagosur rëndë, vazhdoi të luftonte dhe la të plagosur vetë komandantin e paradës Ibrahim Qorr pashanë, i cili ishte mburrur se do ta kapte të gjallë këtë trim të Shqipërisë.¹⁾

Pas një luftimi të ashpër trup me trup me sejmenët e pashës u vra më në fund dhe luftëtari i paepur Asllan Kuca së bashku me picariotët Abaz Thana dhe Karafil Sinani.²⁾

Sipas historianit anglez M. Valentin Kirolit: «M-nastiri është veçanërisht i përmendur në kujtimet e tradhtisë turke... Mehmet Reshit pasha i ftoi krerët shqiptarë për të festuar amnistinë e shpallur nga sulltani. Kur këta krerë u larguan nga tenda e vezirit, dy batalione ushtarësh turq ishin rreshtuar për t'ju dhënë atyre ndërimet ushtarake, por në vend të udhëzimit për të paraqitur për nder armët, veziri i madh me gojën e tij dha urdhërin «zjarr!» Në pak çaste lëndina, të cilën shqiptarët

-
- 1) Thimi Mitko. «Mjaltë nga bleta shqiptare». Vienë, 1924, fq. 35:

«...Dil të shini Qorr pashanë,
Sesi ka përveshur krahnë,
Për të qëlluar Asllanë...»

- 2) AIF. Dosja II e M.K.:

«...O Asllan kë kishe pranë,
Nja di labër kapedanë,
Karafil e Abaz Thanë...»

Shih dhe Demetrio Camarda «Appendice al saggio di grammaticologia comparata sulla lingua Albanese», Livorno (Italia), 1866, nr. 28, fq. 38.



Trimat e Kurveleshit: Asllan Kuca nga Progonati dhe Veliko Jaçë nga Picari.

e quajtën «fusha e tradhtisë» (the field of treachery) u kuq me gjakun më të mirë dhe më fisnik të Shqipërisë. Kudo e kanë ndjekur shqiptarin pritat e çndershme (grackat e tradhëtisë). Indipendencia shqiptare u shtri përdhe, por ajo u ngrit përsëri nga nxitjet fermentonjëse të ngjarjeve të fundit».¹⁾ (Këtu autori bën aluzion pér fitoret e shqiptarëve gjatë «Lidhjes së Prizrenit», mbasi kjo vepër u botua gjatë vitit 1881).

• Rapsodi populor e pasqyron qartë pabesinë e pushtuesit:

«*Asllan beu me Veli benë,
Në manastir van' e mbenë,
Veziri bëri gostinë,
Ftoi Asllan' e Velinë, ...
Kush t'i mori të shkretat armë.
Pisqollat e jataganë,
Dhe atë dyfek' larmë, ...
... Kush ta zhveshi fermelenë.
Edhe kokënë ta prenë,
Kurmi të mbet' në Bitolje,*
Koka të mori Stambollë,
Abaz Thanë luleja,
Trim si Asllan Kuceja,
Vlla o derëzeza,
Sadrazemi ç'i gënjeu,
Në Manastir se ç'i preu»²⁾*

Së bashku me këta udhëheqës të kryengritjeve shqiptare, u vranë dhe trimat shoqërues të tyre. Shumica e këtyre luftëtarëve luftuan trup me trup me sejmenët e vezirit të madh dhe ranë me pallë në dorë. Konsulli gjerman Johan George von Hahn shpjegon se edhe mbas

1) M. Valentin Chirol. «Twixt Greeks and Turks». Londër, 1881, fq. 74.

*) Bitolje — Manastir.

2) AIF, (Dosja II, M.K.)

gjashtë muajve dukej gjaku i këtyre trimave shqiptarë në hipodromin «Anlar yni».¹⁾

Është karakteristike qortimi i drejtë që i bëri populli këtyre trimave të rënë në kurthin e pushtuesit:

«... Si s'i njohët osmanllinjtë,
Ata turq besëkëqinjtë...»²⁾

Në të njëjtën kohë Emin pasha, djali i Mehmet Reshit pashës, masakroi me të njëjtat dredhi në Janinë të tjerë krerë opozitarë me Stambollin, nga të cilët mundi të shpëtonte vetëm vëllai i Asllan Kucës, i quajturi Kapllan Kuca.²⁾

Në përgjigje të masakrave turke të Manastirit dhe të Janinës, luftëtarët e Labërisë që i shpëtuan kurthit të vezirit të madh, Çelo Picari dhe Kapllan Kuca me shokë dogjën pjesën qendrore të Janinës ku banonin funksionarët e lartë turq dhe vranë shumë besnikë të Emin pashës. Nga ana tjeter, Çelo Picari (djali i xhaxhait të Veliko Jaçes) me forcat e tij kapi gjatë rrugës tartarin (korierin) e vezirit të madh, që shpinte (nga krahu i Selanikut) në kryeqytetin e Turqisë kokat e prera të Veliko Jaçes dhe të Asllan Kucës së bashku me një shumë të madhe të hollash (piastra). Çelua ia rrëmbeu nga hejbeja tartarit kokat e prera të këtyre dy luftëtarëve së bashku me të hollat dhe në vend të tyre vuri kokën e prerë të korierit turk,⁴⁾ ndërsa kokat e prera të Abaz Thanës dhe të Karafil Sinanit, Çelua nuk i hodhi dot në dorë. Ato arritën në Stamboll dhe u ekspozuan në Ibret tashe të At Mejda-

1) Johan George von Hahn. «Albanesische Studien», Vienë, 1853, fq. 102.

2) AIF, (Dosja II, M.K.)

3) BAI, Raporti i konsullit frances të Selanikut, dr. St. Sauveur M. Y. Turquie, vell. 259, dok. nr. 4, dt. 27.8.1830.

4) Po aty.

nit*. Për këtë akt të Çelo Picarit flet qartë dhe kënga e hershme popullore:

«*Çelo të pimë dollinë,
Tartarit ç'ja bëtë mirë,
Kukën nga kurmi ia çqitnë,
Në hejbe i vun' të tijnë...»
*Çelua ynë me mustaqe,
Mori hak' e zbardhi faqe....»¹⁾**

Në një raport që veziri i madh i drejtonte në atë kohë Portës së Lartë më datën 23 shtator 1830, pasi fliste gjerësisht pér vrasjen e Asllan Kucës dhe të Veliko Jaçes, ndërmjet të tjerash shkruante: «... Sikurse e kam thënë dhe herë të tjera, ky popull i mallkuar nuk mund të krahasohet në burrëri dhe trimëri me asnje popull tjetër. Kur shohin se mbi ata bie ndonjë peshë e madhe janë aq vetëmohues sa asnje komb tjetër. Pra janë komb luttëtar... Futja e tyre nën zap dhe nën nizam është kon sideruar nga të gjithë si çështje jo vetëm e vështirë, por edhe pamundur».²⁾

*) Ibret — tasheetë janë disa lloj kamare, që ndodhen në një nga sheshet e Stambollit, në At Mejdan, ku ekspozohen kokat e prera të kundërshtarëve të sulltanit.

1) AIF, (Dosja II, M.K.) I pa harruar ka mbetur në Kurvelesh vajtimi i nënave labe, kur u shpunë kokat e prera të këtyre trimave:

«*O Asllan, o Veli,
C'ju qan nëna në shtëpi,
O të zeztë djemt' e mi,
C'ju erdh kuka në sini...
O Asllan i ndritur,
Njerin sy të qitur,
Me harbi goditur»*

2) BAI, F, H-H, Def. Nr. 1, 2, 12, Vesika 521518, dt. 23.9.1830.

UDHËHEQËS TË SHQUAR TË KRYENGRIJTEVE POPULLORE TAFIL BUZI DHE ZYLYFTAR PODA

Lufta e Melesinit më 1831

«Sypatrembur do qëndrojë,
Shqiponja që tundi vëndë,
S'shkroi histori me bojë,
Por me gjak nëpër shkëmbënjas...»

Populli

Gjendja në Shqipërinë e Jugut u bë edhe më e acaruar. Forca të shumta turke në këtë kohë i përmbytën nga të gjitha anët këto krahina kryengritëse shqiptare. Ekspeditat ndëshkimore osmane shkuante anembanë vendit dhe dogjën gjithçka që gjetën përpara. Pushtuesi osman, me gjithë epërsinë e vet ushtarake, nuk mundi të shkelte dot në të gjitha krahinat shqiptare. Krahina e Vlorës mbeti një kala e pamposhtur prej tyre. Ja çfarë shkruan veziri i madh në një raport që i drejton Stambollit më 12 shtator 1830: «Beqir Vlora (vëllai i të vrarit Ismail Vlorës — M.K.) ... nuk do të lëshojë nga dora anët e Vlorës, që i ka në pushtetin e tij. Ibrahim pashës i dhamë pesë mijë ushtarë dhe tre mijë vetë bashibozukë, kalorës dhe këmbësorë. Këto ditë, në ujërat e Vlorës, mbërrin dhe flota detare perandorake. Rrethimi do të bëhet nga toka e nga deti». ¹⁾

Në fakt, gjatë kësaj kohe hordhitë osmane në Labëri dhe në Çamëri nuk shkelën dot. Këto ngjarje pasqyrohen qartë edhe në raportin tjetër që Mehmet Reshit pasha i

1) BAI, vesika 21911, dt. 12.9.1830.

drejton Portës së Lartë më 23 shtator 1830, ku thuhet se: «Shqiptarët, tradhtarë të fesë islame dhe pa asnje fe, ... domin që në rrethana të turbullta të kandisnin nizamët që të arratiseshin në Shqipëri dhe ushtria otomane të shkatërrrohej dhe të shpërndahej. Vetëm tashti që u mor Berati, Korça dhe Janina, duke u ndaluar dhe shitblerja në pazaret e përvjavshme të Beratit dhe të Korçës... do t'i vëmë në zap... Së shpejti do t'i nënshtrojmë dhe anët e Labërisë e të Çamërisë që kanë det, do t'i shtërngojmë me anije nga ana e detit...».¹⁾

Jehona e kryengritjes shqiptare u ndje edhe jashtë vendit. Gazeta ruse «Moskovskie vjedomosti» e datës 27 gusht 1830 njoftonte: «Shqiptarët po zhvillojnë një luftë me guxim dhe me vendosmëri të pashëmbullt dhe në të gjitha pikat përballojnë trupat e sulltanit, të cilat disa herë kalojnë edhe në anën e shqiptarëve». Sipas kësaj gazete thuhet se: «Kryengritësit shqiptarë... kanë vendosur të luftojnë me guxim të madh për pavarësinë e tyre dhe kundër çdo sulmi nga jashtë».²⁾

Një veprimitari të gjéré ka ushtruar në këtë kohë në mbarë Shqipérinë e Jugut Tafil Buzi. Ky simpatizues i flaktë i veprimitarisë së Mehmet Ali pashë Misirit, kërkonte që edhe Shqipëria, si Egjipti, të shkëputej nga Perandoria Turke dhe të bëhej autonome.³⁾

Rapsodët populorë e kanë trajtuar me dashuri figurën e kapedan Tafil Buzit:

.... O Tafil, bir i Shanisë,
Kapedan i Shqipërisë,
I ktheve pallën Turqisë.
Tafil Buzi një pëllëmbë,
E mori pallën me dhëmbë...».⁴⁾

1) Po aty, Vesika 21518, dt. 23.9.1830.

2) Sipas L. Mile, Vep. cit., fq. 66.

3) Archives du Ministère des Affaires de Max Rayband à S.A. le ministre des Affaires Etrangères du 8 juin 1835. Sipas L. Mile, Art. cit. Rev. «Studime historike» Nr. 2, 1966, fq. 105.

4) AIF, Dosja II é M.K.

Sipas historianëve dhe dokumentacionit të huaj: «Tafil Buzi trumbetonte kudo se osmanllinjtë nuk janë të aftë të qeverisin Shqipërinë», «... Tafili flet me zjarr pér lirinë dhe pér dashurinë që ka pér kushtetutat»¹⁾ kurse në një dokument tjeter gjejmë se: «Tafil Buzit i shkojnë mbrapa të varfërít»²⁾

«Lidhja Shqiptare» në këtë kohë ishte forcuar mjaft. Ajo tentonte të shtrihej edhe në krahinat veriore të atdheut. Në këtë kohë luftëtarë i vjetër i Ali pashë Tepele-nës, Zylyftar Poda ishte lidhur në një aleancë ushtarake me bushatlinjtë e Shkodrës, pér luftë kundër Turqisë. Këtë bashkëpunim luftarak midis këtyre krerëve shqiptarë e pasqyron qartë raporti i valiut të Janinës, Emin pashës, që i drejtohet Stambollit më datën 16 shtator 1830: «... Po ju paraqesim letrën e domuzit (derrit) Zylyftar Podës, që i dërgon qafirit Mustafa pashë Bushatliut. Kjo letër ju lutem t'i dorëzohet sulltanit... Mos u shqetësoni fort pér shikak se ky qafir tradhtar, bëri këtë punë tradhtare dhë vuri Toskërinë në lëvizje e kryengritje... Zylyftar Poda ka shpallur kudo se: «Unë jam nga ata që qëndroj edhe pse kam disa plagë plumbi. Ushtria e padishahut u bë perishan (u shkatërrua) dhe gjithë Rumelia dhe nizamët u bashkuani me Mustafa pashë Bushatlinë... Zylyftar Poda dhe Mustafa pashë Bushatliu do zoti do gjejnë belanë».³⁾

Forca të shumta osmane vërshuan në këtë kohë nga të gjitha anët në drejtim të krahinave kryengritëse shqiptare, si në kullat e Qarit (në drejtim të rrugës së Korçës)⁴⁾, të cilat osmanllinjtë i kishin kthyer në kazarma. Atje

1) I. M. Qafëzezi. «Dhaskal Gjoka». Rreth problemit të bashkëpunimit revolucionar të shqiptarëve me grekët, fq. 94, 95.

A. M. A. E. 4 lettres de Max Rayband as A, la Ministère des Aff. Entrangères du juin 1835. A.M.A.E. Turquie, 1 lettre de Poujade, 26 avril 1842. Sipas L. Mile. Vep. cit.

2) BAI, F, H-H Def, nr. 1, 2, 12; vesika 22119.

3) Po aty. dt. 16.9.1830.

4) Po aty. Vesika 21528, dt 1831.

luftoi me trimëri të rrallë i biri i Zyliftarit, Rakipi. Ja ç'thotë kënga popullore për këtë trim:

— «... *Kush dogji kullat e Qarit?*
— *Ky Rakipi i Zyliftarit...*»¹⁾

Sipas këngëve popullore, del se forcat osmane ishin aq të shumta sa që kur kreu i tyre arriti në Leskovik, fundi i saj ndodhej në fshatin Ostanicë (qendër — banimi midis Leskovikut e Janinës), ku Mahmud pashë Tërhalla kishte ngritur shtabin e vet. Sipas folklorit:

«... *Mahmud pasha n'Ostanicë,*
Hordhia zu' Leskoviknë...»²⁾

Forcat kryengritëse, të udhëhequra nga trimi i Podës, u shumëfishuan dhe me ushtarë të shumtë shqiptarë, që dezertonin çdo ditë nga ushtria turke. Thirrjes luftarake të Zyliftarit iu përgjigj mbarë fshatarësia e viseve jugore të atdheut si nga Kolonja, Dangëllia, Shqeria, Tepelena, Përmeti, Korça³⁾. Ndihma të shumta i erdhën trimit të Podës nga Labëria me në krye Sinan Labin dhe nga Çamëria me në krye djemtë e Islam Pronjos nga Paramithia. Këta kishin mbledhur mjaftë fshatarë të krishterë dhe myslimanë në fshatrat e Çamërisë për t'i ardhur në ndihmë Zyliftar Podës.⁴⁾ Të shumta kanë qënë trimëritë e bijve të këtyre krahanave në luftë kundër forcave të shum-

1) AIF. (Dosja II e M.K.)

2) AIF. Ekspedita folkloristike e Kolonjës. Buletini i Shkençave Shoqërore, viti 1965, vëll. I, fq. 191.

3) Sipas L. Mile, Vep. cit., fq. 91.

4) BAI, F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21529, dt. 13.8.1831.

ta të Mahmud pashë Tërhallës. Qartë i pasqyron folklori:

«*Shalësi, Poda dhe Barmashi,
Janë trima kordhëtarë,
Ikë Mahmud pasha, ikë,
S'ke par' trima kolonjarë*». ¹⁾

Serasqeri i Rumelisë Mehmet Reshit pasha dërgoi në fillim kundër luftëtarit të Podës, Mahmud pashë Tërhallën, por më vonë shkoi dhe vetë me forca të trefishuara. Zylyftar Poda, mbas shumë luftimesh të rrepta, duke qenë i rrëthuar nga të gjitha anët prej turqëve, u mbyll në tri kalatë e tij në malin e Melesinit (sipas dokumentacioneve turke) ²⁾ dhe priste dita ditës t'i vinte në ndihmë Mustafa pashë Bushati. Dihet botërisht kjo këngë popullore:

«... *Prit, o trim i Podës,
Të vij' beu i Shkodrës...*»

Lufta në Melesin u zhvillua e egër. Ky mal u kthyte në tym e në flakë. Atje dhe kishat u kthyen në fortesa. Në

1) AIF. (Dosja II e M.K.).

Edhe sot dëgjohen në Labëri këngët popullore, që flasin përmesëmarrjen e bijve të kësaj krahine në luftën e Melesinit në 1831. AIF (Dosja e M.K.):

«*Melesini maja-maja,
E rreh topi kumbaraja,
Del Sinan Labi përpara,
Me dy kobure të lara...*».

2) Në fakt në malin e Melesinit nuk ka kështjella. Atje ndodhet vetëm një kishë. Komandantët turq përfshinë të justifikuar disfatat e tyre para Stambollit, në raportet e tyre edhe kishat i mbiqajtën kështjella.



Pamje e pusit në majë të Melesinit.

Melesin trimat e Zlyftarit treguan burräri të rrallë, duke përdorur si armë edhe gurët për të shfarosur armiqjtë e atdheut. I pahruuar ka mbetur heroizmi i trimit Elmaz Xhem i nga Starja e Kolonjës:

«... Melesini në një brinjë,
Lufton nipi për dainë,
Burr', o Elmaz Xhem', o burrë,
I shove nizamët me gurë.
Elmazi me të vëllanë,
Me pallë në dor' u vranë...»

Pushtuesve u kishte hyrë tmerri. Sipas dokumentave të tyre, thuhet se Artileria turke mundi të shkatërronte dy kala, ndërsa e treta e ngritur në majë të malit Melesin ishte e pakapshme nga predhat e pushtuesit.¹⁾

Luftimet u zhvilluan të përgjakshme trup më trup. Me gjithë epërsinë numerike të kundërshtarit në njerëz dhe në armatime luftëtarët shqiptarë treguan trimëri të rrallë. Atje luftoi në masë vegjëlia shqiptare, që sipas disa të dhënavë, Zlyftar Poda qysh në fillim kishte mblehdhur rreth 12 mijë luftëtarë.²⁾ Përbërja shoqërore e pjesëmarrësve të kryengritjes pasqyrohet qartë nga kënga popullore e poshtëshënuar:

«Melesini maja-maja,
E rreh topi kumbaraja,
Melesini mal' i butë,
Rreth e rrötull me harbutë, *
Melesini i përpjetë,
I vete gjylja shigjetë...»

Muajt kalonin, por lufta vazhdonte edhe më e rreptë. Porta e Lartë kërkonte me këmbëngulje që kryengritja

1) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21529, dt. 2.9.1831.

2) Sipas L. Mile, Vep. e cit. fq. 91.

* Harbut — këtu ka kuptimin e fshatarit të varfër.

të shuhej sa më parë sepse i trembej flakës së saj, që mund të përhapej anembanë Shqipërisë. Raporti i Mehmet Reshit pashës drejtuar Stambollit më 2 shtator 1831 e tregon qartë gjendjen e vështirë të forcave turke të hedhura në luftë kundër trimit të Podës:

«... Janë vende shumë të thepisura e gurore. Asnjë kullë në këtë vend nuk ka mundësi të pushtohet me sulm. Zylyftar Poda në malin e Melesinit ka tri kala, dy prej tyre u shkatërruan me top, por e treta në majë të malit nuk rrighet dot as me topa as me kumbara, ajo mund të mbrohet me njëzet pushkë...»¹⁾ Serasqeri, në pamundësi për t'i mposhtur trimat e Zylyftarit në fushën e luftës, ushtroi bllokadën ekonomike, për t'i hedhur në dorë me anën e urisë. Për t'u prerë krejtësisht furnizimin me ushqim kryengritësve, Mahmud pashë Térhalla i përhapi ushtarët e tij anembanë fshatrave për rreth malit Melesin, si në Postenan, Lashovë, Vrepckë etj. Ai deshi kështu të fuste terror në këto vende, por ekspeditat ndëshkimore osmane morën një mësim të mirë nga luftëtarët e Sinan Labit dhe nga ata të djemve të Islam Pronjos nga Çamëria. Sipas traditës populllore thuhet se trimi i paepur Zylyftar Poda ditit t'i shpëtonte bllokadës ekonomike. Atje, në majë të malit Melesin ai kishte ndërtuar furrën dhe e bluante grurin dhe misrin me mokra të mëdha guri që i sillte përqark me kuaj.²⁾

Në këtë kohë forca të shumta të Mustafa pashë Bushatliut u nisën nga Shkodra për të ndihmuar luftëtarët e trimit të Podës, por ato u shkatërruan keqas gjatë rrujgës nga ushtria turke, për mungesë të organizimit të tyre. Megjithatë, trimat e udhëhequr nga Zylyftari nuk e dhanë veten. Ata e vazhduan luftën edhe më rreptë. Gurët e Melesinit, muret dhe oborri i kishës së Shënlisë (e kthyer në fortësë nga kryengritësit) skuqnin nga gjaku i nizamëve dhe nga ai i luftëtarëve të paepur shqiptarë,

1) BAI, F. H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21529, dt. 2.9.1831.

2) AIF. Ekspedita folkloristike e Kolonjës. Buletini i Shkencave Shoqërore, viti 1966, nr. 1, f. 191.

që me këmbëngulje mbronin autonominë e tyre krahi-nore.

Serasqeri i Rumelisë kur e pa se nuk mund t'i mposhtte dot mbrojtësit e Melesinit dhe duke dashur t'i jepte fund sa më parë luftës në këto vende, vendosi t'i linte rrugë të lirë trimit të Podës për të dalë jashtë Shqipërisë së bashku me luftëtarët e tij.¹⁾

Pas gjashtë muajsh mbrojtjeje burrërore, kur rezervat ushqimore po mbaroheshin, luftëtarët pranuan të pu-shonin qëndresën me disa kushte.

Në muajin tetor të vitit 1831 filluan bisedimet. Zylyftar Poda parashtroi këto kërkesa:

1) Të faleshin të gjithë kryengritësit.

2) Të mos dorëzoheshin armët.

3) Të mos konfiskohej pasuria e kryengritësve nga autoritetet turke.²⁾

Mehmet Reshit pasha i pranoi kushtet e kryengritësve, duke i mbajtur Zylyftarit peng vetëm njërin prej djemve të tij, Hasanin.³⁾

Në këto rrethana, Zylyftar Poda së bashku me luftëtarët e tij u largua, duke lënë të habitur komandantët dhe ushtarët osmanë, të cilët nuk mund ta merrnin me mend se brenda në kishën e Melesinit ndodheshin kaq pak luftëtarë që e mbronin atë. Ja si e pasqyron kënga popullore:

«*Zylyftar Poda ku je,
Gjasht' muaj muhasere,
Pa buk e pa xhephané,
Në dor' halldupit s'i re...»⁴⁾*

Në raportin e tij të mëvonshëm Mehmet Reshit pasha e pranon gabimin (sipas tij) që e la të lirë Zylyftarin. Ja si shprehet ai: «Edhe pse më premtoi Zylyftar Poda

1) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21529, dt. 12.12.1831.

2) Sipas Ligor Mile. Vep. cit. fq. 92.

3) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12; vesika 21956, dt. 22.2.1832.

4) AIF, Ekspedita e Kolonjës, vëll. XIV, f. 20.

se do të hijte dorë nga lufta, përsëri unë dyshoj në këta lloj shqiptarë, ai mund të sakrifikojë edhe birin (që ka lënë peng) dhe të shkojë në aleatët e tij».¹⁾

Edhe pas largimit nga Shqipëria, Zyliftar Poda me luftëtarët e tij nuk hoqi dorë nga lufta kundër pushtuesit osman. Ai së bashku me krerë të tjerë opozitarë të Stambollit u hodh përsëri në kufijtë e Shqipërisë dhe vazhdoi luftën kundër Turqisë. Ja çfarë thuhet në raportin që i drejton Emin pasha atit të tij, serasqerit Mehmet Rushit pashës, që në atë kohë ndodhej në Manastir: «Zyliftar Poda, Abdyl Koka dhe Shahin Delvina gjendeshin në Kretë. Tani kanë ardhur në More (në Greqi). Dërgova dy agjentë dhe më siguruan se ndodhen atje. Kanë për qëllim të përgatitin njerëz për t'i hedhur në këto anë. Së pari do të inkuadrojnë disa në More, pastaj do të kalojnë në Çamëri. Zyliftar Poda do të vijë nga Tërlalla dhe Agraфа. Kemi bllokuar pikat e kalimit».²⁾

1) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12; vesika 21956, dt. 22.2.1832.

2) Po aty, Vesika 21923, dt. 9.2.1833.

**PUSHTUESI TURK NUK MUNDI TA MPOSHTË AS ME
HEKUR AS ME ZJARR SHPIRTIN LIRIDASHËS TË
SHQIPTARËVE. KRYENGRIJTET POPULLORE
NË KRAHINËN E GJIROKASTRËS GJATE
VITIT 1833**

«Nga kjo balt' e kësaj toke,
Merr një grusht e shtrydhe fort,
Pika gjak do të kullojë...»

Populli

Persekutimi turk mbi shqiptarët u shumëfishua gjatë vitit 1833. Autoritetet e osmane u kishte hyrë tmerri nga kryengritësit shqiptarë.

Për të penguar hovin e kryengritjes, turqit mbyllën nëpër burgjet e Beratit dhe të Janinës mjaft nga të afërmët e kryengritësve dhe shpallën anembanë vendit se ata do t'i shfarosnin të parët po të plaste përsëri kryengritja. Ja çfarë thuhet në njërin nga raportet e valiut të Janinës të datës 9 shkurt 1833: «... Kemi bllokuar pikat e kalimit. Në Janinë janë dërguar edhe pengjet e tjera nga krvesorët e parisë. Në kalanë e Beratit mbahen të arrestuarnierëzit e atij rrethi»¹⁾. Tafil Buzi me Zenel Gjolekën, në përgjigje të këtyre kërcënimeve, u hodhën në Dymeqë e Çatallxhë dhe morën peng dy nga funksionarët e lartë osmanallinj: Haxhi Hysen agën dhe Seit beun. Sipas një raportit të valiut të Janinës, Emin pashës, drejtuar Stambollit më datën 8 prill 1833 thuhet: «Tafil Buzi në Dymeqë mo-

1) BAI, F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21923, dt. 9.2.1833.

ri peng hanedanin e Jenisherit Haxhi Hysen agën dhe të Çatallxhesë Seit beun».¹⁾ Njëkohësisht Tafil Buzi, së bashku me kapedanë të tjerë shqiptarë, terrorit turk iu përgjigj me terror. Ai, së bashku me Zenel Gjolekën, u hodhën në Grebenë dhe vranë feudalin turk të vendit, agjentin e valiut të Janinës, Veli aganë²⁾. Vrasja e këtij feudali ishte një paralajmërim për gjithë autoritetet e vendit, se i njëjti fat do t'i priste të gjithë ata që do të silleshin keq me shqiptarët e arrestuar e të mbyllur në burgjet plot lagështi të Janinës e të Beratit. Kapedan Tafil Buzi me shokë, gjatë kësaj kohe, shpërndau letra në mbarë popullin, madje edhe në autoritetet e vendit, në të cilat vinte në dukje luftën e tyre të drejtë. Ja një nga raportet e mytesarrifit (prefektit) të Tërhallës, Mustafa pashës, që i drejtohet vezirit të madh, Mehmet Reshit pashës, më datën 12 shkurt 1833: «Tafil Buzi ka dalë në kazanë e Grebenesë... Ka shpërndarë dhe letra nëpër derbendet, vojvodët, kadilerët dhe në popull...»³⁾.

Gjendja në Shqipëri gjatë vitit 1833 ishte acaruar së tepërmësi. Shqiptarët kërkonin të ruanin me cdo kusht vetëqeverisjen e vendit. Dokumentet diplomatike të vendeve të huaja pohojnë se në atë kohë Shqipëria ishte vendi më me turbullira i Perandorisë Turke⁴⁾. Me dhjetor

1) Po aty, Vesika nr. 21703, dt. 8.4.1833.

2) Botim i Institutit të Folklorit. «Këngë popullore», Tiranë:

«*Tafili me kapedanë,
Me Zenel Gjolekë labë,
Në Grebene u ngren' e vanë,
Të vrasin Veli aganë,
Veli aga Grebeneja,
Tu ngjinë nga penxhereja
Plot me gjak t'u mbush shilteja».*

3) BAI, F, H-H, Def. 1, 12, 12, vesika, 21921, dt. 12.2.1833.

4) Archives du Ministere des Affaires. (AMAE) Turquie 4 lettres de Prevesa du juin 1834. Sipas L. Mile, vep. cit.

tëra ekspedita ndëshkimore osmane e pëershkuane anembanë vendin tonë. Ata shkatërruan në radhë të parë ekonomitë e fshatarësës shqiptare. Pushtuesi në mjaft krahina malore jugore të atdheut kishte vënë bllokadën ekonomike. Kurveleshit i kishte prerë krejt furnizimin me ushqim dhe nuk i lejonte bagëtitë e banorëve të kësaj krahine të zbritnin në kullotat dimërore. Qeveria turke e konsideronte Kurveleshin «qendër të rebelizmit».

Pushtuesi osman gjatë kësaj kohe kishte nxjerrë urdhëresa të shumta për ndalimin e qarkullimit të bereqetit dhe të kripës në krahinat kryengritëse. Autoritetet turke, për të vënë në jetë këto urdhëresa, kishin vënë me dhjetëra derven-agasi (ruajtës të shtigjeve malore) nëpër rrugët që lidhin Kurveleshin e Sipërm dhe të Posthtëm me krahinat e tjera shqiptare. Kundër kryengritësve valiu i Janinës kishte vënë në lëvizje edhe një pjesë të bezlerëve turkomanë të Delvinës, që përfshinin në atë kohë në pronësinë e tyre toka të gjera në mbarë krahinën. Këta renegatë të vendit orvateshin t'i kthenin përsëri në fshatrat e tyre malore kurveleshasit e varfër, që kishin zbritur për arsyе ekonomike në tokat pjellore të Delvinës, ku ndodhen sot fshatrat Vergo, Kopaçe, Palavli etj. Por këto vegla qorre të Emin pashës morën një mësim të mirë në Delvinë nga kapedani i Kurveleshit Çelo Picari. Ja si e pasqyron folklori:

«Ra Çelua në Delvinë,
Bejlerët nuk' e prinë,
Ikën muar' aratinë, . . .
Dual' grat' e ulurinë,
— Çelo të bëjmë rixhanë,
Mos të vriten burrat tanë. . . »¹⁾

Sundimtari i ri i Janinës, Emin pashai kërkonte me këmbëngulje të zbatohej detyrimi ushtarak dhe në zonat malore të Gjirokastërës, Vlorës e Tepelenës. Këto or-

1) AIF (Dosja II M.K.)

vajtje u shoqëruan me djegie, internime dhe me vrasje të shëmtuara në masë.

Në këto vende të varfëra malore, plasi përsëri revoltë popullore.

Qartë e pasqyrojnë shpirtin liridashës dhe vetëmo-hues të shqiptarit raportet e pushtuesit. Ja një nga rapportet e kajmekamit të Manastirit Ismail beut, që mban datën 4 mars 1833: «... Siç dihet shqiptarët gegë dhe toskë janë njerëz të mallkuar dhe kundravajtës. Në këtë sjellje ua kalojnë atyre të viseve të tjera të Perandorisë... Shpresojmë se nga ndëshkimet që kanë pësuar më parë nga dovleti ndoshta janë urtësuar, por paraqitja e këtij populli është e çuditshme, sa herë që sheh se bëhet një kryengritje e re dhe po të mos shtypet kjo menjëherë... bëhet ngjitëse dhe përhapet anembanë!»¹⁾

Trazirat gjatë vitit 1833 filluan më parë në Tepelë e pastaj në mbarë Kurveleshin. Për të shtypur revoltën dhe për të kapur shkaktarët e saj, Emin pasha, valiu i Janinës, dërgoi një ekspeditë ndëshkimore të shoqëruar nga dy emisarë të lartë osmanllinj: Hasan benë dhe Tahsin efendinë. Krerët e kryengritjes si Tafil Buzi, Çelo Picari, Zenel Gjoleka etj. dërguan menjëherë dy nga luftëtarët e tyre në Gjirokastër, të cilët i vranë të dy emisarët e lartë turq, së bashku me shoqëruesit e tyre, në një nga hotelet e këtij qyteti.²⁾

Lajmi i vrasjes së këtyre dy nëpunësave të lartë osmanllinj u përhap në gjithë vilajetin e Janinës. Sundimtari i saj, Emin pasha, i revoltuar nga ky akt i guximshëm i kryengritësve shqiptarë u nis me forca të shumta në drejtim të Gjirokastrës.

Në këtë kohë e gjithë Labëria u ngrit në këmbë nën udhëheqjen e Çelo Picarit dhe Zenel Gjolekës. Një pjesë e mirë e kryengritësve shqiptarë kishin shkuar për qirimin e qytetit të Beratit, që në atë kohë ka qenë qendër

1) BAI, F, H-H Def. nr. 1, 2, 12, vesika 2168, dt. 4 mars 1833.

2) Panajot Aravantinoi. «Hronografia tis Ipiru» (1822-1852). Athinë, 1856. Libri i gjashtë, paragrafi 54.

e madhe administrative dhe ushtarake e pushtuesit, nga varej dhe krahina e Vlorës.

Luftëtarët tanë u dolën përpara trupave turke në afërsi të fshatrave Kakavje, Peshkëpi, Kserovalt dhe Guver.

Një ndihmë e madhe u erdhi këtyre luftëtarëve nga Mallakastra me në krye Tafil Buzin. Në raportin që mytesarrifi i Tërhallës i drejtonte Stambollit gjatë kësaj kohe thuhet: «Emin pasha me forcat e veta dhe i pajisur me topa u nis në drejtim të Gjirokastrës. Ai ka arritur në vendin ku kryengritësit e kanë forcuar, duke ngritur tabje (llogore) dhe barriera...»¹⁾

Gjatë kësaj kohe, kudo në Bregdet ishte dhënë kushtrimi për luftë kundër Turqisë. Bijtë e kësaj krahine nën udhëheqjen e kapelan Spiro Gjikës nga Qeparoi dhe Janaq Kumiut, nga Nivicë-Bubari u hodhën në rrëthin e Gjirokastrës, në ndihmë të kurveleshasve. Sipas folklorit:

*«Dielli që lëshon çika...
Ju kërkon kapelan Gjika,
Kumiut me shtatë drita,
Vishni armët e florinjtë,
Të shkojmë ku është e liga...»²⁾*

Me dhjetëra trima të rinj dolën në udhëheqje të kësaj kryengritjeje popullore. Qartë e pasqyron kjo këngë e hershme popullore organizatorin e ri të kësaj kryengritjeje, Balil Neshën nga Nivica e Kurveleshit:

*«... Që në Krahas e Bolenë,
Balilo, Balil nuri,
Gjithë me Balil u ngrenë,
Kërcyen në Tepelenë,
Lidhën fjal' e bënë benë,
Që nizanë të mos venë...»³⁾*

1) BAI, F, H-H. Dei, nr. 1, 2, 12, vesika 22001, dt. 1833.

2) AIF, (dosja II e M.K.)

3) AIF. Dosja e M.K.

Forcat turke me qëllim që t'u merrnin krahët kryengritësve e zgjeruan vijën e luftimeve. Ata tentuan të hedhin në dorë sa më parë qafën (bogazin) e fshatit Peshkëpi të Libohovës, të cilën pushtuesi e ka patur vazhdimisht pikëmbështetje për sigurimin e rrugës Janinë-Gjirrokastër. Por atje arritën të parët luftëtarët e Nivicës dhe të Rexhinit të udhëhequr nga Balil Nesha dhe Abaz Zeneli (hoxhë Rexhini) me shokë, të cilët mbasi assjësan postëkomandën turke të vendit i dolën përpëra ushtrisë së rregullt osmane dhe u përlleshën në Qafën e Peshkëpisë:

«Në Qafë të Peshkëpisë,
Lufton Balil i Xhixhisë,
Me të bir e Rumelisë,
*Me taboret e Turqisë...»¹⁾
 «... Ç'e kujtoj hoxhë Rexhinë,
Hoq' sarëkun e divinë,
Ngjeshi pisqoll'e martinë,
Iku zuri Peshkëpinë,
Të bëj harb) me osmanllinë...»²⁾**

Atje këmbësoria osmane mbeti e rrrethuar nga forcat shqiptare, kurse suvarinjtë (kalorësit) e shumtë turq, që shkuan nga ana e fushës së Peshkëpisë nuk arritën dot t'u venin në ndihmë forcave osmane të rrrethuara në Qafën e Peshkëpisë, mbasi u angazhuan në luftë me trimat e Bregdetit të udhëhequr nga kapedani i Nivicë-Bubarit, Janaq Kumiu. Kalorësit osmanë edhe pse ishin superioresë në numër dhe në armatime nuk mundën dot t'i mposhtin luftëtarët e Bregdetit. Ata luftuan dhëmb për dhëmb me suvarinjtë e egër turq dhe nuk i lanë të bashkohen

1) AIF. Dosja e M.K.

2) Po aty.

* Harb (fjalë arabe) — luftë.

- me forcat e tjera osmane. Sipas këngëve të hershme populllore labe:

«Në fushë, në Peshkëpi,
Kapetan Janaq Kumi,
Të rrethosën me deli,
Me tetëqind suvari,
Të të merrnin kokën ti...»¹⁾

Por kokat e këtyre trimave të Bregdetit nuk merreshin kaq lehtë nga pushtuesi. Më kot u mundua i biri i serasquerit, Emin pasha, t'i hidhte në dorë të gjallë këta trima. Vetëm nga fshati Nivicë-Bubari i Bregdetit ranë në këtë betejë me shpatë në dorë tetë niviciotë, së bashku me udhëheqësin e tyre kapedanin Janaq Kuminë:

«... Pashai vuri dylbinë,
Të më zini peshlizinë.
Kapedan Janaq Kuminë,
Ta mbaj lidhur në Janinë,
Kapedan Janaq Kumi,
O birbil delikandhi
Qysh të rrethuanë ty?..
Të tetë niviciot' që qenë.
Gjithë sorqeth e levendë,
Të tet' në vend u vranë,
Armët nga gryka s'i dhanë
Po bashkë me ato ranë...»²⁾

Ushtri të reja turke erdhën përsëri nga Janina. Ata e ngritën kampin e tvre në fshatin Kserovalt të Palopogonit. Por edhe atje luftëtarët shqiptarë u dolën përpara. Përsëri luftëtarë i ri Balil Nesha me forcat e tij sulmoi i pari. Kryengritësit u futën në befasi natën nëpër cadrat e osmanllinjve dhe u përleshën fyt më fyt me ta. Atje u vunë

1) AIF, (Dosja II, M.K.)

2) Po aty.

në përdorim vetëm armët e ftohta: palla, hanxhari dhe cfungjia. Në këtë betejë të egër u plagos rëndë dhe Balil Nesha:

«Te hani në Kserovalt,
O Balil, Balil, o dritë,
E bëre sulmin e parë,
Topçinjtë me top tâ dhanë
Flaka të mori fustanë...»
... Të ngriu maj' e cfungjisë,
Balilo, Balil nuri
Ndënë sqetull e në sisë...»¹⁾

Megjithatë ky trim nuk u têrroq nga fusha e betejës, përsëri ai me luftëtarët e tjerë kurveleshas sulmoi i pari mbi topçinjtë (artilierët) turq, që villnin zjarr mbi forcat shqiptare nga hani i Kserovaltit.²⁾ Tradita popullore flet qartë mbi qëndrimin vetëmohues të Balilit, i cili edhe pse i plagosur rëndë dhe i zhuritur nga zjarri i artillerisë osmane i qëndroi deri në fund, me këllëç në hundë, pushtuesit. Sipas këngës së vjetër popullore kapedan Balil Nesha edhe para vdekjes, me plot dhëmbje të mëdha në trup, nuk lëshoi as pikën e lotit për vete, mbasi ato i kishte harxhuar për popullin e tij të shumëvaujtur:

«... Balil fermele me zogje,
Me nizamët u përpoqe,
Sa u zhurite u dogje,
— O Balil ç'i bëre lotë,
— I kam derdhurë për shokë». ²⁾

Udhëheqësi Çelo Picari, së bashku me luftëtarë të tjerë, luftoi në Kakavje. Këtu ishin përqendruar forcat kryesore të valiut. Në këtë zonë Çelua i ngriti një kurth armikut. Ai me një pjesë të luftëtarëve të tij si me Le-

1) AIF, (Dosja II, M.K.).

2) Po aty.

vend Picarin (Bihucaj), Elmaz Latifin, Mane Begirin etj. kishin zënë pikat më kyçe të vendit. Andej ndiqnin me sy çdo lëvizje të armikut. Për t'i futur turqit në kurthim e ngritur, Çelo Picari dërgoi në fillim kundër forcave të valiut të Janinës kordhëtarin Demçe Imo (Picari) në krye të një pakice trimash nga fshati Kolonjë i Kurveleshit. Hordhitë e Emin pashës, të gjenjyera nga numri i vogël i luftëtarëve të Demçe Imos i ndoqën këmba-këmbës këto forca, të cilat filluan të tërhiqeshin drejt vendit ku ndodheshin të fshehura forcat kryesore labe dhe mallakastriote. «T'i qëlloni halldupët, djema», — u tha Çelo Picari, — sipas zakonit të shqiptarit, vetëm kur t'u shikoni të bardhën e syrit» (kur t'u afrohen mirë — M. K.).

Me të rënë turqit në kurthim e ngritur u dha urdhëri «zjarr» nga Çelua dhe Tafil Buzi. Kryengritësit u ranë turqve në befasi. Osmanllinjtë nuk orientoheshin dot. Ata kishin me vete dhe një bej renegat shqiptar, i cili përtë shpëtuar turqit u përpooq me forcat e tij t'u binte pas shpine kryengritësve, por luftëtarët e Çelos e kapën këtë tradhtar dhe ja sollën të gjallë udhëheqësit të tyre. Vetë Çelua me dorën e tij ja këputi kokën.¹⁾

Forcat osmane, me qëllim që t'i shkulnin kryengritësit nga pozicionet e tyre, e zgjeruan vijën e luftimeve nga krahu i Palopagonit dhe zunë fshatin Guver. Atje vrapuan luftëtarët e Golemit të Kurveleshit me në krye kapedan Çobo Mustafanë. Osmanllinjtë luftonin nga shtëpitë e fshatit. Kryengritësit u bënë shumë herë thirrje turqëve të dilnin nga shtëpitë e Guverit dhe të luftonin

1) AIF (Dosja II e M.K.):

«...Gjashtëdhjetë kolonjarë,
Demçe Imo është i parë,
I doli punësë ndanë,
Në pusi të gjithë ranë...
O Çelo ç'e bëre mirë,
Preve bej shallvarezinë,
Më dysh ja ndave fëlqinë».

jashtë, «atje në sheshin e burrave», por komandantët turq nuk pranuan. Luftimet u zhvilluan shtëpi më shtëpi. Kryengritësit vendosën ta çlironin me çdo kusht këtë fshat, sepse pushtimi i këtij vendi nga forcat osmane rrezikonte krahët e luftëtarëve shqiptarë, që luftonin në sektorë të tjerë. Rapsodët labë i kanë kushtuar fjalët më të shtrenjta udhëheqësit të luftëtarëve të Golemit, kapetan Çobo Mustafait.

*«Ra tërmeti u tund vëndi,
Se lufton Çobo Golëmi,
Kapetan i këtij vëndi,
Kapetan që kur kish lerë,
Që lufton me pallë nxjerrë,
Bën dyfek me sadrazemë,
O halldup shallvarevjerë,
Në e zënca dot Guverë,
Të shoç Çobonë një herë,
Të të bëj njëqind të prerë.
Dëgjoi pér të vëllanë,
Zu Hasan benë të gjallë,
Edhe Shishko mirjallanë,
I preu pér të vëllanë,
Lisi me dega t'ergjënda,
E mbylle valinë brënda».* ¹⁾

Në këtë kohë kryengritësve u erdhi ndihma nga krahu i Kakavjesë, me Tafil Buzin dhe Zenel Gjolekën në krye. Mbas luftimesh të përgjakshme fshati Guver u çlirua, por atje u vranë mjaft nga luftëtarët e Golemit, midis tyre dhe vëllai i Çobo Mustafait. Nuk ishin të pakëta dhe humbjet që pësuan banorët e Guverit. Në përgjigje të këtyre vrasjeve, u pushkatuan para masës së fshatarëve të Palopogonit dhe komandantët turq të kapur robëri Shishko Mirjallahu, Hasan beu etj. ²⁾ Gjithashtu ka-

1) AIF (Dosja II M.K.).

2) Po aty.

pedan Tafil Buzi pushkatoi nga parësia e fshatit Kakollakos të Palopogonit spiunin e Emin pashës, Joan Dakarin me djalin dhe me tre nipërit e tij, sepse këta ishin vënë në shërbim të forcave të valiut të Janinës duke shqëruar ekspeditën ndëshkimore osmane nëpër shtigjet malore të Palopogonit, për të qëlluar mbas shpine kryengritësit shqiptarë.¹⁾

Gjatë vitit 1833 kryengritja u shtri dhe në krahinat e tjera të Shqipërisë së Jugut si në Tepelenë, Delvinë, Vlorë etj.²⁾

Trupave ushtarake të Emin pashës u erdhën përforcime të reja. Vendet ku u zhvilluan deri atë çast luftimet ishin krejt të hapëta, pa mbrojtje natyrale nga ku mund t'i shpëtoje rrëthimit. Kryengritësit shqiptarë, për arsyе taktike u tërroqën në brendësi të maleve, drejt grykës së Tepelenës, vende krejtësisht shkëmbore dhe të thepisura. Emin pasha, në krye të ushtrisë së tij u fut me zhurmë në qytetin e Gjirokastrës dhe mbas disa ditëve, i sigurtë se do të korrte fitore u drejtua për në grykën e Tepelenës.

Luftëtarët shqiptarë nën udhëheqjen e Çelo Picarit ishin rreshtuar në afërsi të fshatit Luzat dhe kishin zënë vend në fund të një gryke të ngushtë, e cila e pengonte manovrimin e zgjeruar të trupave të shumta osmane. Sipas traditës popullore, ky vend i quajtur «Buza e Sefer agait» u kthye në një kasaphanë të vërtetë. Kryengritësit shqiptarë për të mposhtur forcat e shumta turke shfrytëzuan dhe gurët e shkëmbinjtë e vendit. Pas një beteje të ashpër malore forcat osmane pësuan disfatë të plotë. Ja çfarë thotë sundimtari turk i Korçës në raportin e tij drejtar valiut të Manastirit: «Emin pasha doli nga Gjirokastra për në Tepelenë, por në Luzat u qëllua dhe u shkatërrua krejt...»³⁾

1) Jorgji Llambbridhis. «Epirotika Meletimata». Athinë, 1880, vël. IV, fq. 42 - (Material i përkthyer pranë AIH).

2) BAI, F, M-H, Def. nr. 1, 2, 12, Vesika 22001, dt. 1833.

3) Po aty, Vesika 22001, dt. 1833.

Të shumta qenë betejat e humbura që pësuan turqit gjatë vitit 1833 në luftimet kundër shqiptarëve. Ja sesi kërkojnë të justifikohen emisarët e lartë osmanllinj në Shqipëri, përpara Portës së Lartë, për këto disfata që pësuan nga kryengritësit: «Shqiptarët janë sherrxinj» (thotë mytesarrifi i Tërhallës), «kanë prirje për kryengritje, për asgjë bëjnë tym e flakë»¹⁾.

Shqiptarët, të entuziazmuar nga fitoret që korrën kundër turqve, i dyfishuan forcat e tyre, me të cilat mbanin të rrrethuar garnizonin turk në kalanë e Beratit. Të shumtë ishin luftëtarët e Kurveleshit, të Tepelenës dhe të Mallakastrës që u drejtuat për në Berat. Qartë pasqyrohen këto ngjarje dhe në këngët e pavdekshme popullore:

«*Celua arap i zi,
Tafili një grusht njeri,
Bashkë me Veis Vasjarë,
Ikën e zunë Beranë,
Duan të marrin kalanë,
Të zënë Emin aganë,
Me bixhak *) t'i marrin xhanë...»²⁾*

Lufta u zhvillua e ashpër anembanë mureve të kala-së. Morali i kryengritësve qëndronte shumë lart, ndërsa në radhët e forcave të pushtuesit çdo ditë shtohej paniku. Sipas gojëdhënavë, kryengritësit për të tmerruar ushtarët osmanllinj, për të lënë përshtypjen se qenë më shumë, ndiznin rrëth e rrotull kalasë me qindra e mijëra zjarre natën, që nga Huznova e Dobrovniku dhe deri në Velabisht.

Mbas mjaft betejash të përgjakshme, më në fund, kryengritësit e hodhën në dorë kalanë. Ja si e pasqyron

1) BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, Vesika 22001, dt. 1833.

*) Bixhak — thikë e vogël. Në rastin konkret: «Me bixhak t'i marrin xhanë», në kuptim që armiku të torturohet para se të vdesë, kaq ishte e madhe urrejtja e shqiptarëve kundër pushtuesit osman.

2) AIF, (Dosja II, M.K.)

këtë gjë valiu i ri i Rumelisë Mahmud Hamdi pasha në raportin e vet të datës 22 tetor 1833:

«Në fillim kryengritësit e Tepelenës dhe të Beratit ishin 10000 vetë. Së pari marshuan mbi Berat dhe e rrethuan mirë kalanë. Myteselimi Emin agai u mbyll brenda... Mori me vete dhe mirmiran Sulejman pashën nga Berati dhe disa nga parësia. Lufta u ndez, por ushtarët i thanë myteselimit të dorëzojë kalanë. Edhe parësia ia pati me hile. Edhe ata i thanë: «shko të shpëtosh kokën». Kalaja u dorëzua dhe myteselimi shkoi në Kavajë»¹⁾.

Qeveria osmane, në pamundësi për t'i mposhtur shqiptarët në fushën e luftës, u mundua t'i largojë ata nga kryengritja me anën e mashtrimit dhe pretimeve të kota. Në këtë kohë Stambolli e akuzon gjoja Emin pashën si shkaktar të të gjithë këtyre turbullirave dhe e zëvendëson me ish-valiun e Bosnjës, Mahmud Hamdi pashën, që sipas Portës së Lartë ishte njjeri i matur, gjakftohtë dhe që kish patur mjaft suksese në zgjidhjen e konflikteve me rrugë paqësore. Të shumta ishin dhe qarkoret plot lajka e pretime që kishte lëshuar Stambolli në atë kohë për shqiptarët për t'i larguar ata nga kryengritja. Ja njëra prej tyre e lëshuar më datën 16 shtator 1833: «Mësuan pér lëvizjen e pahijshme që pat lindur në ato anë pa ndonjë arsy, por vetëm nën ndikimin e disa iluzioneve të kota. Sidoqoftë, këto veprime sado që nuk kishin asnjë bazë ndodhën dhe u bënë shkak që të derdhet gjak... Kjo gjë është e vërtetë, ne na shqetëson shumë. Është e qartë se një gjë të tillë nuk e dëshëron as zoti dhe as padishahu. Tashti pér çdo nevojë që do të keni do të njoftoni valiun e Rumelisë dhe neve. Çështja do t'i njoftohet oborrit mbretëror dhe s'do mend që zemërimi i qeverisë do të kthehet në paqë dhe ndofta do të përbushen ato që do të kërkoni. Por derisa të ketë dali urdhëri dhe dekreti i lartë, lidhur me kërkkesat tuaja, ju duhet të hiqni dorë nga konflikti i padobishëm, nga

1) BAI. F H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21729, Letër e Mahmud Hamdiut, 22 tetor 1833.

lufta e nëmur dhe t'i bindeni sa më parë padishahut. Kjo do të jetë më e mira për ju. Sido që të jetë, ju nuk do të akuzoheni dhe nuk do të paditeni, por do të meritoni mëshirën dhe hirin mbretëror. Sigurimi i të varfërve dhe i të pafuqishmëve ka qënë në çdo kohë detyrë për ne... Kjo nuk ka nevojë të argumentohet. Ne e shkruam këtë letër dhe e dërguam tek ju me qëllim që ju të nxiteni për të përfituar nga shpirtmadhësia e sulltanit, duke parashtruar në çdo rrëth kërkesat tuaja... Shpresojmë se ju do t'i pranoni dhe do t'i vini në jetë këto porosi e këshilla dhe do ta largoni veten tuaj nga dënim i dëngjë gjësia që do të kishit në këtë jetë dhe në jetën e pasosur, në qoftë se do të vazhdoni këtë luftë të pa justifikuar».¹⁾

Pikërisht në këtë kohë Stambolli shpalli amnistinë për gjithë kërret opozitarë me Portën e Lartë, ndërsa udhëheqësin e shqar Zylyftar Podën nën maskën e bashkëbisedimit e thirrën dhe e mbajtën në Stamboll.²⁾ Është shumë interesant në atë kohë një raport sekret i valiut të Rumelisë Mahmud Hamdi pashës që i sugjeron kryeadjutantit të oborrit se Zylyftar Poda me të dy dje-mtë e tij duhej dënuar rëndë. Kur mori dijeni për këtë sultani Mahmudi II iu përgjigj kështu valiut të Rumelisë: «Do të dënohen kur të vijë koha, por mos lëshoni fjalë, duhet të mos ketë dijeni Zylyftar Poda».³⁾

Gjatë kësaj kohe valiu i Rumelisë hyri në bisedime me kryengritësit dhe u premtoi se do të hiqte dorë nga zbatimi i reformave centralizuese osmane në këto krahina. Me këto premtimet ai e hodhi përsëri në dorë kalanë e Beratit.

1) Po aty. Vesika 22001 B, 16 shtator 1833.

2) Foreign Office (më tej FO) 195/97, X/J 6621. Letër e kon-sullit britanik në Shqipëri drejtuar ambasadorit britanik në Stamboll. Prevezë, 26 prill 1834, fq. 355-359. Përkthimi gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë A-80.

3) BAI. F. H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 22021.

KUROREZIMI I KRYENGRITJEVE POPULLORE ME VETEQEVERISJEN E NENTË KRAHINAVE SHQIPTARE

Kryengritësit shqiptarë përsëri e vazhduan luftën. Mahmud Hamdi pasha edhe pse i pranoi kushtet e shqiptarëve, nuk i vuri në jetë kërkesat e tyre. Ai filloi çarmatimin e përgjithshëm të popullsisë dhe në forma të tertiorta u vu në ndjekje për kapjen e udhëheqësve të kryengritësve. Në këto rrethana Tafil Buzi u hodh në Korfuz:

«...Kudhësjotë*) mir' e prinë;
Me treqind desh e gostinë,
— Nga do t'a shkojmë Tafilë?
— Mespërmes Labërinë,
Në Korfuz van' e vërvinë,
Që turqit të mos e dinë...»

Greqia qysh prej pesë vjetësh kishte fituar pavarësinë e saj. Por qeveritarët e Athinës përpinqeshin që kryengritjet shqiptare t'i shfrytëzonin në dobi të tyre.

Kryeministri i atëhershëm i Greqisë Jani Koleti, me origjinë nga Sirakoni i Epirit, ishte folës i mirë i gjuhës shqipe dhe pat qënë mjak i djalit të Ali pashë Tepeleinës, Myftarit, kur ky i fundit ishte vali në Morë¹⁾. Ky kryeministër i inkurajonte shqiptarët për luftë kundër Turqisë dhe u jepte atyre strehim politik sa herë që ndiqeshin nga Turqia.²⁾ Kryeministri Jani Koleti i kishëte premtuar Tafil Buzit me shokë në Korfuz, se me t'u futur ata në luftë kundër Turqisë, Greqia do t'i shpalte

*) Kudhës quhen fshatrat rreth Sëvasterit të Vlorës.

1) Revista «O neos kuvaras», Art. cit., fq. 154.

2) K. Paparigopoulos. «Historia tu Heleniku Ethnus». Athinë, 1865, vëll. VI, libri 15, fq. 267-268.

luftë Stambollit dhe me qëllim nxitjeje preu dhe marrëdhëniet diplomatike me qeverinë turke, duke organizuar dhe disa incidente lokale në kufijtë e saj me Turqinë.

Në muajin mars 1834, Tafil Buzi, Zenel Gjoleka, Mahmud Bajraktari (me mbiemrin Kollovi nga Luarat i Margëllëcit) dhe Nurçe Toska me shoqëruesit e tyre largohen nga Korfuzi dhe zbarkojnë në Dukat të Vlorës¹). Sipas folklorit:

«*Erdhi karta nga Korfuzi,
Thonë doli Tafil Buzi,
Thonë se doli në Vlorë,
Me tre bajrakë në dorë...»²*

Këta kapedanë në rrëthin e Vlorës gjetën kudo përkrahësit e tyre. Fshatrat e «Lumit të Vlorës» ishin ngritur në këmbë nën udhëheqjen e Mete Jazos nga Dukati e Cane Myftarit nga Smokthina. Me këto forca u bashkuan dhe luftëtarët e Kudhësit me në krye Ymer Ali Kudhësin nga Shkoza. Çelo Picari gjatë kësaj kohe kishte mbledhur luftëtarë të shumtë në Kurvelesh dhe në rrëthin e Tepelenës dhe kishte zënë gjithë shtigjet nga ku mendohej se mund të vinin forcat turke.

Territori i Tepelenës ishte pastruar nga forcat turke dhe nga bandat mercenare të pushtuesit. Të shumta ishin municionet dhe armët e mbledhura nga Çelua. Pleqtë tregojnë se në vendlindjen e Çelos në Picar, në vendin e quajtur «Buç», në sheshin e Qarit, ai kishte vendosur topat, dhe atje në një shpellë kishte depozituar dhe barutin:

«*Çelo Picari me vulë,
I mban topatë në buzë,
Lufton me sultani Mahmunë,
Që ka topa gjylë shumë,
Dyzet vjet se sos barunë...»³*

1) P. Aravantinoi. Vep. cit., fq. 398.

2) AIF (Dosja II M.K.)

3) AIF (Dosja II M.K.)

Gjatë kësaj kohe Mahmud Hamdi pashai i kishte zëvendësuar forcat vendase që ruanin kështjellat me ushtarë të rregullt jo shqiptarë, të sjellur nga krahinat e tjera të Perandorisë Osmane dhe për efekte të rekrutimit të detyrueshëm ushtarak kishte filluar regjistrimin me forcë të popullsisë. Të gjitha këto reforma centralizuese ushtarake, administrative dhe financiare osmane i kishin prekur rëndë shqiptarët në ndjenjat e tyre kombëtare. Në këto kushte të rënda bijtë e këtyre krahinave u ngritën përsëri në këmbë dhe vendosën që pushtuesit osman t'i përgjigjen përsëri me grykën e pushkës.

Sipas të dhënave historike, shqiptarët u hodhën në revoltë të hapur kundër turqeve. Kryengritjet e Jugut filluan të gërshetohen edhe me ato të Veriut. Këto të dhëna pasqyrohen qartë në raportin e Hamdi pashës që mban datën 1 maj 1834. Ja çfarë thuhet në këtë letër: «... Populli i Toskërisë dhe ai i Gegërisë kanë vendosur njëzëri që të mos jepin ushtarë dhe të mos lënë kusur për të ndihmuar njëri-tjetrin. Ata janë lidhur fshehu-razi dhe kanë bërë konspiracion...».¹⁾

Në fakt turqit, në këtë kohë, ushtronin pushtetin e tyre vetëm nëpër qytete. Por edhe atje shqiptarët nuk i lanë të qetë pushtuesit. Kryengritësit zbritnin vazhdimisht nëpër qytete dhe vrissnin e digjin gjithçka që ishte e pushtuesit osman. Luftëtarët shqiptarë në 27 qershor 1834 arritën të djegin rezidencën e qeveritarit të përgjithshëm të Rumelisë në Manastir.²⁾

Sipas Aravantinoit, «Tafil Buzi me shokë në Tepe-lenë formoi një ushtri prej dy mijë vetësh dhe së bashku shkuan e qiruan Beratin me përjashtim të kalasë».³⁾

Luftëtarët e udhëhequr nga Tafil Buzi, Çelo Picari dhe Veiz Vasjari me shokë e kishin rrethuar nga të gjitha

1) BAI. F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21712, B. dt. 1.5.1834.

2) Petrika Thëngjilli: «Kryengritjet popullore antiosmane në Shqipërinë e Jugut gjatë viteve 1833-1835». Revista «Studime Historike» nr. 3, viti 1977, fq. 160.

3) P. Aravantinoi, Vep. cit., libri 6, fq. 398, paragr. 57.

anët kështjellën, por garnizoni turk ishte përforuar atje me forca të freskëta që i kishin ardhur nga Kavaja dhe Elbasani.

Kryengritësit e panë të nevojshme të merrnin kryegendrën e vilajetit, Janinën. Sipas vendimeve të marra, Çelo Picari me njerëzit e tij mbeti në rrëthimin e kalasë së Beratit dhe në prite të sulmeve turke që mund të vinin nga krahina e Elbasanit dhe e Vlorës. Forca të shumta osmane ishin përqëndruar në atë kohë në Kavajë dhe në Ohër. Pjesa tjetër e kryengritësve nën udhëheqjen e Tafil Buzit, Zenel Gjolekës, Mahmud Bajraktarit etj. u drejtuan pér çirimin e Janinës, duke shpresuar se hordhitë turke këtë radhë do të viheshin edhe midis zjarrit të forcate greke, sipas marrëveshjes që kishin bërë në Korfuz me kryeministrin grek Jani Koletin. Në fakt ngjarjet morën rrjedhim tjetër. Në afërsi të Janinës, gjashtë orë larg saj, në fshatin Cërvor të Zagorit luftëtarët shqiptarë u rrëthuan keqas nga forcat e shumta të komandantit turk Hasan agait, të cilit i vinin vazhdimisht përforcime. Shqiptarët mbetën vetëm, sepse grekët nuk u ranë forcate turke. Vetëm mbas pesë ditë luftimesh të përgjakshme kryengritësit mundën të çanin rrëthimin dhe u larguan në drejtim të Tepelenës.¹⁾

Këngët e vjetra popullore e përshkruajnë qartë kapedan Tafil Buzin e zemëruar nga tradhtia e qeverisë greke e Jani Koletit, që i la në baltë aleatët e saj shqiptarë në luftën fatkeqe të Cërvorit. Sipas këtyre vargjeve të hershme popullore Tafil Buzi iu drejtua shokëve të tij të armëve si Çelo Mehmetit (Picarit) me shokë, që ta ndihmonin pér t'i dhënë një mësim të mirë kësaj aleateje tradhtare:

«Ra një ves' e zbuti dhenë,
Ra Tafili n'Tepelenë,
Selam pér Çelo Memenë,
Thoni të lëroj dervenë,

1) P. Aravantinoi. Vep. cit., libri 6, fq. 398, paragr. 57.

*Se do shkoj të djeg Morenë,
 Do ta djeg se shkeli benë...
 Moré e zeza Moré,
 Në të ardhça dot atje,
 Do të djeg si kallamé...»¹⁾*

Çelo Picari nuk e lejoi Tafil Buzin të shkonte në luftë kundër Moresë (Greqisë), mbasi armiku i vendit të tyre në atë kohë ishte Turqia. Njëkohësisht anëtari i kryesisë së ku vendit ndërkrahinor të Beratit (7 nëntor 1828), Shahin Delvina kishte lidhur në Korfuz edhe një marrëveshje mossulmimi me qeverinë greke të Kapodistrias.²⁾

Rreth këtyre ngjarjeve ka të dhëna se Çelua nuk ua lejoi kalimin në Derven (rruga që shpie drejt Gjirokastrës dhe Janinës) forcave të Tafil Buzit zemërak. Në këto rrethana luftëtarët shqiptarë u ndeshën dhe me armë me njëri-tjetrin në afërsi të mullinjve të Tepelenës, ku nga radhët e forcave të Çelo Picarit thuhet se pati dhe një të vrarë.

Sidoqoftë, ky trim i Picarit e vlerësoi drejt gjëndjen. Në verë të vitit 1834 Stambolli dërgoi në Shqipëri një forcë të madhe ushtarake nën kryesinë e Daut pashës, i cili ishte betuar se do t'i shtronte «qafirët» shqiptarë që nuk donin t'i bindeshin padishahut, me zjarr dhe me hekur.³⁾

Gjatë kësaj kohe vala e kryengritjes përfshiu shtatë krahina: Vlorën, Tepelenën, Skraparin, Tomoricën, dy Mallakastrat dhe Dëshnicën. Këto krahina nën frymën e kuvëndit ndërkrahinor të madh të Beratit (të vitit 1828) në vjeshtë të tretë të vitit 1834, u mblodhën në një «besëlidhje» për luftë kundër pushtuesit osman. Atje zgjodhën

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Shih referimet mbi përshkrimin e kuvëndit ndërkrahinor të Beratit, 7 nëntor 1828 (më lart).

3) FO, 195/97, X/Y 6621. Letër e W. Meyerit. Prevesa, 8 nëntor 1834.

edhe një pleqësi me përfaqësues nga të shtatë krahinat e lartpërmendura.¹⁾

Udhëheqësit e kryengritjes ranë në marrëveshje edhe me krerët opozitarë të krahinave Veriore të Atdheut. Ata përgatitën një plan të përgjithshëm, që mbas hedhjes në dorë të kalasë së Beratit, një pjesë e mirë e kryengritësve do të shkonte për çlirimin e Shkodrës, ndërsa pjesa tjetër e luftëtarëve, të përkrahur nga kryengritësit e sanxakut të Delvinës do të sulmonte Mahmud Hamdi pashtën në Janinë.²⁾

Tashqi Tafil Buzi me forca të shumëfishuara çlroi qendrën e madhe administrative dhe ushtarake, Beratin (me përjashtim të kalasë) dhe shpérndau në popull gjithë bereqetin e depove të shtetit.³⁾ Me këto krahina kryengritëse u bashkua dhe Verça e Sulova e Elbasanit^{4).}

Vegjelia e këtyre krahinave kryengritëse nuk përmbahej nga urrejtja e madhe që kishte për pushtuesin dhe për feudalët turkomanë të vendit. Mbarë masat fshatare i shtynin udhëheqësit kryengritës të tyre të merrnin Beratin dhe të shpallnin atje vetëqeverisjen e vendit.

Tashqi luftëtarëve të shumtë të Tafil Buzit, të Çelo Picarit, të Mete Jazos nga Dukati, të Cane Myftarit nga Smokthina etj. u erdhën në ndihmë bijtë e Skraparit dhe të Tomoricës me në krye Pasho Kokën nga Kapinova, Selfo Jaskëllarin nga Backa me Kajo Bylykbashin (Hasa) etj. Këtyre kryengritësve iu shtuan dhe luftëtarët e Deshnicës dhe të Mallakastrës. Kryengritësit, sipas dokumentacionit që përputhet plotësisht dhe me këngët e hershme popullore, në rrëthimin e kështjellës së Beratit arrin-

1) Gazeta «Novine Srbske», dt. 30.3.1835.

2) BAI. F, H-H Def. 24-31, vesika 51010.

3) Archives du Ministère des Affaires Etrangères de France. (më tej AMAE). Turquie, CPO, vëll. 4, fq. 174. Prevesa, 3 nëntor 1834.

4) BAI. F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21500. Po aty. Vesika 21719 A.

nin deri në 25000 luftëtarë¹). Sipas folklorit vetëm nga Lumi i Vlorës zbritën në fushën e luftës 9000 kryengritës:

*Berati me Toskërinë,
Delvina me Çamërinë,
N'Velabisht ngritet hordhinë,
Në Murat-Çelepias hanë tainë...
Me dyzet palë shkallë,
Të zën' Myhyrdar të gjallë,
— Myhyrdar mustaqeverdhë,
Priti trimat se t'u derdhë,
Le kalan' me gjithë redhë,
Se të thërresim po si kedhë,
Le kalanë dil si çupë,
Shqipëria s'do halldupë... »²)*

Sikurse e dëshmon qartë folklori përpara mureve të kalasë së Beratit i gjejmë të vëllazëuar për luftë kundër pushtuesit turk po thuaj të gjithë kryengritësit e Shqipërisë së Jugut. Ata, mbasi hëngrën së bashku tainin (racionin e ushqimit në mbrëmje, në lagjen e Beratit, Murat Çelepias, pritën sa u errësua mirë dhe pastaj filluan sulmin për të marrë kalanë. Në muret e kësaj kështjelle u vendosën nga kryengritësit me dhjetëra shkallë. Sokëllimat e luftëtarëve shqiptarë me ja-ja-të e tyre tradicionale dëgjo-heshin kudo në mes të errësirës së natës. Këto zëra ngjethëse u futën tmerrin mbrojtësve osmanllinj të kalasë. Me qindra e mijëra kryengritës, me rrobat karakteristike shqiptare të bardha, të ngjitur nëpër shkallët e drunjta u quajtën si fantazma nga ushtarët e porsaardhur turq për mbrojtjen e kështjellës. Një pjesë e mirë e luftëtarëve arri-tën të mbështesnin këmbët sipër në bedenat e kalasë ku u përleshën grykë më grykë me mbrojtësit osmanllinj të kështjellës. Kudo dëgjoheshin çukitjet e pallave dhe rënkimet e të plagosurve.

1) P. Thëngjilli. Vep. cit., fq. 163, shënimi 37.

2) AIF, (Dosja II, M.K.).

Turqit luftonin tē dëshpëruar, ndërsa morali i kryengritësve ishte i lartë. Tē panumërtë janë heroizmat e bijvë tē vegjëlisë shqiptare në këtë betejë tē përgjakshme malore. Vlen tē përmendet veganërisht në këto luftime udhëheqësi i luftëtarëve të Smokthinës Cane Myftari, i cili kishte dalë vetë në ballë tē luftës, krah më krah me kordhëtarin e Dukatit, Mete Jazon. Ata i qenë ngjitur tē dy shkëmbit tē kalasë.

Osmannlinjtë tē fshehur mbas frengjive tē mureve tē kështjellës villnin pa rreshtur zjarr mbi këta dy luftëtarë tē kazasë së Vlorës. Tē dhënat popullore tregojnë se zëri kumbues i këtyre dy trimave, që ishin ngjitur në majë tē shkëmbit, në afërsi tē kalasë, u jepte zemër luftëtarëve tē tjerë shqiptarë. Gjatë kësaj përleshjeje tē pabarabartë u plagos rëndë trimi e vegjëlisë labe Mete Jazua nga Dukati. Ai, edhe pse me dy plagë tē rënda në krahëror u hodh dhe e zuri i pari fortifikatën e përparuar turke: kullën e kuqe (sot kisha), në afërsi tē kalasë. Në këtë kohë, luftëtarë tjetër i kazasë së Vlorës Cane Myftari duke e parë kordhëtarin trim Mete Jazo tē mbështetur pas shkëmbit e tē mbytur në gjak, hidhet me shpejtësi midis plumbave tek Metia i plagosur dhe e zëvendëson atë në pozicion, mba-si i lidh shpejt atij plagët me këmishën e tij tē grisur dhe e nis me pasuesit e tij në prapavijë:

«Mete Jazua i gjakëtar,
Kullën e kuqe ç'e muarr,
U plagos në kraharuar,
Dy plumba përtej e shpuan,
Dot për toke nuk e shtruan,
Në Dukat e shpun kaluar,
Samari me gjak mbuluar,
E mban e ëma në duar,
E qan e motra në shkallë
— Ngreu Mete sha vëllamë,*

* Sha vëllamë — Shprehje përforcuese dialektale, përdoret shpesh në Labëri.

*Të shkosh me Cane Myftarë,
Të luftosh me Turqistanë,
Ashtu si keshe zananë... »¹⁾*

Aty nga mesi i dhjetorit 1834 mbas disa muajve luftë e përpjekje të përgjakshme kalaja e Beratit ra në duart e kryengritësve^{2).}

Kryengritësit shqiptarë tashti nuk i besuan më premtive përsëritëse të Mahmud Hamdi pashës, se, sipas tij, këtë radhë do t'i respektojë kërkesat e shqiptarëve pér vetëqeverisjen e vendit. Ata iu përgjigjën pashait osmanlli se këtë të drejtë e kanë fituar me grykën e pushkës dhe s'ka arsy e pyetet valiu i Rumelisë pér punët e tyre të brendshme.

Në këtë kohë, luftëtarët shqiptarë nga këto nëntë krahina kryengritëse zgjodhën një garnizon prej 100 vetašh pér ruajtjen e kalasë së Beratit, hodhën dorën dhe në mjaft çifligje të shtetit dhe bylykbashët, që ruanin qytetin i zëvëndësuan me trima nga radhët e kryengritësve.³⁾

Në këto rrethana, pushtuesit turq, atë që nuk e fituan dot në fushën e betejës dhe të mashtrimit, e arritën me anën e renegatëve të vendit. Këta pas disa kohësh ia dorëzuan përsëri kalanë Mahmud Hamdi pashës.

Por valët e reja të pushtimit patën përsëri valë të reja luftërash nga kryengritësit. Kështu në fund të muajit shkurt 1835 trimi Tafil Buzi me shokë mblodhi rrëth vetes 6000-8000 luftëtarë dhe iu vërsul përsëri kalasë së Beratit, por kjo kështjellë këtë radhë ishte e përforuar shumë me ushtarët e shumtë të Daut pashës. Në këto rrethana kryengritësit u nisën në drejtim të Elbasanit.⁴⁾

1) AIF. (Dosja II M.K.)

2) P. Thëngjilli. Vep. e cit., fq. 167.

3) BAI. F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21500, vesika 21719 A. Po aty. Def. nr. 24-31, vesika 49034, B. Letër e kryeministrit drejtuar myshirit të Pallatit.

4) O. Daniel, Choix des documents historiques et géographiques concernant l'Albanie. Paris 1967-1968, vell. Annexe fq. 158-159.

Kryengritjet shqiptare u shtrinë edhe në rrithin e Elbasanit etj.

Në një raport drejtuar Stambollit nga pashallarët turq në Shqipëri më 14 prill 1835 thuhet se opozita antiturke e Elbasanit e ka zakon të jetë kundërshtare. Ata bëjnë ngatërresa.¹⁾

Stambolli, duke e parë veten ngushtë përpara kryengritjeve shqiptare, arriti deri aty sa t'u kërkojë ndihmë Fuqive të Médha evropiane. Në përgjigje të kësaj kërkesë shtetet e mëdha evropiane i premtuan sulltanit se ata do të mblidheshin për ta biseduar kérkesën turke.²⁾

Është shumë interesante përgjigjia që i drejtoi Portës së Lartë ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, politikani i regjur, princi Meternik. Ai letrën e tij e nis me këto fjale: «Austria dëshiron rregull e qetësi në Perandorinë Osmane». Mës i dënon veprimitarët kryengritëse shqiptare, në fund shton se: «Për këtë gjë ka njoftuar dhe ministrin anglez të Punëve të Jashtme. . . »³⁾

Osmannlinjtë, megjithë kérkesat e tyre përulëse drejtuar Fuqive të Médha evropiane, për të mos lejuar strehimin e kryengritësve shqiptarë në shtetet e tyre, ata nuk ia arritën dot qëllimit. Kryengritja popullore gjatë vitit 1835 u zgjerua shumë. Kryengritësit në këtë kohë iu drejtuan Janinës, duke përshkuar krahinat Elbasan-Përmët. Në qafën e Mavrovunit, 8 orë larg Janinës, ata thyen një repart kalorësish të zgjedhur turq dhe kapën rob komandantin e tyre. Tafil Buzi shpérndau dhe një shpallje për popullsinë. Në këtë shpallje kérkohej dëbimi i nëpunësve dhe i ushtarëve të rregullt turq nga tokat shqiptare, ulja e taksës së xhizjes në masën e kohëve të shkuara.

Kérkesat e pasqyruara në këtë shpallje kanë të bëjnë me vetëqeverisjen e tokave shqiptare me në krye një pasha shqiptar, por pa u shkëputur nga Perandoria Osmane. Forca të shumta turke, që i kalonin të 9000 vetët,

1) BAI. F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21708 A, dt. 14.1835.

2) Po aty, Vesika 22004.

3) Po aty, Vesika 46898.

rrethuan fshatin Ostanica, ku gjendeshin kryengritësit, të cilët ishin në pritje të forcave të tjera kryengritëse. Pas një rezistence të gjatë, natën e 2 majit 1835, Tafil Buzi çau rrethimin dhe u tërroq në Konicë.¹⁾

Në muajin maj 1835 në Myzeqenë e shumëvuajtur plasi kryengritja nën udhëheqjen e Alush Frakullës. Ata sulmuan çifligjet shtetërore dhe i shpallën prona të tyre.²⁾

Të shumta kanë qënë betejat e këtyre kryengritësve në rrethin e Beratit. Rapsodët populorë i ngrenë lart figurat e ndritura të bijve të Myzeqesë së dikurshme, plot këneta e moçale, të shfrytëzuar deri në palcë nga bejlerët, agallarët e sundimtarët e huaj. Myzeqari trim diti t'i bëjë llogoret edhe nga driza kur është puna për të luftuar armikun osman që i ka zënë atdheun.

Ja njëra prej këtyre këngëve të hershme popullore:

«— *U bubu q'ësht' ky hiqmet!**
— *Lufton mbreti me një mizë,*
Alush Frakulla në Myzeqet,
I bën llogoret nga drizë...,
Myzeqarëtë luftojnë,
Nëpër shi e në dëborë,
Jo si agallarët tanë,
Në të shir' e në të korrë...»³⁾

Kryengritja e Myzeqesë lindi si kundërshtim i Portës së Lartë që nuk donte të respektonte kërkesat e shqiptarëve për vetëqeverisjen e vendit.⁴⁾

Alush Frakulla kishte lëshuar kushtimin në mbarë popullin e Myzeqesë dhe të Tepelenës për organizimin e një besëlidhjeje për luftë kundër Turqisë. Ky luftëtar

1) P. Thëngjilli, Vep. cit., fq. 173, 174.

2) BAI. F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21498. Letër e valiut të Rumelisë, 25 maj 1835.

*) Hiqmet (fjalë arabe) — çudi.

3) AIF (Dosja II M.K.)

4) P. Thëngjilli, Vep. cit., fq. 177.

kishte si udhëheqje për veprim parullën: «Të mbrojmë të drejtat e popullit, të fakirëve dhe të fukarenjve».¹⁾

Vala kryengritjes së Myzeqesë përfshiu dhe krahi-në e Vlorës. Në fshatin Portezë, në afërsi të qytetit të Beratit u organizua dhe një mbledhje e përbashkët me përfaqësuesit e këtyre krahinave kryengritëse. Atje vendosën dhe krijimin e një ushtrie të përhershme me rrogë mujore, shpenzimet e së cilës do të dilnin nga të ardhurat e ish-qifligjeve shtetërore të sekuestruara. Forcat e kësaj besëlidhjeje arrinin deri në 7000 luftëtarë.²⁾

Në një raport drejtuar Portës së Lartë nga valiu i Rumelisë në datën 24 maj 1835 thuhet: «Vetëm në Shqipëri nuk mund të quhet gjendje e qetë, sepse shumica e popullit shqiptar kanë vënë vulat në një «Besëlidhje». Megjithëse nuk dalin fort në shesh, po nxisin elementin mëndjelehtë... Nxjerrin fesate. Në këtë varg na del tashti Alush Frakulla në rrëthet e Beratit... Duke marrë parasysh dhe ngjarjet e tillë të Shkodrës, afirmohet se populli i Toskërisë është i bashkuar me atë të Gegërisë»³⁾. Këtu valiu ka patur parasysh dhe revoltat në Veri të Atdheut, mbasi kryengritjet popullore gjatë vitit 1835 kishin arritur deri në Shkodër. Luftëtarët shkodranë nën udhëheqjen e Hamza Kazazit dhe Dasho Shkreli me shokë ishin ngritur në këmbë kundër sundimtarit të egër osman Hafiz pashës. Dihet botërisht kjo këngë e hershme popullore:

«O moj Shkodër, moj mizore,
Pak u duke shum' na dole,
Po lufton me tet' tabore,
Hafiz pasha kryelopa,
S'merret Shkodra me tri topa,
As me topa as me havana,
Dasho Shkreli s'ban ma nana,
Preu beglerët ke mejhana...»

1) BAI, F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21466.

2) P. Thëngjilli, Vep, cit, fq. 175.

3) BAI, F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21498.

Gjatë vitit 1835 sundimtari turk i Shkodrës kishte filluar të zbatonte me forcë në këtë krahinë veriore të atdheut reformat skllavëruese osmane. Ai kërkonte çdo ditë në popull ushtarë dhe taksa të shumta.

Gjatë muajit maj 1835 trimat e vegjëlisë shkodrane Hamza Kazazi e Dasho Shkreli me shokë dhanë kushtrimin për luftë kundër sundimtarit të egër osman i njohur në popull «pashë kryelopa»:

*«... Të martën në dy jaci,
Në Shkodër u xu nizaja,
Kush të jetë trim dai,
Le të shkojë te 'Hamzaja...»*

Gjatë kësaj kohe u erdhën në ndihmë trimave të Shkodrës tre mijë malësorë të armatosur me llojet më të ndryshme të armëve deri tek sëpata e hanxhari. E shumtë ishte dhe vegjëlia shkodrane, që u ngrit në këmbë për luftë kundër pushtuesit turk.

Hafiz pasha, me topat e tij, filloi të qëllojë pareshtur kryqëzimet e rrugëve të Shkodrës. Ky qytet pothuaj gjatë gjithë muajve të verës 1835 u kthye në shesh lufte. Luftëtarët e kësaj krahine luftonin me vetëmohim. Ata çdo rrugë e rrugicë të qytetit e kishin kthyer në barrikadë. Luftime të përgjakshme u zhvilluan sidomos në afërsi të xhamisë së Haxhi Bajramit:

*«... Te xhamia e Haxhi Bajramit,
U dha një tym e një flakë,
Aty u gjetn' zogjt' e shkodranit,
Nizamin e hoqn' nën shpatë...»*

Të shumta ishin dëmet që pësuan armiqjtë në këto beteja. Vetëm mbas urës së Bunës mbetën një sasi e mëdha të vrarësh dhe të plagosurish. Sipas folklorit:

*«... Hafiz pasha n'daç me i hikë vorrit,
Zdrypi atit, hyp vaporit...»*

Sundimtari turk Hafiz pasha përparrë disfatave që pësonte çdo ditë nga kryengritësit u detyrua të mbyllej me ushtrinë e tij në kalanë e Shkodrës, por edhe atje lutfëtarët shqiptarë nuk e lanë të qetë. Këta trima i ushtruan armikut bllokadën ekonomike. Rreth ligjenit kryengritësit kishin vendosur forca të shumta për të mos lejuar asnje varkë me ushqime t'i afrohej kalasë.

Forcat e Hamdi pashës ishin urdhëruar të kalonin në Veri në ndihmë të Hafiz pashës, por këto forca ishin gozhduar në Jug të Shqipërisë në luftë me kryengritësit toskë.

Në këto rrethana të vështira, Porta e Lartë e udhëzoi valiun e Rumelisë që të bënte lëshime në drejtim të zbatimit të reformave centralizuese osmane në krahinat e Jugut.

Sipas udhëzimeve të dhëna, nuk do të kishte më shërbim të detyrueshëm ushtarët. Turqisë paskëtaj i mjaftonin vetëm ushtarët që do të regjistroheshin vullnetarisht.

Por, kur osmanllinjtë panë se dhe me këto lloj manovrimesh nuk mundën t'i mashtronin shqiptarët, atëhere valiu i Rumelisë Mahmud Hamdi pasha u detyrua më në fund të binte në marrëveshje me kryengritësit.¹⁾

Luftëtarët shqiptarë të përfaqësuar nga Çelo Picari i parashtruan valiut të Rumelisë këto kërkesa (të njëllojta me ato që u shtruan në kuvendin e madh ndërkrahinor të Beratit në muajin nëntor 1828.²⁾)

1) Administrimi i krahinave kryengritëse t'u besohet vetëm shqiptarëve të zgjedhur nga popullsia e vendit.

2) Turqit të mos përzihen në punët e brendshme të vendit.

3) Të ndalohet zbatimi në këto krahina i reformave

1) «Le Courrier Grec», 1837, nr. 20, fq. 81.

BAI, F, H-H, Def. nr. 1, 2, 12, vesika 21247. Letër e Hamdi pashës.

2) Po aty. Vesika 21513 — I.

Shih dhe P. Aravantinoi. Vep. cit, libri 6, fq. 398, paragr. 57.

centralizuese turke, konkretisht në administratë dhe në ushtri.

4) Qeveria turke të shpallë sa më parë amnistinë për gjithë kryengritësit dhe të heqi dorë nga çarmatimi dhe nga prekja e pasurisë së tyre.

5) Kryengritësit merrnin përsipër të mos i sulmojnë garnizonet turke të Toskërisë, vetëm në qoftë se qeveria turke do të plotësonte kërkesa e tyre.

Stambolli i ndodhur ngushtë i pranoi këto kërkesa. Qeveria osmane shpalli amnistinë për gjithë kryengritësit dhe pushoi çdo ndjekje kundër tyre. Kjo marrëveshje u vu në jetë përfundimisht në fillim të vitit 1836. Sipas marrëveshjes, administrata osmane u tërroq nga këto nëntë krahina shqiptare kryengritëse dhe vendin e saj e zunë përfaqësues të zgjedhur nga popullsia e Skraparit, Lëshnicës, Tepelenës, Mallakastrës së Sipërme dhe të Poshitme, Vlorës dhe Tomoricës.

U dërguan përfaqësues gjithashtu dhe nga Sulova e Vërça si krahina fqinje dhe pjesëmarrëse në lëvizjen e përbashkët kryengritëse.¹⁾

Krerët e këtyre nëntë krahinave si Tafil Buzi, Çelo Picari, Veiz Vasjari, Cane Myftari, Zenel Gjoleka, Nurçe Toska, Pasho Koka, Selfo Jaskëllari etj, pas shpalljes së amnistisë u mblohdën në kështjellën e Beratit, ku u vendos kryeqendra administrative e këtyre nëntë krahinave kryengritëse, që do të merreshin me qeverisjen e mbarë këtyre nëntë krahinave.²⁾

Për rolin e Çelo Picarit, si drejtues dhe përfaqësues të kryengritësve në këtë marrëveshje shqiptaro-turke, flet qartë dhe folklori:

«O Çelo, Xhelo, Xhelili,
Gjuha jote si birbili,
Celon e kërkon Tafili,
Në kuvend e pret veziri,

1) BAI. F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21695-A.

2) Po aty.

*Moj thëllëz' e par' e prillit,
Më dëgjo zën' e Xhelilit,
Në sarajet e vezirit,
Si ja pret fjalën qafirit... »¹⁾*

Në mbledhjen e parë të Beratit përfaqësuesit e këtyre krahinave morën këto vendime:

1 — Të rikthehet në krahinat e tyre mënyra e vjetër e administrimit e ngjashme me atë të kohës së shtetpashallëqeve autonome shqiptare të Ali pashë Tepelenës.

2 — Baza e administrimit të vendit të jetë pushteti lokal, i përbërë prej këshillit të pleqve, i cili do të ngrihet në çdo qendër banimi në rang fshati e qyteti.

3 — Këshilli i pleqve të vishet me funksionin administrativ dhe gjyqësor, duke u mbështetur kryesisht në të drejtën zakonore.

4 — Përfaqësuesit e këshillave krahinore të pleqësisë do të kenë qëndrimin e tyre të pérhershëm në kështjellën e qytetit të Beratit.

5 — Shpenzimet e kësaj administratë do të përballohen kryesisht nga vjelja e taksave të vjetra, si ajo e së dhjetës etj.

6 — Luftëtarët shqiptarë do të luftojnë vetëm nën udhëheqjen e krerëve të krahinave të tyre që do të veprojnë sipas udhëzimeve të marra nëpër mbledhjet e përbashkëta të përfaqësuesve të këtyre krahinave në Berat (kryeqendra e tyre e përbashkët).²⁾

Sesa e dëmtonte pushtuesin osman kjo fitore e popullit tonë pasqyrohet qartë në raportin e lëshuar nga

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) BAI. F, H-H, Def. 1, 2, 12, vesika 21513, vesika 21716-G. Revista «O neos kuvaras». Art. cit. fq. 167-187.

M. Kokalari, «Besëlidhja shqiptare dhe kryengritja e madhe fshatare e vitit 1847». Rev. «Studime historike» Nr. 2/1974, fq. 136-140.

valiu i ri i Janinës, Seit Ahmet pasha, i cili zëvendësoi Mahmud Hamdi pashën. Ky pasha i ri, i trondititur nga rezistenca që i bënte populli i Sulovës dhe i Vërçës, duke mos mundur t'i ndajë këto dy krahina nga lëvizja e Toskërisë i sugjeron në raportin e tij Stambollit:

«Sulova dhe Vërça si fqinje të Toskërisë përzihen në lëvizjet e tyre. Në kohën e paraardhësit tim, të ndjerit Mahmud Hamdi pashës, toskëtë ëndërruan dhe u orvatën që gjithë punët e vendit të kqyreshin vetëm me pëlqimin dhe me anën e vetë popullit të Toskërisë. Për këtë qëllim vendosën në kalanë e Beratit përfaqësuesit e tyre. Rrethanat e kohës e detyruan Mahmud Hamdi pashën të pranonte. Kur u vu në zbatim shtatë kazatë: Skrapari, Dëshnica, Tepelena, Mallakastra e Sipërme dhe e Poshtme, Vlora dhe Tomorica dërguan dhe vendosën përfaqësuesit e tyre në kalanë e Beratit. Thirrën dhe nga popullsia e Sulovës dhe e Vërçës që të dërgonin përfaqësuesit e tyre. Kështu në kala u vendosën përfaqësuesit e nëntë kazave dhe nuk kanë kaluar shumë kohë që punët u zhvilluan në këtë mënyrë. Duhen izoluar krahinat, vetëm (të veçuara) nuk do të bëjnë gjë...»¹⁾

Vetëkuptohet se këto kryengritje popullore të viteve '30 të shek. XIX, në krahasim me lëvizjet e mëparshme, përbëjnë një etapë më të lartë të Lëvizjes Kombëtare, mbasi ato u zhvilluan me një vrull më të madh, me një shtrirje më të gjerë dhe me një përmbajtje të re. Në ballë të luftës kundër pushtuesit nuk ka më luftë të kufizuar të klasës feudale por forca të reja të masave popullore.

Gjendja në Shqipërinë e Jugut u normalizua. Garnizonet turke tashmë ishin kufizuar në disa pikat e caktuara të Shqipërisë së Jugut dhe ishin urdhëruar nga Stamboli të mos përziheshin në punët e brendshme të shqiptarëve.

Shumica dërrmuese e kryengritësve u kthyen në vatrat e tyre. Bjtë e Shqipërisë nuk do të braktisnin më

1) BAI, F, H-H, Def. Nr. 1, 1, 12; vesika 21695, dt. 27 mars 1837,

ekonomitë e tyre dhe nuk do t'i linin më kockat duke luftuar në krahinat e largëta të Perandorisë së madhe Osmane.

Të drejtat e fituara nga kryengritësit shqiptarë nuk qenë vetëm një sfidë ndaj politikës centralizuese turke në Shqipëri, por qenë dhe një hap përpara, drejt synimit për shkëputjen e vendit tonë nga Turqia.

**PERSEKUTIMI I UDHËHEQËSVE DHE I MBARE
TRIMAVE TË FSHATARËSISË SË
SHQIPËRISË SË JUGUT**

«Vanë, more shokë, vanë,
Gjith'ata burrat e parë.....
Arbërinë shkret' e lanë
Do kalben në hapsanë,
Për redif e për nizamë,
Që kërkoj mbreti s'ja dhanë...»

Populli

Porta e Lartë, e gjendur ngushtë përparrë revoltës së luftëtarëve shqiptarë, që nuk i nënshtroheshin reformave centralizuese turke, u detyrua t'i pranonte kërkësat e tyre. Por nga ana tjetër, ajo kishte vënë në lëvizje gjithë agjenturën turke në Shqipëri me qëllim që të eliminonte udhëheqësit e kryengritjes shqiptare.

Prapaskenat e qeverisë osmane dalin qartë dhe nga të dhënat e historianit grek Aravantinoi, i cili thotë se valiu i ri i Janinës Seit Ahmet pasha, i kishte kërkuar Stambollit kompetenca më të gjera, për të rifilluar operacionet ndëshkuese në Shqipëri, pasi shqiptarët çdo ditë e më tepër po e largonin vendin e tyre nga hija e padishahut. Shpjegimet e këtij historiani përputhen plotësisht dhe me dokumentet e Kryeministrisë Turke lidhur më këtë çështje. Fill mbas arritjes së tij në Janinë në 13 maj 1840, ky vali filloj ankesat pranë Portës së Lartë. Vetëqeverisja e nëntë krahinave shqiptare e shqetësonte Seit Ahmet pashën. Ai e quante këtë një fyerje të madhe për Perandorinë e ma-

dhe Osmane. Ky pasha i sugjeronte Stambollit që t'i hijej e drejta e vetëqeverisjes këtyre krahinave kryengritëse, të përçahet uniteti i tyre dhe administrata centralizuese turke me gjithë hallkat e saj të shtrihej përsëri në to. Nga ana tjetër, qeveria turke synonte të hidhte në dorë udhëheqësit e kryengritjes, t'i shkëpuste ata nga masat dhe në fund t'i likuidonte. Por, ajo e kishte të qartë se këto pikësynime nuk mund t'i arrinin lehtë.

Situata në Shqipëri nuk ishte e favorshme për Stambolin. Mjaftonte një hap i nxituar dhe i pamenduar mi-rë i autoriteteve osmane në Shqipëri, për të ndezur zjarrin e një kryengritjeje tjetër popullore, që mund të kishte pasoja dhe më katastrofike për interesat turke. Por, dhel-përa plakë e regjur e Stambollit diti të veprojë dhe në këto situata të krijuara në Shqipëri. Në mënyrë të organizuar dhe pa zhurmë, ajo diti t'i likuidojë heshtas, me mjeshtëri, udhëheqësit shqiptarë. Qeveria turke shballi kudo se shqiptarët paskëtaj janë aleatët e saj (sic). Trimave të Shqipërisë u premtoi paprekshmérinë dhe mosndërhyrjen e saj në punët e brendshme të vendit. Stambolli u mundua të jepet dhe fakte në këtë drejtim. Akti i pushimit në vend i Emin pashës (i posa riemëruar vali në Janinë) për shkeljen e amnistisë, ishte një provë që u jepte Turqia kryengritësve shqiptarë.

Porta e Lartë, me qëllim që t'i hidhte në dorë udhëheqësit shqiptarë, filloi t'u thurte lavde atyre dhe t'u rezervonte poste të ndryshme në administratë e në ushtri vazhdimisht larg nga vendet, ku u lindën dhe u rritën këta trima. Turqit kërkonin me këmbëngulje që udhëheqësit e kryengritjes shqiptare të mbaheshin sa më larg nga zonat e influencës së tyre, larg nga luftëtarët e tyre. Kur ata do të gjendeshin të izoluar, pushtuesi e kishte më lehtë t'i zhdukte, duke i hedhur larg atdheut, në luftërat e saj plot rrezige, kundër armiqve të pasosur të Perandorisë Osmane. Kështu ajo ftoi Zenel Gjolekën së bashku me trimat e tij në Stamboll dhe që andej e nisi me shërbim në Arabi si komandant të trupave të parregullta, me qendër në qytetin e Jufrës, ndërsa Tafil Buzi me njerëzit e tij u ftua në Janinë dhe andej u dërgua me shërbim në

Irak.¹⁾ Rreth këtyre ngjarjeve është karakteristike përpunthja plotësisht e shpjegimeve të historiografëve francezë me folklorin e vendit. Ja si i pasqyrojnë këto ngjarje këngët tona popullore:

«Arapistan mbeç për lumë,
Ç'e gjet Tafil Buz' hajdunë,
I dhan' Bagdán e Mosunjë,
Shkoi te' Gjoleka në Jufërë...»²⁾

Historiani francez Eugene Poujade (Evgjen Puzhad) në veprën e tij «Krishterët dhe Turqit» (Chretiens et turcs) përshkruan pritjen që i bënë në Janinë autoritetet turke Tafil Buzit, para nisjes së tij për në vendet arabe. Ai hyri në krye të njëmijë e pesëqind burrave, i rrethuar nga dymbëdhjetë trima të armatosur me pushkë të gjata, që ecnin në këmbë rreth kalit ku qëndronte Tafili. Këta këndonin këngë ku flitej për trimëritë e Tafil Buzit, kurse trupat që i pasonin, përsëritin refrenin e këngës³⁾. Historiani francez bën fjalë edhe për sëmundjen e Tafil Buzit në Janinë. Këtu udhëheqësi i kryengritjes shqiptare u sëmur rëndë dhe u kurua nga një mjek italian. Pashai dhe funksionarët turq të qytetit, përfituan nga rasti dhe bënë çmos që Tafil Buzi të vdiste. Ata i bënë shumë premtive mjekut italian që ai të mos i bënte mjekimet e nevojshme të sëmurit dhe ta zvarriste shërimin e tij, po mjeku nuk pranoi. Ai bëri çmos për ta shëruar pacientin shqiptar.

Qëllimi i Portës së Lartë del qartë dhe nga letra që valiu i Janinës i dërgoi sundimtarit të Vlorës, ku ai thotë tekstualisht: «Il faut que cet homne disparaisse de la terre» (Ky njeri duhet të zhduket nga faqja e dheut). Këtë dokument na e jep vetë historiani francez.⁴⁾ Vlen të përmendet dhe shprehja plot urrejtje që komandanti turk

1) E. Poujade. Vep. cit. fq. 185.

2) AIF (Dosja II M.K.).

3) E. Poujade, Vep. cit. fq. 185.

4) E. Poujade. Vep. cit., fq. 185.

Osman pasha i drejtoi këtij historiani francez për Tafil Buzin, në kohën kur ky i fundit nisej për në vendet arabe: «Çfarë barrë do t'i shkarkonim vetes sikur hajduti Tafil Buzi të vritet në ato anë»!!!¹⁾

Rezik për Portën e Lartë paraqiste edhe trimi i Smokthinës, Cane Myftari, një nga krerët e kryengritjes në rrethin e Vlorës.

Stambolli kërkonte likuidimin sa më parë të tij.

Me asgjësimin e këtij trimi u mor Emin pasha, që asokohe ishte emëruar përsëri Vali i Janinës. Emin pasha i ngriti një kurth Canes, e lajmëroi atë të paraqitej në Stamboll se gjoja e kërkonte sulltani. Për këtë flet dhe folklori:

*«Të kërkon Emin pashai,
Birbilo Cane Myftari,
— Të vijë Canua poshtë,
Të vijë se i kam punë,
Ta pjek me sultani Mahmunë...»²⁾*

Dhe Cania mbasi u sigurua, zbriti me kalin e tij të shpejtë nga malet e Smokthinës në Vlorë. Po këtu ai ra në kurthin e pushtuesit. Turqit që nuk kishin mundur të mposhtnin dot Canen në fushën e luftës, ia arritën qëllimit duke përdorur veglat e tyre, bejlerët. Cane trimin e helmuat bejlerët e Vlorës. Ja si pasqyrohet kjo ngjarje në folklor:

*«... Hipe kalit hergjelé, Cane Myftar o lule,
Tre sahat Vlorën bëre, » » »
Vajte drejt në kafené, » » »
Me bejlerët takové, Cane Myftar o lule
Të hodhën helm në kafé, » » »
Të plasën sy' e s'e pé » »³⁾*

1) E. Poujade. Vep. cit. fq. 185.

2) AIF. (Dosja II e M.K.)

3) AIF. (Dosja II e M.K.)

Autoritetet turke të vendit nuk besonin që Cania të kishte vdekur. Aq i fortë ishte ky mosbesim dhe dëshira për t'u siguruar, sa turqit shkuan dhe i hapën varrin trimtë të Vlorës. Ja ç'thotë kënga popullore për këtë:

«Te xhamia, te pazari,
Eshtë shtrir' Cane Myftari,
Vjen halldup shallvare brâni,
Nuk besonte qeratai,
E nxori Canen nga varri»¹⁾

Trimat e Lumit të Vlorës, në këngët e tyre, e vajtuan luftëtarin e sprovuar të Smokthinës. Cane Myftarin, duke shprehur keqardhjen e tyre për Canen, që u besoi osmanllinjve dhe zbriti në Vlorë i vetëm, pa trimat e tij:

«O Cane Myftar Smokthina,
T'u mbush varri trëndelina,
Pse s'na more neve trima,
T'ja bënim në Vlorë prima...»

Porta e Lartë po bënte çmos për t'i veçuar nga njëri-tjetri krerët e kryengritjes, me qëllim që t'i mbante ata larg nga masat fshatare dhe t'i asgjësonte me rastin më të parë.

Sipas raportit të konsullit anglez Charl Blunt më datë 10 mars 1838, drejtuar shefit të tij lordit Ponsonby²⁾, botuar dhe në gazeten greke «Elenikos Tahidhromos (Korrieri grek)³⁾ Çelo Picari dhe Veiz Vasjari u emëruan «derven agasi» (ruajtës të shtigjeve malore) gjatë kufirit turko-grek. Çelua në Thesali ndërsa Veizi në zonën e Olimpit. Ky konsull anglez shpjegon në raportin e tij se Çelo Pi-

1) AIF. (Dosja II M.K.).

2) «Britanski dokumenti za istoriata na Makedonskiot narod», vell. I (1797-1839). Skopje. 1968, fq. 266 (Mater, i përkthyer AIH),

3) Gazeta «Elenikos Tahidhromos». Athinë, 1837-1838, fq. 313. (Material i përkthyer — AIH).

cari së bashku me Veiz Vasjarin edhe në këto vende larg Shqipërisë kanë mbajtur qendrim të hapur armiqësor kundër valiut të Janinës, Mustafa pashës, aq shumë i përmendur në atë kohë për mizoritë e tij të shumta.

Edhe mbas këtij emërimi të ri këta dy krerë opozitarë i gjeje më shumë në Shqipëri sesa në kufirin turko-grek.

Agjentura osmane atëherë ndoqi tjetër rrugë për t'ja arritur qëllimit të vet.

Celua me Veiz Vasjarin u ftuan në Stamboll gjoja për të bashkëbiseduar lidhur me rekrutimin e detyrueshëm ushtarak dhe për t'i bërë më të besueshme ftesat i firmosi dhe Shehul Islami, kryetarë i fesë (që përfaqëson të dymbëdhjetë sektet e saj). Celua me Veizin i besuan ftesës osmane dhe shkuan në Stamboll. Atje emisarët e lartë turq u munduan t'i bëjnë me vete, t'i kthejnë në vegla të tyre. Por s'ja arriten dot qëllimit, pas disa javësh arrestimi në burgjet e vjetra bizantine të Stambollit, ata i internuan në Konjë të Anadollit. Sipas folklorit:

«*Celua kur u dënu
Sheh Islami iu besua,
Sheh Islam mbi dhodhekadhë, **
C'e bëre Çelo Picarë,
*Azap Konjënë i dhanë. **»¹⁾

Masat e giera popullore, duke u nisur nga qëndrimi konsekuent i Çelo Picarit (kundër rekrutimit të detyrueshëm shumëvjeçar ushtarak turk) me plot të drejtë në këngët e tyre e hiperbolizojnë qëndrimin e tij në Stamboll. Rapsodët popullorë vënë përballë Çelos dhe vetë sulltan Mahmudin e II (aq shumë i dëgjuar për mizoritë e tij në mbarë Perandorinë). Por, trimi Çelo Picari

*) Dhodhekadhe (fjalë greke) — dymbëdhjetë.

*) Azap (fjalë arabe) — dënim.

1) AIF (Dosja II M.K.)

(sipas këngës) «u hëngër hundë për hundë» dhe me sulltanin, për të mos lenë djemtë e Shqipërisë t'i rekrutojë ushtarë Turqia.

«Çelo Picari furtunë,
U zu me sulttan Mahmunë,
U hëngër hundë për hundë...»

Sulltani i osmanëve, ky sundimtar i madh në tre kontinente, tërbohet nga qëndrimi burrëror i Çelo Picarit. Ai i jep vetë dënimin këtij trimi:

«Nuk e lë andej hajdunë,
Se ngrë vënd' e më prish punë,
Në Konjë surgjun e shpunë...»

Çelo Picari dhe nga Konja e largët i nxiste bashkë-luftëtarët e tij për kryengritje, duke i këshilluar se lufta është e vetmja rrugë shpëtimi nga zgjedha e huaj:

«Ditënë që hyri prilli,
Dërgon kartëra Xhelili,
Kurveleshas krye ngrini,
Taraflleqet t'i lini,
Burra, gra armët të viri,
Se nga tjetër fajde s'kini,
Dhe nizamë të mos vini.»

Labëria e vajtoi së largu Çelon e internuar. Atë e kërkonin trimat që t'i udhëhiqte në luftë:

Ja si e pasqyron folklori:

«Medet o Xhelil aga,
Të mbenë trimat sha, *)
Thotë palla që ri vjerrë,
— Ku ësht' imzot të më nxjerrë? ...»

*) Sha — Këtu në kuptim: pa udhëheqës.

Kënga thotë se Çelon e kërkonte edhe kali i vet, duke hingëlluar e duke turfulluar:

«*Thërret ati në katua,
Thotë: — Ç'mu bë zoti mua?
Të më vijë, të më nisë,
Të më hipë, të gjezdisë».*

Por këta udhëheqës të vegjëlisë shqiptare agjentura osmane i vranë, i burgosi dhe i internoi larg nga vëndi i tyre, pasi e njohu mirë trimërinë e shqiptarit. Të shumta janë këngët popullore që u ngritën për këta trima:

«*Vanë, more shokë, vanë,
Gjith' ata burrat e parë,
Çelua me Veiz Vasjarë,
Me Tafil Buzin me pallë,
Bashkë me Gjolekë lap' në,
Nashti duhen, po ku janë?
Arbërinë shkret' e lanë.*

Rapsodi popullor u jep zë dhe drurëve, lisave e shkozave, të cilat me fëshfërimën e tyre kërkojnë përsëri t'u varin në degët e tyre peshlitë me çekra trimat e Shqipërisë, ashtu si i varnin dikur në kohën e kryengritjes (kur çlodheshin këta luftëtarë nën hijen e tyre), por shton rapsodi, këta burra tashti kalben nëpër burgjet e largëta të Perandorisë Turke, mbasi nuk deshën t'i japid ushtarë dhe taksa sulltanit:

«... Ulurin shkoza me dega,
Na kërkon peshli me çekra,
Peshlitë me çekra vanë.
Do kalbenë, në hapsanë,
Për redif e për nizamë,
Që kërkoj mbreti, s'ja dhamë... »¹⁾

1) AIF (Dosja II e M.K.)

SHPALLJA E TANZIMATIT DHE ZBATIMI I SAJ ME FORÇË NË SHQIPËRİNË E JUGUT PAS VITIT 1840

«Mbretit s'ja kemi takanë,
Me xhelépe, me nizamë,
Me serasquer, me Tanzimanë...»

Populli

Autoritetet osmane pas likuidimit gradual të udhë-heqësve të kryengritjes fshatare, filluan përsëri shtrimin me forcë të reformave të tyre centralizuese në krahinat shqiptare që kishin fituar vetëqeverisjen. Këto masa të pushtuesit u bënë dhe më të egra mbas vitit 1839.

Në vitin 1839 sultani Mahmudi II largohet nga froni dhe vendin e tij e zë sultani Abdyl Mexhidi, i cili më 3 nentor 1839 shpalli: «Hati sherif i gjylhanës» (dekreti i shenjtë i pallatit të trëndafilave). Kjo ishte një reformë e plotë administrative, meqenëse sipas saj do të rregullohejjeta në Turqi.

«Tanzimati» (rregullore, reforma të reja) synonte:

a) Në rimëkëmbjen e autoritetit shtetëror me anën e centralizimit të pushtetit administrativ dhe financiar, që do të zhdukte pushtetin lokal etj. Në vija të përgjithshme duke ruajtur bazën feudale.

b) Në rekrutimin e detyrueshëm ushtarak pa shpërbirim.

Tanzimati synonte të ndreqte superstrukturën e shqërisë dhe të administratës turke dhe si pasojë të përjetësonë sundimin turk në mbarë Perandorinë, duke shkatërruar me anën e taksave dhe sidomos me anën e «niza-

mi xhedit» (rekrutimit të detyrueshëm ushtarak) forcat e gjalla prodhuese në vendet e ndryshme të Perandorisë Osmane.

Për të vënë në jetë dekretin e shenjtë të pallatit të trëndafilave (pasi në këtë pallat në Stamboll u shpall ky dekret nga sultani) në muajin maj të vitit 1840 u dërgua në Janinë Seit Ahmet pasha.¹⁾

Ky vali i Janinës, në fillim, u nis për të nënshtruar dy krahinat kryengritëse: Vérçen dhe Sulovën. Forca të mëdha turke vërshuan nga të gjitha anët e Shqipërisë së Jugut. Ato u shtuan sidomos gjatë vitit 1841. Me gjithë përpjekjet e shqiptarëve, hordhitë e shumta osmane u futën thellë në Shqipërinë e Jugut, duke shkelur marrëveshjen që kishin bërë me shqiptarët. Si pasojë, nëntë krahinave shqiptare iu hoq pjesë-pjesë e drejta e vetadministrimit dhe u zëvendësua përfundimisht pas vitit 1841 me administratën e rregullt turke.

Osmanllinjtë rifilluan zbatimin me forcë të rekrutimit të detyrueshëm ushtarak. Me dhjetëra ekspedita ndëshkimore e përshkuan anembanë Shqipërinë. Kudo në vendin tonë, nëpër gryka dhe shtigje, viheshin roje për të diktuar nëpunësit osmanlli të regjistrimit të popullsisë (sipas popullit — qatipet), të cilët së bashku me togat e shoqërimit kalonin fshat më fshat për të rekrutuar me forcë bijtë e popullit. Me qindra djem qendronin ditë e netë larg familjeve të tyre, të fshehur nëpër shpella dhe pyje, për t'i shpëtuar rekrutimit të detyrueshëm ushtarak. Aplikimi i taksave e vështirësoi akoma dhe më shumë gjendjen në Shqipëri. Këngët popullore e pasqyrojnë qartë mjerimin e vendit tonë:

«*Shokë, do të them një këngë,
Gjarpéri që na ka zënë,
Me këtë sultanë qënë,
Na mori kokën e gjënë...»*

1) BAI. Vesika 21695 — A., dt. 1252.

Bijtë e popullit tonë, bujq e barinj, të vënë përpara, nën kamxhikun e osmanlliut, largoheshin plot mall nga vendi i tyre, larg atdheut, në skajet më të largëta të Perandorisë Osmane, për t'i shërbyer pushtuesit. Sipas rapsodit, këta bij të popullit dhe kur largoheshin nga fshati, nga vendlindja e tyre, nuk rrin pa e kthyer kokën, për t'u dhënë përshëndetjen ndoshta të fundit, vendeve që i rritën, maleve të bukura të Shqipërisë, ku vite me radhë kishin kullotur bagëtitë dhe kufari (trupi) i tyre dridhej për tokën mëmë që aq shumë e donin:

«*Erdhën qatipët jezitë,
I ziu ku t'i lë dhitë,
Ktheva kokënë nga mali,
Nënë se ç'mu tha kufari,
Nënë ç'më gjeti të zinë,
Tek kullosja bagëtinë,
Në malet me trëndelinë,...
Të shkretatë dhënt' e mijë
Do t'i hajë lukunia *)....»*

Djalit të Shqipërisë, në ushtrinë osmane do t'i hiqej kostumi kombëtar, fustanella, dhe këndeje e tutje, thotë repsodi, do të mbante shallvaret e turkut, dhe për shumë vjet do të hajë çorvë nëpër kazanet e ushtrisë turke:

«... *Shokë do çvishet fustani,
Do na vishetë shallvari,
Ne nizamë do të vemi,
Do hamë çorvë legeni....»*

Çdo vit vinte në skelën e Vlorës dhe të Skalomës (Sarandës) vaponi turk me emrin «Haxhi Daut», i cili transportonte rekrutët shqiptarë në vendet e largëta të Perandorisë së madhe Turke, tej nga Arabia, në Jemen e gjetkë nga «Molla e kuqe» shpjegon poeti popullor, ku piqet

*) lukunia — kopeja e ujqërvë.

buka në diell. Atje do të heqin gjithë të zezat bijtë e vendit tonë nga zabitët (oficerat) osmanllinj:

«... *Do shkojmë te moll' e kuqe,*
O djema buzë burbuqe,
Do bëjmë talim me supe,
Do na flas bimbashi turçe,
Neve turçe nukë dimë,
Do na lozinë kamshinë,
Ne turçe do të mësojmë,
Po shqipen të mos harrojmë...»

Sipas të dhënave arkivale dhe gojore me mijëra ushtarë shqiptarë vdisnin në këto vise të largëta nga kolera dhe murtaja. Edhe sot kujtohen me mallëngjim nga pleqtë tanë zérat e dëshpëruara të të rinxve shqiptarë, të sëmu-rë, të uritur, të zhveshur dhe të zbathur në rrëren e djegur të Jemenit, që dilnin në breg të detit dhe u bërtitnin zabitëve turq: «Duam Dautin» dmth vaporin turk, për t'u kthyer në atdhe. Shumë prej tyre linin kockat në këto vende të nxehtha.

Ja si i vajton rapsodi:

«*Mbeçë, more shokë, mbeçë,*
Përtej urës së Qabesë...
Në pyetë nëna përmua,
I thoni se u martua,
Në pyetë se ç'krushq i vanë?
Korbat e sorrat e hanë...
Në pyetë se ç'kalë hipë?
Atje ku hipën meiti...»)*

Ja çfarë pasoja të rënda ka patur zbatimi i Tanzimatit në vendin tonë.

*) Meiti (fjalë arabe) i vdekuri.

Me heqjen e vetëqeverisjes lokale, në Shqipëri u vendos administrata e re turke. Në krahinat tona u ngritën mexhlizet (këshillat administrative nën kryesinë e kryetarit të administratës në çdo qendër administrative të push-tuesit). Dhënia e drejtësisë iu besua gjyqtarëve fetarë islamikë (kadilerëve), që do të gjykonin sipas së drejtës fetare (sheriati). Sipas fermanit të dalë nga sulltani, ministrimi i pagesave do të ushtrohej kryesisht nga në-punës të rregullt të administratës së re osmane. Ligje të forta dolën për çarmatimin e shqiptarëve dhe për ata që do t'i shmangeshin shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Nëpunësve të lartë të administratës turke në Shqipëri, mytesarifëve (prefektëve) e kajmekamëve (nënprefektëve) u qenë dhënë kompetenca të plota për shtypjen e çdo lloj revolte në vendin tonë.

Administrata turke filloi funksionimin e rregullt të saj. Porta e Lartë u bind më në fund se gjithçka ecte në rregull në Shqipëri. Nga fillimi i vitit 1845, sulltani u fali dënimin pjesës së internuar të udhëheqësve të lëvizjes fshatare. Ata u kthyen në atdhe. Turqit mendonin se tani, pas gjithë atij terrori në Shqipëri, këta krerë do të rrinin urtë dhe do të vepronin sipas diktatit të Portës së Lartë.

Kurveleshi e priti krahëhapur udhëheqësin e saj Çelo Picarin. Thonë se përpëra se ta lejonin të kthehej në Shqipëri, Çelon e pyetën turqit: «Në qoftë se Dovleti do të ketë nevojë në të ardhmen për ndihmën tuaj me sa luftëtarë mund të na vini në ndihmë?» «Unë s'kam asnje influencë jo vetëm në krahinë e në fshat, po as në djemtë e mi», u përgjigj labi i zgjuar, që e kuptoi dredhinë e osmanllive.

Shumë legjenda u thurën nga populli lidhur me lëshimin e tij. Disa thonë se emisarët e lartë turq duke u nisur nga kjo përgjigje e goditur e Çelos dhe duke qënë të bindur se ai nuk ishte më i rrezikshëm e liruan menjëherë. Por, kur mësuan për influencën e tij të madhe që vazhdonte të kishte në Shqipëri, dërguan kalorësit e tyre të shpejtë për ta kthyer përsëri në Konjë, në kampin e internimit. Trimi i Labërisë i ndihmuar nga bashkatdhe-

tarët e tij ishte larguar shumë. Ai i kishte hipur anijes. Urdhëri i komandës turke për kapjen e Çelos, të shqiptarit që mbante mustaqe të mëdha, kishte qënë i rreptë. Urdhëri thoshte që ky trim të kapej me çdo kusht, gjallë a vdekur, se përndryshe u pritej koka ndjekësve osmanë. Thuhet se me dhjetëra «mustaqemëdhenj», që u gjetën rrugës ditën e largimit të Çelos, u arrestuan nga sejmenët kalorës osmanë dhe u lidhën pas kuajve të tyre, duke i tërhequr zvarrë, kurse ata që kundërshtuan u vranë barbarisht. Të njëjtin fat pësuan më vonë edhe vetë ndjekësit e Çelos nga eprorët e tyre, sepse u kthyen me duar bosh.

Në Shqipërinë e Jugut edhe sot vazhdon të kujtohet kjo ngjarje e shndërruar në legjendë. Këtu gjen shpjegimin shprehja e vjetër popullore: «U vranë për mustaqet e Çelos».

Fakti është që Çelua u kthyte përsëri në Labëri.

Çelo Picari i gjeti lebërit, ashtu si i kishte lënë, trima e të papërtuar për luftë, të gatshëm për t'u matur me pushtuesin, mjaft që të çlroheshin nga ato reforma skllavëruese. Çelua kuptoi se këta njerëz kishin nevojë më shumë për t'u organizuar sesa për t'i nxitur. Puna e parë që bëri qe pajtimi i gjaqeve dhe shmangia nga gjakderdhjet e kota.

Vejgjelia kishte vendosur të mos jepte më ushtarë për ushtrinë turke dhe të mos i paguante taksa pushtuesit. Ajo kërkonte përbysjen e administratës së re centralizuese turke, që kishte ngritur pushtuesi në Shqipëri. Çelo Picari me shokë u vu në krye të vegjëlisë për realizimin e këtyre kërkesave të thella popullore.

Celua ishte lidhur ngushtë me masën e popullit, patë cilën ai e quante veten të pavlefshëm. Ja si u përgjigj ai një beu vriosnas gjatë luftës së Beratit, kur ky iu ankua e i tha se luftëtarët e tij e kishin gënjer, duke e paraqitur veten Çelo Picari: «Luftëtarët e mi të kanë thënë të vërtetën, ata pa mua mund të jenë Çelo Picari, ndërsa unë pa ata, nuk mund të jem kurrë ai Çelo që ju detyroi të vini tek unë».

Celua përpinqej vazhdimisht që populli i Kurveleshit

të bashkohej e të vëllazërohej. Dhjetëra shembuj flasin pér këtë: Kur një nga fisi Imaj qëlloi me armë njërin nga njerëzit e Çelos ai jo vetëm nuk e humbi gjakftohtësinë, por u mundua t'i pajtonte të dy palët. Ai urdhëroi gruan e tij, Nuren, të shkonte në familjen kundërshtare pér të kërkuar hua një gjilpërë. Pér Çelon hasmëritë dhe grindjet familjare ishin pengesë pér bashkimin dhe vëllazërimin e fshatarëve.

Çelo Picari, me sa mundi, u pérpoq që fshati i tij të zhvillohej e të ndërtohej. Ai vuri në plan ndërtimin e dy rrugëve prej kalldrëmi, të cilat duke u nisur nga fusha arrinin deri në krye të fshatit Picar. Njérën rrugë ai e ndërttoi, ndërsa e dyta i mbeti përgjysmë.

Çelo Picari ishte dhe një ekonomist i mirë, që dinte t'u shpëtonte presioneve ekonomike të detyruara nga arsimku.

Pushtuesi turk sa herë që shkonte në Labëri digjte çdo gjë që gjente përparrë deri të mbjellat e tyre, pér t'i detyruar kryengritësit të dorëzoheshin nga uria. Por Çelua me shokë dhe pér luftën i kishte marrë masat. Mbi fshatin Picar ndodhet një mal, që quhet «Mali me Gropa». Sipër në majë të tij, ka mjaft parcela të mëdha, të cilat më parë përdoreshin vetëm pér kullota në muajt e verës. Me iniciativën e Çelos këto toka u kthyen në ara buke. Ato u punuan shumë kohë, por më vonë pas vdekjes së Çelos dhe të djemve të tij u lanë djerr. Vetëm tanë, në Pushtetin Popullor, filloi të punohet përsëri Mali me Gropa, që nuk u shkel kurrë nga këmba e turkut.

Këta trima, si Çelo Picari me shokë, të pajisur me këto veti burrërore të rralla, populli i Kurveleshit i vuri në krye të luftëtarëve të tij, pér të shpëtuar vendin nga reformat skillavëruese osmane.

Pas vitit 1844, në Shqipëri, me gjithë terrorin e madh turk revolta popullore filloi të ngríhej. Heqja e së drejtës së vetadiministrimit, zbatimi i detyrueshëm ushtarak dhe zbatimi i taksave të reja e acaroi shumë gjendjen në vendin tonë. Përballë kësaj politike të re turke, që me të drejtë shihej nga populli si një nënshtrim i ri i Shqipërisë, filluan

të ngrihen gjerësisht masat fshatare që në atë kohë përbë-nin forcën kryesore më të rëndësishme të lëvizjes së armatosur. Ato dalëngadalë po kuptonin se vetëm lufta kundër qeverisë turke (çifligari më i madh në vendin tonë) mund të krijonte kushte të përshtatshme për të rifituar tokën e grabitur prej çifligarëve dhe shtetit feudal për përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike.

**KRYENGRITJA E MADHE FSHATARE E VITIT 1847
DHE ORGANIZATORJA E SAJ «BESËLIDHJA
SHQIPTARE»**

«Shqipëtarëtë me derte,
Janë trima pa alete,
Dinë shumë marifete,
I thonë dyfekut: lëpe...»

Populli

Në vitin 1846 acarimi i kontradiktave midis popullit shqiptar dhe pushtuesit arriti kulmin. Zbatimi me forcë i reformave centralizuese turke në Shqipëri i ngriti në këmbë shqiptarët. Në këtë kohë në vendin tonë ishin pjekur kushtet për një kryengritje tjetër popullore. Ve gjëlia shqiptare kishte nevojë për t'u organizuar dhe kjo detyrë e madhe u delte krerëve shqiptarë, që qëndronin në opozitë me Portën e Lartë. Udhëheqësit e fshatarësisë: Çelo Picari, Zenel Gjoleka, Rrapo Hekali, Hodo Nivica, Veiz Vasjari, Hadër Sulo Kanina, Dervish Ali Dukati, Çaparenjtë etj., lëshuan kushtimin e luftës anembanë vendit.

Në Shqipërinë e Jugut populli kudo rrëmbeu armët. Vala e kryengritjes u përhap deri në lumin Shkumbin.

Nevoja e luftës bëri të ringjallej përsëri një besëlidhje e krahinave kryengritëse, siç kishte qenë bërë vite më parë.

Nga historianët grekë K. Mekios dhe P. Aravantinoi

etj, mësojmë se në vitin 1846 u bë mbledhja e kësaj besëlidhje, nga e cila doli dhe udhëheqja e kryengritjes.¹⁾

Me dhjetëra krerë të fshatarësise shkuan në këtë kuvend ndërkrashinor, që u zhvillua në vendlindjen e Çelos në Picar të Kurveleshit. Atje u mblodhën përfaqësues nga mjafth krahina, që nga Mallakastra dhe deri në Prevezë.

Në këtë kuvend shkuan dhe një pjesë e feudalëve opozitarë vendas, sepse Tanzimati prekte jo vetëm interesat e mbarë popullit, por edhe ato të feudalëve, të cilët nuk domin që privilegjet e fituara dhe pushtetin t'ia lëshonin administratës turke.

Në Picar shkuan dhe mjafth bejlerë e agallarë të Vlorës, të Beratit, të Gjirokastrës, të Delvinës dhe të Çamërisë.

Në një këngë të vjetër labe thuhet:

«*O Buçi* në shesh të Qarit,
Në vënd të Çelo Picarit,
Aty mblodhi parësinë,
Ku ka Xhelili shtëpinë...
Dhe topi ngritur në buzë,
Kur qëllon, shurdhon Korfuzë...»²⁾

Në këtë këngë nuk tregohet vetëm vendi ku u zhvillua mbledhja, por edhe emrat e përfaqësuesve, që morën pjesë në kuvendin ndërkrashinor të Besëlidhjes shqiptare. Pikërisht po këto emra krerësh shqiptarë i gjejmë dhe në një letër që i drejtojnë mbretit Oton të Greqisë më 15 gusht 1847, për ndihmë materiale:

«*Shqipëtarët'* anembanë,
U mblodhën e fjalën dhanë,
Mbretit s'i japim nizamë,

1) Revista «O neos kuvaras». Athinë, 1966, fq. 141-146. Kristo Mekios. «Historia e Epirit». Kairo, 1909, fq. 258. Panajot Aravantinol. «Hronografia e Epirit» (1822-1853). Athinë, 1856, libri 6, paragrafi 75. Shih dhe «Shënimë dhe kujtime mbi Shqipërinë. Dorëshkrim, fq. 8, pranë AIH.

2) AIF (Dosja II M.K.)

Do t'i zë t'i them me radhë,
 Të parë Çelo Picarë,
 Të dytin Veiz Vasjarë,
 Hadër Sulon në Kaninë,
 Në Dukat Dervish Alinë,
 Në Brataj Matan Haxhinë,
 Lilo Qendro nishanllinë,
 Osman Kuci nga Zhulati,
 Totajtë nga Progonati,
 Labë Dukë qafëgjati,
 Fejzo Çika i borshioti.
 Hodo Ali nivicioti,
 Dule Zoto smokthnjoti,
 Lulo Abaz tërbaçjoti.
 Kamber Delo tragjasjoti,
 Mete Çobo vranishjoti,
 Selim Agai nga Vlora,
 Dhe Hito Daut Mavrova,
 Sinan Malua nga Bolena,
 Sheh Aliu nga Tepelena,
 Dhe Spirua nga Labova,
 E bëri i pari fora... »¹⁾

Në personat që e kanë nënshkruar letrën, që i drejtohen mbretit Oton të Greqisë në krye të përfaqësuesve të kazasë së Delvinës dhe në atë të Mallakastrës ndodhen emrat e Zenel Gjolekës dhe të Rrapo Hekalit (Rrapush Kamdibashi). Pikërisht këta dy emra udhëheqësish janë vënë në dukje në këngën e vjetër labe që i kushtohet kësaj mbledhje. Edhe sot pleqtë e Picarit i kujtojnë fjalët e gjyshërve të tyre lidhur me ardhjen e Rrapo Hekalit me shokë në Picar:

«... Ra tërmeti u tund mali,
 Na erdhi Rrapo Hekali,
 Vjen Gjoleka lab'i Kuçe,

1) AIF (Dosja II e M.K.)

Shih dhe Kosta Biri «Arvanites...». Athinë, 1960, fq. 362.

*Fustani mbi gju hajduçe,
Pall' e larë me xullufe,
Pall' e larë vetëtimë,
E shkreta i rih pëqinë... »¹⁾*

Me kryengritësit u bashkuau dhe trimat e Bregut të Detit, mbasi reformat centralizuese turke, sikurse në gjithë krahinat, u shtrinë dhe në krahinën e Himarës. Autoritetet osmane filluan zbatimin me forcë të reformave edhe në këtë krahinë. Autonomia e himariotëve nuk u respektua më. Gjendja në këtë kohë në Bregdet ishte acaruar mjaft, mbasi pashai i Vilajetit vrau në Janinë dhe përfaqësuesin e Himarës Kost Aleksin, i cili ishte dërguar nga popullsia e kësaj krahine për t'i kujtuar pashait respektimin e autonomisë së tyre, që po merrej nëpër këmbë nga autoritetet osmane. Kjo ngjarje është kënduar në këngët popullore:

*« ... Mbet Kost Aleksi në Janinë,
Për të dhjetat që do jipnë...
Dhe kur doli nga saraj
I tha një fjalë pashai:
— Mbahi, kapetanë, mbahi,
Dhe nga Dovleti mos qaji,
— Dhe nga Dovleti të jetë,
Neve s'japimë të dhjetë,
Gjithë kemi për të vdekë...
Kost Aleks bairak me zogje,
Për Himarën u përpoqe,
Kost Aleks bairak me lule,
Për Himarën veten humbe... »²⁾*

Nën këto rrethana edhe brezdetasit dërguan përfaqësuesit e tyre në kuvendin e Besëlidhjes në Picar të Kurveleshit.

1) AIF, (Dosja II, M.K.)

2) Po aty.

Sipas folklorit:

«... Na erdhën trimat e Bregut,
Të luftojnë për vatanë,
Për xhelepe për nizamë,
Corrajt me Foto Kopalë,
Qeparo Gjikë Thanasnë,
Dhe me kapetan Sokranë,
Të gjithë trima me pallë,
Erdhën e zunë Picarë,
Atje e lidhën kuvëndë,
Tek arra me dega tëndë»¹⁾

Në këtë kuvend ndërkrashinor të Besëlidhjes u vendos të zgjidhej udhëheqja e kryengritjes. Qartë e pasqyron dokumentacionin grek: «Në të kaluarën, në krye të lëvizjes popullore në Shqipëri, vihesin njerëz nga familje të dëgjuara, por këtë herë ndodhi diçka e çuditshme. U arrit nga të gjithë marrëveshja që udhëheqjen e kryengritjes të mos e merrnin njerëz të njohur e pa përvojë lufte, por ta merrnin ata me përvojë lufte edhe pse mund të mos ishin njerëz të dëgjuar»²⁾. Në raportin që nënkonlli grek i Janinës, Klerinxis i drejton qeverisë së tij lidhur me çëndrimin e feudalëve opozitarë shqiptarë në kuvend thuhet: «Parësia dhe disa shqiptarë me rëndësi janë në marrëveshje me kryengritësit e vegjël shqiptarë dhe të një mendimi me ata..., por askush prej tyre nuk u ngrit pér t'u vënë në krye si udhëheqës... dhe këtë qëndrim e mbajnë vetëm pér hir të mbrojtjes së interesave të tyre personale... Familjet e para u mënjanuan në marrjen e udhëheqjes, por sido që të ketë qënë gjendja vendimi i tyre... i shërben interesit të përgjithshëm»³⁾.

Sipas historianëve grekë, me kërkesën këmbëngulësse të shumicës dérrmuese të anëtarëve të kuvendit në udhë-

1) AIF, (Dosja II, M.K.)

2) Revista «O Neos kuvaras». Vep. cit., fq. 164, 165.

3) Po aty. Raporti nr. 2603/295.

héqje të kryengritjes u zgjodhën njerëz të thjeshtë, por të zotët e pushkës.

Janë shumë interesante fjalët që Zenel Gjoleka u drejtoi në kuvend feudalëve opozitarë vendas, të cilët u bashkuan me mendimin, që udhëheqjen ta merrnin njerëzit e thjeshtë të popullit. Sipas historianëve të lartpërme ndur, Gjoleka tha: se «e pranojmë këtë nder që na bëhet», porse shtoi: «Po të ndodhë se ndonjeri prej jush do ta braktisë kryengritjen, atëhere ai do të ketë të bëjë direkt me Zenel Gjolekën».

Këta udhëheqës me plot të drejtë quhen trima të vë gjëlisë, pasi ata u bënë përfaqësues tipik të interesave popullore, duke shkrirë dhe interesat e tyre me vetë qëllimet e kryengritjes.

Asnjë prej emrave të këtyre udhëheqësve nuk del me originë nga familje oxhakësh të përmendur, nga pashallarë apo bejlerë. Për të drejtar kryengritjen u zgjodhën vetëm ata që ishin dalluar për trimëri dhe zgjuarësi. Sikurse kemi theksuar në kapitujt e mëparshëm, tradita popullore flet miaft për originën prei barinjsh të Çelo Picarit, ndërsa për prindërit e Zenel Gjolekës thuhet se kanë qenë artizanë të mirë të punimdrurit. Kundërshtarët e kësaj familjeje në Kuç e quanin familjen «Gjoleka» si jo të fisme, duke i mbiquajtur «prohixhi» ose «bucelaxhi». Të njëjtën originë kanë afersisht dhe krerët e tjerë të kësaj lëvizjeje të madhe fshatare.

Sipas historianëve grekë, në këtë kuvend, anëtarët e Besëlidhies, pasi zgjodhën udhëheqësit e kryengritjes, morën dhe këto vendime:

1) Populli shqiptar, myslimanë dhe të krishterë, është një dhe i pandarë.

2) «Besëlidhja» u siguron nderin, jetën dhe pasurinë gjithë shqiptarëve.

3) Shqiptarët të gjithë papërjashtim, myslimanë dhe të krishterë të hidhen në luftë kundër Turqisë.

4) Me luftë të hapur ta detyrojmë qeverinë turke të heqë këto reforma të reja, që e skllavërojnë popullin shqiptar, si bie fjala: «Nizami xhedid», taksat e reja,

mexhlizet (këshillat krahinore), mytesarrifët (prefektët), kadilerët (gjyqtarët), kryepleqtë, taksidarët etj.

5) Të kufizohen garnizonet turke në Shqipëri.
«Besëlidhja» caktoi afërsisht dhe numrin e luftëtarëve që do të jepte çdo krahinë.

Për luftëtarët e saj ajo nxori këto urdhëra:

a) T'i shmangen dhunës dhe hakmarrjeve.

b) Të mos lindin armiqësi.

c) Mos t'i bien në qafë popullsisë.¹⁾

Autoritetet turke, me anën e agjentëve të tyre dhe me ndihmën e disa feudalëve turkomani vendas si nga familja e Vrionasve etj., mundën të bënin me vete disa nga anëtarët e kësaj «Besëlidhje», si Shaban Peshtanin nga Peshtani i Mallakastrës, Muhamrem Toton nga Progonati i Kurveleshit etj, të cilët u treguan autoritetet e osmane planet dhe udhëheqësit e kryengritjes.²⁾

Sikurse dihet popullsia e krishterë në Perandorinë Osmane nuk thirrej në shërbim ushtarë. Ata paguanin vetëm një farë takse që quhej «Nizamié», por paskëtaj reformat centralizuese turke do të shtriheshin në gjithë popullsinë e Perandorisë. Për zbatimin e këtyre reformave, Porta e Lartë u mundua të bëjë me vete dhe klerin ortodoks, dhe disa prej tyre mundi, me anën e Patrikanës, t'i vëré në shërbim të saj. Qartë e pasqyron folklori:

«Që në Korç' e Tepelenë,
Të krishterët nizam' s'venë,
Djemt' e gjorë muar' malë,
Ikën, as dihen ku vanë,
Ky dhespot i Manastirit,
Ja fali djemtë vezirit,
Ky dhespoti i Përlepit,
Ja fali djemtë dovletit,
O dhespot, more dhespot,
Ne nizamë s'vemi dot...»

1) Revista «O Neos kuvaras». Vep. cit., fq. 167-186.

2) Merko Koroni, «Shpata e Labërisë». SHBA, 1917.

«Besëlidhja» çdo ditë i zgjeronte degët e saj. Tashti në këto krahina kryengritëse shqiptare dëgjohej kënga:

«*Mbrettit s'ja kemi takanë,
Me xhelepe, me nizamë,
Me serasqer, me Tanzimanë...»¹⁾*

Fshatarësia shqiptare e revoltuar priste çastin për të filluar kryengritjen. Dhe çasti u gjet. Në këtë kohë, Porta e Lartë, kishte filluar të zbatonte me forcë çarmatimin e përgjithshëm në Shqipëri.

Kudo ishin lëshuar urdhëresa nga autoritetet turke për të ndaluar lëvizjet e popullsisë nga njëri vend në tjetrin si dhe vajtjet jashtë shtetit, sepse do të bëhej regjistrimi i detyruar i popullsisë, për efekte të evidencës ushtarake. Këto i dhanë shkas ndezjes së kryengritjes së madhe fshatare të vitit 1847.

«Në maj të vitit 1847, — shkruan historiani grek Aravantinoi, — plasi kryengritja në Shqipërinë e Jugut, që po ziente prej kohësh, më e guximshmja dhe më e rrezikshmja nga çdo kryengritje tjetër që nxori ky vend. Pothuaj të gjithë shqiptarët, pa përjashtim, të pakënaqur nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe nga taksat e rënda, erdhën në marrëveshje dhe u betuan që, me një kundërshtim të fortë dhe të përgjithshëm, të detyrojnë qeverinë turke të ndalojë zbatimin e reformave të reja (Tanzimatin).»²⁾

Kryengritja filloi në Kurvelesh me dëbimin e taksi-darëve dhe sipërmarrësve të kullotave. Në fillim kryengritësit cliruan kryeqendrën e krahinës, Delvinën.

Lidhur me ardhjen e forcate fshatare ne këtë qytet, historianët e huaj thonë se kryengritësit i shmangeshin dhunës, pasi nuk donin që të lindnin armiqësi. Ata i largoheshin hakmarrjeve dhe shballën se kishin të bënин vetëm me pushtuesin turk³⁾. Pastaj kryengritësit dogjën

1) Revista «Albania». Bruxelles 1901, fq. 154

2) P. Aravantinoi. Vep. e cit. Libri 6, paragr. 75, 76.

3) Revista «O Neos kuvaras», Cit. fq. 170-195.

kazermat ushtarake turke që ndodheshin në «Qafë të Muzinës», kaluan nëpër fshatrat Dhivër, Dhrovjan, Camanda dhe Babur. Ata kudo mblidhnin popullin dhe i flisnin që të hidhej i téri në luftë kundër pushtuesit turk.

Në fshatin Camanda «Besëlidhja» bëri një mbledhje të shkurtër për bashkërenditjen e luftës me kryengritësit çamë.

Forcat kryengritëse të Çelo Picarit, të Zenel Gjolekës dhe të Lulo e Hamit Çaparit (nga fshati Luarat i Margëllëcit) filluan të shtoheshin. Kudo që shkonin, radhët e tyre shtoheshin nga të varfërit pa dallim feje e krahine. Numri i kryengritësve shtohej edhe më ushtarë shqiptarë, që dezertonin nga repartet e ushtrisë turke.

Komandanti i forcave otomane në Gjirokastër, Sadik Liman Pashai synonte t'i përcante kryengritësit shqiptarë. Për këtë qëllim ai e ftoi Zenel Gjolekën në Gjirokastër. Gjoleka në fillim nuk iu përgjigj ftesës së pashait. Atëherë vetë Sadik Liman pasha i kërkoi Zenelit një takim drejtpërsëdrejti me të. Zenel Gjoleka iu përgjigj pashait se pranonte vetëm me kusht që bisëdimet të zhvilloheshin në praninë e një përfaqësuesi të huaj. Ky përfaqësues (sipas këtij prijësi) do të luante rolin e arbitrit. Kërkesa e Gjolekës nuk u pranua dhe pikërisht në këtë kohë, Sadik Liman pasha, nisi forca të shumta turke kundër kryengritësve. Luftëtarët shqiptarë tashti kishin çliruar fshatrat Lefterhor, Kakodhiq e Kamenë dhe nga mali Sopot u dolën përpara trupave të pashait të Gjirokastrës, duke u dhënë një mësim të mirë osmanllinjve.

Gjatë kësaj kohe në Gjirokastër kishte mbërritur nga Ohri ndihma turke. Me qëllim që t'i futnin tmerrin popullsisë vendase, ata i kishin ngarkuar kafshët e tyre me zinxhirë, me të cilët thonin se do të lidhin kryengritësit.¹⁾

Taboret turke të komanduara nga vetë Sadik Liman pasha, së bashku me disa agallarë shqiptarë, që kishin tradhtuar kryengritjen, si renegati Sulejman Tahiri etj, arritën në Delvinë dhe që andej filluan të ndiqnin kryengritësit.

1) Revista «O Neos kuvaras», cit., fq. 170-195.

Gjatë kësaj kohe në Gjirokastër u emërua sundimtar i saj Ismail pasha. Komandantët turq nuk e ndjenin vreten të sigurtë në Delvinë, ndaj sundimtari i ri turk i Gjirokastrës Ismail pasha, i dërgoi ndihmë Sadik Liman pashës. Por kryengritësit përsëri u dolën në befasi trupave turke në «Qafë të Sopotit» dhe pas një luftimi të rreptë, ushtria turke u shkatërrua. Pjesa që mbeti gjallë ua mbathi këmbëve drejt Gjirokastrës.

Më 18 qershor 1847 Ismail pasha filloi sulmin në drejtim të pozicioneve të kryengritësve në Senicë, Zhulat e Palavli, por përsëri luftëtarët shqiptarë i thyen, duke i shkaktuar dëme të mëdha armikut edhe në kampin e vet. Atje u zunë robër dhe oficerë turq.

Të paharruara kanë mbetur në popullsinë e këtyre krahinave jugore të atdheut trimëritë e bijve të fshatit Rexhin të Kurveleshit në luftën e Senicës (fshat në afërsi të Delvinës). Këta luftëtarë sypatrembur, me në krye kordhëtarin Skëndo Taren treguan trimëri dhe vetëmohim të rrallë përpara forcave të panumërtë osmane. Qartë e pasqyron folklori udhëheqësin e kryengritjes Skëndo Taren:

«Kush e njeh kush e ka parë,
Skëndo Tare kordhëtarë, . . .
Në Senicë mu' tek kisha,
Hingëllin kali si bisha,
Flakë u mori këmisha, . . .
Skëndo Tare fustan-ziu,
Turqit me pallë ç'i griu. . . »

Në këto luftime të përgjakshme kundër pushtuesve osmanë ra me pallë në dorë dhe shoku i armëve të Skëndo Tares, i biri i denjë i fshatit Rexhin, kordhëtarı Hasim Jahua. Ja me çfarë vargje zemre e këndon rapsodi vrasjen e trimit:

« . . . — O Hasim, o çepë krënde,
S'dimë si t'ja bëjm' sat' ëme!
Mbeti qyq' në këto vënde,
Kullon lot mbi pallën tënde. . . »

Lufta e Senicës, e Zhulatit dhe e Palavlisë përfundoi me fitoren e plotë të kryengritësve. Në këto rrethana Ismail pasha i dërrmuar u mbyll së bashku me forcat e tij në kalanë e Gjirokastrës.

Udhëheqësit e kryengritjes për të kontrolluar rrugën e Janinës i kishin shpérndarë forcat e veta, që nga malin Sopot deri në Vella. Kështu ata kontrollonin lëvizjet e ushtrisë armike. Me mësimjet e tyre të befasishme, që u bënин karvaneve armike kryengritësit e izoluan krejtësisht garnizonin turk të Gjirokastrës. Një karvan me gjashëtëdhjetë barrë munizione, që sillte rrogat e ushtarakëve turq i nisur nga Manastiri u kthye në Konicë nga frika e kryengritësve.

Zenel Gjoleka me shokë kishte përqëndruar kudo forca midis rrugës Gjirokastër-Janinë, si në veri të fshatit Peshkëpi e gjetkë. Furnizimi u ndërpren dhe nga krahui i Janinës. Një karvan me dyqind barrë ushqime, që ishte nisur nga Grebeneja në drejtim të Janinës u ndal nga frika në fshatin Protopapë, pesë orë larg Janinës. Garnizoni i këtij qyteti kishte mbetur me gjysmë batalioni dmth me katërqind veta, dhe me njëqind e dyzet ushtarë shqiptarë të rekrutuar me forcë nga rrethet e saj.¹⁾

Krerët e kryengritjes kishin vendosur të çlironin më parë Mecoven, Dhriskon, Pesë Puset dhe vendet e tjera rreth Janinës, pastaj të çlironin Janinën, prej nga do të hidheshin në Gjirokastër dhe Berat. Kështu pra, një repart i kryengritësve, pasi kaloi Palopogonin çlroi Llaken e Poshtme, tetë orë larg Janinës prej nga synonte të merrte Mecovën. Forca të shumta turke rreth tetë mijë ushtarë ishin përqëndruar midis Delvinës dhe Gjirokastrës me qëllim që të rivendosnin komunikacionin me këto vende.

Në këto rrethana, ndërsa banorët e Janinës pritnin dita-ditës të çliroheshin nga kryengritësit, autoritetet turke i kishte zënë tmerri. Valiu mundohej t'i inkurajonte besnikët e tij duke u thënë se kishin si vend të sigurtë kalanë e Janinës.

1) Revista «O Neos kuvaras», cit. fq. 182.

Valiu u mundua të grumbullonte forcat nga popull-sia çame, por këta ushtarë të rekrutuar me detyrim dhe të komanduar nga Osman Dinua, ranë në marrëveshje me kryengritësit dhe qëndruan «sehirxhi», kur kryengritësit i sulmuan në Grebene karvanet armike. Robërit turq së bashku me të plagosurit, pasi i çarmatosën, i dërguan tek pashai në Janinë.

Krerët e kryengritjes kërkonin t'i zgjeronin radhët e tyre sa më shumë me luftëtarë të rinj.

Në qeshor të vitit 1847 crerët e «Besëlidhjes» e panë të arsyeshme të bënин përsëri një takim midis tyre.

Mbledhja u zhvillua në fshatin Mesaplik të Smok-thinës, rrëthi i Vlorës. Qartë e pasqyron folklori:

« . . . *Mesaplik te rrapi thatë,*
Për një ditë e pér një natë
U mblohdhën gjithë kazatë. . . »

Në vazhdim të kësaj kënge, rapsodi popullore vë në dukje dhe pjesëmarrjen e gjerë të kapedanëve të Bregdetit, si Gjikë Thanasin e Sokrat Lekën me shokë, të cilët përfaqësonin të trembëdhjetë fshatrat e Bregdetit.

« . . . *Vjen Himara si rigatë,*
Gjik' e Leka me armatë,
Me trembëdhjetë bajrakë. . . »

Krerët shqiptarë vendosën të hartonin një peticion *dhe t'ja dërgonin sultanit*, serasqerit të Rumelisë dhe valiut të Janinës. Në këtë peticion thuhej se ata do të qëndronin të patundur në kërkësat e tyre të mëparshme para portës së Lartë, se do të vazhdonin luftën kundër Tanzimatit, se nuk do t'i jepnin ushtarë qeverisë turke, dhe se kërkonin me këmbëngulje të hiqej administrata e re osmane. Gjithashtu në peticion kërkohet të dënoheshin rreptësisht të gjithë shkaktarët kryesorë të këtyre trazirave që u bënë në popull dhe që shkaktuan kaq dhunime e padrejtësira të mëdha. Urrejtja drejtohej sidomos kun-

dër Vrionasve. «Besëlidhja» mori dhe këto vendime për forcimin e disiplinës në radhët e luftëtarëve të saj:

a) Të mos bëjnë as dëmtimin më të vogël në popullsinë vendase.

b) Ushqimet e luftëtarëve sa të ishte e mundur të siguroheshin nga e dhjeta e bereqetit, e cila ishte taksa e vjetër (ose nga çdo taksë tjeter e vjetër) dhe për tërheqjen e tyre komandanti i krahanës do të lëshonte dëftesë të rregullt, të nënshkruar.

Kryengritësit, të shumëfishuar tanë në mijëra vetë, ishin udhëzuar të silleshin sa më mirë në popull. Luftëtarët shqiptarë në Delvinë u strehuan vetëm nëpër hane dhe në teqe. Ndërsa nënkonklli grek i Janinës, Klerinxis, në raportin e tij Nr. 2270/216 datë 14 qeshor 1847 shpjegon se: «Kryengritësit ua blenë tregtarëve kripën që sillnin nga Vlora me çmimë të mira (të arsyeshme)».

Në verë të vitit 1847 terreni i luftimeve u zgjerua mjaft.

Vala e kryengritjes u përhap dhe në krahanën e Beratit. Një nga shokët e ngushtë të Çelo Picarit dhe të Zenel Gjolekës, Rrapo Hekali, kishte ngritur flamurin e kryengritjes në krahanën e Mallakastrës. Ai, qysh në rini, së bashku me mallakastriotë të tjera, ishte marrë në shërbim të sultanit dhe kishte luftuar në Bosnjë, në Thesali dhe më vonë në Arabi. Thuhet se atje ishte dalluar për trimëri të rrallë.

Rrapua u kthye në atdhe gjatë kohës që në Shqipëri kishte filluar të vihej me forcë në zbatim reforma e re centralizuese osmane «Nizami xhedid».

Sipas historianëve grekë, të pasqyruar dhe në materialin gojor vendas, luftëtarë Rrapo Hekali del pjesëmarrës në mbledhjet me krerët e tjera opozitarë shqiptarë, për luftë kundër Turqisë, qysh në vitin 1830.

Mjaft material gojor kemi trashëguar mbi karakterin luftarak dhe antifeudal të këtij trimi të Mallakastrës.¹⁾

1) AIF, «Lëvizja e Mallakastrës 1847». Eksp. e Tepelenës, Vell. XIII, fq. 134 e vijues.

Thuhet se Rrapua ishte nga të parët në këtë krahinë, që dha shembullin personal për pajtimin e gjaqeve. Sipas gojëdhënave, bashkëfshatari i tij Mane Goxhaj i kishte vrarë Rrapos babanë, Hasanin, dhe për të shpëtuar nga hakmarrja ishte shpërngulur familjarisht në Kaninë.

Kur u kthyte Rrapua në fshat i dërgoi lajme Manes: «Ktheu në Hekal, se ta kam falur gjakun e babait. Eja të luftojmë turkun». ¹⁾

Në krahinën e Beratit familja e Vrionasve ka qenë përkrahja më e flaktë për zbatimin me forcë të Tanzimatit. Kjo familje e madhe feudale urrehej së tepërmë prej fshatarësisë, jo vetëm se ishte shfrytëzuesja më e egër e saj, por edhe pse ajo i shërbente haptas Stambollit për të shtypur kryengritjet e fshatarësisë shqiptare. Një dokument i shkruar nga një konsull i huaj më 6 gusht 1847 në Janinë thotë: «Dhuna dhe keqpërdorimet e familjes së fuqishme të Vrionasve janë ndoshta shkaku kryesor i kryengritjes së tanishme». ²⁾

Thuhet se Hysen pashë Vrioni (sundimtari i Beratit) e thirri Rrapo Hekalin në Berat së bashku me krerët e tjerë kundërshtarë të kësaj krahine dhe kërkoi ndihmën e tyre për zbatimin e rekrutimit të detyrueshëm ushtarak. Në këtë mbledhje, pashai i Beratit gjeti rezistencë të madhe nga krerët e Mallakastrës me në krye trimin Rrapo Hekali. Atëherë Hysen, pashë Vrioni, i tërbuar nga inati i kërcënoi mallakastriotët se në krahinën e tyre do të rekrutonte jo vetëm djemtë, por edhe vajzat!!

Luftëtarë Rrapo Hekali, në këtë kohë, shkoi në Sinjë të Mallakastrës dhe organizoi një mbledhje të shpejtë me krerë të thirrur nga krahina e Mallakastrës. Aty erdhën Zeqo Xhafo Karbunara, Orhan Bardhanji nga Bardhaj i Fratarit, Shaban Peshtani, Zenel Xhafo nga Aranitasi, Veiz Cakrani, Sulo e Muço Zeneli nga Greshica, Lulo Duranji dhe Yzeir Mahmudi nga Kalenja, Luman Elmazi nga Drizari, Sulejman Çelo Toçi, etj. dhe nga kazaja e Vlorës Beqir

1) AIF. «Lëvizja e Mallakastrës 1847». Eksp. e Tepelenës.

2) L. Mile. «Një dokument i ri mbi kryengritjet e vitit 1847». Revista «Ylli» 1968, nr. 8.

Velo e Hadër Sulo Kanina, Dervish Aliu dhe Elmaz Rodaku nga Dukati, Kamber Delo Tragjasi, Haxhi Hoxha, Tartar Memushi e Dule Zoto nga Smokthina, Imer Kudhësi etj.

Në mbledhje Rrapua i vuri ata në dijeni për kërkësat dhe kërcënimet, që u bëri Hysen pashë Vrioni në lidhje me rekrutimin e detyrueshëm ushtarak. Rrapua u bëri thirrje këtyre burrave që kërkësave të beut t'i përgjigjeshin me grykën e pushkës. Krerët e të dy krahinave e përkrahëni njëzëri trimin Rapo. Në mbledhjen e Sinjës u vendos që asnjë ushtar të mos i jepej Turqisë.

Sipas marrëveshjes, forcat e Mallakastrës dhe të kaza-së së Vlorës u takuan në fshatin Povël dhe andej u nisën në drejtim të Greshicës, ku ishin përqendruar tre batalionet e Hysen pashë Vrionit, nën kryesinë e vëllezërve të tij: Isuf beut, Sulçe beut dhe Lamçe beut. Nga këngët popullore të asaj kohe:

«*Doli Rrapua në Sinjë,
Seç e mblodhi miqësinë,
— Del q Lumi Vlorës-o,
Del se do të dalim-o,
Të mëdhenj të vogjël-o,
Të pjekur në Povël-o,
Kemi hall me Virjon-o,
Na kërkon nizamin-o,
Nizam e xhelepet-o...»*

Forcat e bejlerëve ishin vendosur në pjesën verilindore të fshatit Greshicë, në lagjet: Muçaj, Zotaj dhe Fero-beaj.

Ishte verë e vitit 1847. Lufta filloi në mbrëmje. Greshicötët, nën kryesinë e bashkëfshatarit të tyre, Sulo Zenelit e mbajtën vetë luftën një natë e një ditë. Ata luftuan me trimëri duke kthyer dhe gurët e mokrave në barikadë.¹⁾ Në këtë kohë nga jugperëndimi arritën forcat kryengritëse të Lumit të Vlorës me në krye Tartar Me-

1) AIF. «Lëvizja e Mallakastrës 1847». Eksp. e Tepelenës, vëll, XIII, fq. 144.

mushin nga Smokthina dhe Hadër Sulon nga Kanina. Ato u përleshën me trupat e rregullta të Vrionasve në kodrën e Ferobeajit, ndërsa forcat e Rrapos u hodhën në sektorët e tjerë. Lufta vazhdoi e egër pér tri ditë rrreshth. Dëmet në njerëz ishin të ndjeshme nga të dy anët. Jas i pasqyron folklori:

«*Moj Greshica maja-maja,
Për tri dit' u bë hataja...*»

Pas një beteje të rreptë trup me trup, kodra e Fero-beajës ra në duart e luftëtarëve të kazasë së Vlorës. Dëmet e armikut ishin të mëdha, por edhe ato Lumit të Vlorës nuk ishin të pakëta. Atje u vranë rrëth gjashtëdhjetë smokthijnjotë. Edhe sot dihen në fshatin Greshicë varret e këtyre trimave. Rapsodi popullore lab, me këngët e tij u drejtohet grave të Greshicës, që së bashku me djemtë e tyre të vrarë në këtë luftë, të vajtojnë dhe bijtë e rënë të Smokthinës:

«*O ju grat' e greshiciote...
Qani djemt' e smokthjnjo...*»

Morali i kryengritësve ishte shumë i lartë. Bejlerët me forçat e tyre luftonin të dëshpëruar. Ata, duke parë disfatën e tyre, u tërroqën në lagjen Muçaj. Kryengritësit, të revoltuar nga humbjet që pësuan në kodrën e Fero-beajës, nuk pyetën më se kë kishin përpara. Ata lanë mënjanë pushkët dhe me pallë në dorë, u hodhën mbi ushtarët e mbetur turq, që nuk donin të dorëzoheshin. Përleshja u zhvillua e ashpër shtëpi më shtëpi në lagjen Muçaj, por edhe atje pas një rezistence këmbëngulëse forcat e bejlerëve të Beratit u detyruan të dorëzojnë armët. Bukur i pasqyron folklori humbjet e bejlerëve:

«*Dyqind e tridhjetë me radhë,
I shkuan për nënë pallë...
Tartar Memushi nga Vlora,
Preu sa i deshi dora.*»

Kryekomandanti i forcave pushtuese, Hysen pashë Vrioni mundi të shpëtojë. Ai, me pak ushtarë, u tërhoq nga ana e Gradishtit të Hekalit dhe duke shkuar gjatë bregut të Vjosës arriti në Fier. Kurse tre vellezërit e tij: Isuf beu, Lamçe beu dhe Sulçe beu ranë në duart e kryengritësve, të cilët, pas një gjyqi të shpejtë, i ekzekutuan në Qafë të Sinjës. Kjo pasqyrohet qartë në këngët popullore:

«O more Rrapo Hekali,
Kur thërret sa gjëmon malı,
Primë, Isuf beu, primë,
Në të zënca s'ke të mirë,
Gjakun tënd kam pér ta pirë,
Në dorë ta jap mëlçinë,
Kokën me dy fije brinjë,
Gjyqin ç'ja bëri në Sinjë».

Kështu e pasqyron kënga popullore këtë ngjarje.

Me çlirimin e Mallakastrës kryengritësit iu drejtuan Beratit.

Hysen pashë Vrioni i tmerruar nga disfata e turpshme që pësoi në Greshicë, u mbyll në kalanë e qytetit. Forcat kryengritëse rrrethuan Beratin. Luftëtarët e Kudhësit, me në krye Ymer Alinë u caktuan pér t'i rënë nga ana e Mbrezhdanit. Shaban Peshtani me njerëzit e tij qëndroi në urën e Konisbaltës (sot Ura Vajgurore), pér të goditur forcat osmane që mund të vinin nga jashtë, ndërsa një shumicë luftëtarësh nën drejtimin e Orhan Bardhanit dhe të Zenel Xhafos nga Aranitasi, u futën brenda në qytet. Rrapo Hekali me forcat e tij rrrethuan kalanë. Lufta shpërtheu e fortë. Trimat e Rrapos treguan heroizma të shumta, sidomos përballë kështjellës pér të zënë pozicionet nga krahu i lagjes «Murat Çelepi». Trimi Zenel Xhafo ishte nga të parët, që ngriti flamurin e kryengritjes në kishën e kuqe afër kalasë. Ai u nis drejt portës së kështjellës, por atje ra heroikisht së bashku me luftëtarin tjetër Orhan Bardhanin. Nga këngët e asaj kohe, mësojmë se:

«Topi bam e ti po tutje,
Ç'e zure qishën e kuqe,
Të shkojnë plumbat mbi supe,
Vetëtin palla me lule...»

Gjatë kësaj beteje duke sulmuar për t'ju afruar klasë u vra dhe trimi Sadik Xhelua nga Aranitasi. Të panumërtë janë këngët popullore për trimat e kazasë së Vlorës, që morën pjesë në luftë për çlirimin e Beratit:

«Tragjas e Dukati shumë,
Dil, o Kanina me vulë,
Kaza e Vlorës furtunë,
Asnjë nuk e lojti gurë...»

Në këto këngë të vjetra popullore pasqyrohet qartë ndjenja e zhvilluar kombëtare e këtyre trimave. Vetëm në gjuhën shqipe, ata pranuan t'i përgjigjen pashait osmanlli. Ja si reflektohet në folklor krenaria e ligjshme e luftëtarit Dervish Ali Dukatit:

«Dervish Aliu kur dole,
Pallën në sup e hodhe,
Qafën e Sinjës kaptove,
Në Berat vajte qëndrove,
Me pashallarë luftove,
Ata flisnë e ti s'dëgjoje,
Dije turçe, po nuk doje,
Me terxuman kuvëndoje...»

Me qindra janë trimat që morën pjesë në këto lufte të përgjakshme. Të gjithë nuk mund të përshkruhen. Ndoshta çdo gjë i ka munguar popullit tonë, vetëm trimat nuk i kanë munguar kurrë. Ata i gjen kudo në Shqipëri dhe në çdo kohë, ndoshta të zbathur e të zhveshur, por kurdoherë në këmbë, të gatshëm për t'iu hedhur në grykë armikut. Me plot të drejtë një konsull i huaj në atë kohë ka shkruar: «Karakteri dallues i shqiptarit

është heroizmi. Në të gjitha kohët Shqipëria ka qenë dje-
pi klasik i heronjve». ¹⁾

Serasqeri i Rumelisë Darbihor Mehmet pasha, në këtë
kohë bëri një mbledhje në Ohër me shefat e ushtrisë së
tij. Për të furnizuar me ushqime e municione garnizonin
turk të Gjirokastrës serasqeri ngarkoi mytesarifin e Kos-
turit, Shahin benë. Ky bez së bashku me ushtrinë e tij
u nis nga rruga e Korçës në drejtim të Kolonjës e Les-
kovikut dhe arriti në Kakollakos të Palopogonit. Që andej
shkoi në Peshkëpi, ku u bashkua me forcat turke që ru-
anin rrugët e komunikacionit.

Ishte mesi i korrikut të vitit 1847. Bënte vapë e ma-
dhe, uji mungonte. Shahin beu u detyrua të ekte midis
fushës, anës lumi. Forcat e Çelo Picarit dhe të Zenel
Gjolekës i vrojtonin së largu. Kryengritësit i lanë taboret
e shumta turke të kalonin përpara, ndërsa pas vinin të
shoqëruar karvanet e ngarkuara plot me municione dhe
ushqime. Me një manovrim të shpejtë, kryengritësit tër-
hoqën përpara më të shumtën e forcave turke të Shahin
beut, duke i larguar nga karvanet me material lufte, që
i ndiqnin pas, kështu shqiptarët mundën t'u rrëmbenin
atyre armë e municione që aq shumë u duheshin për t'u
armatosur. ²⁾

Rreth kësaj ngjarje ka mjaft këngë:

«... Thërrët Çelua me trumbetë,
— T'u hidhem i more Gjolekë,
— Mos Çelo se s'ke fishekë,
Se na legendisen djemtë,
Bënë fushës tatëpjetë,
Gjenë Shahin benë vetë,
I vin karvani si bletë,
Seç i morën xhephanetë ...»³⁾

1) Revista «10 Korriku» 1975, nr. 11, fq. 13.

Revista «Ylli», 1962, nr. 1.

2) Revista «O Neos kuvaras». Cit. fq. 190,

3) AIF (Dosja II M.K.)

Shahin beu i tērbuar, që mbeti pa municione, ndali marshimin dhe fushoi në afërsi të Gjirokastrës, për t'u përgatitur për luftë.

Trimat e vegjelisë Zenel Gjoleka, Çelo Picari dhe Hodo Nivica u ngriten një kurth të ri hordhive turke. U dha urdhëri që në fillim ata të qëllonin osmanllinjtë e pastaj të tērhiqeshin menjëherë drejt përrrenjeve që vinin nga Mali i Gjerë, dhe atje të zinin prita pas shkëmbenjve. Forcat e Shahin beut u gënjen nga kjo manovër.

Ata i ndoqën prapa kryengritësit dhe ranë në kurthin e tyre. Forcat e Shahin beut u gjendën kështu të rrethuara nga të katër anët prej forcave kryengritëse. Pastaj u dëgjua zëri kumbues i Zenel Gjolekës, që u bënte thirrje shokëve për sulm. Gryka u shndërrua në një kasaphanë të vërtetë. Shahin beu mezi shpëtoi kokën, duke ikur me kalin e tij të shpejtë, dhe u strehua në kalanë e Libohovës.

Të nesërmen krejt sheshi i luftës ishte mbuluar me kufoma njerëzish e kuajsh të vrarë.

«*Shahin be, o kokë mollë,
Mos e pandeve Mecovë,
Këtu i thonë Arbëri,
Që të zënë ti si mi...»¹⁾*

Kënga e poshtëshënuar tregon dhe lidhjet e vjetra miqësore, që kanë ekzistuar midis bregdetasve dhe kurveleshasve, që morën pjesë në «Besëlidhje» dhe në këto beteja të lavdishme për lirinë e Shqipërisë. Ja si thotë kënga:

«*Shahin be, djalë dovleti,
Mbahu, o Çelo Mehmeti,
Imdatështë Bregudetit,
Në Nivic' ke Kiço Dhulë,*

1) AIF (Dosja II M.K.)

*Që ësht' i pari në vulë, ...
Ke gjysmën e vilajetit,
Që lufton me pallë sheshit. . . »¹⁾*

Në këto luftime trimat e Çelo Picarit i gjejmë të vëllazëruar me trimat e Lunxhërisë. Sipas këngës popullore, të gjithë, burra e gra, u hodhën në luftë kundër Shahin be Kosturit:

*«Në fushi, në Gjirokastër,
Luftojnë burrat e gratë,
Lunxhëria vënd i pakë,
Nga Shëntriadha në urë,
E prishën gjithë taburë. . . »²⁾*

Sipas historianëve grekë Aravantinoit etj., trimat shqiptarë, nën zjarrin e topave turke, sulmuani natën kalanë e Gjirokastrës, ku ishte mbyllur Ismail pasha me katër batalionet e tij. Ky pasha i urryer, për t'i futur tmerrin popullsisë vendase kishte njoftuar ushtarët e tij se për

1) Këngët e hershme popullore flasin mjaft mbi lidhjet e ngushta luftarake të Çelo Picarit me shokë, me kapelanët e Bregdetit, si me Kiço Dhulin nga Nivicë-Bubari, Vjero Priftin nga Qeparoi, Foto Kopalin nga Çorraji etj. Këta trima edhe mbas vdekjes janë përmendur në këngët popullore për të nxitur luftëtarët e rinj të bashkohen për mbrojtjen e atdheut. Këto këngë këndo-heshin sa herë që armiku i afrohej vendeve tona:

*«...Që kur vdiq Çelo Mehmeti,
Kiço Dhuli nga Bregdeti,
Mbeti njeri pas a s'mbeti?...»*)*

*) Shih dhe AIF Nr. 2 «Epika historike». Eksp. Gjirokastrës, 1954, vell. XV, fq. 306/455.

AIF «Këngë luftë për liri». Eksp. e Tepelenës, vell. XIV, fq. 35,

2) Po aty.

çdo kokë kryengritësi që do t'i sillnin do të shpërble-heshin me nga një flori.

Kështu ushtarët e Ismail pashës dilnin nga kalaja e Gjirokastrës me skuadra të vogla, vrisnin buqit, që gjennin nëpër fushë dhe kokat e tyre ja sillnin Ismail pashës për koka kryengritësish. Për të evitar këtë masakër barebare, Gjoleka, Çelua dhe Hodo Nivica, vendosën në çdo hendek nga dy luftëtarë. Njëri nga këta mbushte armët, tjetri qëllonte kalorësit që delnin për këtë gjah mizor në njerëz. Kështu turqit humbën përmbi njëqind kalorës dhe u arrit të evitohet masakra.

Në këtë kohë Ismail pasha për të treguar forcën e tij bëri një demostrim të trupave ushtarake që nga Gjirokastra e deri në fshatin Terihat. Ai urdhëroi ushtarët të ecnin me hapa të shpejta sipas ritmit të bandës, që ishte në krye të ushtrisë.

Afér Terihatit, në «Bregun e së bukurës» (Oriase), ku janë gërmadhat e një kështjelle të vjetër, qëndronte Hodo Nivica me pesëqind shokët e tij, në të djathtë kishte zënë vend trimi Gjoleka, ndërsa në të majtë qëndronin çamërit me në krye sypatremburin Hamit Çaparin nga fshati Lurat i Margëllécit. Qëlluesit më të mirë ishin vënë në pikat kyçe. Të gjithë luftëtarët ishin maskuar mirë. Ata i lanë hordhitë turke t'u afroheshin shumë. Kryengritësit hapën zjarr të parët. Pushka plasi nga të gjitha anët. Osmanllinjtë u habitën. Ata nuk orientoheshin dot se nga vinin plumbat. Në fillim u vra komandanti i paradës, pastaj dhe mjaft oficerë të tjerë. Vetë Ismail pashait iu vra kali. Ushtarët turq të mbetur pa komandë dhe të tmerruar nga kjo grackë e papritur, ua mbathën këmbëve në drejtë të Gjirokastrës.¹⁾

Historianët grekë lidhur me vazhdimin e luftës shpje-gojnë: «Është për t'u admiruar suksesi i shkëlqyer, që duket si i pabesuar i kryengritësve në fshatin Dhulana në veriperëndim të Janinës. Nga ora një pas mesnate kryengritësit iu afruan fshatit. Këta lëshuan përdhe gu-

1) Revista «Neos kuvaras». Athinë 1966, fq. 195.

nat e pushkët dhe me kordhë në dorë, duke bërtitur, u hodhën në sulm me shumë guxim, u futën në shtëpitë e fshatit dhe i masakruan turqit. Masakra vazhdoi deri në mëngjes. Ushtria turke e përbërë prej pesë mijë vëtësh u shpartallua. Ata që mbenë gjallë, të tmerruar ua mbathën këmbëve në drejtim të Janinës.¹⁾

«... Dhulanas i vunë zjarre, Prishën pes'tabor nizamë...»

Nga mesi i muajit gusht një ushtri e madhe turke me në krye vetë serasqerin e Rumelisë Darbihor Mehmet pashën, doli në Ohër dhe që andej u drejtua për në Elbasan. Këtu, pasi i shtoi akoma forcat me njerëzit e mobilizuar nga mythesarifi i Elbasanit si dhe me ato të rene-gatit shqiptar Aga Balashit (me origjinë nga katundi Shëngjergj i Tiranës) i njohur në Toskëri me emrin Haxhi Gegë fermanlli (ose Gegë mirjallahu) iu vërsul Beratit.²⁾

Në këtë kohë forcat e Rrapo Hekalit tradhtohen nga Shaban Peshtani. Ai braktisi sektorin e Konisbaltës, që i qe besuar për ta mbrojtur dhe u bashkua me vrionasit:

«... Moj Dhëlpër e marsitë, Shaban Peshtan qerata, Njerëzit' tan' i trathëtove, Me vrionas u bashkove...»

Në urën e Konisbaltës mbetën forcat e pakta të Rrapos me ato të kazasë së Vlorës. Osmanlinjtë kërkonin me çdo kusht të hidhnin në dorë urën. Filloi lufta, që arriti në përleshje trup me trup. I paharuar do të mbetet qëndrimi vetëmohues i luftëtarëve të kazasë së Vlorës për mbrojtjen e urës. Me gjithë epërsinë numërike të armikut, këta trima nuk nguruan të përleshën me hor-

1) P. Aravantinoi. «Hronografia e Epirit». Athinë 1856, libri 6, paragrafi 85.

2) AIH. Dosja invent. A-IV-201.

dhitë e shumta turke (të përbëra në shumicën dërrmuese prej çerkezësh, që njiheshin si luftëtarë të sprovuar). Rapsodi popullor i ngre këto vargje Dervish Ali Dukatit, që tregoi heroizëm të rrallë në mbrojtjen e urës së Konisbaltës:

«... *Dervish Aliu e kish nurë,*
U rrin me këllëç në hundë,
Halldupëve gunë murrë;
I shkon si dhëntë në shtrungë,
Ç'i palos për nën urë...»

Ushtria turke shtohej dita-ditës me forca të freskëta të ardhura nga Elbasani dhe Kavaja. Kryengritësve nuk u erdhi asnjë ndihmë e re. Ata vazhdimisht pakësohe-shin. Në këto luftime ra heroikisht dhe njëri nga udhëhe-qësit kryesorë të luftëtarëve të kazasë së Vlorës, Elmaz Rodaku nga Dukati. Populli i këndon:

«*Tek ura në Konisbaltë,*
Mbenë tragjas e dukatë, ...
C'u përvëluan në flakë,
Hiqu Dervish se të zunë,
Se Elmazë ta përgjunjë...»

Të shumta janë trimëritë e sakrificat e luftëtarëve të Rrapo Hekalit, të Luman Elmazit nga Drizari, të Lulo Duranjit e të Yzeir Mahmudit nga Kalenja, të Sulejman Çelo Tocit, të Sulo e Muço Zenelit nga Greshica, etj. Të gjithë nuk mund të pëershkuhen dot. Trupat e shumta osmane filluan të vërshonin në Shqipëri edhe nga ana e detit. Vlora u mbush plot me nizamë. Përleshjet për mbrojtjen e Beratit morën përpjestime të gjera. Çdo luftëtar shqiptar i takonte të luftonte me dhjetë nizamë. Serasqeri i Rumelisë Darbihor Mehmet pasha, kërkonte me këmbëngulje të futesh sa më parë në qytetin e Beratit, por trimat e Mallakastrës dhe të Labërisë, edhe pse të paktë në numër, jo vetëm nuk i lëshuan pozicionet e tyre të avan-

cuara, por u hodhën edhe në sulm në krahun e urës së Konisbaltës. Kalorësit e rëndë turq u ndoqën këmba-këmbës nga kavaleria e lehtë shqiptare. Nizamët e serasquerit, të habitur nga sulmi i befasishëm i shqiptarëve ua mbathën këmbëve. Thuhet se ushtarët osmanllinj të mbetur prapa përfunduan nën shpatën e trimave shqiptarë. Mjaft nga kalorësit turq, të vënë në ndjekje, flutruan nga shalat e kuajve dhe ranë përdhe sikur t'i kishte rrëmbyer era. Kuajt e shqiptarëve u shkuan përsipër, i shkelën dhe i dërrmuani.

Gjatë kësaj kohe, udhëheqja e kryengritjes lëshoi urdhërin e tërheqjes për luftëtarët që mbronin Beratin, mbasi ata ndodheshin nën rrezikun e rrethimit të plotë nga ana e osmanllinjve.

Luftëtarë i paepur i Mallakastrës, Rrapo Hekali, i tradhtuar dhe nga disa krerë të tjerë feudalë vendas, në pamundësi për të qëndruar në Mallakastër, së bashku me vëllanë e tij Hamitin dhe me trima të tjerë, u hodh në Labëri.

Anëtarët e «Besëlidhjes» në këtë kohë i dërguan dhe një letër mbretit Oton të Greqisë, në të cilën i kërkonin ndihmë materiale. Ajo ishte e nënshkruar nga 89 krerë, që përfaqësonin krahinat e ndryshme në «Besëlidhje». Në krye ndodhet emri i Zenel Gjolekës dhe i Çelo Picarit. Letra mban datën 15 gusht 1847.

Ajo u dërgua në Athinë me anën e anëtarit të «Besëlidhjes» Stefan Calit nga Qeparoi i Himarës.

Sipas renditjes së emrave në letër, vëmë në dukje emrat e përfaqësuesve që e kanë firmosur:

Kazaja e Delvinës:

Zenel Gjoleka, Xhelil aga (Çelo Picari).
Sejko Bilushi, Avdul bej Koka, Muharem Behluli,
Lulo Çapari, Muhamet Abazi, Muho Pronjo, Zahir Pronjo,
Osman Kuci, Muhamet Selmani, Aliko Hodo, Xhate Selfo,
Latif Elmazi, Mane Beqiri, Demçe Picari, Hodo Nivica,
Sulo Çobo, Labë Duka, Sadik Bolena, Dervish Kallarati,

Lame Petani, Sinan Malo, Mustafa Ibrahim, Kapo Myftari, Lame Huso, Mustafa Bedo, Myftar Pina, Sheh Duro, Elmaz Çobo, Xhafer Demi, Ahmet Dino.

Kazaja e Vlorës:

Beqir Velo Kanina, Hadër Sulo Kanina, Mustafa Bimo Kanina, Sadik Armeni, Muhamet Muço, Ismail Mekati, Zeqo Xhafo Karbunara, Pasho Selman Koculi, Haxhi Tahir Mavrova, Dalip Çelo Mavrova, Selim aga Vlora, Meçan aga Vlora, Fejzo bej, Lato Kanina, Myrto Nelo Lopësi, Mato Caush Lopësi, Xhaxha Martallozi, Abedin Sheshi, Sadedin Vasjari, Ahmet aga Vasjari, Mehmet Qolasi, Osman Rrapo Fratari, Beqir Braçani, Lulo Abazi, Zenel Hodo, Ibrahim Qibro, Lilo Qendro, Mete Çobo, Talo Habili, Sinan Dervishi, Hito Daut Mavrova, Zibo Keshti, Mehmet Drashovica, Ymer Ali Kullesi, Mustafa Bega, Bega Ismail, Dervish Ali Dukati, Metan Ali Dukati, Kamber Delo Tragjas, Mahmud Hoxha, Dule Zoto, Bajram Muço, Selam Hasani, Haxhi Hoxhë Smokthina.

Të dy Mallakastrat:

Rrapush aga Kamdibashi, Shaban Peshtani, Skendo Hyso Qesarati, Sulejman Çelo Toçi, Osman Byli, Dule Mati Kalivaçi, Xhelil Duro Kalivaçi, Sadik Luftinja, Remkë Komani, Ahmet Martallozi, Mahmud Lame Levani, Xhaxha Levani.

Mbreti i Greqisë Otoni ua ktheu përgjigjen negative shqiptarëve, duke u justifikuar se (sipas tij), arkat i ka bosh e për pasojë nuk mund t'i ndihmonte dot.¹⁾

«Besëlidhja» mori vendim që ata të gjithë, nga shtatë vjec e lart, të ishin gati të vdisnin me armë në dorë në qoftë se sulltani nuk do të merrte parasysh kërkjesat e tyre të drejta.

1) Kosta Biri. «Arvanites...» Athinë, 1960, fq. 362. Revista «O Neos kuvaras». Cit., fq. 180,

Historianët shovinistë grekë janë munduar vazhdimisht t'i errësojnë këto kryengritje masive shqiptare. Ata qdo kryengritje shqiptare e paraqesin kryengritje greke, se çdo lëvizje në Shqipëri gjoja është e organizuar, e drejtuar dhe e ndihmuar prej tyre. Ja si mundohen t'i shpjegojnë këto ngjarje njerëzit e megalidesë në revistën vjetore greke «Neos kuvaras», faqe 167, botuar në Athinë më 1966. Atje thuhet se kryengritësit shqiptarë u futën në këtë luttë me shumë romanticizëm, pasi ishin të sigurtë se prapa tyre fshihej qeveria greke në atë kohë me kryeministër Jani Koletin. Municionet, paratë dhe udhëzimet ishin të tijat. Ai i drejtonte mendimet politike të Gjolekës me shokë. Me këto synime megalideiste janë komentuar, shtrembëruar dhe falsifikuar dhe materiali arkival i tyre, konkretisht edhe përbajtja e letrës që kërret e kryengritjes shqiptare i kishin drejtar mbretit të Greqisë, Otonit.

Një rol me rëndësi në hartimin e shkresave, të letrave e të petacioneve dhe në mbarë organizimin e mbledhjeve të ndryshme të «Besëlidhjes» ka luajtur dhe plaku i zgjuar Luto Shehu nga fshati Kutë i Mallakastrës, i njohur në këtë krajinë si sekretar dhe këshilltar i Rrapo Hekalit, kurse në Kurvelesh këtë detyrë e ka kryer luftëtar i regjur mulla Lazo Kofina nga fshati Fterrë i Kurveleshit, i cili njihet në mbarë Labërinë si këshilltar i Zenel Gjolekës me shokë.

Mulla Lazua, njeri me iniciativë, me dije dhe trimëri, ka organizuar me dhjetëra betime në masat fshatare, labe për të mos shkuar ushtarë. Sipas folklorit:

«... Kurvelesh derë më derë,
Me një mulla Lazo Fterrë,
Lidhën fjal' e bënë benë;
Që nizamë të mos venë...»

Ky bir i fshatarësisë së varfër labe nuk u përkul kurrë as para dhunës së osmanlliut dhe as para gradave e shpërblimeve (sipas popullit — sqimave) që i ofroi vazhdimisht qeveria turke për ta larguar Lazon nga «Besëlidhja».

Ai edhe pse i varfër mbeti deri në fund bir besnik
dhe mbrojtës i flaktë i interesave jetike të vegjelisë labe.
Ja si e pasqyron rapsodi i Kurveleshit të kaluarën e mje-
ruar plot varféri, por të pastër të këtij trimi të papërku-
lur:

«... O more Lazo Kofina,
Që s'pranove kurrë sqima,
Plot me arna t'u mbush linja...»

Gjatë kësaj kohe forca të reja turke kishin hyrë në Shqipëri. Fuqitë e tyre tashti ishin të shumëfishuara me trupa të freskëta, ndërsa forcat kryengritëse shqiptare ishin të pakëta në njerëz e armatime. Anëtarët e «Besëlidhjes» u shpérndanë anembanë vendit për mobilizimin e popullsisë. Gjatë kësaj kohe radhët e luftëtarëve shqiptarë u shtuan me trima të rinj. Një ndihmë e mirë u erdhë kryengritësve edhe nga Bregdeti. Himariotët u hodhën pa rezerva në luftë kundër pushtuesit osman, pasi në këtë kohë qeveria turke e hoqi dhe autonominë e Himarës, që e gjëzonte kjo krahinë prej shekujsh. Bregdetasve, me kaq tradita të pasura atdherashurie nuk ishte aq e lehtë t'u hijje vetëqeverisjen e tyre shekullore. Në kujtimet e himariotëve mbahej akoma e gjallë e kaluara e lavdishme e Himarës së vjetër, e kësaj krahine, mbështetëse e dikurshme e sigurtë e Skënderbeut dhe më vonë e djalit të tij, Gjon Kastriotit.

Këngët e hershme himariote plot trimëri dhe patri-otizëm, akoma këndohen nga bijtë e Himarës, që kanë ngritur krye përsëri kundër të njëjtit armik, që luftoi dikur dhe Skënderbeu. Ja si kujtohen në këngët e hershme himariote vëllazërimi i krahinave të këtyre anëve dhe trimat që nxorën këto vende për luftë kundër pushtuesit osman:

«Qysh ka qënë mëmëdheja,
Iskënderi si rrufeja, ...
Olimpiadha nga Janina,
Që kish pjellë ata trima. ...»



Zenel Gjoleka, Çelo Picari, Hodo Ali Nivica.

Valiu i Janinës pér t'i têrhequr trimat e Himarës nga «Besëlidhja» dhe nga rruga e kryengritjes, u premtoi se do t'u jepte përsëri autonominë. Por, me gjithë dhelpëritë që përdori, ai nuk mundi të ndalojë bregdetasit të hidheshin në kryengritje. Folklori e pasqyron këtë fakt:

*... Himara pér kadiminë,
Kundërshtoi çerqezinë,
Haxhi gegë fermanllinë... »¹⁾*

Bregdetasit e kishin akoma të freskët në kujtesën e tyre vrasjen e shëmtuar të përfaqësuesit të Himarës kapetan Kost Aleksit, nga valiu i Janinës.²⁾

Sipas planit të këshillit drejtues të kryengritjes, ishte vendosur të çlrohej kryeqendra e vilajetit, Janina³⁾. Në fakt trupat kryengritëse i qenë afruar asaj, por arritura e serasqerit të Rumelisë në Berat e Mallakastër me forca të shumta dhe me armët më moderne të kohës i detyroi kërret e kryengritjes të têrhiqeshin me forcat e tyre në drejtim të maleve të Labërisë pér të organizuar mbrojtjen.⁴⁾

Në këtë kohë forca të shumta turke u futën nga të gjitha anët në Shqipëri. Gazeta ruse «St. Peterburgskie», duke ndjekur zhvillimin e lëvizjes fshatare në Shqipëri njoftonte: «Porta e Lartë me notën e datës 2 gusht 1847 u bëri të ditur ambasadave të huaja se pér një muaj brigjet e Shqipërisë që nga Preveza deri në Durrës do të jenë të blokuara nga forcat detare turke». ⁵⁾

Ushtri të tjera turke zbarkuan nga deti në Vlorë dhe në Himarë, u bashkuan me forcat e mëdha të serasqerit

1) AIF. «Këngë të rezistencës kundër sundimit turk», Vell. XXXIII, fq. 267.

2) AIF (Dosja II M.K.)

3) Revista «O neos kuvaras». Cit. fq. 186.

4) Po aty.

5) L. Mile. «Rreth kryengritjeve të mëdha fshatare të vitit 1847». Buletin i USHT, fq. 79. Seria e shkencave shqërore 1/1961.

të Rumelisë. Hordhitë osmane morën rrugën për në thellësi të Labërisë. Ata nuk kaluan nga grykat ku i pritnin kryengritësit, por u drejtuani nga ana e Mesaplikut, mba-si ishin informuar më parë nga një pjesë e parësisi turkomanë të Vlorës dhe nga mercenarë të tjerë si Sulejman Tahiri etj.

Lufta në fillim plasi në vendin e quajtur Horë, në afërsi të fshatit Vranisht, ku osmanllinjtë kishin ngritur çadrat e tyre. Sipas folklorit:

«... N'urë të Brate u hodhë,
Mesaplik ngulën taborë,
Ngritën çadëret në Horë...»

Fshatarësia e kazasë së Vlorës, e tradhtuar nga bejlerët turkomanë të vendit, u tërroq në brendësi të maleve dhe u dha betejë osmanllinje në fillim në Horë, në Bogdan dhe në Gjomih. Kryengritësit luftuan me trimëri të madhe. Ata zbatuan me mjeshtëri taktikën e luftës së çetave, duke i sulmuar turqit edhe natën nëpër çadrat e tyre.

Në këto luftime u dalluan për trimëri të rrallë luftëtarët e Tërbacit si Lulo Abazi, Dulo Koka, Dino Dreri, Beqir Selimi etj.

Rapsodi popullor e përshkruan bukur figurën e trimit Lulo Abazi:

«... O Lulo Abaz Mehmeti,
O mali në mes të detit,
I ktheve gjoksin dovetit,
Që në Tanzimat e tutje,
Të mbeti palla mbi supe... »¹⁾

Lufta midis kryengritësve dhe turqve nuk ishte një luftë fronti dhe kjo jepte mundësi për manovrime të gjera. Shqiptarët, duke përdorur me sukses taktikën e luftës së çetave, e sulmonin dhe anash armikun, duke i

1) AIF (Dosja II M.K.)

shkatërruar prapavijen dhe bazat e furnizimit. Trimat e Labërisë, të zotët e këtyre shkrepave të thepisura malore, i futën në panik nizamët e shumtë të serasqerit duke i goditur edhe natën:

«*Beqir labi gunë zi,
Turget se ç'u sokëlli,
Natën në lloh' e në shi,
Merrte shënjën në llami...*»¹⁾

Me fjalë të tjera, merrte shenjën natën në dritë të vetëtimës.

Sipas gojëdhënavë, trimi Dulo Koka i udhëhoqi trimat e tij nëpër shtigjet verore dhe u doli mbas shpine turqve, ndërsa Dino Dreri së bashku me luftëtarët e tjerë të Vranishtit e të Mavrovës me në krye Mete Çobon dhe Hito Dautin zunë vendet më të rrezikshme.

Shqiptarët betejat i zhvillonin pa një komandë të përgjithshme. Çetat e fshatrave pa u kujdesur shumë për planin e caktuar nga «Këshilli drejtues i kryengritjes» vepronin sipas rrëthanave, ndërsa komanda turke vepronët në mënyrë të organizuar. Ata hodhën kundër kryengritësve forcat më të mira të tyre. Bukur pëershkruehet në folklor trimi i Tërbaçit Dulo Koka. Ai ishte nga të parët që i sulmoi osmanllinjëtë në zonën e Bogdanit:

«... Që nga Bogdani në Horë,
*Luftove me tre taborë,
Luftove bashkë me trimë,
Dulo koka, vetëtima...*»
*Dulo Koka, Dino Dreri,
Sokëllijn' sa tundej vendi, . . .
Bogdan Dulo Kokë trimi,
Gjomicha Beqir Selimi...»²⁾*

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

Të shumtë janë trimat që zbritën në fushën e luftës nga fshatrat e kazasë së Vlorës si Dalip Çelo Mavrova, Lilo Qendro nga Brataj, i dalluar si shënues i shkëlqyer, Haxhi Hoxhë Smokthina, Mehmet Drashovica, Mustafa Bega nga Sevesteri, Selam Hasani nga Velçë etj.

Së bashku me luftëtarët e kazasë së Vlorës luftuan trimërisht dhe kapedanët e Bregdetit me Gjikë Thanasin në krye:

«Dërgoi Gjoleka njerinë,
Lumi e Bregu të vinë,
Ç'u shkulën që në Kaninë,
Jaupi me Margarinë, . . . »¹⁾

apo:

«. . . Gjik' Thanasi vet' i pestë,
Griu, vrau pesëdhjetë. . . »

Gjatë kësaj kohe luftimet u zhvendosën gjatë lumbit Shushicë. Atje vazhduan edhe më egër luftën bijtë e «gjalmëzezave» (sikurse i quan populli bijtë e Labërisë). Gojëdhëna popullore shpjegon se lufta në lumin Shushicë ishte aq e rreptë sa dhe uji u kuq me gjakun e ushtarëve turq dhe me të luftëtarëve shqiptarë që kishin vendosur të rronin të lirë në vendin e tyre.

Komandantët dhe ushtarët turq, shumica dërrmuese çerkezë, të tërbuar nga humbjet e shumta që pësonin, kudo që shkonin linin pas vetes lotë dhe mjerime, shtëpi e të mbjella të djegura. Me mijëra bagëti u therën dhe u rrëmbyen nga ushtarët e Darbihor Mehmet pashës.

Nga trimat e Labërisë që u dalluan më shumë në luftimet rreth lumbit Shushicë, vlen të përmenden në radhë të parë bijtë e fshatit Bolenë. Rapsodët e hershëm populorë i kanë gdhëndur në këngë emrat e ndritura të Leskodukajve si të Sadikut, Birçes, Leskos, Birbilit etj. Ata,

1) AIF. «Festivali folkloristik i rrethit të Vlorës». Vell. 76 fq. 12.

së bashku me trimat e tjerë të Bolenës si me Sinan Malon, Kasëm Mullanë, Zenon etj, luftuan me trimëri të rrallë në Gjomisha, Bogdan, në Horë dhe në lumin e Shushicës. Gojëdhëna popullore pohon se lufta në këto krahina u zhvillua e ashpër. Shqiptarët u ndodhën para forcave të panumërturke, por palla e këtyre trimave, e leskodus kajve me shokë qëndroi vazhdimisht lart, mbi kokat e armiqve. Ajo nuk u përkul dhe as u thye:

«... Ç'ësht' ajo që na shkon tutje,
— Pall' e lar' e Leskoduke,
E mban Birçeja mbi supe,
O Sadik, o Lesko,
Pall' e lar' e Birçeso,
Pall' e lar' e Leskoduke,
Me ripa supe më supe,
Moj e shkreta s'u këpuse...
Sadiku lufton në këmbë,
I pret plumbatë me dhëmbë.
O Sadik, o Lesko,
Pall' e lar' e Birçeso...»

Këta barinj të lirë të Kurveleshit të bashkuar, **gra** dhe burra, luftuan dhëmb për dhëmb me armikun dhe nuk e lanë të bënte këmbë më tutje ushtrinë e madhe osmane. Në këto beteja të përgjakshme vetëm nga Bolena ranë rrëth tetëdhjetë veta. Së bashku me këta trima ra në fushën e nderit dhe njëri nga udhëheqësit e luftëtarëve të Bolenës, miku i vjetër i Çelo Mehmetit (Çelo Picarit) kapet dan Sinan Malua. Populli ynë, në këngët e tij ngre lart heroizmin e Sinan Malos, që nuk ia bënte syri tërr, mbasi ai luftonte për çështjen e madhe të lirisë, për mbrojtjen e atdheut:

«... Kuc, Kallarat e Bolenë,
Në lum' e zunë dufenë,
Sinan Malua çepeverdhë,
Vrit e prit m'ata levendë...»

Rapsodi popullor me këngën e tij edhe nga varri kërkon të ngrejë trimin e Bolenës Sinan Malon, që ai të luftojë përsëri kundër osmanlliut, krahas trimave si Çelo Picari (Mehmeti) me shokë:

«... Ngrehu Sinan dhe njëherë,
Ashtu si keshe adenë,
Bashkë me Çelo Mehmenë»¹⁾.

Vrasja e kapedan Sinanit me shokë i hodhi gjithë bijtë e Bolenës, të Kuçit dhe të Kallaratit në sulm. Gojëdhëna popullore flet për heroizmin e shtatë bijve të Leskodukajve në Shushicë, Buzer etj. që me pallë zhveshur dhe duke sokëllitur, u futën midis rreshtave të ushtrisë otomane. Në këto luftime të pabarabarta ra në fushën e luftës dhe njëri nga shtatë Leskodukajt, kapedani i ri Birbil Leskuia, i biri i Lesko Mingos nga Bolena dhe i Sose Mustafarait nga Kuçi i Kurveleshit. Birbili edhe pse u plagos rëndë, nuk u tërroq nga beteja, por luftoi deri në pikën e fundit të gjakut krah për krah me udhëheqësin, Zenel Gjolekën me famë. Birbili e dha shpirtin në krahë të këtij trimi të paepur. Sipas gojëdhënave, thuhet se edhe vdekja nuk mundi t'ja zbehi bukurinë e mahnitshme këtij trimi të ri, aq shumë të përmendur në mbarë krahinën. Ja me çfarë fjalëzëmre e ka kënduar poeti i mrekullueshëm, populli, figurën e ndritur të kapedan Birbil Leskos, kur e shpunë të vrarë në vendlindjen e tij, në Bolenë:

«Ja ku na prunë Birbilë,
Shkallë më shkallë si yllë,
Se ç'u mblohdhën se ç'i thanë,
— Vall' i kuja ësht' ky djale,
Vall' i kuja ësht' kjo pemë?
— I Lesko Mingo Bolenë,
— Vallë ç'nënë e ka pjellë?
— Një Sose Kuçe e verdhë...»

1) AIF, Ekps. e Gjirokastërës 3a nr 180/422.

Turqit, pas shumë përpjekjesh, me anën e tradhtatëve bimbash Sulejman Tahirit dhe Haxhi aga Mustafa Balashit, mundën të futen në brendësi të fshatit Bolenë dhe i vunë atij zjarrin. Lufta u zhvillua e egër prag më prag. Çdo shtëpi e kasolle që digjej, e paguante pushtuesi me koka ushtarësh të tij. Urrejtja e banorëve trima të Bolenës ishte e papërmabjatur:

«*Bolenë, e zeza Bolenë,
Që bëre dyfek me mbrenë,
Gjashtë muaj dit' e natë
Bëjnë luft' me një rigatë.*)
Djemtë tanë se ç'luftojnë,
Të shkretët Bolen' e dogjnë,
Ato shtëpit' me tavanë,
Erdhi turku i vu zjarrë.
Birçe Guxha pallëlarë,
Se ç'u hodh nga bregu parë,
Me Zenon Kasëm Mullanë,
Leskodukajtë të shtatë,
Luftuan me një rigatë...»*

Dhe me të vërtetë këta trima çdo shtëpi të Bolenës, të vendlindjes së tyre e kthyen në barrikadë. Sipas gojëdhënës popullore, thuhet se nga çdo zgavër a birë që shkaktonë artilleria osmane në muret e shtëpive të Bolenës, andej dilnin tytat e pushkëve dhe kokat me festet e bardha të këtyre barinjve të lirë të Labërisë, që me këngë në gojë dhe me pushkë e pallë në duar nuk linin këmbë turku e tradhtari të afrohej. Të shumta ishin orvatjet e dëshpëruara të komandantëve turq, që i shtynin ushtarët osmanëllinj të hidheshin përpara, por rreshtat e këtyre ushtarëve të mjerë priteshin qysh në barrikadat e para nga plumbat e shqiptarëve. Edhe toka shqiptare që i rriti këta trima dukej sikur u jepte jetë dhe energji të reja për luftë kundër

*) Fjala - rigatë - është shtrëmbërim i fjalës latine - rex, regis - mbret. Këtu ka kuptimin e fjalës mbretëri.

pushtuesit. Këta bij të vendit ishin ngjeshur mirë me tokën e tyre amtare. Ata manovronin bukur në këto gërxhe labe, sepse e njihnin me pëllëmbë tokën qysh në fëmijëri, kur bridhni si era e maleve pas dhive.

Shembuj të shkëlqyer trimërie treguan luftëtarët e Zenel Gjolekës në grykën e Kuçit. E paharruar ka mbetur në popull beteja legjendare e kësaj gryke që është një vend i thepisur malor, i rrethuar me male të larta dhe me rrugë të ngushta, ku pakujdesia më e vogël udhëtarit i rrezikon jetën. Ja si e pëershkruan në poezitë e tij poeti Andon Zako Çajupi këtë vend:


*«... Shkëmbinj e shpella si thikë,
Që t'i shikosh të vjen frikë,
Grykës Kuçit kush ka shkuar
Dhe gjaku s'i ka qëndruar?
N' ato gryka, n'ato male,
Edhe zogu shkon ngadale. . . »*

Pikërisht në këtë grykë të thellë, kapedan Gjoleka me 1300 luftëtarë shqiparë i priti hordhitë e panumërtur turke. Kur turqit u futën në këtë grykë të ngushtë malore, trimat shqiptarë u vërsulën mbi ata si shqiponja dhe shfarosën një pjesë të mirë të tyre. Në këtë betejë bijtë e vegjelisë shqiptare vunë në përdorim edhe të ashtuquajturën «artileri e shqiptarëve» — shkëmbinjtë dhe gurët e vendit. Sipas folklorit:

*«...Gryk' e Kuçit, gryk' e keqe,
Njëmijë treqind dyfeqe,...
Ejeri Gjolekë, o burrë,
Jo pér mish, por pér lëkurë, . . . »*

Luftha në Grykën e Kuçit u ndez nga të gjitha anët. Trupat osmane dyndeshin njëra mbas tjetrës, por asnë nga bijtë e Shqipërisë nuk e lëshoi istikamin e parë.

Këngët tradicionale popullore e pasqyrojnë qartë at-dhedashurinë e bijve të Shqipërisë. Këta trima, kur zbrasin në fushën e luftës pér liri, nuk pyesin pér sasinë nume-



Gryka e Kuçit (Shur' i Kuçë)

rike të kundërshtarit. Sipas librit përbledhës të këngëve labë «Shpata e Labërisë» të Merko Koronit:

«... Ar niqtë grykës iu funë,
Gjolekës nuk iu tund këmba.
— Le të jenë miliunë,
Se ja thosh gjaku në rrëmba,
Të haej hundë pér hundë...»

Gojëdhëna popullore shpjegon se në Grykën e Kuçit u përqëndruan forcat më kryesore të Darbihor Mehmet pashës. Ata e zgjeruan kudo vijën e zjarrit. Thuhet se shqiptarët u bënë një më tokën mëmë dhe asnjë nuk e lëshoi shkëmbin që kish zënë në Grykën e Kuçit. Dëmet u bënë të ndjeshme nga të dy anët. Në këtë betejë të ashpër malore ranë me armë në dorë përmbi treqind shehit (dëshmorë). Ja si e pasqyron këtë luftë legjendare rapsodi ynë popullor:

«Gryk' e Kuçitë, moj grykë,
Ç'hata bëre atë ditë,
U vran' djemt' e Shqipërisë,
Treqind e ca djem shehitë...»

Gryka e Kuçit u kthye në kasaphanë pér ushtarët e sultani. Atje pushtuesi osman nuk bëri këmbë më tej. Gjoleka me trimat e tjerë të këtyre fshatrave të varfëra malore si me Kapo Myftarin, Mustafa Ibrahimin dhe Lame Huson nga Kuçi, të vëllazëruar me djemtë e Kallaratit si Lame Petani dhe Dervish Kallarati me shokë shkruan faqe të lavdishme në historinë e Shqipërisë. Të shumtë ishin ushtarët osmanlinj, që përfunduan nën shpatën e këtyre trimave të vendit. Zenel Gjoleka me shokë ishin të ndërgjegjshëm, se luftonin jo pér vete, por pér çështjen e gjithë popullit: —

Ja si i përgjigjet Gjoleka popullit në këngë:

«— Pse lufton, o derëzi,
— As pér mua, as pér ti,
Po pér gjithë Shqipëri...»

Ose varianti tjetër:

«... U trete Gjolek' u trete,
Duke i rën' asaj trumbete,
Sos u përpoqe për vete,
Po për gjithë vilajete, ...»

Me plot të drejtë këta kryengritës popullorë quhen dallandyshet e para që shënuan fillimin e Rilindjes sonë Kombëtare.

«Besëlidhja» e mbështetur në të tillë trima të Shqipërisë të sprovuar nëpër beteja nuk nguronte të futej në luftë me forcat e panumërtë osmane që ishin të pajisura me armët më moderne të kohës .

Hordhitë e shumta turke, që zbarkuan në Sarandë, së bashku me ushtrinë tjetër që kishte dalë në Himarë, ranë në përpjekje me kryengritësit e udhëhequr nga Çelo Picari dhe Hodo Aliu në pellgun e Delvinës, në afërsi të fshatit Palavli dhe Kamenicë. Kjo luftë pasqyrohet bukur edhe në folklor:

«— Trimat e Çelos levendë,
Ku janë nisur e venë?
— Të piqen me Hodo benë.
Hodo beu i kalasë,
E rreh topi i kumbarasë,
Kumbaraja me zinxhirë,
Nizam dymbëdhjetëmijë,
Ranë pellgut në Delvinë,
Mbi Sulo Kallapodhinë... »¹⁾

Para këtij rreziku, mjaft nga krerët e «Besëlidhjes» u shpërndanë anembamë vendit për të mbledhur përsëri luftëtarë të rinj. Çelo Picari shkoi tek miqtë e tij bregdetas, si tek kapedan Kiço Dhuli etj. për të kërkuar ndihmë. Vetëm nga Qeparoi me në krye Vjero Priftin dolën mbi

1) AIF (Dosja II M.K.)

dyqind djem, të cilët së bashku me forcat e tjera të Bregdetit, të bashkuara me ato të fshatit Çorraj të udhëhequr nga Dukë Kopali i shkuan në ndihmë luftëtarëve të Çelo Picarit dhe Hodo Nivicës në fushën e Delvinës.¹⁾

Në këto beteja të përgjakshme u dalluan për trimëri të rrallë luftëtarët gjirokastritë të udhëhequr nga kordhëtarisypatrembur Ibrahim Sinua, trimat e Bregdetit, të Çamërisë, ata të Zhulatit të komanduar nga Osman Kuci si dhe luftëtarët e fshatit Fterrë me në krye mulla Lazo Kofinën.

Këta luftëtarë i dhanë një goditje të fortë forcave të shumta osmane në luginën e Delvinës, që mbanin të rrethuar luftëtarët e Delvinës të udhëhequr nga Sulo Kallapolli.

Reth fshatrave Palavli e Kamenicë lufta vazhdonte e egër. Atje këta barinj të lirë të Labërisë luftuan me trimëri të madhe. Udhëheqësit e tyre: Çelo Picari, Zen¹ Gjoleka dhe Hodo Nivica me shokë në këto luftime të pabarabarta u dalluan si prijës të talentuar ushtarakë. Këta trima dinin të shfrytëzonin me zotësi terrenin e këtyre fshatrave, ku zhvilloheshin luftimet. Populli u këndoi me dashuri këtyre trimave, që ditën t'i dilnin zot vatanit në këto kohëra kaq të vështira:

«Në Kurvelesh tre nishanë,
Bëjnë harb me padishanë,
Çelo Picari i parë,
Gjolekë Kuçi me pallë,
Hodua që mban kalanë...»²⁾

Në luftimet e Delvinës, pjesa më e madhe e luftëtarëve të vjetër ishin vrarë. Kështu që radhët e tyre ishin plotësuar me djem të rinj, që nuk e njihnin artin e vësh-

1) M. Kokalari. «Besëlidhja shqiptare dhe kryengritja e madhe fshatare e vitit 1847. Revista «Studime historike», viti 1974, nr.

2, fq. 153

2) AIF (Dosja II, M.K.)

tirë të luftës. Mobilizimi i fundit i hodhi të gjithë të rinjtë në paravijë. Ky fakt reflektohet në folklor:

«... I shkreti Hodo Ali,
I ka djemtë cilimi,
— O djema, t'u hidhemi,
Mos u trëmb se s'vritemi,
Eshtë nat' e s'shihemis,
Me plumbë s'goditemi,
Me palla do pritemi...»

Rapsodi popullore e ka përshkruar me dashuri figurën e ndritur të udhëheqësit të lëvizjes fshatare, Hodo Aliut nga Nivica e Kurveleshit:

«O bajrak i kuq me lule,
Kaza më kaza u ngule,
Parësinë e sëmure,
Parësinë e vilajetit,
Hodo kapetan i detit,
I rri për karshi dovletit...»¹⁾

Luftimet e Kurveleshit dhe të Delvinës shënuan rënien e përkohshme të kryengritjes fshatare në Shqipërinë e Jugut. Megjithatë edhe mbas kësaj periudhe lëvizjet popullore nuk pushuan në vendin tonë. Ato zhvendoseshin sa në njërin në tjeterin vend; sa shuhej revolta fshatare në një krahinë, ndizej në tjetrën.

Stambolli nuk arriti dot kurrë në Shqipëri të zbatojë plotësisht reformat e tij skllavëruese. Atdheu ynë mbeti deri në fund për sultatin një fuçi baruti. Historia e popullit tonë gjatë okupacioneve mbeti deri në fund histori kryengritjesh. Pas rënies së kryengritjes së madhe fshatare të vitit 1847, në gjithë Shqipërinë e Jugut shpërtheu një ofensivë e egër ndëshkuese nga ana e pushtuesit. Me qindra luftëtarë u futën nëpër qelitë plot lagështi të kështjellës

1) Botim i Institutit të Folklorit. «Këngë popullore».

së Gjirokastrës dhe të Janinës. Një pjesë prej tyre push-tuesit i mbyllën në hambarët e errët të anijeve luftarake dhe i nisën për në Stamboll. Ekspeditat ndëshkimore turke i ndoqën këmba-këmbës luftëtarët shqiptarë. Dimri i egër i vitit 1847 i gjeti krerët e kryengritjes të fshehur nëpër gërxhet dhe grykat e thepisura të Shqipërisë së Jugut, të vetmet vende strehimi dhe aleate besnike për trimat e vegjëlisë si Çelo Picarin, Zenel Gjolekën, Rrapo Hekalin e Hodo Nivicën me shokë.

Kryeministri grek K. Xhavella nuk u dha strehim kryengritësve shqiptarë, pasi në këtë kohë qeveria greke i kishte normalizuar marrëdhëniet e saj me sulttanin.¹⁾

Nga Aravantinoi në librin «Hronografia e Epirit» si dhe nga gazetat ruse të Sant Petersburgut, etj., mësojmë se turqit kapën 500 kryengritës, midis të cilëve Çelo Picarin, Veiz Vasjarin, djemtë dhe nipërit e Ismail Vlorës, Selim pashë Vlorën, Rrapo Hekalin me vëllanë e tij, Hamitin, Sulo Kallapolin dhe Abdyl Kokën nga Delvina, Tahir Çaparin nga Margëllëci etj.²⁾

Sipas folklorit:

«*Krerëtë e Shqipërisë,
I vun' para suvarisë,
Në Stamboll van'i konisnë...»*

Çelo Picarin së bashku me të dy djemtë e Ismail Vlorës, Mahmud bej Vlorëns dhe Selim pashë Vlorëns e internuan në Konjë të Anadollit. Trimin Hodo Nivica në fillim e internuan në qytetin Akra të Sirisë, pastaj e dérguan në Konjë. Luftëtarin Rrapo Hekali, e hodhën në dorë tradhtisht në fshatin Qesarat të Mallakastrës. Serasqeri i Rumelisë e dérgoi Rrapon në Manastir prej nga nuk u

1) K. Paparigopoulos. «Historia tu Heleniki Ethnus». Athinë, 1932, vell. VI, libri 15, fq. 167-268.

2) L. Mile. Vep. cit, fq. 160.

kthyte më, pasi e helmuat turqit. Poeti popullor e vajton së largu këtë trim të Shqipërisë:

«*Çeli gjethi, hyri prilli,
S'këndon qyqja e birbili,
Rrapon e ngriti veziri,
E shpuri nga Manastiri,
As e vrau, as e farkoi,
Veçse me helm e helmoi...»¹⁾*

Të njëjtin fat pësoi dhe trimi i Dukatit, Dervish Aliu. Muza popullore e trajton bukur krenarinë e ligjshme të këtij trimi të kazasë së Vlorës:

«*Na vdiq një trim nga Dukati,
Dervish Ali mëndjeartë,
Mbeti ati me zengjinë,
Që çaje me të hordhinë,
Mbi 'të gjykoje valinë...»*

Repartet ndëshkimore turke mundën të kapnin në mal të fshatit Tërbaç dhe trimin Dulo Kokën, të cilin e dërguan me roje të shumta në burgun e Beratit. Tërbaçi, vendlinja e këtij trimi, u kthyte në shkrumb e hi nga pushuesi.

Ja si e pasqyron këtë ngjarje folklori:

«*Dulo Koka i türbuar,
Me bezeliqe në duar,
Me pranga në kraharuar,
Vështronte vëndin kundruall,
Të djegur, të përvëluar...»*

Agjentura osmane kishte rënë dhe në gjurmat e familjes së Zenel Gjolekës. Ata gjetën në malin e Bolenës

1) Instituti i Shkencave «Këngë popullore historike». Tiranë, 1956, fq 161. Shih dhe AIF. «Lëvizja e Mallakastrës 1847», fq. 50,

gruan dhe djalin e mitur të Zenelit, Myslimin, të cilin e mbajtën peng në Delvinë pranë serasqerit. Për kapjen e tyre ndihmuani shumë bejlerët e Këlcyrés sidomos Hysen bej Këlcyra, që ishte vegël e pushtuesit turk. Ja ç'thonë këngët popullore të asaj kohe:

«... O Myslim, ah un' e nxira,
Erdhi Hysen bej Këlcyra,
Na tregoj ca fjal' të mira.
Lanet pastë Hysen beu,
Me ca fjalë na gënjeu,
Sa të mori dhe s'të ktheu...»

Osmanllinjtë ishin vënë në ndjekje për kapjen e Zenel Gjolekës. Ai në fillim u strehua në vendlindjen e tij në Havar të Kuçit. Më vonë e ndërrroi vendin. Gjoleka u largua nga fshati i tij. Ky trim dimërin e ashpër të vitit 1847 e kaloi i fshehur në malin e fshatit Çorraj. Gjolekën e kishin strehuár me kujdes në shpellën e Karanit, në Harapë, luftëtarët e këtij vendi, Malo Duka me shokë.

Për mikpritjen e tij të njohur Malo Duka ishte i popullarizuar në gjithë krahinën dhe me emrin Malo Buka. Agjentura turke e kishte nuhatur këtë strehë të arratisurish në malin e Çorrajt dhe kishte nisur në drejtim të këtij fshati repartet e veta ndëshkimore. Ato vërvshuan nga dy drejtime: nga Borshi i vjetër dhe nga Rrëza e Vake. Në këto rrethana luftëtarët e Çorrajt, të udhëhequr nga trimat Malo Duka dhe Foto Kopali, e shpërndagulën krejt popullsinë e fshatit dhe e quan lart në mal, në Harapë, ndërsa vetë u rreshtuan në pozicione luftimi, duke zënë vend që nga lumi deri në Katafigj.

Lufta u zhvillua e ashpër nga të dy dy anët. Edhe pse krahinat e tjera gjatë kësaj kohe ishin tërhequr nga lufta, trimat e këtij fshati, jo vetëm nuk i pushuan luftimet, por e hodhën poshtë me përbuzje propozimin e pashait turk, se do t'i linte të lirë luftëtarët shqiptarë, mjaftonte që ata t'i lejonin rrugë të lirë kolonës ushtarake osmane

për të shkuar në Harapë. Rapsodi popullor e përshkruan qart qëndrimin e çorriotëve trima:

«...Gjithë fshatërat u falë,
Çorrajtë hal' e brihalë...»

Dhe me të vërtetë, edhe më vonë, trimat e fshatit Çorraj i qëndruan thikë më thikë pushtuesit. Ata u hëngrën dhëmb për dhëmb me të dhe nuk e lanë të kalonte për në Harapë. Luftëtarët e kësaj ane, që e njihnin mirë vendin e luftimeve, kaluan nëpër shtigjet verore të malit dhe u morën krahët hordhive turke, duke bërë kërdinë mbi ta. Edhe sot kanë mbetur të paharruara fjalët plot mallkim të pashait osman drejtuar këtij fshati që e dëmttoi aq shumë: «U shfarostë ky millet qafir! Kur pastë bukën, mos pastë kripën dhe kur pastë kripën, mos pastë bukën». Serasqeri i Rumelisë ngulte këmbë për kalimin e trupave në Harapë. Në këto rrrethana pashai osman në pamundësi për të kaluar në Harapë nga grykat, ku ishin rreshtuar luftëtarët shqiptarë, u mundua të gjente tjetër rrugëkalimi. Atë që pushtuesi nuk e arriti dot haptas në fushën e luftës, u përhoq ta arrinte me anën e dredhisë. Ai zuri të gjitha rrugët dhe vendburimet nga furnizohej mali me ujë, për t'i shtrënguar këta trima të dorëzoheshin nga etja. Por këto pengesa u kaluan nga kryengritësit, meqënëse vetë bijtë e vendit gjetën rrugë të reja kalimi për t'u furnizuar me ujë, pa u diktuar nga hordhitë osmane.

Në një pasdite të vonë, turqit mundën të kapin në befasi duke mbushur ujë, bijën luftëtarët të fshatit Çorraj, trimëreshën Maro Kondi, që kishte zbritur fshehtas nga mali për të furnizuar luftëtarët me ujë. Turqit në fillim e morën me të mirë Maron, që t'u tregonte shtigjet e reja të kalimit për në mal, dhe pasi nuk ia arriten qëllimit, filluan ta torturonin. Me kamxhik në dorë ata e detyruan të ecte andej nga kishte ardhur.

Shtegu për në strehim (në Katafigj) ishte sa i thikte aq dhe i rrezikshëm. Pakujdesia më e vogël të hidhët në humnerë.

Shpella në atërsi të Kuçit ku stërhohej Zenel Gjoleka.



Ushtarët osmanllinj që ecnin këmba-dorës të lidhur me litarë njëri mbas tjetrit, me sytë e tyre të zgurdulluar shikonin të tmerruar honin (humnerën) e pafund që shtrihet poshtë këmbëve të tyre, ndërsa Maro Kondi megjithëse e torturuar, ecte krenare në ballë të kolonës armike me fëmijën e saj në duar.

Ushtarët e kësaj ekspedite ndëshkimore, pasi bënë një pushim të shkurtër në vendin e quajtur Zangua, e vazhduan edhe më lart rrugën, të gjithë të rreshtuar pas kësaj trimëreshe shqiptare.

Kur luftëtarja Maro Kondi arriti në kthesën e faqes tjetër të malit, në një kënd shumë të rrezikshëm, ku ushtarët osmanllinj duhet të kalonin për një, duke ecur ijas e duke u mbajtur me zor pas shkëmbinjve të thepisur, ajo u kthye mbrapsht me rrëmbim dhe hodhi në humnerë ushtarë e parë turk që vinte pas saj. Duke qenë i lidhur me të tjerët ai mori me vete të gjithë ushtarët, që ishin lidhur me të. Britmat e lemerishme të ushtarëve osmanllinj u dëgjuan anembanë vendit. Luftëtarët shqiptarë që e vrojtonin nga pozicionet e tyre lëvizjen e kolonës armike, i qenë afruar grykës. Ushtarët turq, që i shpëtuan grackës, u vërsulën mbi këtë bijë vetëmohuese shqiptare. Ajo, pasi tërhoqi pas vetes dhe një nga ushtarët që e kishte mbërthyer, u hodh në humnerë së bashku me fëmijën e saj.

Në këtë kohë, luftëtarët shqiptarë të posambërrijturi, vunë në përdorim të ashtuquajturën «artileri e shqiptarëve», pra shkëmbinjtë e gurët e malit. Luftëtarët ua mbyllën shtegun e kalimit turqve të mbetur në qafë të malit. Përfundimisht dhe këta agresorë përfunduan në fund të humnerës, të copëtuar pas shkëmbinjve dhe të shtypur nga gurët e shumtë, që u vinin si breshër nga lart.

Ditën e nesërme forca të tjera ndëshkimore osmane e mësynë këtë vend të thepisur malor. Lufta u zhvillua e ashpër nga të dy palët. Thuhet se edhe shkëmbinjtë e Katafigjitet u skuqën nga gjaku i ushtarëve turq dhe nga ai i luftëtarëve shqiptarë, që asnjëherë nuk pranuan në vendin e tyre reformat skllavëruese osmane.

Sakrificat e banorëve të fshatit Çorrax ose Çernogo-

rica (sipas emërtimit të vjetër të fshatit) janë përjetësuar në vargjet popullore:

«... Katafigji portë-portë,
Shove çorogoriciotë...»

Rreth nëntëdhjetë ushtarë e oficerë turq u gjendën të copëtuar nëpër shkëmbinjtë e Katafigjit:

«... Katafigji shtigje-shtigje,
Nxore nëndëdhjetë vigje...»

Ata u mbartën nga autoritetet osmane dhe u varrosën në Delvinë, ndërsa Maro trimen, të copëtuar, së bashku me fëmijën e saj e varrosën luftëtarët shqiptarë, poshtë Katafigjit, në rrëzë të Harapës, te Guri i Gjatë. Kur u hap varri i saj para tridhjetë vjetëve u gjend kafka e kokës së kësaj trimëreshe së bashku me atë të fëmijës.

Ekspedita të tjera osmane i përshkuante anembanë këto vende. Serasqeri i Rumelisë ngulte këmbë që me çdo kusht të hidhte në dorë krerët e kryengritjes, Zenel Gjolekën me shokë. Por trimat e Shqipërisë i strehonte dhe i ruante mbarë populli.

Qeveria turke me qindra e mijëra familje i shpërndal nga vendbanimet e tyre, duke i akuzuar se kishin strehuar të arratisurit. Me mijëra kokë bagëti u therën nga ushtarët otomanë. Pushtuesi turk hynte kudo me urë në dorë, duke djegur gjithçka që i dilte përpara, shtëpi e të mbjella. Për shkak të këtyre rrëthanave, Gjoleka u detyrua të largohej nga Labëria. Nga mesi i muajit prill 1848, Zenel Gjoleka me dyzet luftëtarë u ndalën tek një han, tetë orë larg Mecovës, por hanxhiu fshehurazi lajmëroi komandën e afërmë turke. Çeta e kuptoï rrezikun ndaj u largua për në Hasja të Tërhallës. Atje u gjend e rrëthuar nga forcat e Haxhi Hysen pashës dhe mbas një luftimi të egër Zenel trimi ra i plagosur në duart e tyre. Në 10 maj 1848 Gjolekën nga Tërhalla e shpunë tek serasqeri në Manastir dhe ai menjëherë e dërgoi në Stamboll.¹⁾ Atje u dënuai nga Gjykata e Lartë Turke.

1) Revista «O Neos kuvaras». Cit, fq. 218.

Sipas të dhënavë historike, Çelo Picarin e mbajtën më tepër nga të tjerët në internim. Në kujtimet e tij Ismail Qemali shkruan: «Vetëm xhaxhai im, Selim pasha dhe luftëtar i famshëm kapetan Çelo Picari, meqenëse konsideroheshin elementë të rrezikshëm nga qeveria turke, u detyruan të qëndronin dhe disa kohë në internim». ¹⁾

Tradhtari Muharrem Totua (ish-anëtar i Besëlidhjes) ia kishte rënduar shumë akuzën Çelos para organeve qeveritare turke. Qartë i pasqyron folklori shprehjet e Çelo Picarit plot urrejtje e mallkim për Muharrem Toton, që tradhtoi interesat e vendit:

«... Edhe Çelua u dërgoi,
Shqipëri nuri ç'më thoi...
Muharremi kallëzoi,
Muharrem t'u shoft' oxhaku,
Ç'i bëre këtij sanxhaku,
Që s'i le një djale pragu,
E shove, të shoftë haku...» ²⁾

Vegjelia e ndjente shumë mungesën e Çelos, të këtij udhëheqësi të paepur të kryengritjes popullore. Nëpërmjet këngëve të vjetra popullore figura e Çelo Picarit lartësohet akoma më shumë. Nëpërmjet fjalëve të vëna në gojën e Çelo Picarit, poeti anonim shpreh keqardhjen për bijtë e popullit, që do të shkrihen e veniten në Jemen e gjetkë për interesat e sulltanit, ndërsa mundimi i nënave shqiptare, që i lindën dhe i rritën, do të shkojë kot:

— Pse nuk flet, o mal i zi?
Fol, o Çelo Picari!
— C'të them o Hodo Ali,
Vaj medet kjo djalëri,

1) Ismail Qemali. «Memoirs of Ismail Bey». Londër, 1920, fq. 12.

2) AIF (Dosja II e M.K.)

*Djemtë Jemenin na zunë,
Muharremi prishi punë.
Qani mëma sa të shëmi,
Mundim' e djeme që bëni,
Ju vate për dhjamë qëni,
Ja u mori mbret zallëmi... »¹⁾*

Ja pra si luftuan këta trima të Shqipërisë, që vegjelia, për luftën dhe trimëritë e tyre, i vuri në krye të «Besëlidhjes shqiptare». Ishin ata që udhëhoqën kryengritjen e madhe popullore, e cila hodhi farën e zhvillimit të ndërgjegjes kombëtare dhe përgatiti terrenin për kërkesat që do të shtronte lëvizja nationale e mëvonshme. Këto kryengritje shpejtuan unitetin kombëtar dhe bënë që të delte në shesh politika e ndyrë e feudalëve të vendit, që morën haptas anën e pushtuesit turk për të mposhtur lëvizjen popullore. Tradhtarët e vendit si Hysen pashë Vrioni me shokë morën gjatë kësaj kohe dënimin e merituar nga forcat kryengritëse.

Ja një dokument që flet haptas për tradhtinë e Hysen pashë Vrionit:
Kajmekamit të Beratit
Hysen pashë Vrionit,

Ne e çmojmë shumë veprimtarinë tuaj për zgjidhjen e gjithë problemeve të rëndësishme të kazasës së Beratit, që ju është besuar juve, për zbatimin e shariatit të shenjtë dhe të ligjit të nderuar në çështjet që i përkasin popullsisë. Sidomos çmojmë përpjekjet e mëdha, veprimtarinë dhe vullnetin që keni treguar gjatë trazirave të Toskërisë. Kjo veprimtari e juaj që jeni një nga bendegjenët (servilët, robët) e mbretërisë provon edhe një herë besnikërinë tuaj personale. Kjo tregon se ju meritonit të mbeteni përsëri në detyren tuaj. Po kështu të veproni dhe këndeje e tutje.

Valiu i Janinës.²⁾

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) AIH. Dosja e shërisë së Beratit.

PJESA E DYTË

**TRIMAT E KRYENGRIJEVE POPULLORE TË
SHQIPÉRISÉ SË JUGUT NË NDIHMÉ TË
MALESORÉVE TË VERIUT PËR MBROJTJEN
E TËRËSISÉ TOKËSORE TË ATDHEUT
GJATË VITIT 1852**

“Luftën që prish njerëzinë,
E urrej s'e dua kurre,
Po në më shkelshin kufinë,
Do luftoj nënë si burrë...»

Cajupi

Duke filluar nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, në Gadishullin Ballkanik acarohen edhe më shumë kontradiktat midis shteteve të mëdha evropiane për ndarjen e trashëgimit të Perandorisë Turke, e cila tashmë kishte marrë tatëpjetën.

Veçanërisht aktive u bë gjatë kësaj kohe, Rusia cariste, e cila në rrugë të ndryshme përpinqej të depërtonte në Ballkan. Për qëllimet e saj thjesht pushtuese, ajo dilte si mbrojtëse e popujve të krishterë në këtë gadishull dhe i ftonte popujt e Ballkanit për luftë kundër Turqisë.¹⁾

Më 1852 shpërtheu një krizë e përgjithshme ndërkomëbtare, e para e një serie që hapte rrugën edhe për zgjidhen e çështjes ballkanike. Porse duke u parë ky problem në kuadrin e gjendjes ndërkomëbtare të asaj kohe del se çështja e çlirimit të plotë dhe të bashkimit kombëtar, të

1) Basbakanlik arsivi. Junanistan defteri. Viti hixhri 1270 (1854). Materiali ndodhet i përkthyer në Arkivin e Institutut të Historisë. Dosja A-III-349, fq. 100. (Më tutje do të citohet AIH. BAJD).

ballkanasve nga një anë favorizohej dhe nga ana tjetër pengohej.

Kështu, nga një anë konflikti ruso-turk dobësonë Perandorinë Osmane dhe u krijonte ballkanasve kushte më të lehta për t'u ngritur e përt'u cliruar; nga ana tjetër synimet politike të shteteve të mëdha evropiane ndikonin negativisht në zgjidhjen e drejtë të problemit të clirimt e të bashkimit kombëtar të tyre. Rusia kërkonte të shtrinte sundimin e saj në Ballkan për të dalë në Mesdhe, ndërsa Anglia dhe Franca bashkë me Austrinë përpinqeshin me cdo kusht të pengonin shtrirjen e Rúsie në zonën juglindore të Evropës, që kishte një rëndësi aq të madhe strategjike. Këto Fuqi të Mëdha filluan të përkrahnin Turqinë. Ata nuk donin asnjë ndërlikim të shkaktuar prapa krahëve të forcave turke, sepse kjo gjë shkonte në dobi të Rúsie. Synimi i parë historik i shteteve të reja ballkanike: Mali i Zi, Serbia, Greqia ishte i drejtë. Ata kërkoni të realizonin plotësisht bashkimin kombëtar, duke cliruar krahinat e mbetur ende nën sundimin turk, detyrë që Lenini, kur u realizua më 1912, e quajti plotësisht të drejtë e progresive.

Por zgjidhja e drejtë e këtyre detyrate vështirësohej nga një varg rrëthanash. Në kushtet ekzistuese, popullsitë e Ballkanit ishin ndërthurur njëra me tjetrën. Përcaktimi i territorave nacionale përkatëse ishte punë jo e lehtë, gjë që të conte shpejt në konflikte.

Zgjidhja e drejtë e këtyre detyrate dhe kontradiktave vështirësohej edhe më shumë nga fakti se qeveritë e këtyre shteteve të reja ballkanike, që përfaqësonin interesat e një oligarkie oborrtarësh e të borgjezisë së madhe, për të realizuar synimet e tyre, kërkoni ta kthenin këtë luftë të drejtë në një luftë grabitqare e pushtuese. Me këtë politikë shoviniste ato i vunë kazmën miqësisë së vjetër tradicionale, që kishin popujt e Ballkanit midis tyre, miqësi që ishte farkëtuar me vuajtje e luftë të përbashkët kundër pushtuesit turk, sundues i përbashkët i tyre. Kështu, gjatë vitit 1852 sundimtari i Malit të Zi, futi i pari trupat e tij në tokat shqiptare dhe synonte dhe më tej drejt Shkodrës.

Turqia, pjesën më të madhe të ushtrisë së saj, e kish-te angazhuar në kufijtë e saj me Rusinë. Duke ditur do-bësinë e saj, ajo u detyrua nga e keqja t'i lejonte krerët shqiptarë t'i mbronin vetë kufijtë e atdheut të tyre, edhe pse kishin qënë pikërisht këta krerë ata që në 20 vjetët e fundit, me qëndresën e tyre kundër Tanzimatit i kishin shkaktuar vështirësi të mëdha politikës së Portës së Lartë.

Në fakt banorët e krahinave të kërcënuaara shqiptare u mobilizuan të gjithë për mbrojtjen e atdheut dhe kjo ishte e natyrshme, mbasi në radhë të parë ishin shqiptarët, që dëmtoheshin nga veprimet e qeverisë së Malit të Zi, sepse në qoftë se sunduesit turq humbisnin një pjesë të tokave të Perandorisë së tyre, shqiptarët humbisnin toka të atdheut dhe kërcënosheshin drejtpërsëdrejti nga rreziku i asimilimit. Ja si shpjegohet që banorët e këtyre krahinave të kërcënuaara shqiptare, që bënë kaq luftëra kundër Portës për të mos shkuar ushtarë, tanë dilnin vetë vullnetarisht dhe shkonin në luftë për të mbrojtur tërësinë e paprekshmérinë e tokave të veta.

Në krye të lëvizjes, për mbrojtjen e këtyre krahinave veriore të atdheut, u vunë elementë nga radhët e opozitës feudale, që kishin qenë në luftë me pushtetin qëndror turk, krerë ushtarakë që kishin qenë dikur mbështetja shoqërore dhe politike e Bushatlinje të Shkodrës dhe të Ali pashë Tepelenës, si dhe kapedanë të fshatarësisë dhe të malësorëve, të cilët kishin kontribuar mjaft për ruajtjen dhe forcimin e autonome krahinore shqiptare. Ishte pikërisht kjo situatë e rrezikshme, që i afroi këto forca dikur opozitare me qeverinë e Stambollit.

Vlen të përmendet qëndrimi që kishin mbajtur këta krerë opozitarë pak kohë më parë, atëherë kur Stamboli u bëri thirrje forcave shqiptare për të shkuar në ndihmë të ushtrisë turke në luftë kundër Rusisë. Kësaj kërkese krerët shqiptarë i qenë përgjigjur se do t'i mbanin forcat e tyre në vend, për të mbrojtur tokat e veta nga synimet e shteteve fqinje.

E shtrënguar nga rrëthanat, Porta e Lartë kishte qenë e detyruar t'iu njohë krerëve opozitarë shqiptarë të drej-

të e komandimit, në rast lufte, të reparteve të veçanta (jo të inkuadruara në ushtrinë e rregullt turke).

Në rrëthanat e krijuara sulltani fali dhe një varg krerësh opozitarë të internuar apo të burgosur të kryengritjes së madhe fshatare të vitit 1847, midis tyre Zenel Gjolekën, Hodo Nivicën, Çelo Picarin, Selim pashë Vlorën, Mahmud bez Vlorën etj.

Gjatë vitit 1852 forcat malazeze u dukën në fillim në veri të ligjenit të Shkodrës, në Kernicë, ndërsa një pjesë tjetër kishte marrë drejtimin nga mali i Taraboshit.

Në ndihmë të malësorëve, që udhëhiqeshin nga kapetani i Mirditës Bib Doda etj. shkuan dhe luftëtarët e Labërisë e të Bregdetit të udhëhequr nga Zenel Gjoleka, Hodo Nivica, Gjikë Thanasi, Jani Ligori, Halim Toto etj.

«*Shqipëtarët u lëshuan,
Se ish lufta në kufi,
Nga të gjithë anët shkuan,
Me Gjolekën në Mal të Zi. . . »¹⁾*

Lufta në fillim plasi në zonën e Kernicës. Ajo u zgjeraua dhe nga krahu i Taraboshit. Në këtë krah u lëshuan trimat e udhëhequr nga Hodo Nivica. Sipas folklorit:

«*Taraboshi brigje-brigje,
Mal'i sert' pa fare shtigje,
Iu qep Hodua një kurrizi,
Nxori pallën e llamurisi,^{*)}
Karadakn ç'e lanetisi. . . »²⁾*

Shkodra, kjo kryeqendër e madhe administrative e vendit, ishte e mbushur plot me agjentë malazezë, të cilët, duke përfituar nga dobësia e autoriteteve lokale, manovronin lirisht brenda në qytet, nën hundën e administratës

1) AIF (Dosja II M.K.)

*) Llamurisi — e ndriti.

2) Po aty.

së kalbur osmane. Gjendja ishte vështirësuar shumë. Përrullat shoviniste sllave, thellësisht antishqiptare, ishin përhapur anembanë krahinave veriore të atdheut.

Në këngët e bukura popullore pasqyrohet qartë vëllazërimi i shqiptarëve të Jugut me ata të Veriut, të cilët së bashku i ndoqën këmba-këmbës ushtarët e knjaz Nikollës nga tokat shqiptare:

«*Hodua me gjith' Gjolekë,
Me trima toskë dhe gegë,
Iu ngjitën malit përpjetë,
— Ik, o Niko, se të zunë,
Brënda në Rekë t'u funë,
Reka me kulla të larta,
Nga Çetina dukej flaka. . . »¹⁾*

Këta trima të kryengritjeve popullore të Shqipërisë së Jugut luftuan dhe e derdhën gjakun së bashku me luftëtarët e Shpuzës dhe të Podgoricës:

«*Podgorica me shpuzanë,
Gjithë kapedanë janë,
Luftojnë me Karadanë, . . .
I shkreti Hodo Nivicë,
Bën dyfek në Podgoricë. . . »²⁾*

Edhe pse dokumentacioni përkatës na mungon, tradita popullore flet qartë për vëllazërimin e luftëtarëve shqiptarë nga të gjitha anët e vendit, ndryshe nuk ka si të kendohen këngët mbi Shpuzën dhe Podgoricën në Labëri.

Këto luftime të ashpra kufitare u zhvilluan në një terren të thyer malor. Të tjerë luftëtarë lebër, nën drejtimin e Halim Behlul Totos, shkuan drejt Veriut për mbrojtjen e krahinave veriore të atdheut. Ata, të bashkuar me

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

forcat e udhëhequra nga Gjoleka, u dhanë një mësim të mirë trupave malazeze në krahinën e Piperit. Më vonë u hodhën në sektorë të tjerë. Kudo vendi i luftimeve ishte i veshur në shkëmb, ku edhe gurët mund të përdoreshin në vend të armëve. Malazeztë artilerinë e tyre e kishin vendosur në vende kyçe. Gjylet e armikut nuk të lejonin të bëje këmbë përpëra. Me gjithë manovrimet e tyre, në kushtet e terrenit, luftëtarët e Halimit u dëmtuan mjaft. Por këtyre u erdhi në ndihmë trimi Hodo Nivica së bashku me dy mijë malësorë:

*«... Mbahu, mbahu Halim nuri,
Se vjen Hodo trim desturi,*
Me dymijë djem prej guri,
Me dymijë malësorë,
Gjithë me kordhë në dorë...»¹⁾*

Këta luftëtarë morën përsipër asgjësimin e artilerisë malazeze. Vetë Hodua në krye të trimave të tij kurveleshas dhe me një pjesë të mirë të malësorëve, kaloi nëpër shtigjet verore të malit dhe i doli mbas shpine çerdhes së artilerisë armike. Atje, mbas një beteje të përgjakshme fyt më fyt, shqiptarët i shkatërruan topat dhe i zunë robër topçinjtë. Qartë e pasqyron folklori:

*«... Hodo trimi nur, o nur,
Fora me këllëç destur...
Në qafë te' karaulli,
Topçinjtë të gjall' i zuri...»²⁾*

Një pjesë e mirë e tokave shqiptare qenë cliruar, por malazeztë akoma nuk kishin hequr dorë nga lufta. Luftimet vazhdonin kudo të ashpra.

Vlen të përmendet në këto luftime të egra malore trimëria e bijve të Kurveleshit të Poshtëm të udhëhequr nga

* Destur — (fjalë arabe) përpëra.

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

prijësi i talentuar ushtarak Zenel Gjoleka dhe i bregdetasve me në krye kapedan Gjikë Thanasin nga Qeparoi i Himarës, të cilët qysh në fillim ushtruan taktikën e luf-tës së çetave, sidomos natën. Shqiptarët u delnin malazezë-ve në befasi atje ku nuk i pritnin. Këto luftime i çorientuan mjaft fuqitë shoviniste malazeze, mbasi nuk mund të përcaktonin as afërsisht sasinë e fuqive të kundërshtarit, i cili sa vente bëhej dhe më i guximshëm. Në rrethana të tilla malazeztë si njohës të mirë të terrenit malor ku zhvilloheshin luftimet e ndërruan taktikën. Ata u tërroqën në brëndësi të vendit dhe ushtruan luftën e pritave. Malazeztë, me anën e këtij lloj luftimi, synuan në radhë të parë të vritnin udhëheqjen e kundërshtarit. Ata pjesërisht ia arritin qëllimit. Në pritën e organizuar prej tyre në «Shkallën e Kërstiqit» e futën në pusi dhe e vranë luftëtarin e dëgjuar lab Zenel Gjolekën së bashku me besnikët e tij kuçiotë si Shuaip Qurdukën, Hasan Çelën etj. Qartë e pasqyron këtë ngjarje folklori:

«Dërgon Vlladikë qafiri,
Ju kapedanë sa jini,
Shkallën e Kërstiqit zini,
Vjen Gjoleka po t'i bini,
Në pusi të parë hyri.
Ç'u ndez bataré e tymi,
U tund vëndi nga rënkimi,
Vuri hëngëllimën çili... »¹⁾

Zenel Gjoleka vdiq në këmbë, i papërkulur, ashtu si u ka hije trimave. Sipas këngëve popullore edhe në kohën e vdekjes, i plagosur rëndë, nuk pranoi që koka e tij të binte në duar të armiqve. Ja si i lutet trimi në agoni, luftëtarit të ri Shuaip Qurdukës:

«... Shuaip në të kam djalë,
Mos më le në 'ta të gjallë,
Hiqëm kokënë me pallë... »²⁾

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

Vetëm një dashuri e madhe për lirinë, mund të nxjerrë trima të tillë si Gjoleka.

Në mungesë të ndërgjegjes kombëtare të plotë, ka patur zëra në atë kohë në Labëri që e dënuan kalimin e Gjolekës në Veri, në luftë kundër Malit të Zi. Sipas tyre, Gjolekës «I shkoi koka te Vlladika...» në një kohë që aq shumë ky prijës i talentuar ushtarak i duhej Labërisë përmbrojtjen e saj. Por sipas argumentimit shkencor i mbështetur në materializmin historik këto beteja kufitare në Veri të Atdheut kundër Malit të Zi, bëjnë pjesë në kuadrin e luftërave të drejta. Luftimet e Gjolekës, kontribuan përmbrojtjen e tërësisë tokësore të krahinave Veriore të Shqipërisë.

Ja si e vlerëson Gjolekë Kuçin kjo këngë e hershme popullore:

«... Me karadakas ç'u ther,
Sa rroi palla s'iu terr,
I erdhi vdekja me nder...»¹⁾

Së bashku me Gjolekën në këtë luftë u vranë dhe dy nga udhëheqësit e luftëtarëve të Bregdetit: Gjikë Thanasi nga Qeparoi dhe Jani Ligori nga Çorraji.

Dy rreshtat e fundit të një kënge të hershme popullore e pasqyrojnë qartë karakterin e drejtë të kësaj lufte kufitare:

«... Bashkë me Gjikë Thanasnë,
Në Karadak na u vranë,
Në sinor ngulën bajraknë...»²⁾

Malazëtë i kishin ngritur mjaft prita edhe prijësit tjetër të luftëtarëve të Labërisë Hodo Ali Nivicës, por ky

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

trim, sipas traditës, me kalin e tij të shpejtë «balashiri», u kishte shpëtuar kurtheve të ngritura nga armiku:

«*Të lumtë, o at i bardhë,
Që nxore Hodon të gjallë,
Malazeztë dot s'e vranë...*»¹⁾

Ky kordhëtar i talentuar për luftë çetash, u dilte armiq-ve atje ku nuk e pritnin. Por gjatë kësaj lufte të egër malore trimi Hodo Nivica u sëmur rëndë. Vuajtjet e shumta ia rënduan gjendjen shëndetësore. Ai vdiq në afërsi të Re-kës. Varri i tij sot ndodhet në Shpuzë i rrëthuar me kan-gjella hekuri.

«... *Tëën jten e të xhumanë,
Hodo trimi e dha xhanë,
Hëngëllin i shkreti kalë,
Hëngëllin e s'do të hajë,
Njëzet veta dot s'e mbajnë...*»²⁾

Populli ynë, në këngët e tij, i ka vlerësuar drejt këto përpjekje për mbrojtjen e integritetit tokësor verior të atdheut. Bukur i pasqyrojnë këto përpjekje vajet e grave të Labërisë.

«*Labëria ra në serë,
Mbenë gratë me lesh sterri,
Mbajnë zi pr' ata të mjerë,
Që nxiruan Labërinë,
Për Gjolek', Hodo Alinë
Mbenë larg nga vëndi ynë,
Për të ruajtur kufinë...*»³⁾

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

3) Po aty.

**TRIMAT E KRYENGRIJTEVE POPULLORE NË LUFTË
PËR MBROJTJEN E KRAHINAVE JUGORE
TË ATDHEUT GJATË VITIT 1854**

«*Shqipëri, moj pall' e zhveshur,
Që kur lindi historia,
Në sup të mbeti dyfeku,
Në gjak të mbiu liria...»*

Populli

Qeveria borgjezo-madhe greke në fillim të vitit 1854 filloi sulmet e saj grabitqare për pushtimin e krahinave jugore të Shqipërisë. Ajo nuk mendonte vetëm për çlirimin e tokave të saj nga Turqia, por synonte edhe më tej. Shovinistët e Athinës niseshin nga teoritë e vjetra reaksionare, qysh në kohën e Bizantit, se kudo që ndodhen ortodoksë janë toka greke dhe sipas tyre këto vende në Shqipëri shtrihen deri në Shkumbin.¹⁾

Qeveria shoviniste greke gjatë vitit 1854 organizoi çeta të shumta të komanduara nga oficerë të stërvitur të saj, të cilët në fillim hynë në territoret greke të paçliruara si në ato të Thesalisë etj. dhe pastaj u futën thellë në tokat shqiptare. Ata arritën deri në Delvinë dhe Himarë. Sikurse theksuan më lart, Anglia në atë kohë ishte

1) M. Kokalari. «Dështimet e para të shtetit shovinist grek për copëtimin e Shqipërisë së Jugut gjatë vitit 1854». «Studime Historike». Tiranë, 1976, nr. 1, fq. 103. Sipas AIH. BAJF. fq. 107. Shih dhe AIH — Dhimitër Hasiotis «Disertacione dhe kumtesa mbi Epirin», fq. 100 (Material i përkthyer).

aleate me Turqinë. Ajo pér ta penguar shtrirjen e Rusicë nё zonën juglindore të Evropës, e bindur se çdo ndërlikim i shkaktuar prapa krahëve të forcave turke shkonte nё dobi të Rusicë, dërgoi menjëherë luftanijet e saj dhe blokoi portin e Piresë, pér ta detyruar qeverinë greke të hiqte dorë nga plani pér një aksion ushtarak.¹⁾

Qeveritarët shovinistë të Athinës, të ndodhur përparrë presionit të blokadës navale, u përpqoën të zgjidhnin çështjen me anën e një veprimi të tërthortë, duke u maskuar e fshehur prapa një aksioni çetash, që gjoja ishin të pavarura prej saj dhe i kishin shpëtuar prej dore.

Qëllimi i qeverisë shoviniste greke ishte që nё Shqipërinë e Jugut të shkaktonte një kryengritje të përgjithshme të popullsisë lokale.

Ata e llogaritën këtë mësymjë si një fitore të lehtë duke marrë parasysh faktin që forcat turke ishin zënë me luftën nё frontin rus. Me këtë aksion qeveria greke llogariste të bënte fakt të kryer aneksimin e këtyre tokave, duke e përligjur veprimin edhe ndaj qeverisë angleze. Zbatimin e këtij plani qeveria e Athinës e mbështeste mbi teorinë reaksionare të «megali idesë».

Qeveria shoviniste greke, me qëllim që të hidhte nga krahua i saj sa më shumë shqiptarë, luftës së saj i dha ngjyrën e një lufte të përbashkët greko-shqiptare kundër push-tuesit turk. Pikërisht pér këtë qeveritarët e Athinës shumicën e oficerëve që vunë nё krye të çetave të nisura drejt krahinave jugore të Shqipërisë i zgjodhën shqiptarë, si suiliotë, arbëreshë të Greqisë etj.

Qeveria greke pretendonte se trazirat që po ndodhnn nё zonat kufitare ishin nxitur nga një organizatë e fshehtë fetare ortodokse, që sipas informatave të mbledhura gjøja prej qeverisë së Athinës, quhej «Shoqëria e miqve të fesë së vërtetë». Në deklaratën që i lëshoi Athina, me anën e legatës së saj, Portës së Lartë thuhej midis të tjerash, se qeveria greke kishte filluar hetimet pér të zbuluar këtë organizatë të fshehtë fetare, që kishte nxitur këto

1) Po aty.

turbullira në Shqipëri, në Thesali, në rrithin e Livadjesë
dhe në atë të Selanikut.¹⁾

Raportet e funksionarëve turq të drejtuara Stambollit
flasin qartë për vërshimin e bandave greke në toka shqiptare.
Ato flasin edhe për faktin se kush qëndronte prapa
qeverisë shoviniste greke në këtë mes. «... Zjarri që kanë
ndezur banditët grekë po përhapet në Çamëri. Mendohet
që ata kërkojnë të bashkohen me banditët e tjerë grekë
të dalë në krahinën e Himarës. Himara është e njohur
për pozitën e fortë natyrore të saj... Mundet që banditët
grekë mendojnë të bashkohen me malazeztë me qëllim
që t'i nxjerrin andralla Perandorisë Osmane. ...»²⁾ «... Nuk
ka dyshim se dhe rusët kanë nga larg gisht, në këtë punë.
Përpëra se të ndodhin këto turbullira, grekët patën shpërndarë
në këto vise komunikata në emër të Rusisë. Luftërat
midis Perandorisë Osmane dhe asaj Ruse kanë marrë
ngjyrën e një lufte fetare... Perandorët rusë kanë marrë në
mbrojtje të krishterët. Në komunikatë rusët thonë se të
krishterët që janë të zotët e pushkës duhet t'u bëjnë qëndresë
myslimanëve...»³⁾

Qeveria shoviniste greke me anë të konsullatatave të
veta ushtronte në atë kohë një veprintari të gjërë në to-
kat shqiptare për të propaganduar luftën e vet si lüftë
çlirimtare.

Ja një nga thirrjet e këtyre qarqeve, e veshur me
petkun e fesë, që u drejtohet më 6 janar 1854 të krishterëve
shqiptarë: «O ju vëllezër që jeni të fesë krishterë,
na ndihmoni t'i mundim të pa fetë... Në qoftë se bashko-
hen me ne dhe myslimanët e Shqipërisë... ne zotohem
se do t'u sigurojmë atyre jetën, nderin, pasurinë dhe fe-
në...»⁴⁾ Por meqenëse kjo thirrje nuk gjeti ndonjë je-
honë tek të krishterët shqiptarë për t'u rreshtuar në të

1) AIH. BAJD, fq. 35, 37, 82, 97, 98, 107.

2) Po aty, fq. 97, 98, 99.

3) Po aty, fq. 100.

4) Po aty, fq. 27.

ashtuquajturën «shoqëria e miqve të fesë së vërtetë»¹), përfaqësuesit e «megal i idesë» filluan të përdorin kërcë-nime e shantazhe ndaj shqiptarëve duke dekluaruar në një letër të tyre, të datës 28 shkurt 1854 se «... Shqiptarëve paskëtaj u rrezikohet jeta, nderi dhe pasuria e tyre...»².

Synimet shtetmadhe greke pér zëvendësimin e push-timit turk me atë grek në Shqipëri, pasqyrohet qartë dhe në vulën, që u vinin në krye fletushkave të tyre propagandistike. Në fushën e kësaj vule ishin shkruar greqisht këto fjalë:

— Liri o vdekje
Shqipëri —Thesali — Selanik³)

Vërvshimi i bandave greke në tokën jugore shqiptare tronditi vendin dhe përtej krahinave të prekura drejt përsëdrejti. Para këtij rreziku imediat, pér mënjanimin e cop-timit të Shqipërisë nga shteti borgjezomadh grek, bijtë e këtyre krahinave të kërcënuara shqiptare morën përsipër mbrojtjen e integritetit tokësor jugor të atdheut, ashtu sikurse vepruan dhe në mbrojtjen e krahinave veriore të Shqipërisë.

Nga bijtë e vendit që zbritën të parët në fushën e betejës kanë qenë Mahmud bez Vlorë, Selim pashë Vlora, Halit bez Frashëri, Çelo Picari dhe Kalem Hadëri nga fshati Picar i Kurveleshit, Ibrahim Sino nga Gjirokastra, Ahmet Çapari nga fshati Luarat i Margellëcit, Selam Hasani nga Velçë e Vlorës, Hasan Çako nga fshati Kaparjel i Kurveleshit, Shako Xhaka nga fshati Tërbaç

1) AIH. BAJD, fq. 107. Shih edhe revistën «O neos kuvaras». Athinë, 1962; «Greqia dhe Shqipëria», fq. 135-177 (Flet pér qëndrimin e popullsisë së krishtere shqiptare).

2) AIH, BAJD, fq. 89.

3) Po aty, fq. 93.

i Vlorës etj. Shumica dërrmuese e këtyre kërëve kishin qënë organizatorë dhe udhëheqës luftarakë të kryengritjes së madhe fshatare të vitit 1847 dhe ishin liruar nga interrimi.¹⁾

Ashtu si në luftën kundër Malit të Zi, Porta e Lartë, e shtrënguar nga rrëthanat, u detyrua t'ia njohë kërëve kundërshtarë shqiptarë edhe të drejtën e komandimit në këtë luftë të reparteve të veçanta (jo të inkadruara në ushtrinë e rregullt turke).

Kundrejt mbrojtësve që luftonin për paprekshmërinë e tokave të atdheut qëndronte një grup i vogël renegatësh shqiptarë. Midis këtyre si më i zellshmi i qeverisë së Athinës dallohej tradhtari i regjur Spiro Milo (i pari me këtë emër) me origjinë nga Himara, i cili gjatë këtyre trazirave u emërua nga qeveria shoviniste greke komandan i zonës së Greqisë Perëndimore, me gradë gjenerali. Këtij renegati i qenë akorduar dhe një sërë fondesh për të rekrutuar sa më shumë agjentë në Shqipërinë e Jugut për t'i shërbyer realizimit të politikës shtetmadhe. Ai deklaronte hapur se kufiri grek duhej të arrinte deri në lumin Shkumbin.²⁾

Spiro Milo, në krye të bandave greke, kishte zbarkuar në bregdetin e Himarës dhe andej përpiquej të pushtonte Vlorën.

Stambolli u shqetësua shumë nga ky vërshim i bandave greke në këto krahina të Perandorisë dhe me datën 12 xhumadil ahire 1270 (12 mars 1854) i drejtohet si më poshtë valiut të Shkodrës:

«... Banditët grekë kanë grupe të shumta në Janinë dhe në Çamëri. Ata kanë arritur deri në Himarë, që ndodhet në afërsi të Vlorës. Në qoftë se ata do të zgjerojnë veprimtarinë e tyre është rrezik që ata mund të

1) Ismail Qemali. «Memoirs of Ismail Bey». Edited by Somerville Story. Londër, 1920, fq. 12.

2) AIH, BAJD, fq. 107.

bashkohen dhe me banditët e Malit të Zi...»¹⁾ Po në këtë datë u caktuan forca të shumta që të niseshin nga Berati, në drejtim të krahinës së Vlorës, për të zembrapsur bandat greke; mbasi të vendosnin qetësinë, ata duhet të linin atje një forcë prej pesëqind vetash dhe të drejtosheshin për në Çamëri ku ishin përqëndruar banda të shumta greke.²⁾ Të tjera forca vendase u nisën nën drejtimin e Mahmud bej Vlorës dhe Selim pashë Vlorës dhe bashkë me luftëtarët e Lumin të Vlorës të udhëhequr nga Selam Hasani nga Velça dhe nga Shako Xhaka nga Tërbaçi, u hodhën në krahinën e Himarës. Atje, të bashkuar me forcat beratase dhe me trimat e Bregdetit të udhëhequr nga kapetan Sokrat Leka prej Qeparoi dhe Mëhill Qirjaqi nga Corraj i Kurveleshit etj. i hodhën në det bandat greke.¹⁾ Kalem Hadëri (Seferi), i nipi i Çelo Picarit, me një pjesë të mirë të luftëtarëve të Kurveleshit shkoi në Delvinë dhe mbasi e pastroi vendin, u hodh në Filat.²⁾

Gjatë kësaj kohe Çelo Picari në krye të luftëtarëve labër, i pajisur dhe me disa topa, u fut në thellësi të Çamërisë për çlirimin e Prevezës, Nartës dhe për të shtënë në dorë skelën e Salahorës, e cila ishte kthyer në një pikëzbarkimi me rëndësi të forcave greke nga krahu i Çamërisë.³⁾ Forca të shumta shqiptare dolën dhe nga Çamëria, nën udhëheqjen e trimit Ahmet Çapari nga Luarati i Margellëcit.

Në mbarë Shqipërinë e Jugut ishte lëshuar kushtrimi. Asnjë krahinë, pothuaj, nuk mbeti pa nxjerrë luftëtarë kundër bandave greke. Forca të tillë u ngritën në këmbë edhe nga Dangëllia, Dishnica dhe Shqeria, të udhë-

1) AIH, BAJD, fq. 35.

Shovinistët grekë me intrigat e tyre nën maskën e fesë janë munduar vazhdimisht që Bregdetin ta fusin në përcarje me krahinat e tjera shqiptare. Akoma kujtohen në krahinën e Himarës fjalët e urta të atdhetarit kapedan Gjikë Spiros kur mori vesh se Anglia ia dorëzoi Korfuzin qeverisë greke: «Na erdhë gjitoni i lik, duhet të flëmë me zhapa (opinga) nën kukë (kokë)».

2) AIH, BAJD, fq. 79, 82.

3) Po aty, fq. 95.

hequra nga Halit bez Frashëri, i cili mori me vete për të stërvitur në luftë dhe patriotin e ardhshëm, djalin e tij 16 vjeçar Abdylin.¹⁾

Këngët tonë popullore i pasqyrojnë mjaft mirë këto ngjarje. Ato gërshtohen bukur me dokumentacionin ekzistues dhe flasin qartë për pjesëmarrësit në këto luftime, për trimin Çelo Picari me shokë si dhe për andartët (bandat greke) të udhëhequr nga gjeneral Theodhor Griva etj. Ja njëra prej tyre:

«*Ngrehu Çelo përsëri,
T'i japsh këllëçit veri,
Se duall' andart' të ri,
Griva me vëllezëri;
Ngrehu Çelo si më parë,
Ngjish këllëçin me gajtanë,
Të bësh dyfek me Junanë;
Trimat e Çelo Mehmesë,
Me jataganin në brezë,
U lidhën «besa me besë»,
Do t'i vënë fré Morésë...»²⁾*

Sjellja e bandave greke në krahinat shqiptare ka qënë shumë e egër. Ata i binin në qafë popullsisë me lloj-lloj aktesh dhune dhe poshtërsish. Në mënyrë të veçantë u dalluan për keqbërjet e tyre gjeneralmajor Theodhor Griva së bashku me djalin e tij oficerin madhor Dhimitër Griva, të cilët nuk kanë lënë gjë pa bërë në popullsinë e pafajshme shqiptare.... «Ata ishin dërguar të dy nga qeveria shoviniste greke në Epirin shqiptar për të organizuar kryengritje. Kudo shiheshin shtëpi dhe të mbjella të djegura. I biri i gjeneralit, Dhimitër Griva dogji 183 shtëpi në

1) Sami Frashëri, «Kamus al alami». Stamboll, 1891, vëll. III, fq. 2282, vëll. IV, fq. 3113.

2) AIF (Dosja II M.K.)

Mecovë, dhe grabiti trimijë lira turke, përveç sendeve të tjera të vyera. Nga fshatrat shqiptare, që u dëmtuan më shumë janë: Luzeci Koritjani, Fortezi, etj. Në këto fshatra janë parë kafshë të ngarkuara plot me plaçka të vjedhura, që i biri i gjeneralit i dërgonte në Greqi». ¹⁾ Nuk ishte më i mirë nga ata oficeri madhor Dhimitër Jorgji Karaiskaqi, i cili në veprimet e tij udhëhiqeje nga parulla «Përpëra me kryqin në njerën dorë dhe në tjetrën thikën, të marsojmë dhe çdo ditë nga një stacion të ndërrojmë». ²⁾ Fushata e bandave greke në Shqipëri nuk mundi të ngrejë çeta me komitë vendas që të mund të maskohej, sepse nuk gjeti asnjë mbështetje në popullin e krahinave ku këto banda vërshuan. ³⁾ Në këto rrethana bandat shoviniste greke mbetën të vetmuara përballë luftëtarëve shqiptarë vendas, që e njihnin më terrenin, dhe që luftonin e kishin mbështetjen e gjerë të popullit.

Udhëheqësit e luftëtarëve shqiptarë, Çelo Picari me shokë u bënë në fillim thirrje oficerëve grekë që, t'i të hiqnin forcat e tyre nga tokat shqiptare, duke iu drejtuar mënyrë të veçantë komandantëve suliotë, që ishin në shërbim të shtetit grek, me një pjesë të të cilëve ata njiheshin që nga koha kur suliotët, në fazën e fundit, u bashkuau me luftën e Ali pashë Tepelenës kundër forcave turke. Por fatkeqësisht propaganda kishte verbuar logjikën e këtyre trimave. Ata besonin se të krishterët e Shqipërisë mund të siguronin lirinë, vetëm me përkrahjen e mbretërisë greke në kuadrin e së cilës duhej bërë bashkim i këtyre dy kombeve.

1) J. Llambbridhis, «Epirotika meletimata», Athinë, 1888, vëll. IV fq. 42-49. Të shihet dhe Emile Isamber, Orient, Grèce et Turquie d'Europe, fq. 815, kap. V, Shqipëria, seksioni I, rruga 77, nga Mecova në Janinë. Rruga 78, nga Arta dhe Preveza në Janinë, fq. 821; nga Preveza në Janinë fq. 839... Çamëria, fq. 845; Vilajeti i Janinës.

2) Jani Kordhatos: «Historia tis neoteris Elladhas», Athinë, vëll. III, fq. 614, 617.

3) AIH, BAJD, fq. 89, 107.

Në këto rrethana fjala u mbeti armëve. Shqiptarët nga krahë i Çamërisë, me në krye Çelo Picarin dhe Ahmet Çaparin, korrën fitore. Bandat greke të thyera u detyruan të tërhiqen drejt pjesës jugore të Çamërisë.

Gjenerali plak suliot Kiço Xhavella, duke parë se Çelua i ndau luftëtarët shqiptarë në tre grupe, urdhëroi Foto Xhavellën të zinte kodrat e Shën Llisë, Dhimitër Karaiskaqi të qëndronte në vendin e quajtur Feneromen, ndërsa Dhimitër Griva të mbante pozicionet në fshatin Bani. Lufta në fillim plasi në fshatin Bani, ku luftëtarët e Çelo Picarit i thyen keqas bandat shoviniste greke, që komandoheshin nga Dhimitër Griva.¹⁾ Me një manovrim të shpejtë, Çelua mundi të godiste dhe të dëbonte repartet greke nga qytetet e fshatrat shqiptare si Paramithia, Llaka, etj. Ai u prit përzemërsisht nga popullsia e vendit.

Tashti forcat e Çelo Picarit u forcuan dhe me luftëtarët e shumtë të Çamërisë. Luftime u zhvilluan kudo në Çamëri. Shqiptarët, që luftonin me këmbëngulje për mbrojtjen e tokës së tyre amtare, i detyruan forcat greke të kolonel Zervës dhe ato të N. Boçarit të braktisnën pozicionet strategjike të Sulit.²⁾

Në krahun e Shën Llisë dhe të Feneromenit luftonte Halim Totua nga fshati Progonat i Kurveleshit me një pjesë të mirë të luftëtarëve të Tepelenës.

Çelo Picari me forcat e tij, së bashku me luftëtarët gjirokastritë, të udhëhequr nga Ibrahim Sinua, u nisën në drejtim të fshatit Peta, ku ishte përqëndruar pjesa më e madhe e fuqive greke dhe komanda drejtuese e saj. Udhëheqësit shqiptarë e vlerësuan drejt gjendjen. Ata e parashikuani se marrja e Petës do të shënonte disfatën kryesore për bandat greke në këtë krah të frontit. Çelua në fillim e rrethoi Petën. Aty lufta filloi e ashpër me përlleshje trup me trup. Këtë ngjarje e përkujton kënga popullore me vargjet:

1) J. Kordhatos. Vep. cit., fq. 614.

2) AIH, BAJD, fq. 107.

*«Kush u hodh në Pet i pari,
Ky Çelo mustaqe-çari...»¹⁾*

Oficerët madhorë të Athinës kërkonin me këmbëngulje që Peta, kjo qendër e madhe e bandave shoviniste greke të mbahej me çdo sakrificë, mbasi ishin të sigurtë se rënia e saj në duar të luftëtarëve shqiptarë do të shënonte disfatën kryesore të tyre. Të shumtë kanë qënë dhe komandantët grekë, që u vranë në këtë luftë të egër malore, duke mos mundur të çanin rrëthimin që u kishin bërë luftëtarët shqiptarë. Peta ra më në fund në duar të luftëtarëve shqiptarë, që drejtosheshin nga luftëtarë i talentuar ushtarëk Çelo Picari dhe nga trimi i ri i Gjirokastrës Ibrahim Sinoja.

Por aksioni grek në Shqipërinë e Jugut nuk gjeti mbështetje as dhe në planin ndërkombëtar. Anglia, duke qënë në atë kohë aleate e Turqisë në luftë kundër Rusisë dhe e interesuar të mos lejonte përhapjen e influencës ruse as dhe dobësimin më të vogël të pozitës së Perandorisë Osmane në gadishullin e Ballkanit, nuk i aprovoi këto veprime, që faktikisht shkonin në dobi të politikës cariste dhe nga ana tjetër mund të cënonin pozitat angleze në ishujt jonianë.

Londra protestoi pranë qeverisë së Athinës për këto operacione luftarake në tokat e Perandorisë Turke.

Ky qëndrim i qeverisë angleze pasqyrohet qartë në një letër që i drejton komisari anglez i ishujve jonianë H.G.Uard komandantit të ri të Greqisë Perëndimore, gjeneralit Spiro Milo, më 17 maj 1854 nga porti i Karvassarës. Ja një pjesë nga kjo letër, e cila e nisur nga interesat angleze, prapëserapë fakton më së miri qëndrimin hap-tas shovinist të qeverisë greke dhe metodat e saj dhelprake.

«... Mësova lajmin mbi emërimin tuaj si komandant i Greqisë Perëndimore... Dokumentet që u gjetën në Pe-të... nxjerrin në shesh rolin e qeverisë greke në ngjarjet

1) AIF. (Dosja II M.K.)

e Epirit (Shqipërisë së Jugut — M.K.) dhe pasojat e mjërueshme që ndodhën atje. Marrja e Petës qe shoqëruar me tërheqjen e detyruar të të gjithë udhëheqësve të kryengritjes. Gjeneral Xhavella në letrën që i drejton mbretit dhe ministrit të Luftës shpjegon se agresioni grek pak mbështetje kishte gjetur në vendin që ai kërkonte të çlirojë, çlirim që i ka shërbyer atij si pretek për dhunimin e të drejtave të njerëzve... Peta u dorëzua... Gjeneral Xhavella qe nga të parët që hapi kufirin... Kolonel Zerva dhe N.Boçari i braktisën pozicionet strategjike të Sulit e të Paramithisë... Nuk dua t'u zë besë fjalëve që kam dëgjuar lidhur me qëllimin e misionit tuaj dhe mbi përdorimin e mundshëm të fondeve, që u janë vënë në dispozicion... që paqja në ishujt jonianë të prishet nga agjentët grekë... »¹⁾.

Megjithëse shovinistët pësuan disfatë të plotë në Petë, ata nuk hoqën dorë nga lufta e tyre grabitqare dhe përsëri i grumbulluan forcat. Mbeturinat e bandave greke, të përforcuara dhe me fuqi të reja, nën komandën e oficerit madhor Haxhi Petro, u tërhoqën në Kallabakë, me qëllim që të krijonin terren të favorshëm për fitore.²⁾

Më 6 qershor 1854 luftëtarët shqiptarë u organizuan në dy grupe; njëri nën komandën e Çelo Picarit dhe të Ibrahim Sinos dhe tjetri nën komandën e Halit baj Frashërit.

Forcat e Çelo Picarit, mbasi çiruan rrrethin e Nartës, u hodhën në Kallabakë. Lufta filloi e ashpër. Pozicionet e shovinistëve grekë qenë shumë të forta, vendi qe krejt shkëmbor dhe i lartë, megjithatë oficerët madhorë grekë u mundën nga barinjtë e buqit e krahinave jugore të Shqipërisë. Sipas folklorit:

«*Celua me Ibrahimë,
Nga Narta u ngren' e iknë,*

1) AIH, BAJD, fq. 107.

2) J. Kordhatos. Vep. cit., fq. 614.

*Për tërë natën q'u dinë,
Kallabakut iu vërvinë... »¹⁾*

Rapsodët popullorë, pjesëmarrës vetë në këto beteja, e përshkruajnë qartë në këngët e tyre terrenin shkëmbor, ku u zhvilluan luftimet, ku dhe vetë vendi mjegullonte nga tymi i dyfjeve ndërsa oficerët grekë të ardhur nga Mania e Peloponezit (Morea), të quajtur nga shqiptarët «manjatët», ishin strukur në fortifikatat e tyre:

*«... Kallabaku vend i lartë,
Duman një dit' e një natë.
Korak' e zeza Korakë,
Në maj' të shkëmbit një pllakë,
Mbyllurë brënda manjatë,
Morait kësulëgjatë,
Papa Kosta me armatë... »²⁾*

Në këngët popullore pasqyrohen dhe krahinat shqiptare, që morën pjesë në këto luftime, prej të cilave ranë mjaft luftëtarë pér mbrojtjen e tokave shqiptare:

*«... Kush u hodh e u bë kajtë? *)
Tepelenas e vlonjatë,
Që rrojnë me bukë thatë,
Me mish të pjekur në napë... »³⁾*

Në këto beteja të ashpra malore treguan trimëri të rrallë dhe luftëtarët gjirokastritë të udhëhequr nga kordhëtarë i dëgjuar Ibrahim Sinua nga lagjja Manalat e Gjirokastrës. Të shumta janë këngët popullore që janë gëretshetuar pér këtë trim gjirokastrit dhe pér shokun e tij të

1) AIF (Dosja M.K.)

2) Po aty.

*) kajtë — theror.

3) AIF (Dosja II M.K.)

armëve Zubo Hormovën, i cili ra heroikisht në këto bëteja:

« . . . Ibrahim Sinua vjen përpjetë,
Lule o Zubo Hormova,
Ç'i ndjek rrëkeja-rrëketë.
Se ç'luftove mor' i shkretë,
Sa t'u sosnë kryezestë, *)
Si s'të njoha në trumbetë,
Qënkish Karkaranxa vetë,
Lule, o Zubo Hormova,
Ashkosun, të lumtë dora, **)
Unë hakënë ta mora. . . » ¹⁾

Në këto luftime për mbrojtjen e integritetit tokësor të atdheut del qartë heroizmi masiv i luftëtarëve të këtyre krahinave të kërcënua shqiptare.

Të paharruara kanë mbetur në traditën popullore trimëritë e luftëtarit të zgjuar Hasan Çakos nga fshati Kaparjel i Kurveleshit. Ai, së bashku me mjaft bij të tjerë të Labërisë, mundi t'i shfarosë forcat e freskëta greke që u erdhën në ndihmë bandave megalideiste të Athinës, që ishin të rrethuara në Kallabakë. Hasani, me shokët e tij, qysh në fillim zuri vendet më të rrezikshme. Ai vendosi ta zhvillonte betejën sipas «traditës shqiptare: tërhiqe armikun, përgatiti pusinë dhe godite në befasi». ²⁾

Ishte koha e mbrëmjes, akoma dukej kolona e gjatë shumëmijëshe e andartëve grekë, që po ngjiteshin kodrave

*) Kryezestë — plumbat.

**) Ashkosun — të lumtë.

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Populli shqiptar ka qënë i detyruar gjatë shekujve të luftojë me armiq shumë më të mëdhenj në numër, të pajisur me armët më moderne të kohës. Kjo e detyroi shqiptarin të krijojë traditën e tij të veçantë luftarakë në përshtatje me kushtet e tij, ndryshe nuk mund t'i përballonte armiq të e shumtë që erdhën valë-valë pa mbarim në vatrat tona.

në drejtim të pozicioneve greke. Hasani i radhiti shpejt luftëtarët e tij të paktë dhe priti sa u errësua. Vetë ai zuri vend në ballë të tyre dhe me pallë zhveshur majë kalit dha urdhërin për sulm. Kuajtë e vegjël por të shpejtë të shqiptarëve, të racës së Myzeqesë, të nxehur nga fshikujt dhe nga klithmat e të zotërve të tyre u lëshuan me revan përpara. Largesa me kolonën armike sa vente zvogëlohej. Luftëtarët shqiptarë u munduan ta fusnin kolonën e madhe të andartëve në një kullotë të ngushtë fshati, pa mundësi të gjerë manovrimi dhe ia arritën qëllimit. Përfundimisht bandat greke u futën në darën e hekurtë të kalorisë së lehtë shqiptare, që me sokëllimat tradicionale të tyre «ja - ja - të» i futën tmerrin ushtrisë shoviniste greke. Ata mbeten të rrethuar kudo në errësirën e natës nga kalorësit kurveleshas, që u ndritnin pallat në duar nga rrezet e hënës. Çukitjet e shpatave dhe rënkimet e të plagosurve dëgjoheshin anembanë fushës së luftës. Hasan Çakua ja kishte marrë mirë dorën shpatës. Ai ishte një luftëtar i sprovuar në armët e bardha dhe dinte me mjeshtëri t'ja shkëpuste armën nga dora kundërshtarit. Të shumtë qenë andartët që përfunduan nën presën e jataganit të trimit Hasan Çako, i mbiquajtur prej grekërve Deli Hasani.¹⁾

Nuk është ngritur rastësisht kënga e vjetër popullore:

«... Hasan Çako pallëlari
Vllam të kish Çelo Picari,
Dilje nga të parëtë,
Zije kapetanëtë,
Dhe iu merrje armëtë...»²⁾

Forcat e shumta andarte, mbas një rezistence të ash-për trup me trup, u tërroqën. Ata u ndoqën këmba-këmbës nga kavaleria e lehtë shqiptare.

Beteja e Kallabakës u kurorëzua me fitoren e plotë të shqiptarëve. Por, midis trimave të Shqipërisë në këto

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

luftime të ashpra malore u plagos rëndë në gjoks dhe luftëtar i Labërisë Hasan Çakua. Shokët e tij të armëve e sollën këtë trim të atdheut me trup të rënduar në vendlindjen e tij, në Kaparjel. Vajtimet e ngritura për këtë luftëtar flasin qartë për trimëritë e tij.¹⁾

Gjatë këtyre betejave luftëtarët shqiptarë u treguan të gjithë të zotët e pushkës. Nga udhëheqësit e tyre. Çelo Picari si zakonisht u dallua si prijës i talentuar ushtarak, veçanërisht në luftë çetash. Ai u shqua për manovrime të shpejta, për goditje në befasi dhe për maskimet, që u bënte luftëtarëve gjatë sulmeve, duke shfrytëzuar dhe errësirën e natës pa hënë.

Pjesa e mbetur e bandave greke, me në krye gjeneralmajorin Theodor Grivën, për arsyen taktike u tërroqën thellë në brendësi të vendit dhe u dhanë betejë luftëtarëve

1) AIF (Dosja M.K.):

«...Hasan Çako kordhëtar,
Derdhurë margaritari,
Vlla, o zëmëro,
Dukesh që nukë rroje,
As mbi at dot nuk qëndroje.
Fustani një fush' e gjérë,
Armëtë kush do t'i ngrërë,
Hasano, zebusho,
Kush do t'i mbajë ato,
Të kujoj a derëzeza,
Hasano, zebusho,
Në gurin e shtrungëso,
Kur i bije culëso,
Me anën e buzëso,
Vlla, o zëmëro,
Vlla a derëzeza».

Një variant tjetër të kësaj kënge popullore e kemi gjetur dhe tek D. Camarda «Appendice al saggio di grammaticologia comparata sulla lingua Albanese». Livorno (Itali) 1866, fq. 40, nr. 31.



Hasan Çako

të Vlorës në shkrepat e thepisura të Mecovës. Qartë e pasqyron folklori:

«Kush u hodh proto n'Mecovë,
I shkreti Mahmud bej Vlorë,
Selami një vetullhollë,
Fora me pallë në dorë,
Gremisi katër taborë,
Me pallë në dorë fora,
E mblodhi grivën sa dora...»¹⁾
«... Shako Xhakë, Mahmud beu,
Luftojnë sa tundet dheu,
Lumin përpjetë ç'e ktheu...»²⁾

Kudo në këto anë shikoje shtëpi dhe të mbjella të dje-gura nga ushtarët e gjeneralit të ri Dhimitër Grivës. Ma-sakrat e këtij oficeri madhor dhe të babait të tij kanë qënë të panumërtë nga krahu i Mecovës. Nga çdo anë të dilnin përpara pleq, gra dhe fëmijë të rreckosur, që braktisnin fshatrat e tyre dhe me tesha të ngarkuara në shpinë tër-hiqeshin në brendësi të tokave shqiptare.³⁾

Dhe nga vetë përbajtja e këngëve popullore del qartë lufta e drejtë që zhvilluan këta trima për mbrojtjen e integritetit tokësor të atdheut:

«Shako Xhakë bajraktari,
Në Mecov' u hodh i pari,
Ky Shako Xhakë Tërbaçi,
I Shqipëris' ish ilaçi,
O ilaç i Shqipërisë,
I vjen rrëth e rrëth kufisë,
I vure dyfek Greqisë,
Për hudut e Shqipërisë».⁴⁾

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

3) J. Llambridhis. Vep. fq. 42-49.

4) AIF (Dosja II M.K.)

Luftha në Mecovë u zhvillua e ashpër nga të dy anët. Bandat e mbeturat greke kishin zënë vendet më strategjike. Vend i luftës ishte krejt i veshur në shkëmb dhe i mbrojtur mirë nga krahët. Shqiptarët ishin të detyruar të luftonin në terren të hapët.

Andartët, të udhëhequr nga oficerë të sprovuar të ushtrisë së rregullt greke, të mbyllur nëpër fortifikatat e kullat e tyre, villnin nga frëngjité vazhdimisht zgjarr mbi shqiptarët. Sipas gojëdhënës popullore, luftëtarët shqiptarë, me sokëllimat e tyre u bënë shumë herë thirrje forcave shoviniste greke të mos fshiheshin pas frëngjive, por të zbritin në sheshin e burrave dhe të luftonin ballë përballë me shqiptarët, jo duke qëlluar së largu me plumbë, por me pallë sheshit. Ja si i pasqyron folklori:

«... *Morait qeratallarë*, *)
Neve jemi shqipëtarë,
Jo me tjetër, por me pallë,
Krerëtë do t'u përlajmë... » 2)

Të shumta janë këngët popullore mbi këta trima, që i dëbuani bandat shoviniste greke nga këto krahina jugore të Atdheut. Ja dhe një këngë që flet qartë për luftëtarët labër të udhëhequr nga kordhëtari Shako Xhakë Tërbaci:

«*O Shako ç'e bëre mirë,*
Ngrite tabjet në Muzinë, 3)
Një natë në suferinë...
Labërit gjysmë opingë,
Ç'e përzunë gjiritlinë,

*) Moraitë quhen ushtarët grekë të ardhur nga Morea (Peloponezi), mbasi atje u formua për herë të parë shteti grek.

2) Lidhur me popullsinë shqiptare të këtyre krahinave flet qartë: Emile Isambert. Orient, Gréce et Turquie d'Europe, fq. 815, kapitulli V. Shqipëria, seksioni I, Rruga 77, nga Mecova në Janinë; Rruga 78, nga Arta dhe Preveza në Janinë, fq. 821; nga Preveza në Janinë, fq. 829... Çamëria, fq. 845, Vilajeti i Janinës.

3) Llogoret.

*Kapetan Kosta Forinë,
S'e pa i pari të dinë,
Lanë vrapin në Athinë...»*

Mjaft fortifikata ranë në duar të shqiptarëve, por njëra prej tyre, e ashtuquajtura «kulla» vazhdonte me ngulm të rezistonte. Trimi Selam Hasani vendosi ta likuidonte vetë edhe këtë çerdhe të armikut.

Shovinistët grekë me zjarrin e tyre të vazhdueshëm, nuk linin asnje t'i afrohej kullës. Selami urdhëroi luftëtarët e Vlorës të qëllonin pa rreshtur mbi kullën dhe ai, nën hijen e plumbave iu ngjit bregut përpjetë drejt kullës. Kështu vepruan dhe shokët e tij. Selami u hodh brënda dhe u kacafyt grykë më grykë me qëlluesit e kullës. Sipas folklorit ky trim i Velçës me pallën e tij «mynxyrjare» bëri kërdinë mbi armiqtë:

*«... Bir, o bir Selam Hasani,
Gjak të kallon jatagani,
Preve sa të deshi xhani,
Se të qe zënë vatani...»¹⁾*

Por atje u rrethua keq. Ai ra më në fund heroikisht në këtë përlleshje të pabarabartë.²⁾ Megjithatë shqiptarët i vazhduan sulmet dhe kjo fortifikatë ra në duart e tyre.

1) AIF. (Dosja II M.K.)

2) AIF (Dosja M.K.). Në vazhdim të këngëve popullore mbi luftëtarin Selam Hasanin:

*«... Britnë morait», — amani,
Se na griu jatagani,
Na preu kordh' e Selamit...
O Selam kur u godite,
Skishte vatur mes'i dite,
Të shkretën pallë ç'e qite,
Përmbi Grivën u vërvite,*)
Lumin e Vlorës e rite...»*

*) Gjeneral Theodhor Griva.

Pas pak ditëve beteja e Mecovës përfundoi me fitoren e plotë të shqiptarëve. Të shumtë qenë robërit, kuajtë dhe armët që ranë në duar të luftëtarëve shqiptarë. Ja si u tallën luftëtarët tanë me përhapësit e megalidesë në këto anë:

«*Në manastir buzë shkëmbi,
Dridhet gumeni si qëni.
O gumen, o mjekër fshesë,
Ç'i bëre djemt' e Moresë,
U ndanë nga katr' a pesë,
Si shelegëtë në vesë,
Nga plumbat' e shishanesë».¹⁾*

Sipas traditës, armët e ndritura të kapedan Selam Hasanit, mbasi kaluan me nderim dorë më dorë tek luftëtarët shqiptarë u dërguan në vendlindjen e këtij trimi:

«*Se ç'u nxi gryk'e Sazanit,
Një pampor sa gjysm' e malit,
Ngulur në mes të limanit,
Bie armët e Selamit,
Shyt' ergjend e pall' e Shamit.*²⁾*

Folklori, ky visar i madh i popullit edhe sot i mban të freskëta vajet e ngritura për humbjen e parakohshme

Dhe vetë nga përbajtja e këtyre vargjeve popullore pasqyrohet qartë lufta e drejtë e shqiptarëve:

«... *Shqiptarët kur s'janë falë,
Po kanë vdekur me pallë...
U dogjën toskët e shkretë,
U dogjën dhe u vranë,
Për të ruajtur vatanë.*»

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

* Shami — qytet në Arabi.



Selam Hasani

të këtij trimi të ri të Labërisë, që nuk kurseu as jetën për mbrojtjen e tokës së tij amtare:

«*Gjëmon shkëmbi i Presaranit,**)
Vinë çobankat e stanit,
Me lot e me djers' ballit
Bëjnë kujen e Selamit...»¹⁾

Me fitoren e betejës së Mecovës dështuan dhe tentativat e para të qeverisë shoviniste greke për pushtimin e Shqipërisë së Jugut gjatë vitit 1854.

*) Presarani — emër shkëmbi në afërsi të fshatit Velçë, rrjeti

¹ Vlorës.

1) AIF, (Dosja II M.K.)

**SHPIRTIN LIRIDASHËS TË SHQIPTARIT NUK E
MPOSHTËN DOT AS TOPAT DHE AS DEKRETET
E SULLTANIT (15 shkurt 1856)**

«Shqipëri, kështjell' e fortë,
Kalaja që s'merret dot,
As me lajka, as me top...»

Populli.

Gjatë këtyre vjetëve, krizat në Perandorinë e madhe Osmane vinin njëra mbas tjetrës. Ato çdo ditë ia shkurtonin jetën asaj. Turqia qëndronte në këmbë në sajë të kontradiktave të mëdha që kishin shtetet e mëdha evropiane. Kështu Perandoria Turke në konfliktin e saj me Rusinë cariste (1853-1856) shpëtoi kryesisht në sajë të këtyre kontradiktave. Gjatë këtij konflikti siç është theksuar, Anglia dhe Franca së bashku me mbretërinë e Sardenjës morën anën e Turqisë dhe krejt operacionet ushtarake i zhvendosën në gadishullin e Krimesë. Edhe sot kujtohen në këngët tona popullore betejat e përgjakshme, që u zhvilluan në Sevastopol, veçanërisht ato të kodrës «Malakov»:

«Tre vjet punoi gjëmia,
Sa u mbush Anadollia,
Sevastopol e Rusia,
Sevastopol anës detit,
Memleqeti mir' i shkreti,
C'ja vuri synë dovleti,
E qëllon me top nga deti...»

*Njëzetedy gjeneralë,
Në Sevastopull u vranë,
Viktories kur ja thanë,
Lidhi duart' e zu vajnë,
Malakov'n e muarnë,
Po të gjith' u shuanë...»*

Stambolli me gjithë përpjekjet e tij nën maskën e «mbrojtjes së fesë islame» nuk mundi t'i mobilizonte dot forcat shqiptare, për t'i dërguar në frontin rus. Në fakt, kërët shqiptarë qysh në fillim iu përgjigjën Portës së Lartë se forcat e tyre do t'i mbanin në vend për të mbrojtur tërësinë tokësore të Shqipërisë nga synimet grabitare malazeze ose greke.

Sikurse theksohet qartë në veprat e K. Marksit dhe F. Engelsit, Stambolli propagandonte se për myslimanët nuk ekzistonte parimi i kombësisë, se Perandoria teokratike Otomane mbështetetë mbi gjithë myslimanët e Perandorisë, pa dallim kombësie. Perandoria Otomane, siç shkruante në këtë kohë Karl Marks, e kishte «thjeshtësuar në mënyrë rrënjosore gjeografinë dhe etnografinë», për atë ekzistonin «vetëm myslimanë dhe të pabesë».¹⁾

Me anën e këtyre teorive reaksionare të veshura me petkun e fesë, Stambolli mundi të mbajë nën influencën e tij në rradhë të parë turkomanët e vendit që përbëhej shin nga elementë fanatikë të klerit mysliman. Këta feudalë interesat e tyre i kishin të lidhura ngushtë me pushtuesin si dhe shtresat e prapambitura të vendit, që nuk ishin shkëputur nga paragjykimet fetare.

Megjithatë Porta e Lartë nuk mundi t'ja arrijë qëllimit. Shqiptarët nuk pranuan t'i shkojnë ushtarë Turqisë në frontin rus.

Gjendja ekonomike e Shqipërisë në atë kohë ishte e mjeruar. Fshatarësia ishte rënduar shumë nga barra e taksave dhe nga shërbimi i detyruar ushtarak shumëvje-

1) Instituti i Historisë. «Historia e Shqipërisë». Tiranë, 1965, vëll. II, fq. 85.

çar turk. Revoltat filluan përsëri në vendin tonë. Më 8 gusht 1854 në Shkodër ndodhën trazira të mëdha, të shkaktuara nga gjëndja e keqe ekonomike dhe nga abuzimet e autoriteteve osmane. Funksionarët turq në Shkodër grumbulluan drithin dhe e shitën atë jashtë Shqipërisë, duke shkaktuar në vend ngritjen e çmimit. Vegjelia shkodrane, nën kryesinë e trimit sheh Shamia vërvshoi në treg, me armë në dorë kërkoi largimin e valiut turk, hapi hambarët dhe rrëmbeu drithin. Forcat e pushtuesit të tmerruar u mbyllën në kala. U desh ndërhyrja e vetë konsullit francez të Shkodrës për të qetësuar masat e revoltuara të vegjelisë shkodrane. Ai ndërmjetësoi për transferimin e valiut me qëllim që të mbyllej çështja.

Revoltat në këtë kohë plasën anembanë vendit. Këto e pengonin seriozisht pushtuesin për të vjelur taksat dhe për të mbledhur rekrutët.

Gjatë kësaj kohe sultani Abdyl Mexhiti, në 15 shkurt 1856, shpalli dekretin e ri perandorak «Hat-i humajun», që nuk ishte gjë tjetër veçse një zhvillim i mëtejshëm i reformës së mëparshme administrative, konkretisht i «Hat-i sherif i gjylhanës», i shpallur gjatë vitit 1839, që mori më në fund emrin «Tanzimat». ¹⁾

Me shpalljen e këtij dekreti të ri, filloi periudha e dytë për zbatimin e Tanzimatit.

Këto reforma skllavëruese turke, në radhë të parë synonin në mbledhjen sistematike të taksave dhe për rekrutimin e djemve në shërbimin e detyrueshëm shumëvjeçar ushtarak osman.

Zbatimi i këtij dekreti të ri skllavërues turk në vendin tonë gjeti pengesa të mëdha, mbasi populli u ngrit në këmbë, veçanërisht fshatarët, të cilët përsëri u bënë forca lëvizëse e kësaj rezistencë shumëvjeçare populllore.

Stambolli, për ta administruar më lehtë Shqipërinë e pabindur, i ndau tokat shqiptare në tri vilajete: Vilajeti i Janinës, i Shkodrës dhe i Manastirit. Më vonë Sta-

1) Instituti i Historisë. «Historia e Shqipërisë». Tiranë, 1965, vëll. II, fq. 68.

mbolli krijoi dhe vilajetin e Kosovës me kryeqendër Prishtinën. Secili prej këtyre vilajeteve ndahej në sanxhaqe (prefektura), kaza (nënprefektura) dhe nahije (komune). ¹⁾

Përsëri zjarr dhe hekur derdhi pushtuesi në krahinat tona kryengritëse. Megjithatë Porta e Lartë nuk mundi të mposhte dot shpirtin luftarak dhe atdhedashës të shqiptarit.

Qartë e pasqyron rapsodi ynë popullor, në gojën e sulltanit, trimërinë dhe zgjuarësinë e shqiptarëve dhe gjendjen e mjeruar të vendit tonë nën sundimin turk, të rrethuar nga shtetet fqinj grabitqarë sllavogrekë që kërkojnë copëtimin e Shqipërisë:

*«Shqipëri tre vilajete,
Në mes të kralevë mbete.
I thanë sulltanit: — Jepe,
— Nuk e jap e kam për vete,
Janë trima pa alete,
Dinë shumë marifete,
I thonë dufekut: «Lepe»... »* ²⁾

Udhëtarët e huaj që kanë përshkruar gjatë vjetëve 1860-1875 Shqipërinë flasin shumë për varfërinë e madhe që kishte pllakosur vendin tonë. Konsulli rus Trojanovski në kujtimet e tij flet mjaft për mjerimin që mbretëronte në atë kohë në Shqipëri, ku, dhe shumë familje që kanë qënë dikur mirë kanë rënë në gjendje të rëndë varfërie.

«S'është aspak për t'u çuditur — shkruante Jonin, një tjetër diplomat rus — përsë fshatari i mjerë, duke jetuar humbi çdo shije dhe dëshirë për punë...» ³⁾

Me vendosjen e kësaj administratë të re turke në Shqipëri, dhënia e drejtësisë i qe besuar kryesisht vetëm kadilerëve (gjyqtarëve). Ata mbështeteshin në të ashtuqu-

1) Instituti i Historisë. «Historia e Shqipërisë». Tiranë, 1965, vell. II, fq. 81.

2) AIF (Dosja M.K.).

3) Instituti i Historisë. «Historia e Shqipërisë». Tiranë, 1965.

ajturën e drejta fetare (sheriati), e cila zëvendësoi të drejtën zakonore vendase.

Në popullin tonë akoma kujtohen grabitjet e shumta që kanë bërë kadilerët nën zbatimin e «sheriatit». Ryshfetet, grabitjet, dhuna e padrejtësia e hapur ishin në atë kohë në rendin e ditës.

Qartë e pasqyron kënga e poetit të hershëm Zyko Kamberit karakterin grabitqar të këtij ligji të shenjtë islam:

«*O mik mos tē zëntë krraba,
Tek sheriati tē tē shpjerë,
Se si lejleku që ha zhaba,
As mish, as kocka nuk tē lënë...*»

Fshati shqiptar sa vente varfërohej nga barra e rëndë e taksave. Toka shumë herë mbetej djerr (pa punuar) nga mungesa e krahëve të punës, mbasi djemtë e fshatarëve ndodheshin ushtarë larg atdheut, në skajet e largëta të Perandorisë së madhe Osmane.

Mjaft ushtarë, të rënduar nga shfrytëzimi i egër feudal, nga taksat e rënda dhe nga mungesa e krahëve të punës, duke qënë të lejuar nga ligji i ri turk agrar «Eraz-i kanuni», shitnin tokën dhe zbritnin në qytet ose merrnin rrugët e mërgimit si në Rumani, Greqi, Egjipt etj.

Në vitet 1850-1860 në Stamboll numëroheshin me mijëra zejtarë të mërguar nga Shqipëria, përvèç dhjetëra mijëra krahë pune. «Të gjithë ata që rrëmojnë, ndërtojnë, sharrojnë, djegin qymyr në Turqinë evropiane dhe në Greqi janë shqiptarë» shkruante konsulli austriak J. G. Han.¹⁾ Të mërguar pati më shumë nga krahinat jugore të atdheut.

Edhe me ardhjen në fuqi të sultani Abdyl Azizit (1861-1876) gjendja në Perandorinë Turke nuk ndryshoi.

Shqiptarët, gjatë kësaj kohe, filluan të hedhin dhe hapat e para drejt diturisë për një arsim me karakter kombëtar.

1) Instituti i Historisë. «Historia e Shqipërisë». Tiranë, 1965, vëll. II, fq. 83.

Patriotët e përparuar si Naum Veqilharxhi me abetaren e tij shqip nën sjetull, u mundua të rrënjosni kudo dashurinë për gjuhën amtare shqipe. Gjurmët e këtij patrioti i ndoqën me dhjetëra atdherashës të tjerë. Në Stamboll u ngrit e para shoqëri shqiptare, që përfaqësoi në atë kohë lëvizjen kulturore kombëtare shqiptare, por kjo veprimtari patriotike shqiptare nuk u prit mirë nga Porta e Lartë dhe nga rrethet megalideiste, veçanërisht nga Patrikana, të cilët filluan një fushatë të egër kundër atdherëve tanë, që guxuan të flasin për gjuhën amtare dhe pér të drejtat e tyre kombëtare.

Patriotët intelektualë shqiptarë u munduan që dituria të shtrihej sa më gjërë te luftëtarët shqiptarë, duke u mësuar atyre të shkruarit e gjuhës shqipe, në mënyrë që ndërgjegjja kombëtare të kalitej dhe të bëhej qëllim pér luftën kundër pushtuesit. Këta patriotë, me shkollë, u munduan që kudo në Shqipëri pushka të gërshtetohej me penën, që këto përpjekje pér liri të ishin të organizuara, me pikësynime të qarta pér çlirim e plotë të vendit.

Nga trimat e kryengritjeve popullore që përqafuan të parët idetë patriotike plot dashuri për gjuhën shqipe dhe për kombin shqiptar ishte dhe luftëtarë i vjetër Çelo Picari me djemtë e tij, së bashku me trimin tjetër të ri të Labërisë Muslim Gjolekën me shokë. Ata, në atë kohë, u lidhën ngushtë në Janinë me bijtë e familjes patriotike Frashëri, dhe luajtën një rol me rëndësi në përhapjen e veprimtarisë patriotike në mbarë sanxhaqet e vilajetit të Janinës, veçanërisht në sferat e influencës së tyre si në Labëri, Çamëri e gjetkë, krahina këto të mbushura plot me të rinj të arratisur, që nuk donin të shkonin ushtarë në shërbim të Turqisë.

LËVIZJA E KAÇAKËVE NJË NGA FORMAT E HERSHME TË LUFTËS KLASORE

Gjatë kësaj kohe kemi një zgjerim të dukshëm të lëvizjes së kaçakëve në mbarë vilajetin e Janinës.

Mjaft bij të vegjëlisë shqiptare, për t'i shpëtuar shtypjes e shfrytëzimit të egër osman, që përkrahej pa rezervë nga feudalët turkomanë të vendit, rrëmbenin armët dhe i ngjiteshin malit përpjetë, duke formuar çeta hajdutësh më vete.

Lëvizja e kaçakëve ose e hajdutëve, e pasqyruar prej kohësh në histori, jo gjithnjë është argumentuar drejt. Shkencërisht ajo përcaktohet si shprehje e protestës sociale dhe formë e hershme e luftës klasore së fshatarësisë së shtypur, kundër rritjes së shfrytëzimit feudal vendas në shërbim të sulltanit.

Këto momente antifeudale janë manifestuar prej kohësh në vendin tonë, porse gjatë kohës së shtimit me forcë të reformave centralizuese osmane, sidomos gjatë zbatimit të shërbimit të detyrueshëm shumëvjeçar ushtarak kjo levizje mori një vërshim më të gjerë. Me qindra bij të Shqipërisë, për t'iu shmangur detyrimit ushtarak osman hidheshin në arrati.

Francezi Ami Bué, që kishte vizituar në atë kohë Shqipërinë, në veprën e tij «Turquia Evropiane» shkruante: «... Për hajdutët e Perandorisë Osmane nuk kanë qenë të huaja ndjenjat e dashurisë për atdhe, ndjenjat e njerëzimit, të zemërgjerësisë të mirësjelljes. Në kushtet konkrete ata qenë bërë udhëheqës të shquar të bashkatdhatarëve të tyre në luftën çlirimtare». Ky autor francez i vishtë hajdutëve jo vetëm karakterin grabitqar, por edhe atë politik çlirimtar. Për këta të ashtuquajtur hajdutë (nga pushuesi) nuk kanë qënë të pakta rastet kur sendet e gra-

bitura nga thesari i qeverisë turke dhe nga pasanikët e vendit ua shpërndanin të varfërve, u blenin qetë e par mendës, martonin vajzat e të varfërve, hakmerreshin kundër familjeve të mëdha të parësisë që i keqpërdoroni dhe i vritnin të varfërit. Të tillë «hajdutë» kanë qënë Birbiljenjtë, Shemo Hajduti, Numan Bala etj.

Birbil Shakua nga fshati Rexhin i Kurveleshit, qysh në fëmijëri u njoh me Resul Sejdinin nga Progonati. Të dy ishin barinj nga Kurveleshi. Ata u rritën së bashku, duke bredhur pas dhive, me gjysmë opingë, si era e maleve nëpër shkrepat e grykat e thepisura të Labërisë. Këta bij të vegjëlisë qysh në rini provuan mbi shpatullat e tyre vuajtjen, skamjen dhe përbuzjen, sepse u rritën së bashku me to. Me intuitën e tyre prej biri të vegjëlisë e kuptuan ndryshimin e madh klasor, që ekzistonte midis popullsisë të kësaj krahine të shumëvaujtur. Ata panë me sytë e tyre luksin pa fré të pasanikëve dhe varfërinë që kishte pllakosur masat e gjera të popullsisë, panë se të drejtat dhe liria e njerëzve të thjeshtë ishin vetëm një lodër e zakonshme në dorë të pushtuesit dhe të feudalëve e pasanikëve të vendit, të drejta këto që merreshin dhe jepeshin sipas dëshirës së tyre.

Ku nuk u dëgjuan krisma e pushkës dhe frëngëllima e pallës së këtyre trimave të vegjëlisë! Bejlerët dhe pasanikët shfrytëzues të vendit nuk qarkullonin më lirisht. Me forcë të madhe realiste e pasqyron folklori këtë:

«... O birbil në këto vënde,
More nam me pallën tënde... »¹⁾

Sa ekspedita ndëshkimore osmane e përshkuan anembanë Shqipérinë e Jugut për të hedhur në dorë Birbilenjtë. Sa herë u rrethuan ata! Por këta trima mbarë krahanat jugore të atdheut i kishin «jatak». Në të gjitha stanet e këtyre anëve barinjtë i pritnin krahëhapët të ashtuquajturi «hajdutë», që i kishin dalë zot popullit fukara.

1) AIF (Dosja II M.K.).

Luftëtarë Birbil Shako me shokët e tij u dilte repar-teve ndëshkimore osmane atje ku nuk e pritnin, sulmonte mbi ata dhe zhdukej si era. Me plot të drejtë, rapsodi popullor, në këngët e tij e krahason sypatremburin Birbil Shako me malin madhështor të vendlindjes së tij, me Këndervicën legjendare, ku edhe pse malet u mbushën me taboret osmane, ai nuk u përgjunj asnëjëherë para forcave të panumërtë armike:

« . . . O birbil, Birbil Nivica,
I madhi sa Këndervica,
Sa Këndervica me borë,
Mbushe malet me taborë . . . »¹⁾

Birbil kordhëtarit nuk iu tremb asnëjëherë syri nga forcat e panumërtë osmane. Ai mbështetej në fuqinë e pashtershme të popullit, në ndihmën e tij. Çeta e vogël e këtij trimi në kohë lufte mbushej me qindra luftëtarë; prandaj ai asnëjëherë nuk i rrahu qepallat, kur futesh në luftë me nizamët e shumtë të sulltanit.

« . . . Doli nëna në sufa,
— O birbil c'janë ata?
— Halldupë me dolloma,
Lei moj nënë, mos i nga,
Se do shkoj un' nëpër 'ta,
T'i pres t'i bëj lakërâ . . . »²⁾

Vjetët kalonin, por çdo ditë çeta e birbilenjve bëhej më e rrezikshme për feudalët e mbarë pasanikët e vilajetit të Janinës, që ishin fryrë si shushunja me gjakun e vëgjëlisë. Nuk kishte javë që të mos dëgjoheshin aksionet e birbilenjve. Mjaft depo të bereqetit të shtetit (të ardhura nga taksat e së dhjetës) dhe nga ato të çifligarëve ishin hapur nga trimat e Birbilit dhe i qenë shpërndarë popullit.

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

Karvanet me ngarkesa të pasanikëve dhe posta me para e qeverisë, «hazineja» edhe pse shoqërohesh nga dervenagasitë dhe roje të forta osmane, ato nuk shpëtonin pa rënë në duar të birbilenjve:

«... Birbil preve hazinetë,
Birbilo, Birbil palla,
U ngjite malit përpjetë,
Birbilo, Birbil palla... »¹⁾

Këta trima të vegjëlisë kishin arritur të futeshin edhe ditën nëpër qytete, duke grabitur pasanikët dhe zyrat qeveritare. Nëpunësit, të tmerruar braktisinë zyrat dhe merrnin arratinë.

Karakteristike për birbilenjtë ishte, se kudo që shkoni, ngrinin «gjyqet e fukarasë» (gjyqet popullore), për gjykimin e shtypësve dhe shfrytëzuesve të vendit, të lidhur ngushtë me Turqinë. Këta luftëtarë, përveç dënimit me vdekje, kundër armiqve zbatonin si dënim plotësues dhe djegien e pallateve të tyre. I tillë ka qenë edhe rasti i djegies së sarajit të Xhelil Xhufit në Voshtinë, i cili u gjykuar dhe u dënuar me vdekje në mungesë. Xhelil Voshtina me njerëzit e tij kishte kohë, që ishte vënë në shërbim të Turqisë për kapjen e këtyre trimave. Ankimet e Xhelilit kishin arritur deri në Stamboll, tek sulltani. Ky bej pasanik trumbetonte me të madhe, para Portës së Lartë, se qe një ofendim i hapët për sultantanin në qoftë se do të liheshin akoma të qarkullonin lirisht birbilenjtë në vilajetin e Janinës.

Sipas historiografëve të huaj, pasqyruar po kështu edhe në gojëdhënën popullore, birbilenjtë gjatë vitit 1855 kapën një nga feudalët më të trezikshëm të vilajetit, Ahmet beun, i cili herë pas here, në mënyrë sistematike, me sejmenët e tij grabiste popullsinë e pafajshme të Zagorisë

1) AIF (Dosja II M.K.)

dhe të Palopogonit, si në Delvinaq etj. duke arritur deri në vrasjen e banorëve, si Jani Kaculi etj.¹⁾

Valiu i Janinës, në pamundësi për të hedhur në dorë Birbil Shakon me shokë, me qëllim afrimi për ta zhdukur, i dha titullin «Derven agasi» (ruajtës të shtigjeve malore), por kjo nuk pati asnë rezultat; Birbil Shakua me çetën e tij, jo vetëm nuk e pushoi luftën, por e dyfishoi atë, sidomos kundër feudalëve të lidhur me osmanllinjtë.

Në këtë fazë të lindjes fillestare të marrëdhënieve kapitaliste në vendin tonë, kjo lëvizje spontane e kaçakëve ose e hajdutëve filloj të zgjerohet edhe më shumë. Ajo u përkrah edhe nga banorët e varfër të qyteteve, tashti të zmadhuara, që po krijonin një tregti dhe një artizanat pak a shumë të zhvilluar. Në këtë kohë çeta të tjera hajdutësh ishin ngritur në vilajetin e Janinës, si ajo e Shemo Hajdutit, e Bejo Dukës, e Hysen Labit, e Beqo Bodurit, etj.

Valiu i Janinës, Hysni pasha, nuk kishte lënë gur pa luajtur për të hedhur në dorë këta trima. Ai kishte lajmëruar Stambolin pér rrezikshmérinë e madhe të kësaj lëvizjeje spontane që kishte filluar të zgjerohej në Shqipëri. Porta e Lartë e tronditur, urdhëroi të niseshin forca të shumta në drejtim të krahinave ku u lindën dhe u rritën këta trima. Sipas folklorit:

«*Shtatë pashallar' u shkulë,
Për Birbil e pér Resulë;
O Progonati me vulë,
Të bënë sa doli ujë...»²⁾*

Megjithatë kjo lëvizje spontane e kaçakëve ose e hajdutëve të këtyre anëve edhe pse ishte e paorganizuar dhe e palidhur me lëvizjet e kaçakëve të krahinave të tjera të vendit, qëndronte në këmbë, mbasi mbështetej në popullin fukara, në vegjelinë, që i mbronte dhe i donte këta trima

1) Jorgji Llambridhis. «Epirotika meletimata». Athinë, 1880, fq. 24 (Material i përkth. pranë AIH).

2) AIF (Dosja II M.K.)

që i delnin për zot sa herë që ata ndodheshin ngushtë për bukën e gojës.

Pushtuesi osman, atë që nuk mundi të arrinte tek birbilenjtë me anë intrigash apo me shpatë në sheshin e luftës, ia mbërriti me anën e bllokadës ekonomike. Pushtuesi u preu krejt furnizimin me ushqime zonave malore, që ndodheshin nën influencën e kaçakëve. Autoritetet osmane urdhëruan që të mos lejoheshin bagëtitë e këtyre vendeve malore të zbritnin në kullotat dimërore.

«... *Mbenë bagëtitë në shkëmb,
Kërkojnë bar për të ngrënë,
Qysh do të vejë halli tënë,
S'do mbëtet asnje pér rënje...*»¹⁾

Këto masa u shoqëruan dhe me arrestime e internime të shumta. Mjaft prej tyre ishin arrestuar pér të vetmin faj, pse kishin pranuar opingat, festet dhe gunat e dhuruar nga birbilenjtë që i kishin rrëmbyer në tregtarët e mëdhenj të Janinës.

Fshatra të tëra në Labëri, qeveria turke i zbrazi nga burrat dhe me pranga në duar të lidhur mbas kuajve të ushtarëve turq i nisën pér në Janinë e në Stamboll, nëpër burgjet e errëta të tyre si në atë të Tersanës etj. Të njëjtin fat pësoi dhe fshati Tërbaç i rrëthit të Vlorës, vendi ku ishin strehuar birbilenjtë. Edhe sot, në këtë katund, vazhdon të quhet me emrin e birbilenjeve shpella ku ishin fshehur këta trima.

Në këtë kohë valiu i Janinës kishte dërguar tesqire (urdhëresë) anembanë Shqipërisë së Jugut. Ato arritën dhe në fshatin malor Tërbaç.

Valiu u premitonte shpërblime të majme atyre që do të hidhnin në dorë gjallë a vdekur birbilenjtë. Qartë i pas-qyrojnë këto ngjarje këngët popullore:

«... *Të xhumanë në pasdrekkë,
Tërbaç erdhën tesqiretë,*

1) AIF (Dosja II M.K.)

*Ē këndova gramën vetë,
— Ç'më thua, moj gram' e shkretë?
— Të zihenë birbilenjtë...¹⁾*

Sipas gojëdhënës thuhet se atë vit ka qënë dimër i madh. Borë e shumtë kishte rënë anembanë Labërisë. Mbarë bejlerët e Shqipërisë së Jugut së bashku me njerëzit e tyre ishin vënë të gjithë në lëvizje për kapjen e këtyre trimave:

*«O ju të zestë kaçkënë,
Ju kërkojnë e dō t'ju zënë,
Gjith' shtigjet u janë zënë,
Shkurti ju prishi takëmë,
Ju hodhi borë të rendë,
Në fushë pesë pëllëmbë;
S'e çan dot kali me këmbë...»²⁾*

Në këtë kohë gjendja ishte acaruar edhe më shumë, mbasi birbilenjtë kishin grabitur rrugës dhe «hazinenë e mbretit» (postën neveritare) plot me flori, që valiu i Janinës çdo vit i dërgonte Stambollit.

Ky akt i guximshëm i kishte tërbuar autoritetet osmane. Ata kërkonin më këmbëngulje kapjen e birbilenjeve:

*«... O Birbil ç'e bëre vetë,
Që kur prishe hazinetë...»³⁾*

Forca të shumta osmane kishin sulmuar anembanë krahinën e Vlorës. Turqit shkuan edhe në Tërbaç dhe arrestuan gjithë burrat e fshatit.

Kapedan Birbil Shakua për të shpëtuar vendasit nga persekutimi turk, u detyrua të largohet. Ai e la shpellën e Tërbaçit, duke lënë pas tij togje të shumta zjarri, për të

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

3) Po aty.

krijuar panik në forcat e pushtuesit. Ky trim mori drejtimin nga Nivica, shkoi në vendlindjen e tij dhe iu ngjit malit Këndervicë plot borë, i ndjekur këmba-këmbës nga taboret e shumta osmane. Atje gjeti përsëri mbrojtje shpellat e shkëmbinjtë e Këndervicës. Këngët e mrekullueshme popullore hedhin mjaft dritë rrëth këtyre ngjarjeve:

« . . . Bëre lart nga Këndervica,
Bir, o bir, Birbil Nivica,
Këndervica mal me borë,
Birbili me pall' në dorë,
Gremisi katër taborë. . . »¹⁾

Luftha u zhvillua e egër. Birbil Shakua tashti i diktuar u rrëthua nga të gjitha anët. Atje birbilenjtë çdo shkëmb e kthven në barrikadë.

Sipas gojëdhënës, thuhet se edhe bora e Këndervicës, u kuq nga gjaku i nizamëve dhe nga birbilenjtë trima që nuk deshën t'i nënshtroheshin sulltanit. Përveç të vrarëve, uria dhe të ftohtit e madh të shkurtit, i paksonte çdo ditë radhët e birbilenive. Jo vetëm baruti u mbarua, por edhe pallat e këtvre trimave thuhet se u këpütën së luftuari. Në këto rrëthana çeta e madhe e Birbil Shakos u paksua në trembëdhjetë veta, shumica dërrmuese e tvre ishin të plagosur, të uritur dhe të sëmurë. Megjithë këtë trimat zemërshkëmb nuk epeshin përparrë forcave të shumta osmane, edhe pse rrëthimi sa vente ngushtohej. Sipas folklorit:

« — O Birbil se c'të rrethosnë,
Hidhi armët se t'u sosnë.
— S'e hedh Birbili manxharë, *)
E kam fituar me pallë.
Në Voshtin' kur vura zjarre. . . »²⁾

1) AIF (Dosja II M.K.)

*) Manxharë = pushkë e prodhuar në Manxharistan — Hungari.

2) Po aty.

Ditën e fundit ata luftuan me tërbim deri në mbrëmje dhe mbasi u err, duke mbajtur në shpinë të plagosurit dhe luftëtarët me gjymtyrë të ngrira nga të ftohtit, tentuan të çanin rrëthimin, por ata ranë tradhtisht në pritën e forcave turke, të përgatitur nga rënegatët e vendit. Trimë zemërshkëmb Birbil Shako vetë i trembëdhjeti ra më në fund në duar të pushtuesve osmanë, që aq shumë e pritnin kapjen e tyre.

«... Birbil Shako çepe krënde,
Të zunë përtej në shkëmbe,
Të hodh hekurat për këmbe,
U shkoj haberi golëme,
Të gjorës mëmës tënde...»¹⁾

Kapja e këtyre trimave u trumbetua anembanë vendit me bujë nga autoritetet turke.

Hysni pasha, për të mposhtur shpirtin luftarak të bijve të këtyre krahinave të varfëra malore, urdhëroi që birbilenjtë të lidhur me vargonj këmbë e duar të ekspozoheshin në mbarë këto vende:

«... Në Rexhin i prun kaluar,
Me bezeliqe në duar,
Me litar në kraharuar...»²⁾

Rapsodët popullorë, me dhjetëra këngë, u kanë gëreshetuar birbilenjve. Ato vazhdojnë të këndohen me èndje edhe sot nga bijtë e popullit. Me mijëra njerëz u mblodhën në Janinë për të parë këta trima liridashës të mëmës Shqipëri:

«Janin', e zeza Janinë,
Dil të shihni cilët vinë,
Vjen Resuli me Birbilë,
Që nderuan Shqipërinë.

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

Kapja tradhtisht e birbilenjve u quajt nga osmanllinjtë si një fitore e madhe e tyre. Këtë fitore të tyre ata e përshëndetën me të shtëna artilerie, ndërsa poeti popullor trimin Birbil Shako me shokë, të përplasur në burgjet e errëta plot lagështi të Janinës në këngët e tij e krahason me bilbilin e mbyllur në kafaz:

«*Doli marsi, hyri prilli,*
— *Pse s'u dëgjua Birbili?*
— *Në kafaz e mban veziri...»*

I paharruar do të mbetet qëndrimi vetëmohues i birbilenjve trima përpara xhelatëve osmanllinj në Janinë. Ata vdiqën me këngë në gojë, duke kthyer çdo fjalë të tyre në plumb e kamxhik për tiranët e vendit dhe për pushtuesin e huaj. Me këto vargje plot mospërfillje për vdekjen dhe për armikun iu drejtuani bimbashit osman birbilenjtë para litarit:

«... *Janinë tek rrapi falë,*
Bimbashi hapi fermanë,
— *Ngreu Birbil e hidh litarë,*
— *Dale bej, të sos cingarë,*
Se nuk jam çanak me dhallë,
Po jam Birbili me pallë. ²⁾

Këta trima nuk pranuan t'i varte xhelati osman:

«... *Mu' tek rrapi në të dalë,*
Birbil Shako trim të rrallë,
C'i këpuse tre litarë...» ³⁾

Birbilenjtë, këta trima vetëmohues të vegjëlisë shqiptare, shkuan dhe u varën vetë në litarë. Ja çfarë vargje të

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

3) Po aty.

mrekullueshme u gërshtetoi gjeniu popull këtyre trimave. Ata e pështynë në sy renegatin Xhelil Voshtina:

«... Një nga një te' rrapi vjetër,
Birbilenjtë trembëdhjetë,
Vanë në litarë vetë;
Lanet paç Xhelil Voshtina,
Vare trembëdhjetë trima...»¹⁾

Pushtuesit osmanlinj dhe veglat e tyre e shihnin të tmerruar trupin e bukur të varur të Birbil Shakos, i cili në shenjë urrejtjeje dhe mospërfilljeje për pushtuesin dhe spiunët e tij nuk pranoi as cigaren ta hiqte nga goja:

«... Birbil Shakua me pallë,
Vate vetë në litarë,
Me dhëmbë e mbajti cingarë...»²⁾

Vetëm një dashuri e madhe për lirinë mund të nxjerrë trima të tillë. Këtu lufta dhe dashuria për jetën janë të lidhura me njëra-tjétrën. Ata lirinë dhe ndjenjën kombëtare e mbrojtën me fanatizëm të rrallë. Birbilenjtë trima nuk donin që bijtë e këtij vendi të trajtoheshin si «çanak me dhallë» nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm.

Gratë e Labërisë, nënët zëmërshkëmb labe, vajet më të mrekullueshme gërshtuan për këta kordhëtarë. Ja si i drejtohen në këto vaje bashkëshortes së kapedan Birbil Shakos:

«Qaje mir' moj gushëbardhë,
Se Birbil Shalon e varrë;
Qaje gushëbardh' me lot,
Birbil Shako nuk gjen dot,
Pa burra në radhë plot...»³⁾

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

3) Po aty.

Sipas zakonit të vjetër të Labërisë thuhet se për këta trima, në të gjithë këtë krahinë, në shenjë zije, u prenë lejletë kafshëve dhe ua hoqën zilet e këmborët bagëtive për të mos oshëtirë grykat e gërxhet e Labërisë, që aq shumë i deshën dhe i mbrojtën birbilenjtë. Gojëdhëna popullore shpjegon se në rrapin ku u varën birbilenjtë, çdo vit bie rrufeja:

** . . . Janinë, Janin' e shkretë,
Dil shikoni birbilenjtë,
Varturë degë më degë.
Ky Resuli me Birbile,
Tundi gjithë Shqipérinë. . . »¹⁾*

Në kuadrin e lëvizjes së kaçakëve ose të hajdutëve bën pjesë dhe i biri i vegjëlisë gjirokastrite Shemo Kasua.

Sipas gojëdhënës popullore, Shemo Kasua, i biri i Ibrahimit, i popularizuar me emrin Shemo Hajduti me datëlindje 1822, vjen nga një familje e varfër nga lagjja Manalat e qytetit të Gjirokastrës. Kjo familje kishte qenë në armiqësi të vazhdueshme me bejlerët, agallarët e me mbarë pasanikët e vendit që ishin lidhur ngushtë me push-tuesin osman. Shemua, qysh në rini, u rrit midis vuajtjeve, skamjes dhe përbuzjes. Ai ndjeu mbi shpatullat e tij peshën e rëndë të varfërisë.

Vetë shfrytëzimi i egër feudal vendas dhe i huaj e detyroi këtë bir të vegjëlisë gjirokastrite të marrë pallën dhe të dalë malit përpjetë në luftë për ekzistencë, ashtu si e kuontonte ai, thikë më thikë, me pasanikët dhe me mbarë feudalët shfrytëzues të vendit.

Ai ë urrente administratën skllavëruese të pushtuesit osman, që ishte ngritur dhe mbajtur në bashkëpunim të ngushtë me feudalët gjakpirës të vendit. Thuhet se kudo ë shkelte këmba e këtij trimi digjeshin zyrat qeveritare dhe hapeshin dyert e burgjeve dhe kafazet e zogjeve. «Ata duhet të fluturojnë të lirë» thoshte ky bir i Gjirokastrës.

Shemo Kasua i përbuzte lypësit dhe quante të drejtë

1) AIF (Dosja II M.K.)

vetëm rrëmbimin, duke ushtruar dhunën tek pasanikët e majmur në sajë të djersës dhe gjakut të vegjëlisë.

Urrejtja e tij e thellë kundrejt bejlerëve, agallarëve, tregtarëve dhe arhondëve i qe kalitur qysh në vegjëli, kur ai bridhte i uritur dhe i zhveshur nëpër rrugët plot gurë të Gjirokastrës për t'i siguruar kafshatën e gojës familjes së vet. Origjina e tij e varfér pasqyrohet qartë në këngët popullore. Kjo del haptas nga përgjigjet që i jep ky trim pyetjeve të gruas se me çfarë të ardhura do të rriten djemtë e tij:

“... — *Shemo si do të rriten djemtë?*
— *Ashtu si jam rritur vetë,*
Maleve posht' e përpjetë,
Me rrëpic' e me lëpjetë...»

Dhe me të vërtetë ashtu u rrit Shemo Kasua, i ndjekur këmba-këmbës nga nizamët osmanlli nëpër malet e thata të rrethit të Gjirokastrës. Ai i lagte buzët e tij të trasha prej etjes me ujin e shiut të grumbulluar nëpër zgarbuj (kufkot) e druve shekullorë, të skuqur nga ngjyra e drurit. Ja me se e shuanet etjen dhe urinë Shemo trimi:

“... *Me uj' në zgarbull si verë,*
Me mish të pjekur dy herë...»

Sa herë u përpoqën autoritetet osmane dhe feudalët e vendit për të hedhur në dorë këtë kordhëtar, që aq shumë u kishte prishur gjakun e qetësinë pasanikëve të vendit, por më kot u munduan. Nuk ishte lehtë të kapej ky trim. Ai ku mbillej, nuk korrej. Atë e mbronte kudo vegjelia; mbarë fshatarësia e priste krahëhapët në shtëpi në stane dhe me të i qante hallet. Tregonjë për Shemon se ai së bashku me shokët e tij kishte marrë në mbrojtje një sërë fshatrash në Lunxhëri, Zagori, Pagon etj, sepse feudalët e vendit, me ekspeditat e tyre ndëshkimore plot grabitje dhe dhunime, ia kishin bërë jetën të padurueshme banorëve të këtyre krahinave të varfëra malore.

Gojëdhëna popullore tregon për Shemo hajdutin, se

në fshatrat që ai merrte «deurde» (në mbrojtje), në fillim i mblidhte banorët e tyre dhe kërkonte prej tyre që ata të zotoheshin se do ta përkrahnin pa rezervë: do t'i siguronin luftëtarët e tij me ushqim e strehim, me fishekë dhe duhan. Atëherë ky kordhëtar në shenjë pranimi bënte betimin. Ai varte në pjesën qëndrore të fshatit gunën dhe pallën e mbiquajtur «Mynxyrjare», që sipas tij sillte mynxyrën në armiqtë. Ky gjest demostrues, i shoqëruar me tri të rëna borije briri, simbolizonte paprekshmérinë e fshatit dhe detyrimin. që merrte përsipër trimi pér mbrojtjen e banorëve të këtij vendi. Kjo ceremoni e thjeshtë prej komiti e Shemo hajdutit me shokë mjaftonte pér t'u futur tmerrin feudalëve ver das. Ata tashti i vinin «gishtin kokës» sa herë që orvateshin të nisnin në këto fshatra bandat e tyre grabitoare. Shemo Kasua nuk përtonte t'u bënte gjyqin dhe ekzekutimin aty pér aty, në mes të popullit, këtyre gjakpirësve.

E paharruar ka mbetur në popull gjuha e prerë e Reuf beut nga Shemua. Ky bej, së bashku me njerëzit e tij ishte dérguar fshehurazi nga valiu i Janinës në krahinën e Pogonit dhe të Zagories pér të diktuar forcat dhe strehuesit e Shemo hajdutit. Beu, së bashku me njerëzit e tij ra në duar të Shemos, por nuk u vra. Ai u gjykua si hafije (si spiun) dhe u lejua të kthehet tek valiu, veçse me gjuhë të prerë.

Valiu i Janinës kishte urdhëruar, që fshatrat e vëna në mbrojtjen e Shemos, mos të furnizoheshin me kripë dhe me ushqime. Në fakt asnjëherë ky urdhër i valiut nuk u vu në jetë. Tregtarët vendas, të tmerruar nga qëndrimi luftarak i këtij hajduti kordhëtar, me gjithë persekutimin turk, nuk ua kishin prerë kurrë furnizimin me ushqime këtyre fshatrave të varfëra malore. Tregtarët e këtyre anëve e kishin dëgjuar mirë çfarë pësoi nga Shemua tregtarë spekulator i Janinës. Nikolea, që nuk pranoi të furnizonte me ushqime këto fshatra. Në përgjigje të këtij qëndrimi Shemua i rrëmbeu peng të dy djemtë dhe pér lirimin e tyre i kërkoi Nikolesë tre mijë lira flori. Ky spekulator nuk pranoi dhe u vu në mbrojtjen e pushtuesit osman. Atëherë Shemo hajduti së bashku me trimat e tij, duke

mos i përfillur sejmenët e valiut të ri, Hysni pashës, shkoi vetë në Janinë dhe u fut brenda në shtëpinë e Nikolesë. Thuhet se tregtari, i tmerruar nga paraqitja e hajdutit mjekërosh, për ta zbutur atë u thirri vajzave greqisht t'i sillnin verë dhe raki, mbasi u erdhi pér darkë si mik «Deli Shemua»!!

Shemo Kasua ua hapi vetë depot e bereqetit fshatarëve dhe mbasi mbaroi këtë aksion, mori përsëri malet i pasuar nga karvanet e kuajve të fshatarëve plot me ushqime, të rrëmbyera nga depot e këtij tregtari spekulator.

Shemo hajdutin nuk e trembi as krisma e pushkës dhe as presa e jataganit të feudalit. Ai nuk e peshoi kurrë parësinë dhe mbarë pasanikët e vendit. Ja si e pasqyron kënga e bukur popullore:

«... *Shemo Kaso kordhëtari,
Kur shkoje dridhej pazari, ...*»

Në pamundësi të kapjes së këtij trimi, qeveria turke vuri në ndjekje të Shemos reparte të rregullta ushtarake (nizamët). Me ta u organizuan me dhjetëra ekspedita ndëshkimore në zonat ku qarkullonte ky trim me shokët e tij, që në kohë lufte ktheheshin me qindra.

Gjatë kësaj kohe Shemo Kasua vepronte me forca të shumta në rrethin e Janinës. Ai u kishte futur tmerrin nizamëve të Hysni pashës. Sipas folklorit:

«*Në malet mbi Veleshicë,
Lule more Shemo, lule,
Shemo 'Brahimi, o lule.
Hodhi mali bor' e shinë,
Nizamët mezi u gdhinë,
Pall' e Shemos vetëtimë,
Pall' e Shemos me gjatanë,
Turqit i zuri të gjallë. ...*»

Nëpër shtigjet e rrugëve malore shumë herë gjendenë koka të prera të bashnizamëve osmanë, të ekspozuara nga vetë Shemo Kasua në përgjigje të angazhimit që ki-

shin marrë këta komandantë mburravecë para valiut se do të ishin ata të parët që do të sillnin në Janinë kokën e prerë të Shemos, pér të fituar shumën e madhe të floririt, që me aq bujë ishte shpallur nga qeveria turke. Këta bashnizamë, që me aq zell ishin vënë në ndjekje pér kapjen e trimit, Shemua i tërhiqte në brendësi të maleve dhe atje kokat e tyre përfundonin nën presën e jataganit të këtij trimi, duke lënë me gojë hapët dhe vetë vezirin:

«... Kur futeshe në tabuâr,
Dilje me kokë në duâr,
Thosh veziri: kush i muar?
— Ai trim që s'ka sinuar...»

Shemo Hajduti i qëndroi me këllëç në hundë dhe vetë Hysni pashës, që ishte vënë në krye të taboreve osmane pér kapjen e tij:

«... Në malet mbi Samarinë,
Lufton Shemua me Hysninë,
Primë Hysni pasha, primë,
Të shoç Shemo mjekërzinë,
Se si di ta los cfungjinë...»

Me gjithë epërsinë numerike në njerëz dhe në armatime të pushtuesit, ky kordhëtar vazhdimisht delte fitimtar. Ai nuk rrëzohej, mbasi mbështetej në popullin fukara të vilajetit. Ata e donin dhe e mbronin, dhe e ndanin së bashku bukën me të. Me dhjetëra vargje ledhatonjëse i ka gërshetuar populli këtij trimi:

«... Shemo s'ma priste fiqiri,
Se do ishe kaq i miri...»

Dhe me të vërtetë Shemua pér vegjelinë ishte i mirë, mbasi ishte shok i pandarë në fatkeqësi me të.

Vjetët kalonin, por çeta e këtij kordhëtari sa vinte e shtohej. Zbatimi me forcë i rekrutimit të detyrueshëm shumëvjeçar turk nga sultani Azisi i kishte zgjeruar

radhët e luftëtarëve të këtij trimi. Çeta të tjera hajdutësh qarkullonin në vilajet. Aktiviteti i tyre ishte shtrirë jo vetëm në tokë, por edhe në det.

Këngët popullore pasqyrojnë gjithashtu aksionet në det «të byrazerit» të Shemos, të Bejo Dukës nga Gusmari i Kurveleshit. Ja si ua shpërndante florinjtë e rrëmbyera ky trim bashkëfshatarëve të tij të varfër:

«...Ç'e pru Progonat Hysninë,
Kërkon Bejo Dukë trimë,
Në det e rropi gjeminë,
Me grusht e ndau florinë...»

Kanë qënë pikërisht këto lëvizje hajdutësh që e mbannin vazhdimisht në tension Stambollin midis kryengritjeve të mëdha të asaj kohe. Këto lëvizje kaçakësh e tronditnin orë e çast rendin e brendshëm, të administratës osmane. Nëpunësit turq rronin çdo ditë me «qefin në krahë».

Të shumta kanë qënë ekspeditat ndëshkimore osmane, që e përshkuan anembanë vendin tonë. Ata kudo linin mbas tyre lotë dhe shkatërrime në ekonomitë e fshatarësise shqiptare. Megjithatë lëvizja e kaçakëve nuk mposhtej. Ajo qëndronte në këmbë.

Në këto rrethana, valiu i Janinës u hodh në fushën e intrigave. Me anën e agjenturës së tij ai arriti ta fusi në grindje Shemon me shokun e tij të ngushtë, Muhedin Vasjarin. Gjendja u acarua shumë. Muhedini u vu në ndjekje të Shemos. Ky i fundit e lajmëroi të mos e ndiqte dhe si shenjë pajtimi i vuri në një çezmë bukë dhe kripë, që t'i kujtonte luftëtarit të Vasjarit miqësinë dhe bukën që kishin ngrënë bashkë, por Muhedini e vazhdoi ndjekjen; atëhere Shemua e zëvendësoi bukën dhe kripën me një fishek dyfeku, por ish-«byrazer» i Shemos nuk u tërroq. Më në fund Shemua me zemër të thyer e vrasë vëllamin e tij, Muhedin Vasjarin, që aq shumë e donte.

Qartë e pasqyron folklori:

«... Që kur vrava Muhedinë,
S'më vate dyfeku mirë,
Më theu plumbi kërcinë...»

Me gjithë intrigat dhe terrorin turk, Shemua e vazhdoi edhe më egër luftën kundër pushtuesit.

Ky bir i vegjëlisë gjirokastrite mundi të bjerë në dorë të Hysni pashës vetëm me anën e tradhtisë. Shemo hajduti u kap tradhtisht i plagosur në këto rrethana: xhaxhai i Muhedinit, i zemëruar nga vrasja e të nipit, u bashkua me forcat ndjekëse osmane. Ai ra në gjurmët e Shemos dhe e ftoi për bashkëbisedim duke i premtuar besën. Shemua u bind dhe shkoi të shfajësoshev tek xhaxhai i Muhedinit. Vendi i takimit u caktua në afërsi të maleve të Grebenesë. Por atje sejmenët e fshehur të valiut të Janinës iu hodhën përsipër kordhëtarit të plagosur. Shemua edhe pse ishte me këmbë të thyer u rezistoi armiqve dhe mundi të bjerë në dorë (gjatë vitit 1875) vetëm mbas plagëve të tjera që mori nëpër ije, tradhtisht, mbas shpine:

«... *Jataganë pas ja ngjinë,*
C'e *plagosën derëzinë...*»

Në Janinë kapja e tij u kthye në festë nga autoritetet turke. Valiu i Janinës, Hysni pasha e përshëndeti këtë fitore me njëzet e një të shtëna artilerie.

«*Moj Gjirokastër me vulë,*
Me mënde me halle shumë,
C'e bëre Shemo hajdunë?
— *Lidhur në Janin' e shpunë,*
Njëzet e një topa shtunë...»

Këto këngë të hershme populllore flasin qartë për qendrimin heroik të Shemo trimit përpara valiut të egër të Janinës, Hysni pashës.

Ky bir i vegjëlisë gjirokastrite qendroi sypatrembur para sundimtarit të egër osman:

«... *Dhe pashai u ngrit në gjunjë!*
— *O Shemo na trego mirë,*
Ku ke ngrën' e ku ke pirë?

— *Pasha do të them një punë,
S'më vjen keq sepse më zunë,
Se bëra si desha unë
Tridhjet vjet hajdut me vulë. . . »*

Janë karakteristike në këto këngë shprehjet plot at-dheshuri të bashkëshortes së Shemos, të Lules, e cila kërkoi të hedhë pallën mbi supe dhe të ecë në gjurmët e burrit të saj, për t'i dalë zot popullit fukara. Sipas folklorit, nga qelitë e errëta të burgut famëkeq të Janinës Shemo luftëtar pyet për gruan e tij:

« — *C'hotë Lulia për mua?
Lule Shemo palla lule,
Shemo Brahimi, o lule.
— Unë burrë tjetër s'dua,
Do gjezdis krua më krua,
Sa të gjej gjurmët e tua. . . »*

Ky kordhëtar edhe para trekëmbëshit qëndroi i paepur. Sipas gojëdhënës amaneti i fundit i Shemos ishte që së bashku me të, të varnin dhe jataganin e tij, që kur të frynte era t'ja dëgjonin armiqëtë vrangëllimën edhe mbas vdekjes së tij.

Gjirokastra e shumëvuajtur, vendlindja e Shemos, e vajtoi së largu birin e saj. Ja ç'vargje të mrekullueshme thurën në vajtimet e tyre nënët gjirokastrite:

«*Në Dullgë u vu sallaja,
Vdiq Shemo ogiq sërmaja,
Vdiqe more Shemo, vdiqe,
O namustërqar' i mique. . . »*

Thuhet se edhe për këtë kordhëtar, për një kohë të caktuar në të gjithë krahinën, si shenjë zie u prenë lejletë kafshëve dhe ua hoqën kumborët e zilet bagëtive, që të mos oshëtijnë grykat e gërxhet e këtyre vendeve të varfëra malore, që aq shumë e mbrojtën.

* * *

Të shumtë kanë qenë kaçakë të tillë në atë kohë, por të gjithë nuk mund të përshkruhen dot.

Vetëkuptohet se këto lëvizje kaçakësh, që aq shumë e kanë mbajtur në tension pushtuesin osman nuk kanë pasur pikësynim të qartë politik. Ato kanë qenë të paorganizuara dhe të palidhura me lëvizjet e kaçakëve të krahinave të tjera. Këto kanë patur karakter spontan, gjë që lehtësonte likuidimin e tyre nga feudalët e vendit të përkrahur pa rezervë nga pushtuesi.

Megjithatë edhe pse trimat si Birbil Shakua dhe Sheimo Kasua me shokë zhdukeshin, kjo lëvizje vazhdonte me prijës të tjerë, sepse vazhdonte të ekzistonte shfrytëzimi feudal, shtypja osmane. Arbitrariteti, taksat, rekrutimi i detyrueshëm shumëvjeçar ushtarak, vazhdonin të shkatërronin më tej forcat e gjalla prodhuese të vendit.

**BIJTË E SHQIPÉRISË VAZHDUAN LUFTËN E TYRE
PËR MBROJTJEN E TËRËSISË TOKËSORE
NË JUGË TË ATDHEUT**

«Shqipëri, o shkëmb e gurë,
Këshfu ke qënë qëkurë,
Vrite prite për flamurë,
Bota hiq e tinë vurë...»

Populli

Gjatë vitit 1877 Harillas Trikupi, ministër i Jashtëm i Greqisë e përfaqësues i tërbuar i reaksionit grek, ka ndjekur një politikë thellësisht shoviniste kundër vendit tonë.

Nën maskën e aleatit të popullit shqiptar për luftë kundër Turqisë në muajin korrik të vitit 1877 ai dërgoi fshehumëzurën në Janinë misionarin e tij Mavromatin për të hyrë në marrëveshje me përfaqësuesin e patriotëve shqiptarë, Abdyl Frashërin, për bashkimin e Shqipërisë me mbretërinë greke dhe për heqjen dorë të shqiptarëve nga Epiri (Shqipëria e Jugut), mbasi, sipas tyre, kjo tokë ishte greke.

Sipas dy raporteve sekrete më datë 15 dhe 19 korrik 1877, të shpallura në Athinë në revistën vjetore «Neos kuvaras» në vitin 1962, Mavromati i raporton padronit të tij, Harillas Trikupit:

«Marrëveshjet tona me përfaqësuesin e shqiptarëve janë ndërprerë, meqenëse Abdyl Frashëri ngul këmbë për sovranitetin shqiptar dhe nuk pranon që Epiri t'i jepet mbretërisë greke, pasi është tokë autoktone shqiptare.

Më poshtë misionari Mavromatis, në vazhdim të raportit të dytë shton:

«Është e nevojshme të zgjerohen dhe veprimet e llojit tjetër (I parashtrojmë në mënyrë përbledhëse — M.K.):

1) Të zbarkojmë një repart ushtarak në Himarë në qoftë se negociatat tonë do të dështojnë. Dalja e ushtrisë sonë në Himarë do të shkaktojë në Epir konfuzion dhe tronuditje, duke bërë që batalionet e rregullta të ushtrisë turke të përbëra krejt prej shqiptarëve që ndodhen në Epir, do të dezertojnë për të kaluar drejt veriut (në drejtim të Himarës) për të mbrojtur vratat e tyre dhe duke u shpërndarë shqiptarët në drejtim të veriut, Epiri do të mbetet i lirë, pa shqiptarë të armatosur dhe si pasojë ne atëhere do t'i kemi duart të lira për të vepruar në Epir (në Shqipërinë e Jugut) dhe do t'u heqim frikën që kanë njerëzit tanë në Epir (me fjalë të tjera njerëzit e agjenturës së tyre — M. K.). 2) Të komprometohen kuadrot luftarakë shqiptare, duke i ekspozuar para organeve qeveritare turke, në mënyrë që të fillojë persekutimi turk kundër tyre... Këtu në Janinë përpinqem me të këtushmit (me agjentë të tjerë grekë — M.K.) të ngjallim dyshimin e valiut kundër Muslim Gjolekës¹⁾ dhe siç po më sigurojnë, tani është vendosur nga valiu transferimi i Gjolekës nga Himara në Radovinë të Thesalisë, por u shty për shkak të

1) Një nga kuadrot luftarakë shqiptare të asaj kohe ka qenë dhe Muslim Gjoleka, i biri i udhëheqësit të madh të kryengritjes fshatare, Zenel Gjolekës. Ky atdhetar, megjithë synimet shoviniste të qarqeve sunduese greke, qe një ndër ata që u përpoqën krahas Abdyl Frashërit për t'i siguruar popullit tonë aleat në luf-tën kundër pushtuesit osman. Ata u munduan të shfrytëzonin dhe bisedimet me misionarët e qeverisë greke në Janinë e Korfuz si me Mavromatin, deputetin Petmezas, M. Llapas, Aravantinoin, kolonelin Plasa, Panajot Kërpica (Qilica) etj. Kur u pa se qëllimi i këtyre bisedimeve ishte bashkimi i Shqipërisë me mbretërinë greke dhe për njohjen e Shqipërisë së Jugut si tokë autoktone greke, përfqaqësuesit e shqiptarëve Abdyl Frashëri dhe Muslim Gjoleka u tërhoqën menjëherë.

pushimit të valiut të këtushëm. Shtojmë se këtu duhet shumë mjeshtëri që të mos preket sedra e shqiptarëve...»

Në këtë raport misionari Mavromatis i shfaq keqardhjen Harillas Trikupit që të krishterët e Shqipërisë së Jugut nuk pranuan kërkesën greke pér të luftuar kundër atdheut të tyre, Shqipërisë dhe pér këtë qendrim të drejtë të shqiptarëve, ky misionar nuk lë fyerje pa u drejtar patriotëve shqiptarë, që nuk deshën të bëhen vegël e shovinizmit grek.

Qeveria greke në atë kohë, pér të bërë me vete (si aleate të saj) krahinën e Himarës, përveç misionarëve të saj, dërgoi në Himarë fshehurazi dhe renegatin shqiptar Jorgji Stefanin nga Qeparoi, të birin e Stefan Çalit. Jorgji pasi erdhi në Himarë, kërkoi takim me kapedanin e Bregdetit Sokrat Lekën nga Qeparoi, i cili gjëzonte autoritet në gjithë krahinën e Himarës. Takimi i tyre u bë në vendin e quajtur «Lëmënjerë», në fushë të Qeparoit. Ka qenë ditë gushti e vitit 1877. Jorgji Stefani i parashtroi planin grek pér të zbarkuar në Skalomë, në buzë të detit të Qeparoit. Kapedan Sokrati, pasi e dëgjoi deri në fund, iu përgjigj: «Hasm familjar të kam, por turpin nuk ta dua, sepse jemi nga një vend. Kjo udhë që ke nisur nuk të del mbarë. Kështu nuk i shërben vatanit, por shejtmanit. Ty të kanë gënjerë ata që të kanë dërguar. Po u matët të zbrisni në Skalomë, ta dish mirë se do të vejë gjaku gjer në gju. Sa jemi ne gjallë këmbë greku nuk shkel në bregdet. Ti nxive faqen tënde, kérkon të nxish dhe timen. Këtë faqe që kur ma bëri Zaharua (e éma) e deri sot kurrë nuk e kam zhyer». Sa tha këto fjalë, kapedan Sokrati u ngrit në këmbë, zbathi shollët (opingat) dhe i shkundi duke thënë: «Asnjë thërrime pluhur mos më mbettë nga ky vend i mallkuar ku u bënë fjalë të tillë» dhe u largua pa i dhënë as pëershëndetjen e zakonshme.

Qeveria shoviniste e Athinës, e përkrahur nga Fuqitë e Mëdha imperialiste si Rusia cariste, Franca etj. kishte kohë që orvatej të zgjeronte kufijtë e saj në kurriz të tokave shqiptare.

Situata e Shqipërisë ishte shumë kritike. Jemi në pragun e Kongresit të Berlinit. Qeveria greke kërkonte sa

më parë t'i fuste brenda kufijve të saj krahinat jugore të atdheut tonë, për t'i ligjëruar më vonë në këtë Kongres famëkeq, që aq shumë padrejtësira i solli popullit tonë, duke arritur edhe në mohimin e ekzistencës së kombit tonë. Patriotët tanë dhe mbarë populli u ngritën në këmbë, sepse në plan të parë ishin shqiptarët të interesuar për mbrojtjen e tokave të tyre.

Në qoftë se Stambolli humbiste një pjesë të krahinave të tij perandorake, populli ynë humbiste atdheun.

Në janar të vitit 1878 ministri i Jashtëm i Greqisë Harillas Trikupi u bë kryeministër. Ai, me të marrë fuqinë në dorë, vuri menjëherë në zbatim propozimin e agjentit Mavromat.

Dhe me të vërtetë, një mëngjes herët të datës 12 shkurt 1878 në jug të viseve të atdheut tonë, thellë nga deti u dëgjuan të shtëna artilerie në drejtim të bregdetit. Kudo u përhap fjala se greku doli në Sarandë dhe mori drejtimin nga Lëkurësi.

Qeveria shoviniste e Athinës, mbasi nuk mundi t'i bënte me vete bijtë e Himarës e ndërrroi vendzbarkimin nga Himara në Lëkurës (vend në afërsi të Sarandës) për të patur afër bazën e saj ushtarake, Korfuzin.

Nga këngët popullore që u ngritën për luftën e Lëkurësit mësojmë se:

«... Që në Sarand' e Kastri,
Vjen vapor i zeherli,
Nëpër det si mal' i zi,
Një vapor me tre gjemi...
Përdridhet si gjarpëri,
Vështron vendin me dylbi,
Ku bie Lëkurësi...»

Me plot të drejtë bijtë e Shqipërisë s'përbaheshin nga urrejtja për ardhjen e këtij «komshiu të paftuar».

«... Ç'kérkon Jorgua i Greqisë,
Në sinor të Shqipërisë?
Shqipe zez' si korbi pisë,
Do ta bëj që të noisë...»

Me fjalë të tjera shqiptarët do ta bënин që të pendohej Jorgen, këtë mbret grabitqar që kërkonte të shkelte sinorët (kufijtë) e Shqipërisë.

Zbarkimi i ushtrisë shoviniste greke në Bregdetin shqiptar tronditi gjithë vendin¹⁾. Në këtë kohë bijtë e thjeshtë të Shqipërisë, bujqit dhe barinjtë e këtyre krahinave, lëshuan kushtrimin anembanë vendit.

Të shumtë ishin luftëtarët shqiptarë që zbritën në fushën e luftës si Idriz Alidhima, Rakip Gjoça nga Zhulati, Bako Çarçani nga Fushë-Bardha, Islam Fterra, Rakip Dervina, Iliaz Tatzati, Myslim Zenel Gjoleka. Secili prej tyre kishte sjellë me vete me dhjetëra e qindra vullnetarë.

Edhe i moshuari, 78 vjeçari Çelo Picari u ngrit në këmbë dhe i hodhi në luftë të tre bijtë e tij: Rustemin, Iljazin dhe Shahinin të pasuar nga picariotë, golemas dhe kardhiqotë të shumtë.

Para këtij rreziku vetëm nga fshati Zhulat dolën tri çeta. Nga krahina e Himarës u nisën për në luftë bregdetasit të udhëhequr nga Odhise Kasneci (Nesturi) nga Vunoj dhe Sokrat Qirjaqi nga Çorrash i Kurveleshit.

Agjentura greke nuk mundi t'i përcnjë dot shqiptarët nga njëri-tjetri. Më kot u mundua në Janinë në korrik 1877 misionari grek Mavromatis dhe renegati Jorgji Stefanë të fusë grindje midis shqiptarëve. Edhe sot ruhet kënga e bukur labe:

«Doli greku në Sarëndë,
Kush është djalë në këmbë,
Të hidhet të zërë vëndë...»

Me këto këngë patriotike në gojë zbritën të vëllazëruar çobenjtë e Labërisë nga majat e maleve, në vitin 1878. Bujqit lanë mënjanë parmandat dhe me martinat e lidhura me gjalmë iu ngjitën brigjeve të Lëkurësit e të Berdeneshit, ku ishin përqendruar forcat kryesore greke.

1) Revista «Kalendar kombiar». Tiranë, 1928, vëll. 22, fq. 50.

Luftëtarët e Zhulatit dhe të Kalasës të udhëhequr nga sypatremburi Idriz Alidhima me shokë ishin të parët që i zembrapsën forcat greke nga Qafa e Gjashtës. Bandat greke u orvatën shumë herë ta hidhnin në dorë këtë vend strategjik. Në këto luftime, njerëzit e renegatit Ziso Stavros nga Dhivra ranë pothuaj të gjithë robër në duar të shqiptarëve që në përpjekjet e para.

Asgjë nuk i tundi këta trima nga istikami i parë i luftës që zunë. Ata më një vetëmohim të rrallë i mbajtën me dhëmbë pozicionet e tyre.

Ushtria e rregullt greke e udhëhequr nga komandanti i tyre Tritaqis, i përsëriti sulmet e saj për të pushtuar Qafën e Gjashtës, por barinjtë e Zhulatit edhe pse ishin armatosur keq, përsëri rezistuan dhe nuk u dhanë asnje pëllëmbë tokë shovinistëve grekë, që u ndihmuani edhe nga artileria detare e tyre.

E paharruar do të mbetet në historinë tonë trimëria e këtyre bijve të thjeshtë të popullit që u ndodhën rastësisht me bagëtitë e tyre në këtë zonë bregdetare. Asnjë nuk lëvizi nga vendi, thotë populli, edhe pse rënkonte deti dhe dridhej mali nga gjylet e shumta të artilerisë detare greke. Gojëdhëna popullore tregon se vetë udhëheqësi i tyre i paepur Idriz Alidhima, pa e peshuar fare veten, ngrihej në këmbë dhe u bërtiste plot urrejtje shovinistëve grekë, që kërkonin t'i robëronin vatanë. Rapsodi popullor e ka përjetësuar në vargjet e tij patriotizmin e këtyre bijve të thjeshtë të popullit. Ja me çfarë gjuhe të prerë i drejtohen luftëtarët shqiptarë mbretit grabitqar të Greqisë, Jorgos:

«Jorgo, dhëndër i Rusisë,
S'ke par' djemt' e Shqipërisë,
Kuqur' e bërë si bishë,
Të vënë majë cfungjisë...»

Sipas këngës, luftëtarët shqiptarë kur plagosën nuk kanë fasho të lidhin plagët, por me atë copë këmishë të

grisur që u ndodhet, fshijnë gjakun e tyre të pastër, duke ua fshehur shokëve plagët e marra.

«... Kur marrin plumbat në sisë,
Fshinë gjakun me këmishë,
I thonë shokut: «Një çikë»,
Pa opinga nën këmbë,
I presin plumbat me dhëmbë...»

Qeveria shoviniste greke përveç ushtrisë së saj të rregulltë, zbarkoi në bregdetin shqiptar dhe mjaft njerëz të degjeneruar, aventurierë të çdo kallëpi, grekë, italianë e shqiptarë, si konti Kontrubio di Milano,¹⁾ Jorgji Stefani, Vangjel Kucoi etj. Por luftëtarët shqiptarë i kthyen në kërma këto banda shumëngjyrëshe të vëna në shërbim të shovinizmit grek.

«Gryk' e Korfuzit gjëmoi,
Thonë vjen Vangjel Kucoi,
Mirë vjen! po ku do shkojë??!!

Lufta plasi edhe nga ana e Ksamiles. Atje luftuan trimat e Kuçit të udhëhequr nga Myslim Gjoleka. Bandat greke u përhapën deri në Kara-Alibejas. Idriz Alidhima me shokë i ngriti në këmbë gjithë fshatrat e Rrëzomës si Kalasën, Tatzatin, Vergon, Kopaçen, Palavlin etj. E gjithë popullsia u mobilizua për pastrimin e vendit nga bandat greke. Të shumtë qenë dhe trimat që dolën nga këto fshatra si Fejzo Muhameti e Islam Hadëri nga Palavlia, Iljaz Tatzati etj. Këta dy të fundit u vranë në këto luftime.

Thuhet se edhe pleqtë morën pjesë për shfarosjen e bandave shoviniste të Athinës. Qartë e pasqyron folklori:

«Pleqtë tanë me romuze,
Me silah e me çibuqe,
Dyfekun me dyzet strufe,
Mustaqet supe më supe,
U hodhën përtej në lugje,
Topi bam dhe ata tutje...»

1) Arturo Galanti. «L'Albania». Romë, 1901, fq. 231.

Bandat shoviniste greke në asnjë vend nuk i mbajtën këmbët. Bukur i ka përshkruar Andon Zako Çajupi në veprën e tij «Baba Tomorri» çobanët e Labërisë të ndodhur në Fushë-Vërri etj., që aq shpejt i zëvendësuan kërrabat me pushkë dhe u dhanë dërmën shovinistëve të Athinës:

«... Për këtë gjë nga Vërria,
U derdhën çobanëria,
Nga qdo an' që u zu dyfeku,
Po si dhia iku greku...»

Gojëdhëna popullore shpjegon se mbarë krahina e Gjirokastrës ishte kthyer në gjendje lufte. Kudo, nëpër kuvendet e lagjeve dhe fshatrave, u dha kushtimi i lutfës popullore për të mos lënë këmbë shovinisti grek në vratat shqiptare. Sipas popullit thuhet se Mali i Gjérë dhe Qafa e Sopotit u nxi nga gjongulitë (vullnetarët) e shumtë gjirokastritë, që edhe pse të armatosur keq, shkonin drejt Sarandës për të ndjekur pushtuesin grek.

Nga luftëtarët e Gjirokastrës, që u dalluan më shumë në këto luftime bregdetare ishin dhe bijtë e këtij qyteti të lashtë si Asim Sinani, Ferhat Toska, Isuf (Çufe) Gjarpëri, Damo Lengo etj. Sipas këngëve të hershme popullore:

«Qaj kalaja mbi Sarëndë,
Morait të kanë zënë,
Të kanë rrethuar vëndë,
Mbushur vëndi me llagëmë, ...
Ferhat Toska me Asimë,
Sipër në kala ç'u ngjinë...»

Luftëtarët e Delvinës me në krye sypatremburin Rakip Demon, mbasi u vëllazëruan me forcat e Idriz Alidhimës në Gjinaj, u dolën të parët fuqive shoviniste greke që kishin zënë Qafën e Gjashtës:

«Kush u hodh në Gjasht'i pari,
Rakip Demo Bajraktari...»

Bijtë e popullit shqiptar të këtyre krahanave jugore
të atdheut, i ndoqën këmba-këmbës forcat greke derisa
i hodhën në det.

É madhe është urrejtja e këtyre luftëtarëve për agresorët
grekë, që kërkuan me forcë të ngrënë flamurin e
tyre në tokën shqiptare:

«*Bandier e bardhë me lule,
Shkule Jorgo derri, shkule,
Shkule Jorgo se t' arrinë,
Vlorasit me korçallinë,
Ndihmë kanë Argjirinë...»*

Vetë historiografët grekë shpjegon se shqiptarët
nuk e përfillin fare vdekjen. Ata pa u ruajtur dilnin
haptas në ballë të luftës¹⁾. Në këto luftime ranë në duar
të shqiptarëve mjaft robër dhe plaçkë luftë:

«... *Përpjetë kalas' q'iu ngjinë,
Zunë skllevër disa mijë,
Disa mijë skllevër zunë,
Kal' i bardhë sa një kullë...»*

E bukur është satira popullore, që i kundërvihet mbretit
të Greqisë, Jorgos së bashku me gruan e tij Ollgën,
të bijën e carit rus, që mundohesh t'u jepte zemër ushtarëve,
duke i dehur me konjak:

«... *Bën dyfek mbreti Moresë,
Ollga nga frika do vdesë,
— C'e kujton Jorgo lanenë,
Mori në qafë milenë,
U dha konjak e u dehnë,
Shapkatë në vënd u mbenë...»*

Dhe, me të vërtetë shapkat (këpucët) ushtarëve shovinistë
grekë u mbenë në truallin e Shqipërisë, bile dhe

1) Revista «O Neos kuvaras». Cit, fq. 223.

kokat e tyre, ndërsa një pjesë e vogël që shpëtoi e la vrapin në Korfuz.

Vlen të përmendet në këto luftime të pabarabarta vetëmohimi i bijve të Progonatit si i Asim Zhupës dhe i Bejo Ganës me shokë, që pa pyetur për forcat e shumta shoviniste greke, u futën midis tyre e çanë rrëthimin, për të shpëtuar shokët e tyre të rrëthuar në Kara-Alibejas. Qartë e pasqyron folklori rënien e këtyre trimave të Labërisë në këto luftime:

«... *U vran' dy djem kapetanë,*
Asim Zhup' e Bajo Ganë,
Se ç'i qan nëna në shkallë...»

Nga fshatrat që u sakrifikuan më shumë në këto luftime figuron në radhë të parë Zhulati. Vetëm nga ky fshat ranë në fushën e nderit dyzet e gjashtë luftëtarë:

«... *Të xhumanë që me natë,*
Vjen një ulurim' e thatë,
Thanë u vranë zhulatë,
Dyzet e gjashtë mandatë...»

Së bashku me këta trima ra në këto luftime edhe luftëtarë i paepur i Labërisë Idriz Alidhima nga Zhulati. Ky bir i thjeshtë i vegjëlisë labe i udhëhoqi forcat e Zhulatit në fushën e luftës për të mbrojtur tokën e shenjtë të atdheut. Mbarë krahina, të afërmit e Idrizit dhe motra e tij Gjylsimi, sipas zakonit të trimave, nuk e vajtuan këtë luftëtar patriot, por e përjetësuan në këngë.

Edhe pse kaloi afro një shekull, këto këngë trimërie e ruajnë akoma freskinë dhe aktualitetin deri në ditët tona. Ja njëra prej tyre:

«... *Do të them një këngë vetë,*
Këngë trimi le të jetë.
Në Gjashtë u vranë zhuletë,
Idrizi një trim me fletë,»

*Idriz palla vetëtima,
Iu qep bregut me mëlqinja,
Atje ku lufton martina,
Vjen plumbi si bubuzhima...»*

Pikësynimet e kryeministrit grek Harillas Trikupit, nuk u realizuan. Kjo luftë përfundoi me fitoren e plotë të luftëtarëve shqiptarë.



Idriz Alidhima

LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR HYN NË NJË RRUGË TË RE, TË ORGANIZUAR. LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT.

(10 qershor 1878)

«Shqipëri moj famëmadhe,
Nga gryk' e pushkës u ngjalle»

Populli

Lufta e popullit shqiptar gjatë vitit 1878 hyri në një rrugë të re, më të organizuar. Filluan të lindin gjerësish shkëndijat e lëvizjes kombëtare.

Më 10 qershor 1878 patriotët shqiptarë, nën udhëheqjen e patriotit të madh Abdyl Frashërit themeluan në qytetin e Prizrenit Lidhjen e fuqishme politiko-ushtarakë Shqiptare.

Kjo «Lidhje» ishte një organizatë masive e popullit shqiptar me karakter kombëtar, që luftonte për liri, integritet tokësor dhe për pavarësi të plotë të atdheut.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u luftua si nga Fuqitë e Mëdha evropiane, ashtu dhe nga Turqia që përkrahej pa rezerva nga feudalët turkomanë të vendit. Si pasojë kjo organizatë masive politiko-ushtarake shqiptare duhej të luftonte në dy fronte kryesore: kundër Perandorisë Osmane dhe politikës së saj mashtruese dhe kundër synimeve grabitqare të fqinjëve shovinistë, që përkraheshin haptas nga shtetet e mëdha imperialiste evropiane.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte një protestë e fu-

qishme e popullit shqiptar kundër vendimeve grabitqare të marra në Kongresin famëkeq të Berlinit, ku shtetet e mëdha kapitaliste mohuan gjithçka që ishte shqiptarë: kombin, gjuhën, historinë, ndërsa fjalën «Shqipëri» e konsideruan vetëm një shprehje të thjeshtë gjeografike.

Sipas këtyre shteteve të mëdha imperialiste evropiane, trualli i popullit shqiptar, i këtij kombi me rrënje të lashta etnike, që nuk ishte shkrirë gjatë shekujve në etnitë e mëdha historike bizantino-greke, sllave, turke e në kulturat e tyre tanë do të copëtohet si një entitet amorf, si një mbeturinë e historisë, trojet e tij do të ndaheshin si një «tokë e kurkujt» dhe do të shërbenin si lëndë ndërtimi për të fuqizuar shtetet e reja fqinje ballkanike, por me luftën e Lidhjes, populli shqiptar i hodhi frontit të bashkuar të forcave të reaksionit një sfidë të pashe-mbullt.

Programi i Lidhjes nuk mbeti i thatë në letër. Ai me t'u hartuar u vu në jetë në llogoret e luftës për mbrojtjen e trojeve të atdheut, konkretisht, në Plavë e Guci, në Hot e Grudë, në Ulqin e në Jug. Lufta e Popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të viteve 1878-1881 çau rrugë të reja në historinë tonë kombëtare. Ajo qëndron si një bllok masiv në themelët e jetës së re të kombit shqiptar.

Lidhja dhe lufta e masave popullore që ajo udhëhoqi përbëjnë një nga ato ngjarje, për të cilën mund të thuhej, se pa të rrjedha e historisë mund të kishte qenë detyruar të merrte tjetër rrugë, të çbënte çka kishin ndërtuar vitet e shekujt.

Pak ishin në numër vitet kur veproi Lidhja, por çfarë vitesh! Çfarë ngjarjesh të ngjeshura e të stuhihme i mbushin ato! Si në çdo moment historik, kur në arenë hyjnë masat popullore, të pajisura me një program që e kanë bërë vetë si mishërim të aspiratave të tyre jetësore, në këto vite ecuria historike bëri hope të vrullshme, arriti shkallë pjekurie politike, që do të ishin të pamendueshme për vite të një zhvillimi normal. Me energji revolucionare të pashteruara, me një patriotizëm të pastër masat popullore shqiptare si kurdoherë që janë në rrezik

interesat e tyre jetësore, gjetën në veten e vet forcat morale e materiale, nxorën nga gjiri i vet forcat udhëheqëse dhe, sypatrembur e zemërhekur, u ngritën në luftë, pa mbështetje politike nga jashtë, por me vëtbesim të patundur në forcat e veta.¹⁾

Ja disa nga vendimet që u morën në këtë kuvend të madh të shqiptarëve: «... Qëllimi i Kuvendit është që t'ua presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që t'i mbrojmë me gjak trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë... Qëllimi i shqiptarëve është të mos u japim asnje pëllëmbë tokë nga Shqipëria bullgarëve, serbëve, malazezëve e grekëve dhe të formojmë një vilajet të Shqipërisë me administratë të unifikuar. Lidhja e jonë u formua me qëllim... që të veprojë aktivisht me të gjitha mjetet për të mbrojtur tërësinë e vendit.»

Krahas detyrës për të shpëtuar atdheun nga copëtimi territorial Lidhja Shqiptare filloi të mënjanonte pushtetin osman dhe të ngrinte pushtetin shqiptar. Ajo mëkëmbi ushtrinë, administratën, gjyqet dhe financat e veta. Me këto funksione qeverisëse, Lidhja Shqiptare filloi të realizonte me rrugë revolucionare autonominë e Shqipërisë.

Të panumërtë janë mashtrimet e Portës së Lartë për të mbytur shpirtin liridashës të shqiptarit. Stambolli kërkonte ta kthente Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në një shtojcë të politikës osmane në Shqipëri. Me qindra e mijëra patriotë shqiptarë mbushën burgjet plot lagështi të Shkodrës, Manastirit, të Janinës dhe ato të Tërsanës në Stamboll, për të vetmen arsy se ata domin të rronin të lirë, pa pushtues në atdheun e tyre.

Perandoria e kalbur Osmane, edhe pse kishte marrë tatëpjetën, mundohej akoma ta mbante të shtrënguar në kthetrat e saja të përgjakura popullin tonë të talentuar, trim dhe atdhedashës.

1) Për hollësi: Prof. Aleks Buda «Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjet e saj historike» (Referat). Mbahtur në konferencën kombëtare të studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Tiranë 12-14 qershor 1978.

Më 13 qershor 1878 u mblodh Kongresi grabitqar i Berlinit. Delegacioni turk ishte angazhuar para Fuqive të Mëdha evropiane se do t'i vinte në jetë vendimet e marra në këtë Kongres për copëtimin e tokave shqiptare midis shteteve fqinje shoviniste.

Këto pretendime grabitqare përkraheshin në veçanti nga imperializmi rusomadh, i cili i veshur me petkun e mbrojtësit të të krishterëve të Ballkanit tentonte të dilte në detin Mesdhe.

Në muajin shtator 1878 sulltani dërgoi në Shqipëri mareshalin Mehmet Ali pashai për të bindur shqiptaret t'i dorëzonin pa luftë Malit të Zi, Plavën dhe Gucinë.

Anëtarët e kryesisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në mbledhjet e tyre vendosën që kërkesës së pashait turk t'i përgjigjen me grykën e pushkës:

*«Pa u farue Shqipnia krejt,
Këtu nuk hyn as krajl as mbret.»*

Dhe më 6 shtator 1878 i deleguari i sulltanit Mehmet Ali pasha u vra në Gjakovë nga trimat e Shqipërisë: Col Delia dhe Islam Geghyseni (të dy nga Tropoja):

*«...Dhe me i pas kraht me fluturue,
Gjall' prej kulle s'e lam me shkue,
Gjall' prej kulle pashën s'e lamë,
S'e lam' pashën kurr' për të gjallë...
E tan Shqipnia asht betue,
Tokat shkjaut mos me ja lëshue,
Toka shkjaut mos me i lanë,
Pa e mbush varre anembanë.»*

Më 1 nëntor 1878 mblidhet kuvendi i Dibrës. Atje u morën këto vendime:

— Të gjitha viset e Shqipërisë të përmblidhen në një vilajet të vetëm.

— Të gjithë nëpunësit të dinë gjuhën shqipe.

— Të përhapet arsimi dhe në shkolla të mësohet gjuha shqipe.

— Kuvendi i përgjithshëm i vilajetit të zbatojë reforma të dobishme për kombin.

— Të caktohet një sasi e mjaftueshme e të ardhurave për nevojat e vendit.

Sipas një letre të datës 2 dhjetor 1878 të patriotit të madh Abdyl Frashëri drejtuar kryesisë së Lidhjes, thuhet se popullsia e viseve që ai vizitoi pas kuvendit të Dibrës, si në Elbasan, Berat, Vlorë, Delvinë, Prevezë dhe Janinë, e miratoi plotësisht kërkesën për autonominë e Shqipërisë.

Karakteristike është në këtë kohë hopi i madh cilësor i ndërgjegjes kombëtare nën ndikimin e Lidhjes Shqiptare. Sipas këngëve të hershme popullore që aq bukur e pasqyrojnë të vërtetë historike, zemërimi shqiptar i detyroi «Të shtatë krajlat të rahin telin», mirëpo bijtë e Shqipërisë nuk i besuan zërit të telit, por zërit të malherit. Për këtë gjë shqiptarët «Qingjat në mal vetëm i kanë lanë, nga pesë për shpi po shkojnë në luftë».

Në muajin tetor 1879 knjaz Nikolla dërgoi 12.000 ushtarë për pushtimin e Plavës dhe të Gucisë. Luftëtarët shqiptarë me në krye Ali pashë Gucinë dhe me trimin Haxhi Zeka u ngritën në këmbë:

*«Aferim, mori Shqipni,
T'bukur nam kam nie për ty,
Ke lidh' besë për m'u shkri,
Mos me l'shu Plav' e Guci.

Ali pasha i hypi atit,
Ngjeshi shpatën prej dukatit,
Ngjeshi shpatën e dul për Plavë,
Haxhi Zekës i çoi fjalë,
Haxhi Zekës fjal' i ka cue,
Sot ni javë kam me liftue,
Kam me ardh kam me qindrue,
Krajl' e mbretit kam me i distue,
Tokën e babës s'kam kurr' me è l'shue...»*

Në këto këngë popullore del haptas se barrën e luf-tës e kanë mbajtur njerëzit e thjeshtë, fukarenjtë, të zba-thurit.

Forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit përbënин një ushtri popullore, që komandohej nga udhëheqës populorë sikurse ishte dhe vetë komandanti i përgjithshëm i këtyre forcave Sulejman Vokshi, biri i një zejtari të thjeshtë kosovar. Ja si u përgjigjen këta trima plevianëve dhe gu-cianasve të rrrethuar nga ushtritë e shumta malazeze të komanduara nga Mark Milani, i cili me pushtimin e këtyre dy krahanave shqiptare do të vinte në jetë vendimet gra-bitqare të Kongresit të Berlinit:

«... Veç gjashtë dit' në mujshi me qindrue,
Fukaraja opingat sa me i arnue,
I madh dhe i vogël ç'atje don me dalë,
Don me dal' e don me liftue,
Plavn e Gucin, gjall' s'kena me ja lëshue...»

Kudo del qartë thellimi i ndërgjegjes kombëtare, karakteri populor i kësaj ushtrie dhe shpirti liridashës dhe vetëmohues i shqiptarit:

«... Po u folka Sulejmani,
Hije i paska kaparani,
— Na për Plavë rrugën kena marrë,
Se Marki sonde në kufi ka dalë,
I madh dhe i vogël te tan' jan' çue,
Të tan kah Plava kan' t'fillue...»

Forcat shoviniste malazeze u rrrethuan keqas në afërsi të lumbit Lim. Të shumtë ishin vojnikët (ushtarët) malazeze që u mbytën dhe u vranë në këtë betejë:

«Po hip Marki në Previ, *)
Shikon lumin me dylbi,

* Emër vendi — Qafa e Previsë.

— *C'a ky Lim ci dirgjet zi,
Haj medet, vojnikt' e mi,
C'a ky Lim ci dirgjet gjak,
Vojnikt' m' benë në balltak...»*

Në këtë gjendje të vështirë shtetet e mëdha evropiane vendosën që në vend të Plavës dhe të Gucisë, Malit të Zi t'i japid Hotin, Grudën, Kelmenden dhe Kastratin. Por përsëri këta armiq të mëdhenj të popujve i bënë llogaritë pa pyetur shqiptarët, të zotë e vërtetë të këtij trualli, të cilët ashtu si dhe në rastin e parë, ishin betuar me besa-besë që të mos lëshojnë asnjë pëllëmbë nga toka e Atdheut:

«*Hot' e Grudë ishin betue,
Pa gjak malet mos me lëshue...»*

Prapë Mizéri në vatrat tonë:

«*Shum' asqer po' qet pampori,
Të tan' po i qet ma zi se korbi...»*

Në afërsi të Rzhanicës trupat malazeze u thyen keq nga luftëtarët shqiptarë që ishin pajisur me armët primitive dhe me ato që u morën armiqve:

«*Krisi pushka, gjëmoj toka,
Sa me shpejt u mblohd ordia,
U çudit e gjith' Evropa,
C'trima paska Shqipnia»*

Armiqtë e tërbuar të Shqipërisë, duke filluar që nga shtetet e mëdha evropiane, Perandoria e madhe Turke si dhe shtetet fqinje shoviniste çuditeshin që një grusht luftëtarësh shqiptarë guxonin të kundërshtonin me armë vendimet e një kongresi evropian, ku në ato shprehej vullneti i gjithë shteteve më të mëdha kapitaliste të kohës,

që në duart e tyre përqëndronin ushtri të panumërtë, të pajisura në tokë dhe në det me armët më moderne të kohës.

Pjesëmarrësit e Kongresit famëkeq të Berlinit, duke parë se nuk mundën t'ua shkulnin nga duart shqiptarëve Hotin, Grudën, Kelmendin dhe Kastratin, vendosën përfundimisht ta zëvendësojnë me Ulqinin: për këtë qëllim forcat malazeze dhe turke do të ndihmoheshin nga anijet luftarake të shteteve të mëdha imperialiste evropiane. Të panumërtë janë heroizmat e popullit tonë për mbrojtjen e Ulqinit. Thuhet se nga çdo zgavër që shkaktonte artilleria detare armike nëpër muret e shtëpive të Ulqinit, dilnin kokat me festet e bardha dhe tytat e pushkëve të shqiptarëve, të cilët me klithmat e tyre luftarake u sokëllin armiqve:

*«Me ngadal moj cërnagore,
Ta qes sillën nér vapore...
Mark Milani bani be:
— Me ksi trimash kurr' s'jam pre,
Kurr' s'jam pre me k'si far' trimit,
Qysh në vakt t'Mujit e t'Halilit...»*

Sikurse e theksuan Lidhja Shqiptare e Prizrenit u kthye në një qeveri të përkohshme me në krye patriotët: Abdyl Frashëri, Omer Prizreni dhe me komandant të ushtrisë Sulejman Vokshin. Pushteti i kësaj qeverie u shtri në mbarë vendin: Në Prizren, Shkup, Prishtinë, Gjirokastër, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Dibër, Korçë, Tetovë, Gostivar, Kostur, Tropojë, Lumë, Guci, Vuçitern, Preshevë etj. Nëpunësit turq u zëvendësuan me anëtarë të Lidhjes. Qeveria e përkohshme shpalli më në fund se nga 'mbarimi i vitit 1881 do të organizonte një kuvend të madh, ku do të merrnin pjesë delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë.

Nga fundi i muajit mars 1881 Stambolli futi nga krahu i Shkupit 20.000 ushtarë me Dervish pashën në krye, të pajisur me armët moderne të kohës si dhe me artileri.

Prapë mizori në vatrat tonë: «Shqipëria zbardh me

çadra anembanë». /«Nga gjëma e nga gjylet gjithë bota gjëmonte/ nga tymi i dyfëqeve malet mjegullonin/ nga gjaku i ushtarëve skuqte ujët e lumenjve». «Fushat u nxinë nga hordhi të reja»; luftëtarëve tanë plumbat u kalonin përmbi supe, por për lirinë asgjë nuk kursehet. Me ç'dhimbje dramatike ë me ç'bukuri lirie tingëllojnë vargjet e një kënge popullore kur shqiptari i flet vëtmisë së tij!

«Kush të ket' i fyshek me m'dhanë,
I ap tokën anembanë,
I ap tokë i ap shpi,
I fal bjeshkë i fal vërrri. . . »

Urrejtje më e madhe për armikun nuk mund të imajjinohet.

Valë të reja të pushtimit patën kurdoherë valë të reja luftërash. Përfaqësuesi i malësisë së Krasniqes në Lihjen Shqiptare të Prizrenit, trimi i paepur Mic Sokoli lëshoi kushtrimin për luftë. Tre mijë luftëtarë me Ali Ibrën në krye nga malësia e Krasniqes dhe nga Gashi Ibrën iu përgjigjën thirrjes së këtij trimi:

«Mic Sokoli po bërtet,
Ali Ibrën po e thrret;
— Merr bajraqet hajdë shpejt,
Na rrethoi asqeri mbret. . . »

Sipas traditës, është nëna ajo që e puth e fundit djalin kur e përcjell në luftë; po që se vritet, të vdesë me puthjen e nënës. Kështu veproi dhe nëna e trimit Mic Sokoli, para se t'i dorëzonte të birit shpatën, duke e posositur se edhe ajo ishte e gatshme ta hidhte pallën mbi supe për mbrojtjen e Atdheut:

«Mic Sokoli me dy tagana,
— Udh' e mbarë m'i ka than' nana,

*Lufto bir, ti për Shqipni,
Mos i le turqit me hy,
N'koft nevoja vi me ty...»*

Luftëtarët popullorë të Lidhjes Shqiptare kishin zënë grykën e Cernalevës, ndërsa taboret turke mbërritën në Slivovë dhe atje ngriten kampin e tyre. Kudo që shkeli ushtria e madhe e kryegjeneralit të egër osman Dervish pashës, la mbrapa lotë e mjerime të panumërtë në vratatona. Sipas këngëve të hershme popullore ja çfarë thuhet:

*«Dervish pasha prej Stambolli:
— Ku i ka çadrat Mic Sokoli?
Ku i ka çadrat, ku i ka t'part?
M'ka çue mbreti me ia çart'
Me ia çartë m'ka çue dovleti,
Don me kan' shah nën veti,
Shah nen veti don me kanë,
Kurrgja mbretit mos me i dhanë...»*

Në historinë e lavdishme të popullit tonë do të mbetet për jetë si pishtar i pashuar akti vetëmohues i trimit Mic Sokoli, në betejën e Cernalevës gjatë muajit prill 1881.

Sipas të dhënave historike, luftëtarët shqiptarë nga lartësitë e mëdha të grykës së Cernalevës i vrojtonin bukur të gjitha lëvizjet e armikut. Të shumta ishin sulmet e befasishme që bënин natën këta trima duke ua dëmtuar rëndë prapavijën.

Shumë herë luftëtarë i paepur Mic Sokoli, bashkë me luftëtarët e tij, visheshin me uniformën e armikut, futeshin thellë në kampin turk dhe përlesheshin fytas me ta deri në çadrat e tyre. Në mëngjes ktheheshin në pozicionet e tyre plot me armë, duke lënë pas frikë dhe pasiguri në radhët e ushtarëve të Dervish pashës.

Trimi Mic Sokoli me një manovrim të bukur mundi të shkëpusë prapavijën e armikut dhe katër taboreve armike ua rrëmbeu krejt xhepanenë (municione), armët rezervë dhe ushqimet. Kjo shqiponjë e paepur u kthyte tek

shokët me kuajt e armiqve ngarkuar plot me voza baruti, armë dhe ushqime. Këto aksione të shqiptarëve përsëritezhin vazhdimisht në kampin turk. Luftëtarë të tjerë të Mic Sokolit të udhëhequr nga djaloshi sypatrembur Smajl Hyseni u futën thellë një mbrëmje në afërsi të çadrave të ushtarëve osmanllinj dhe u vunë zjarrin kashtës së kavaletave. Krejt vendi u mbush tym e flakë. Luftëtarë Mic Sokoli atë natë u kishte përgatitur turqve një kurth tjetër. Ai urdhëroi luftëtarët e tij që i kishte vendosur nga krahu i majtë, të qëllonin mbi kampin e armikut. Osmanllinjtë, duke kujtuar se krahu i djathjtë ishte krejt i hapët, u hodhën nga kjo anë, por këndej ranë në kurthin e përgatitur nga trimi i zgjuar Mic Sokoli, i cili vozat e rrëmbyera me barut i kishte mbushur edhe me gurishte. Ai i kishte rreshtuar njëra mbas tjetrës me lidhje fitili të përbashkët dhe kur u afruan afër forcat turke i vuri menjëherë zjarrin fitilit. Mbas pak krejt vendi u trondit. Tmerri, lebetitja dhe britmat gjerrëse të osmanllinjve morën dhenë. Ushtarët që mbenë pa u copëtar, vraponin të çoroditur pa ditur nga shkonin. Komanda e armikut tashti nuk ishte në gjendje të përcaktonte jo vetëm sasinë e luftëtarëve shqiptarë, por as llojet e armëve të tyre.

Të nesërmen lufta filloi me tërbim. Komanda osmane kishte vendosur me çdo sakrificë të pushtonte grykën, ndryshe nuk mund të arrinte në kryeqendrën e kryengritësve, në Prizren.

Gjenerali i regjur Dervish pasha e kishte shumëfishtuar zjarrin e artilerisë drejt grykës, megjithatë shqiptarët qëndruan të patundur në pozicionet e tyre edhe pse gjithë gryka e malit u kthyte në tym e flakë.

Më 20 prill 1881 filloi gjerësish sulmi i armikut. Osman pasha me gjashtë batalionet e tij u hodh i pari në sulm drejt grykës, ndërsa pas tij vinte me plot bujë Ibrahim pasha me shtatë batalione.

Pozicionet e shqiptarëve ishin ngritur në vende të thepisura dhe artilleria osmane nuk i kapte dot, por nga këto pozicione zotëruese nuk mund të zbritje lehtë në fushën e betejës.

Kryegjenerali me përvojë Dervish pasha e kishte pa-

rashikuar këtë pikë kyçë të kryengritësve dhe me anën e një topi të madh villte vazhdimisht zjarr rrith shtigjeve të kalimit, pér t'u mbyllur rrugët e zbritjes kryengritësve pér në fushën e betejës.

Të gjashtë batalionet e Osman pashës sa vinin i afro-heshin grykës. Kryetrimin Mic Sokolin nuk e mbante dot vendi. Ai donte t'u hidhej në grykë armiqve, por topi i osmanllinjve ishte bërë pengesë serioze pér kryengritësit. «Ai duhet hedhur në erë» tha Mici dhe kështu veproi.

Me urdhër të këtij trimi, luftëtarët i shumëfishuan të shtënati e pushkëve nga krahu ku ndodhej topi, ndërsa Mic Sokoli me pak trima shqiptarë zbriti si ortek nga mali dhe nën hijen e plumbave iu afrua topit, por armiku e diktoi. Një plumb i shpoi faqen e majtë, por ky trim nuk u ndal. Të tjerë plumba i përshkuat trupin. Qartë e pas-qyron folklori:

«*Mic Sokoli ban me dorë,
— Bini djem se s'muj me folë,
Se m'ka ra do gjak në gojë,
Se m'ka ra do gjak në bark,
Shtatë martina i kam në shtat.*...»

Dhe në kohën që artilierët do të tërhiqnin litarin pér të qëlluar me top, ky trim i maleve të Krasniqes me një vetëmohim të rrallë u hodh menjëherë dhe me gjoksin e tij bllokoi grykën e topit xhebel (malor). Një gulçimë e rëndë topi u dëgjua anembanë dhe toka nga tronditja u duk sikur do përmbysej. Trupi vigan i luftëtarit shqiptar Mic Sokolit u hodh në erë së bashku me artillerët turq. Shtegu pér të zbritur shqiptarët në fushën e betejës u hap.

Atëherë luftëtarët shqiptarë si një uragan që zbret me shpejtësi nga mali u vërsulën duke sokëllitur me palla nëpër duar mbi turqit duke vrarë, prerë e bërë kërdinë mbi pushtuesit.

Akti heroik i kryetrimit Mic Sokoli është përjetësuar në këngët e gjeniut popull:

*«Mic Sokoli si azgan,
Drejt kah topi ai po shkon,
Grykn e topit ai e msyni,
T' tanë asqerët i mloi tymi. . . »*

Në betejën e Slivovës, Mic Sokoli së bëshku me tëtëqind atdhetarë të tjera ra heroikisht për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut.

**VEPRIMTARIA PATRIOTIKE E LIDHJES SHQIPTARE
TË PRIZRENIT NË JUG TË ATDHEUT**

**MEMORANDUMI DHE PROJEKTI LÜFTARAK I
KUVENDIT NDÉRKRAHINOR TË JANINËS**

(24 korrik 1878)

**«Shqipëri flamur i rrallë,
Kush të prek e merr në ballë»**

Populli

Më 24 korrik 1878 me iniciativën e patriotit të madh Abdyl Frashërit dhe me ndihmën e mjaft krerëve opozitarë shqiptarë të Shqipërisë së Jugut si Çelo Picari me shokë, u organizua mbledhja ndérkrahinore e Janinës. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues nga parësia e Gjirokastrës, e Beratit, e Kurveleshit, e Tepelenës, e e Delvinës dhe e Përmetit, si Ali bej Berati, Ibrahim Dragoti, Myslim Zenel Gjoleka, djemtë e Çelo Picarit (Rustemi dhe Iljazi) dhe mjaft patriotë të tjera.

Në Janinë, Çelo Picari, u lidh ngushtë me atdhetarin e madh Abdyl Frashërin. Me familjen e këtij patrioti Çelua kishte miqësi të vjetër luftarake që në djalëri. Sipas folklorit:

*«Kurvelesh t'u rritë nami,
Ju kërkon Çelo Picari.
Çelua dërgoi bujurdinë,
Përmbi gjithë Labërinë,*

*Të mblidhemi në Janinë,
Ditë të mira nashtinë,
Do vinë për Shqipërinë... »¹⁾*

Para se të fillonte mbledhja e Janinës, Abdyl Frashëri u vuri në dukje të deleguarve se po të mos merrnin shqiptarët vetë në dorë gjendjen, po të mos luftonin vetë ata për mbrojtjen e Atdheut, në kushtet e krijuara, Shqipëria do të zhdukej.

Në këtë mbledhje, patriotët e mbledhur nga gjithë krahinat jugore të Shqipërisë hartuan një memorandum, të cilin ia drejtuani Portës së Lartë (me anën e valiut të Janinës Rasim pashës).

Në memorandum kërkohej:

1) Bashkimi i gjithë vilajeteve shqiptare në një vilajet të vetëm.

2) Administrata e këtij vilajeti duhej të përbëhej prej nëpunësish shqiptarë.

3) Të gjitha të ardhurat nga taksat të shpenzoheshin brenda vilajetit.

4) Nënshtetasit shqiptarë të kryenin shërbimin ushtarë brenda kufijve të vilajetit shqiptar.

5) Të hapeshin shkolla dhe gjyqe në gjuhën shqipe.²⁾

Sipas dokumenteve greke, rezulton se përvèç memorandumit, Abdyl Frashëri, Çelo Picari, Myslim Gjoleka dhe anëtarë të tjerë të mbledhjes së Janinës, hartuan në kushte ilegale dhe projektin e kryengritjes kundër Turqisë, në qoftë se Stambolli nuk do ta pranonte memorandumin e shqiptarëve.

Në këtë projekt ushtarë brenda një nate nëpër shtëpitë e tyre së

1) AIF (Dosja M.K.)

2) AQSH. RPSSH. Fondi nr. 56, dosja nr. 89 f-2 (përkthyer nga origjinali turqisht). Memorandumi i është dërguar valiut të Janinës Rasim pashës më 24 korrik 1878.

bashku me valinë dhe mytesarifët (prefektët). Në mbledhjen e Janinës u vendos, që me ushtarët dhe oficerët shqiptarë, të sulmohej kalaja e Janinës dhe të arrestoheshin të pesëmbëdhjetë artilierët e saj. Pasi të realizoheshin këto, menjëherë do të formohej një qeveri provizore, që do t'i bënte të njohur Evropës dhe qeverisë greke pavarësinë e Shqipërisë. Ushqimi ishte i sigurt, sepse e dhjeta (taksa e së dhjetës në bereqet) gjatë viti 1878 ishte mbajtur në vend.¹⁾

Nga ana tjeter Stambolli nuk rrinte duarlidhur. Agjentura e tij në Shqipëri kishte rënë në gjurmët e aktivitetit të këtyre patriotëve shqiptarë. Ata kishin nuhatur projektin luftarak të mbledhjes së Janinës. Për këtë arsy filloj vala e arrestimeve, e cila përfshiu dhe patriotin e vjetër Çelo Picari.

E paharruar do të mbetet përgjigja që i dha Çelua i burgosur, valiut të Janinës, i cili donte ta bindte se shqiptarët sado trima që të janë, janë të paktë në numër dhe s'mund të maten kurrë me forcat e shumta turke. Çelua me thjeshtësinë e tij të zakonshme ju përgjigj: «Numerimin Shqipëria e përdor për bagëtinë, nuk e ka përtrimërinë».

Të shumta kanë qënë torturat që pushtuesi turk, përdori mbi të burgosurit shqiptarë në burgun famëkeq të Janinës. Një pjesë e këtyre patriotëve u internuan, ndërsa pjesa tjeter, pjesa më me rëndësi e krerëve opozitarë shqiptarë si Çelo Picari më të birin etj. i nisen për në Stamboll, ku do të gjykokeshin nga gjykata e lartë ushtarake, për tradhti të lartë kundrejt Portës.(sic).

Këta bij të Shqipërisë vuajtën shumë gjatë rrugës. Të lidhur, ata ecnin të rraskapitur dhe të gjakosur, plot me plagë në fytyrë e në shpinë, të shkaktuara këto nga kamxhiku i suvarinjve (kalorësve) të egër osmanlli. Folklori ynë i pasqyron qartë:

1) Revista «O neos kuvaras». Athinë 1962, fq. 135-177. (Material i përkthyer pranë AIH).

«... Mbi 'ta i pari delive,
 Shtrengon rrypat e zengjive,
 U jep komand' suvarinjve,
 Na bijn' me kamxhik turive...»¹⁾

Gjatë rrugës, në afërsi të Selanikut, toga turke, që shoqëronte të burgosurit, ra në pritën e kryengritësve grekë, të udhëhequr nga kapedan Delijani. Kalorësit turq u thyen keqas dhe u shpérndanë, ndërsa të arrestuarit u çliruan duke u bashkuar me kryengritësit.²⁾ Çelo Picari së bashku me djalin e tij Shahinin dhe me trima të tjera shqiptarë, në pamundësi për t'u kthyer në atdhe, mbetën në Thesali. Sipas historianëve dhe mbarë traditës, thuhet se Çelo Picari në krye të një reparti luftëtarësh shqiptarë mori pjesë në kryengritjen e popullsisë së atjeshme ku-ndër pushtuesve turq dhe u dallua për trimëri, veçanë-risht në betejën e Magrinicës:³⁾

«Çelua me shokë gjithë,
 Bën dyfek në Magrinicë...»⁴⁾

Gjatë kësaj kohe, gjykata e lartë turke në Stamboll, e gjykoi Çelon në mungesë dhe e dënoi me vdekje.

Pas dështimit të kryengritjes së Thesalisë, Çelo Picari i kaluar në moshë, i ndjekur këmba-këmbës nga agjentura turke shkoi në Athinë si emigrant politik.

Qeveria greke, për arsyе taktike, pas vitit 1860 kishte filluar një politikë afrimi me shqiptarët. Njerëzit e megaliides bënin zhurmë të madhe për një front të përbashkët greko-shqiptar kundër turqve. Ata filluan të flasin për një bashkim shtetëror të Shqipërisë me Greqinë me të drejtë të barabarta, duke shfrytëzuar këtu luftën e Ali pashë Tepelenës kundër Turqisë, gjatë së cilës shumë nga ka-

1) AIF. Ekspedita e Kuçit.

2) Sipas kujtimeve të trashëgimtarëve të Çelo Picarit.

3) Enciklopedia e madhe greke «Pirsos», vell. II, fq. 278.

4) AIF. (Dosja II M.K.)

pedanët grekë luftuan në ushtrinë e Ali pashës, që në atë kohë kishte formuar një shtet të përbërë prej tokash shqiptare dhe greke.¹⁾ Qeveria e Athinës që prej vitit 1862 kishte ngritur komitete si në Janinë, Durrës e gjetkë, të cilët propagandonin bashkimin e Shqipërisë me Greqinë. Sipas tekstit të Historisë së Shqipërisë, në manifestin që ata kishin shpérndarë, midis të tjerash thuhej: «Nën pushtetin e mbretit Gjergj (Jorgo) të gjitha fetë do të jenë të barabarta, shqiptarët do të përbëjnë lulen e ushtrisë dhe të gjitha pronat turke në Thesali dhe në Epir do t'u jepen atyre në pronësi (sic).²⁾ Këtë lloj propagande për shqiptarët kishin filluar në atë kohë qeveritarët e Athinës. Mbarë shtypi grek synonte t'i afronte sa më shumë bijtë e Shqipërisë në sferën e politikës së tyre shoviniste, në mënyrë që këta trima të mos mendonin më për pavarësinë e atdheut të tyre, por çdo aktivitet politik në Shqipëri (sipas tyre) të drejtohej nga qeveria greke. Në këtë atmosferë mbytëse për interesat shqiptare u ndodh Çelua në Athinë, kur ai shkoi atje si emigrant politik.

Greqia e kishte fituar pavarësinë e saj qysh në vitin 1828. Një kontribut të madh për pavarësinë greke kanë dhënë dhe arbëreshët. Sipas një artikulli të patriotit Abdyl Frashëri, botuar në gazeten «Moniteur universel» të Parisit, në maj të vitit 1879 del se arbëreshët e Greqisë (Me përjashtim të arbëreshëve të Peloponezit — M.K) në atë kohë përbënин një popullatë prej dyqindmijë frymësh, shumica dërrmuese e tyre banonin në rrëthin e Athinës, bile dhe brenda në kryeqytetin grek, në një lagje të veçuar të quajtur «Plake». Këta trima me origjinë shqiptare, për kontributin e madh që kishin dhënë për pavarësinë e Greqisë, me formimin e shtetit grek u zgjodhën dhe deputetë dhe zunë poste në administratën e qeverisë greke si dhe në ushtri; bile ka pasur zëra në parlamentin grek që përvèç gjuhës amtare (greke), të lejohej dhe përdorimi i gjuhës shqipe, pasi mjaft nga kapedanët suliotë dhe arbëreshë nuk e zotëronin mirë gjuhën greke,

1) P. Chiara. «L'Albania». Palermo, 1869, fq. 169.

2) L. Mile, Vep. cit., fq. 188.

për të folur lirisht në këtë institucion qendror ligjëvë-nës grek.

Sipas të dhënave historike, arbëreshët si pjesa fshatave e popullsisë ishin të pakënaqur nga qeveritë në fuqi. Ata përbënин një lëvizje rezervë të lëvizjes demokratike, por asnjëherë nuk u përkrahën si lëvizje arbëreshë nga partitë e opozitës, të cilat nuk qenë aspak më të mira se qeveria e Trikupit, sepse këtë e treguan kur erdhën në fuqi.

Në gjirin e kësaj popullsie ka patur mjaft patriotë që kishin simpati për shqiptarët dhe për lëvizjen shqiptare, si Anastas Kullurioti, Panajot Kupitori dhe shumë të tjera. Këta arbërëshë atdhedashës mblidheshin në klubin «Kafeneja e Janopullit» dhe atje flitnin për çlirimin e Shqipërisë dhe për vëllazërimin e popullit grek me atë shqiptar. Ata, me fjalët e tyre të zjarrta, e luftonin shovinizmin që aq shumë i largon dhe i kundërvë popujt me njëri-tjetrin,¹⁾ por fatkeqësisht këta patriotë nuk mundën të impononin pikëpamjet e tyre mbi opinionin publik.

Në këtë ambient jetoi Çelo Picari në kryeqytetin grek; megjithatë ai u orientua shpejt në qytetin e Athinës. Figura e këtij udhëheqësi ushtarak shqiptar nuk ishte e huaj në kryeqytetin grek, ajo ishte e njohur prej kohësh në Athinë, veçanërisht në kuadrin e lartë ushtarak grek, arbëreshë suliot. Ata flitnin me admirim për takтикën luftarake të këtij kapedani të vjetër shqiptar.

Rrethet patriotike arbëreshë jo vetëm e vlerësuan drejt qëndrimin burrror të këtij udhëheqësi të vegjëlisë shqiptare, por e morën dhe në mbrojtjen e tyre. Arbëreshët u bënë një mbështetje e sigurtë për Çelon, që krijoj me ata edhe lidhje familjare, duke martuar djalin e tij Shahinin me një vajzë arbëreshë nga qyteti i Menidhit.

1) Enciklopedia e madhe «Pirsos», vëll. II, fq. 275.

Shih dhe Instituti Gjuhë-Letërsi. «Historia e letërsisë shqipe», vëll. II, fq. 208.

Me autoritetin e kësaj popullate luftarake, që shtrihej me shumicë në rrëthin e Athinës, nuk mund të luhej lehtë. Megjithëse historianët shovinistë grekë janë munduar ta paraqesin në shkrimet e tyre Çelo Picarin si një figurë pa asnjë aktivitet patriotik, prapëserapë u kanë shpëtuar mjaft shprehje, që tregojnë patriotizmin e këtij trimi. Mjafton të lexojmë veprën e historianit Kosta Birit «Arvanites...» Ja çfarë thotë ai: «Çelo Picari në Athinë, edhe pse qe në moshë të kaluar, nuk e la vrullin e tij luftarak dhe e mbajti vazhdimisht lart interesimin për çështjen kombëtare». Ndërsa historianë të tjerë grekë thonë për Çelon se ishte nga fshati Picar i Kurveleshit, i nxjerrë jashtë ligjit nga Perandoria Turke qysh prej vitit 1828 dhe se në kohët e fundit të jetës së tij ka qënë në Athinë, ku është njojur si tip hero, dhe politikan me përvojë...»¹⁾

Këta autorë të mbështetur në dokumentacionin e institucionit qendror të arkivës greke, na jepin dashur pa dashur figurën e vërtetë të Çelo Picarit, të këtij luftëtarit të lirisë, me horizont të gjerë politik për kushtet e kohës.

Për të mësuar se çfarë trajtim i bënë në Athinë qeveritarët grekë këtij trimi të Shqipërisë, le t'i referohemi enciklopedisë së madhe greke «Pirso»²⁾. Edhe pse figura e Çelo Picarit në këtë enciklopedi (si dhe në materialet e tjera) është hiperbolizuar në disa raste nga historianët grekë, megjithatë përbajtja e këtij materiali është shumë interesante. I parashtrojmë në mënyrë të përmbledhur: «Çelo Picari me origjinë shqiptare, erdhi në Athinë pas mbarimit të kryengritjes së Thesalisë më 1878. Mbante të veshur një fustan me shumë pala, kësulë të ngritur lart, i pajisur me pallë të përkulur dhe me armaturë të plotë. Kishte marrë pjesë në betejat e Thesalisë dhe u dallua si komandant i sprovuar kundër turqve në betejën e Magrinicës. Gjatë ditëve të para të ardhjes së tij në

1) AIH (material i përkthyer). «Ipiros». Athinë, 1964, vëll. II, fq. 64.

2) Enciklopedia greke «Pirso», vëll. fq. 278.

Athinë shoqërohej prej dhjetë trimave (shqiptarë) të armatosur.

Poëtët e asaj kohe e hyjnizuan si hero. Por... shpejt erdhën ditë të këqia për Çelon. Kryeministri grek Harillas Trikupi nuk i dha asnje farë pensioni si emigrant politik Çelo Picarit. Ai ra në një varfëri të madhe. Skamja dhe pleqëria ja përkuli kurrizin. Kryetari i bashkisë së Athinës, Dhimitër Suco (me qëllim diskreditimi) i ofroi detyrën e ndezësit të fenerëve të rrugëve të Athinës. Çelua nuk e pranoi, duke e konsideruar këtë lloj pune si një fyterje për një kapedan».

Këtu del haptas se qeveria greke, ndryshe i trajtonte me fjalë shqiptarët dhe ndryshe me vepra. Më poshtë po në këtë enciklopedi thuhet: «Çelua, më vonë u vu në krye të demostratave të vegjëlisë së qytetit të Athinës dhe jepte sinjalin në demonstrata kundër politikës fiskale (taksëvënëse) të kryeministrit Trikup. Gjatë demonstratave ai hidhte parullën «Poshtë vajgurxhiu i madh», sepse Trikupi politikën e tij ua kishte nënshtruar monopoleve të vajgurit, ose parullën tjetër «Poshtë paqetaxhiu», sepse kryeministri Trikup kishte taksuar duhanin. Çelua në Athinë u popullarizua shumë; nuk mund të imajginojeasnje demonstratë, pa patur në krye këtë kapedan heroik (shqiptar)». Më tutje thuhet se kur një deputet i quajti demonstruesit «zbatharakë», Çelo Picari u pa të nesërmen në krye të një demonstratë të madhe, duke mbajtur në majë të një shtize të ngritur lart një opingë të vjetër, dhe duke e konsideruar atë si flamur të shenjtë. Gazetat botuan fotografinë e flamurmbajtësit dhe publiku u informua se ishte ai njeri i dikurshëm, nga i cili tmerrohej e gjithë Perandoria Otomane. Në Athinë Çelua ishte futur shpeshherë nëpër burgjet e policisë, por ai u shpjegonte atyre se edhe nga turqit ishte burgosur shumë herë në burgjet e tmerrshme të Janinës. Çelua deri në fund mbeti armik i papajtueshëm i megalidesë dhe flamurtar i opingesë së vjetër.

Këto na shpjegon enciklopedia e madhe greke «Pirso» për Çelo Picarin. Ajo e kalon krejt në heshtje interesimin e këtij trimi për çështjen kombëtare shqiptare dhe bashkë-


punimin e tij me arbëreshët e Greqisë. Aktivitetin e tij në Athinë e lidh vetëm me kërkesa ekonomike.

Kryeministri grek Harillas Trikupi, si politikan borgjez me përvojë, para një situate të tillë të krijuar në kryeqyjetin grek u detyrua t'u bënte lëshime të përkohshme patriotëve arbëreshë.

Në vitin 1879 ai lejoi Anastas Kulluriotin të botonte në Athinë gazetën «I foni tis Alvanias» (Zëri i Shqipërisë), e cila u mor krejtësisht me mbrojtjen e interesave shqiptare. Po këtë vit në Athinë u hap shkolla shqipe e mbrëmjes, u botuan abetare dhe mjaft libra të tjera shqipe. Gjithashtu në formë artikujsh u botua në gazetën «Zëri i Shqipërisë», «E vërteta mbi Shqipërinë» e Vaso pashë Shkodranit. Me anën e këtij botimi patriotët Anastas Kullurioti dhe Thimi Mitko kanë pasur për qëllim të propagandojnë sa më shumë synimet e «Lidhjes Shqiptare të Prizrenit».

Luftha e rreptë politike për marrjen e pushtetit, që zhvillohej në atë kohë në Athinë, bënte që në Greqi të kishte një farë liriveprimi. Pikërisht këtë situatë patriotët arbëreshë ditën ta shfrytëzonin. Ata gjetën rastin më të volitshëm për t'i shkëputur qeverisë greke disa të drejta, të përkohshme. Por këto lëshime të qeverisë greke nuk zgjaten shumë. Qeveritarët e Athinës duke parë se nuk mund t'i mashtronin patriotët arbëreshë e shqiptarë (brenda e jashtë Greqisë) as me lëshimet e bëra, u hodhën në luftë të hapët kundër tyre, duke e zëvendësuar demagogjinë me dhunë. Kështu, emigrantëve politikë shqiptarë, që ndodheshin në Greqi si Çelo Picari me shokë ua hoqën dhe ato pak «të ashtuquajtura liri demokratike» që kishin. Çelon plak e futën në listën e njerëzve të dyshimitë dhe e vunë nën mbikqyrjen e policisë, duke i kufizuar dhe territorin e qarkullimit. Veç kësaj ai' çdo mbrëmje së bashku me djalin e tij Shahinin, duhej të paraqitej në zyrën e policisë.

Ky plak shqiptar, me festë të bardhë në kokë, me trup të përkulur nga skamja e pleqeria, i shqetësonë mjaft shovinistët grekë, të cilët i trembeshin akoma influencës së tij në Shqipëri dhe në Greqi.



**Emigrant politik, plaku Çelo Picari, në qytetin e Athinës, në ditët
e fundit të jetës së tij.**

Nga fillimi i vitit 1880, pas dy vjet qendrimi si emigrant politik në Greqi, plaku Çelo Picari vdiq i helmuar në burgjet e Athinës, i varfër dhe i vetmuar, larg shokëve dhe larg atdheut që aq shumë e deshi. Trupin e Çelos e morën djemtë që banonin në Janinë dhe e varrosën në xhaminë e «Namasgjahut». Sot në këtë vend janë ngritur institucionet e drejtësisë greke dhe varri është zhvendosur në xhaminë e Asllan pashës brenda në kala.

Asgjë më e bukur nuk i shkon këtij luftëtari të pagunjëzuar sesa kjo copë mbishkrimi që ka mbetur mbi varrin e tij:

«O udhëtar, mos iu trëmb vdekjes, bota është e guximtarëve, e atyre që luftojnë për vatanë»¹⁾.

Shqipëria i vajtoi së largu bijtë e saj:

«Do ta qaj un' Labërinë,
Për Çelon që vdiq në Athinë,
Gjolekë kordhë-këqinë,
Bashkë me Hodo Alinë,
O imzot o kordhë-shpata,
U dëgjuat në rigata...»

Edhe sot e kësaj dite në Jug të atdheut emri i Çelos vihet si epitet nderi sa herë që njerëzit duan të nderoinë

1) Të dhënat mbi përshkrimin e varrit të Çelo Picarit në Janinë janë tërhequr prej vetë autorit nga trashëgimtarët e Çelos, që vite me radhë kanë jetuar në lagjen Dederuç të Janinës. — Është karakteristike urrejtja e papërmabjatur e shovinistëve grekë dhe e grekomanëve kundër kapetanit Çelo Picarit. Ata nuk kanë lënë gur pa luajtur për të errësuar figurën e ndritur të këtij luftëtari patriot. Qartë pasqyrohet kjo urrejtje dhe në gazeten «Përlindja e Shqipërisë» Nr. 2, 4 janar 1914, fq. 3: «...Sot mësojmë nga burime të sigurta se ushtria e mbretit Kostandin (ushtria greke — M.K.) vajti në Picar dhe si vodhi ç'mundi i vu zjarrin katundit për të marrë shpagën e Çelo Picarit».

Të njëjtit të dhëna pasqyrohen sot dhe nga pleqtë e Picarit, të torturuar nga shovinistët grekë.

apo tē vlerësojnë dikë; kështu thuhet: Çelo djalë, Çelo burrë etj.

Kohët tona plot dritë, i ndriçojnë qartë figurat e këtyre luftëtarëve të vegjëlisë, që gjithë jetën e tyre ia kushtuan popullit të vet.

TRIMAT E KRYENGRITJEVE POPULLORE DINË T'U PËRGJIGJEN ARMIQVE JO VETËM NË FUSHËN E LUFTËS POR EDHE NË ARENËN POLITIKE

«Sypatrembur do qëndrojë,
Shqiponja që tundi vendë,
S'shkroi histori me bojë,
Por me gjak nëpër shkëmbenjë»

Populli.

Karakteristike në këtë kohë është mobilizimi i gjithë aparatit propagandistik dhe agjentorial grek për të komprometuar patriotët shqiptarë. Në shtypin e tyre shihen shtrembërimet të hapta dhe sidomos në dokumentacionin arkival, ka shtrembërimet të fakteve historike.

Agjentura greke nuk ka lënë gur pa lëvizur për të diskredituar dhe trimin e ri të Labërisë, Myslimin, të birin e Zenel Gjolekës. Megaliideistët e Epirit në vitin 1878, arritën sa të hapnin fjalë në masa se gjoja Myslimi u bë vegël e Greqisë,¹⁾ me qëllim që këtë patriot ta izoloni nga populli dhe nga luftëtarët e tij, tek të cilët kishte shumë influencë. Por veprimitaria patriotike e tij kundër politikës shoviniste greke vë në dukje më së miri atdheda-shurinë e këtij patrioti.

1) Lefter Dilo. «Gjirokastra — një nga degët e «Lidhjes së Prizrenit». Gjirokastër, 1966.

Gazeta «Përlindja e Shqipërisë», nr. 30, dt. 30.13. vjeshtë e tretë 1913, fq. 5.

Muin Çami. «Në kujtimet e pjesëmarrësve vlonjatë me rastin e 50 vjetorit të Luftës së Vlorës».

Urrejtja kundrejt shovinistëve grekë ka qënë e njo-hur në familjen Gjoleka të asaj kohe. Sipas revistës vjetore kronikale greke «Neos kuvaras», botuar në vitin 1966 në Athinë, thuhet se i ati i Myslimit, Zenel Gjoleka, pasi vrau Kaftan Agasiun turk në vitin 1830, u hodh në Himarë dhe andej shkoi në Greqi. Atje vrau një kapedan grek, pse i kishte prekur sedrën kombëtare. Për këtë akt qeveria greke e kishte burgosur.¹⁾

Sipas historianëve të huaj si dhe në folklorin e vendit, Myslim Gjoleka, i biri i Zenelit dhe i Pullë-Imerjes lindi më 1835 në fshatin Kuç të Kurveleshit. Myslimi qysh në fëmijëri e ndjeu thundrën e rëndë të pushtuesit osman. Veprimtaria antiturke e theksuar e babait të tij bëri që kjo familje të ishte vazhdimisht e persekutuar nga organet qeveritare të pushtuesit.

Myslimi fëmijërinë e tij e kaloi më të shumtën e kohës së bashku me mëmën, i fshehur nëpër gërxhet e grykat e thepisura të Labërisë. Ai u rrit nën kamxhikun e nën presën e jataganit të sunduesit osman. Në dimrin e egër të vitit 1847 Myslimi i vogël së bashku me mëmën e tij u gjetën nga ushtarët turq, të plevitosur dhe të uritur në një nga shpellat e malit të Bolenës. Ata të dy, mëmë e bir, u shpuna të arrestuar tek serasqeri në Delvinë. Vlen të përmendet zelli i tepruar i renegatëve të vendit, të vënë në shërbim të Turqisë, si Hysen bej Këlcyra, i cili përfundoi neutralizuar veprimtarinë e mëtejshme të Zenel Gjolekës dhe përfundoi detyruar atë që të dorëzohej, e mbajti Myslimin e mitur peng në Delvinë.

Vitet kalonin. Probleme të reja lindën në Ballkan. Të tjera halle e pllakosën Shqipërinë. Sikurse e theksuanë në kapitujt e mëparshëm, shtetet e reja shoviniste të Ballkanit si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, të inkurajuara nga Perandoria e madhe Ruse, qysh prej vitit 1850

1) Revista «O neos kuvaras». «Gjoleka në Greqi». Cit. fq. 155. Mat. përkth. AIH.

Shih dhe: AIF «Këngë të rezistencës së Labërisë të vitit 1847». Ekspedita e Tepelenës, 1952, vëll. XII, fq. 81.

zunë të hartonin plane për zgjerimin e tokave të tyre në kurriz të tokave shqiptare. Gjatë vitit 1852 Zenel Gjoleka me luftëtarët e Labërisë, shkoi në ndihmë të malësorëve të Veriut për mbrojtjen e tokave veriore të atdheut nga malazezët. Ai mori me vete për të stërvitur në luftë edhe djalin e tij 17 vjeçar Myslimin. Ky trim i vogël u ndodh së bashku me babë Zenelin kur ai u vra tradh-tisht në priten që i organizuan malazeztë. Sipas folklorit:

«... *Mbet Myslimi në qeder,
I vogël e s'kish haber...*»

Me fitoren e kësaj lufte kufitare Myslimi 17 vjeçar u kthyte në vendlindje. Ai mbaroi më vonë shkollën ushtarake në Manastir. Atje u dallua në përvetësimin e artit ushtarak të asaj kohe.

Gjatë kohës që Myslimi ka qenë nëpunës u dallua si administrator i mirë. Ai qysh në fillim u mundua që vendlindjen e tij Kuçin, ta përmirësonte ekonomikisht. I biri i Gjolekës, me gjithë rezistencën e madhe të klerit (të shehlerëve) dhe të feudalëve të Delvinës, mundi më në fund më 1875 ta kthejë Kuçin në nënprefekturë.

«*Seneja nendëdhjet e një,
I biri Gjolekësë,
Kuçin kasaba e bë,
Shkojnë telat nëpër 'të...*»

Por figura e tij e vërtetë shkëlqeu si luftëtar nëpër sheshet e luftës, kundër dallgëve të pafund të pushtuesve, duke qenë kudo në ballë të luftimeve.

Muslim Gjoleka ishte nga të parët që u fut në konflikt me parësinë e Sulit të vënë në shërbim të shtetit grek kundër interesave jetike të popullit shqiptar.¹⁾ Ky trim qe një nga pjesëmarrësit kryesorë të «Mbledhjes së Janinës» në vitin 1878, ku u hartuan kërkesat e para të

1) J. Llambbridhis. Vep. cit. fq. 23 (material i përkthyer AIH).

organizuara për autonominë e Shqipërisë. Ai, në bashkëpunim të ngushtë me Abdyl Frashërin dhe me patriotë të tjerë si Çelo Picarin me shokë, hartuan në kushte ilegale dhe projektin e kryengritjes kundër Turqisë.

Myslimi nuk ishte vetëm një luftëtar i sprovar në fushën e luftës; ai dallohej gjithashtu edhe në arenën politike. Prej kohësh Myslimi e kishte diktuar politikën dhelparake sa dhe të rrezikshme për interesat shqiptare të qeverisë shoviniste greke. Në luftën e Lekurësit, në shkurt 1878, Myslim Gjoleka, me zgjuarësinë e trimërinë e tij i bëri qesharakë njerëzit e megalidesë, që kujtonin se do t'i hidhnin këmbët si të donin në Shqipëri. Bukur e pasqyron folklori:

«*Gjoleka Jorgos i shkroi,
— Unë odat do t'i shtroj,
Mirë punën ta mbaroj.
Jorgo qéni e besoi,
Dhe asqerët i dërgoi
Myslim trimi ja shkurtoi,
Gjak u bë ngado që shkoi,
Hajde Gjoleka i shkretë,
Ju të dy e s'ka të tretë».* ¹⁾

Vetë historiografët grekë shpjegojnë: «Myslim Gjoleka nuk e përfillte fare vdekjen dhe pa u ruajtur, dilte haptas në ballë të luftës. Ai në luftën e Lëkurësit ka treuar trimëri të rrallë»

I biri i Zenel Gjolekës i sulmoi bandat greke nga toka e nga deti. Ai u doli atyre nga ana e Ksamiljes dhe i rrithoi keqas. Myslim Gjoleka ka qënë një nga krerët më besnikë dhe më luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për degën e Gjirokastrës. Qëndrimi patriotik i këtij trimi u tregua dhe në mbrojtjen e tërësisë tokësore në Veri të Atdheut.

Sikurse theksuam edhe më lart, në muajin tetor

1) AIF (Dosja M.K.)

1879 Mali i Zi, i inkurajuar nga vendimet e marra në Kongresin grabitqar të Berlinit, mobilizoi forca të shumta pér të pushtuar tokat shqiptare: Plavën dhe Gucinë. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, kishte lëshuar kushtimin anembanë vendit. Në ndihmë të malësorëve të Veriut, të komanduar nga Ali pashë Gucia etj. shkoi dhe Myslim Gjoleka me trimat e Labërisë dhe me ata të Bregdetit të udhëhequr nga kapedan Sokrat Leka nga Qeparoi.¹⁾ Ky trim, së bashku me trimin tjetër të Bregdetit Odhise Kasnecin (Nesturi) etj. ishte në radhët e para të atyre që u pérpoqën pér organizimin e një ushtrie kombëtare shqiptare. Kjo na pasqyrohet në gazetën «I foni tis Alvanias» (Zëri i Shqipërisë), botuar në Athinë më 23 gusht 1880.

Në këtë gazetë thuhej: «Me kënaqësi botojmë marrëveshjen midis myslimanëve dhe të krishterëve, që Gjoleka i ndodhur në Gjirokastër në komisionin e atjeshëm, u dërgoi komisioneve të «Lidhjes Shqiptare» nëpër qytete të tjera. Në këtë marrëveshje është marrë përsipër (detyrimi) që të shkojnë të gjithë ushtarë, prej moshës 18 vjeç e deri në moshën 70 vjeç, pér të mbrojtur atdheun e tyre të shenjtë, Shqipërinë».

Midis kushteve të marrëveshjes në fjalë vihet në dukje rrethi i Naselishtës (midis Kolonjës dhe Kosturit me shtatëdhjetë fshatra me kryeqendër Lapsishten) se atje «myslimanët dhe të krishterët u shpallën vëllezër. Jeta, nderi dhe pasuria e të krishterëve është jeta, nderi dhe pasuria e gjithë shqiptarëve dhe do t'i mbrojmë ato me çdo sakrificë të tyre dhe ai që do të faktohet si kundërvaprues (rebel), do të gjykohet dhe do të dënohet». Lidhur me personat që do t'i shmangen shërbimit të detyrueshëm ushtarak thuhet: «Dezertorët (ata që i shmanngen shërbimit të detyrueshëm ushtarak) me t'i kapur do të pushkatohen, shtëpitë e tyre do të digjen, pasuria e tyre do të shitet në ankand. Do të dënohen gjithashtu edhe ata që i fshehin (strehuesit)».

1) Arkivi Historik i Shtetit, Tiranë (më tutje do të citohet AHSHT).

Për të ruajtur vëllazërimin e shqiptarëve nga intrigat dhe kurthet e qeverisë shoviniste greke, këtyre dispozitave ligjore, që flasin për rekrutimin e detyrueshëm ushtarak iu shtua dhe ky nen: «Askush nuk mund të shkojë në mbretërinë greke pa lajmëruar dhe kërkuar më parë lejen e komisionit të «Lidhjes». Shpallja e këtij legjislacioni dhe zbatimi i saj në rrëthim e Naselishtes, i vuri në lëvizje shovinistët e Athinës, pasi ata prej vjetësh ëndërronin, që këtë krahinë thjesht shqiptare ta bashkonin me mbretërinë greke. Më në fund agjentura greke, e bindur se nuk mund ta mposhtë këtë trim, filloi të përhapte anembanë fjalë se Myslim Gjoleka është blerë nga qeveria greke. Sillogët e Epirit me këto lloj shpifje i mbushën edhe këngët e tyre për Myslim Gjolekën. Ai u thirr dhe nga Porta e Lartë për të dhënë shpjegime rrëth këtyre akuzave. Sipas këngëve popullore thuhet se edhe vetë sultani u çudit me burrërinë dhe me patriotizmin e madh të këtij trimi të Shqipërisë:

“... Se ç'i tha e se ç'e pyeti,
Tre sahat në këmb' e treti,
Asnjë hile nuk i gjeti,
Nuk kam parë k'si mileti,
Soj asllani xhet pas xheti,
Paska bërë djale Gjoleka,
Myslimin me të vërteta ...»¹⁾

Myslim Gjoleka u kthye përsëri në atdhe. Agjentura greke plasi që nuk e zhduku dot këtë trim as me anën e shpifjeve tendencioze, që kishte bërë pranë organeve qeveritare turke. Atëhere ajo vuri më në fund në përdorim armën e saj të zakonshme, vrasjen mbas shpine.

Në verë të vitit 1880 kur Myslimi shkonte në vëndin e ri të emërimit – në Paramithi, u vra rrugës në një han nga agjentura shoviniste greke (ndërsa në një variant tjeter popullor thuhet se e helmuau).

1) AIF (Dosja II M.K.)

Ja si e shpjegon vrasjen e Myslim Gjolekës nga shovinistët grekë historiani anglez M. Valentin Kirol në veprën e tij «Twixt Greeks and Turks» kur vizitoi Janinën në vjeshtë të vitit 1880: «... Por tashti brigantët nuk i kanë të kufizuara dëfrimet e tyre vetëm në torturat që u bëjnë fshatarëve fatkeqë, ata kanë filluar të sulmojnë dhe disa nga udhëheqësit... dhe një përshtypje jo e vogël u shkaktua dhjetë ditë para se unë të vizitoja Janinën, nga vrasja e Myslim agait, një nga organizatorët e dalluar të agjizacionit shqiptar «(...by the murder of Myslim Agha, one of the prominent promoters of the Albanian agitation»).

Ja si e gdhëndi në vargje poeti popullor lab këtë ngjarje të trishtueshme:

*«Myslim pallë donatia,
Qysh të humbi bukuria,
Ike nga Paramithia,
M'udhë se ç'tu ngrit pusia,
Tertipi që nga frëngjia,
Qëndrove te' mehania,
Të helmoi grekëria...»¹⁾*

Ndërsa nënët labe i thurën këtij biri të shtrenjtë të Shqipërisë këtë vajtim:

*«... Qan Zareli me Çipinë,
Qajn' malet me trëndelinë,
Qajnë që humbën Myslimë;
Mendjeholl' e zemërtrimë...»²⁾*

Myslim Gjoleka u varros në Janinë në krah të varrit të Çelo Picarit në xhaminë e Namasgjahut.

Kjo lloj tragedie është lojtur vazhdimisht nga armiqtë e Shqipërisë sa herë që ndesheshin me bijtë patri-

1) AIF (Dosja II M.K.)

2) Po aty.

otë të popullit tonë. Në pamundësi për ta mposhtur hap-tas popullin shqiptar trim dhe liridashës, ata u kundërvini luftëtarëve tanë helmin dhe thikën pas shpine, spinazhin dhe diversionin, mbarë aparatin e tyre shtetëror të frontit legal dhe ilegal. Kurse bijtë e këtij vendi të shumëvuajtur ishin të detyruar të dilnin përballë armiqve, ballëhapët, me shpatë zhveshur dhe vazhdimisht me shprehjen e tyre tradicionale në gojë: «Dil, të dalim», shprehje aq shumë e huaj për armiqtë e Shqipërisë me plot intriga, pabesi dhe kurthe pas shpine. Ja në çfarë kushte të vështira ka luftuar populli ynë kundër push-tuesve të shumtë, të ndryshëm dhe të pasosur që erdhën valë-valë pa mbarim në vendin tonë.

Në të njëjtat kushte jetoi e luftoi dhe shoku i armëve i Myslim Gjolekës, anëtari i kryesisë së «Lidhjes Shqiptare të Prizrenit» për degën e Gjirokastrës Odise Kasneci (Nesturi) nga fshati Vuno i Bregdetit.

Edhe pse kaluan dekada e gjenerata të tëra populli ynë e ka mbajtur të freskët figurën e ndritur të këtij trimi të shtrënjtë të kësaj krahine bregdetare, që nuk kur-seu as jetën për të mbajtur të ndezur dhe të pa prekur ndjenjat e atdherdashurisë në mbarë Bregdetin. Sipas rapsodëve popullorë, vazhdimisht këtyre trimave: «U ka kënduar bilbili në pallë dhe në çark të dyfekut, kur ishte puna për të mbrojtur lirinë, pavarësinë e vendit. Nuk janë gërshetuar rastësisht këto vargje popullore për këta trima atdherdashës:

«*Bregudetit gurë-gurë,
Kreve kapetanë shumë...»*

Pikërisht në radhët e këtyre kapedanëve e gjejmë të rreshtuar edhe Odise Kasnecin, këtë dré të pakapshëm të maleve të Bregdetit.

Stambolli prej kohësh kishte vendosur ta likuidonte me çdo kusht autonominë e krahinës së Himarës. Porta e Lartë kërkonte me këmbëngulje të shtrinte reformat e saj centralizuese edhe në këtë krahinë kryengritëse shqiptare.

Sipas marrëdhënieve tradicionale që kanë pasur himariotët qysh nga shekulli XVIII, me mbretërinë e Napolit, për mbrojtjen e vendit, dërguan për të studiuar në shkollat ushtarake të Italisë mjaft djem, midis tyre edhe djaloshin vunjotas Odise Kasnecin (Nesturi) për t'i përgatitur në të ardhshmen si kuadro të luftëtarëve kryengritës. Atje ky bir i familjes Kasneci mbaroi shkollën ushtarake (të kadetëve).

Në Itali Odisea u lidh ngushtë me rrethet patriotike të arbëreshëve të Italisë, të cilët kërkonin ta shihnin përsëri të lirë, pa turq Shqipërinë. Ata dësheronin që në vendin e shqiponjave të ngjallej përsëri lavdia e dikurshme e Skënderbeut.

Edhe në atdhe ky luftëtar me shkollë nga Bregdeti mësoi shumë nga libri i madh i jetës. Odisea, me nuhatjen e tij prej patrioti, e vlerësoi drejt gjendjen kritike të vendit të tij. Ky bregdetas nuk deshi që Shqipëria të mbetej nën thundrën e rëndë të pushtuesve të egër osmanlli, vend intrigash e pazarllëqesh për shtetet e mëdha imperialiste si Rusia etj. dhe pré për shtetet fqinje shoviniste. Kapedan Odisea, së bashku me trima të tjera të Bregdetit dhe të Labërisë si me Myslim Gjolekën etj., u hodh pa rezerva në luftën e madhe patriotike për çlirimin e vendit, në fillim kundër murtajës pesëqindvjeçare turke dhe më vonë në dëbimin e bandave shoviniste greke, që nën ndikimin e Rusisë cariste kishin zbarkuar herë pas here në bregdetin e bukur të Himarës, duke filluar qysh prej viti 1854.

Odise Kasneci ishte nga të parët e kapedanëve të Bregdetit, që jo vetëm hodhi poshtë kërkesën greke për zbarkimin e tyre në Himarë, por u tha se ai me luftëtarët e tij do të ishte përsëri nga të parët që do t'u kthejë pushkët bandave shoviniste greke në qoftë se ata do të provojnë të dalin në bregdetin shqiptar. Sikurse e theksuam, më 12 shkurt 1878 ushtria shoviniste greke zbarkoi në Sarandë dhe andej mori rrugën drejt Lëkurësit.

Në gojëdhënën popullore ka mbetur i paharruar vëllazërimi luftarak përballë Lukovës i forcave të Bregdetit të udhëhequra nga Odise Kasneci dhe Sokrat Leka

nga Qeparoi, me ato të Kurveleshit të Poshtëm nën kryesinë e Myslim Gjolekës etj. Gjatë përshëndetjes me pushkë u vra aksidentalish djali i vetëm i luftëtarit të dëgjuar kuçiot Malo Ymerit, por megjithatë këta luftëtarë të vëllazëruar nuk e ngadalësuan marshimin drejt Lëkurësit. Atje u vendos që ceremoninë e përmortshme ta bënин mbasi të ktheheshin nga lufta, ndërsa para të vrarit u betuan se do ta shtojnë edhe më shumë vëllazërimin luftarak dhe urrejtjen për shovinistët grekë, që aq shumë kanë dashur me anë intrigash t'i ndajnë këto krahina nga njëra-tjetra.

Në Lëkurës grekët edhe pse ishin më të shumtë në numër dhe në armatime, nuk mundën dot t'i shkulini nga istikami barinjtë dhe bujqit e vëllazëruar të krahinave jugore të Shqipërisë. Në veçanti do të mbeten të paharruartrimëritë e bijve të Vunoit të udhëhequr nga kapetani Odise Kasneci në sektorin e Berdeneshit dhe të Çukës. Atje, këta trima, me gjakun e tyre të kulluar shkruan faqe të lavdishme për historinë e Shqipërisë.

Odise Kasnecin, fill mbas ngritjes së organizatës së fuqishme shqiptare «Lidhja Shqiptare e Prizrenit», e gjejmë përfaqësues të Bregdetit në kryesinë e degës së «Lidhjes» së Gjirokastrës.

Ky kapetan i Bregdetit ishte nga të parët e «Lidhjes» që së bashku me luftëtarin kuçiot Myslim Gjolekën hartuan në Gjirokastër një lloj legjislacioni për organizimin e një ushtrie kombëtare shqiptare, që të përfshinte gjithë shqiptarët pa dallim feje.

Vetëkuptohet se të gjitha këto veprime patriotike të shqiptarëve ishin një sfidë e madhe për politikën shoviniste greke, pasi ata prej kohësh ëndërronin që këto krahina shqiptare t'i përfshinin nën mbretërinë greke.

Qeveria e Athinës në pamundësi për ta bërë me vete kapetanin e paepur të Bregdetit Odise Kasnecin, me anën e organizatës së fshehtë greke «Filiqi eteria» (Shoqëria e miqve të fesë së vërtetë), vuri më në fund në përdorim armën e saj të zakonshme: helmimin dhe vrasjen. Por zhdukja e këtij trimi nuk ishte kaq e lehtë. Odisenë e mbronte gjithë Bregdeti dhe mbarë Labëria. Lidhja

Shqiptare kishte ngarkuar qysh në fillim Myslim Gjolekën, që ndodhej atëherë me punë në Himarë, të interesohet për mbrojtjen e kapedanit bregdetas, por shovinistët grekë e helmuani pabesishtrimin e Labërisë. Më në fund edhe këtë atdhetar megalideistët e vranë tradhtisht:

Në një mbrëmje të errët dimri plot erë dhe shi, kapedan Odisea së bashku me trimin Sulo Bolena kthehet i lodhur nga një udhëtim i largët për në shtëpi. Agjentura greke e mbështetur në familjen e renegatit Spiro Milos, në vendin e quajtur Vishë në Jonostath i kishte përgatitur pusinë. Atje përlleshja u bë e egër. Kapedan Odisea edhe pse i moshuar dhe i plagosur rëndë, luftoi trimërisht deri në frymën e fundit dhe ra si burrat i paepur, së bashku me birin e shtrenjtë të Labërisë, Sulo Bolenën.

Ja çfarë këngë trimërie i gërshtetoi populli Odise Kasnecit, këtij dreri të maleve të Bregdetit:

«Ç'ka Pulja që vetëtin,
Kuja që tutje po vin,
Jonostathi ulurin,
Për atë të bukur trim,
Trim dhe kapetan me lule,
Hajmedet qysh u përgjunje,
U godite me tre plumbe...»

I paharuar ka mbetur në vajet e Labërisë dhe të Bregdetit qëndrimi heroik i nënës së trimit Sulo Bolena, kur u vu në dijeni për vrasjen e djalit të saj të vetëm, që ra së bashku me kapedan Odisenë. Ja si e priti lajmin e vrasjes kjo nënë labe zëmërshkëmb:

«O Sulo Bolena astriti,
E gjora mëmë qysh e priti,
Kur i vate sihariqi,
Kur i vate dhe i thanë:
— E vranë Sulon, e vranë,
Me Odise kapetanë,
— Hallall qumështi, o djalë.»

Madhështore janë dhe vargjet që populli i ka ngritur (me rastin e vdekjes) trimit të Bregdetit, Sokrat Lekës nga Qeparoi, këtij mbrojtësi të vëllazërimit të Bregdetit me Kurveleshin, të këtyre dy krahinave fqinje, që aq shumë agjentura shoviniste greke dhe ajo turke kanë dashur t'i përcajnjë nga njëra-tjetra me anën e fesë:

«Qeparo në buzë shkëmbi,
Pataksem pse s'lot nga vëndi,
Humbi Sokrat Lekë dreri,
Humbi Sokrat Lek' i shkreti,
Kapetan i Bregutdetit,
Plaf i gjithë Kurveleshit,
Pall'e namuz i miletit,
Nur' i gjithë vilajetit...»

Sa helm dhe vrer është derdhur nga armiqtë e Shqipërisë për të zhdukur atdhedashësit shqiptarë, por tashti këta armiq turq, grekë, a serb qofshin, nuk mund të vaprojnë më si dikur, mbasi në Shqipëri ishte formuar organizata e fuqishme politike shqiptare «Lidhja Shqiptare e Prizrenit», degët e së cilës filluan të shtrihen anembanë atdheut.

Mbas vitit 1878 në mjaft krahina të Shqipërisë ndihet dora e dy pushteteve: e administratës turke dhe ajo e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Vetë zbatimi në popullsinë vëndase i dispozitave ligjore të degës së Lidhjes së Gjirokastrës, mbi rekrutimin e detyrueshëm ushtarak, e konkretizon më së miri ekzistencën e dy pushteteve.

Të njëjtët shembuj kemi edhe në Shkodër etj. Në mjaft krahina të atdheut shqiptarët kishin filluar të administrin vetë vendin.

Në Shqipërinë e Jugut, djemtë e Çelo Picarit, Rustemi dhe Iljazi, të influencuar nga përpjekjet e të jatit, ishin bërë mbështetje e Lidhjes.

Rustemi bënte pjesë në kryesinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për degën e Janinës, ndërsa Iljazi ishte në kryesinë e Lidhjes për degën e Gjirokastrës.

Gjatë kësaj kohe qeveria shoviniste greke, e përkrahur nga vendimet e marra në Kongresin famëkeq të Berlinit, filloj përsëri pretendimet e saj për të zgjeruar kufijtë në kurriz të tokave shqiptare.

Lidhur me pretendimet greke, në vjeshtën e vitit 1878, u bë një mbledhje e madhe në fshatin Frashër të Përmetit, nën drejtimin e Abdyl Frashërit, ku morën pjesë përfaqësues nga të gjithë anët e vendit. Atje djemtë e Çelo Picarit, Rustemi dhe Iljazi u zotuan përparrë mbledhjes se ishin gati së bashku me forcat e tyre të mos linin këmbë greku të shkelte atdheun.

Më 6 shkurt 1879 në Prevezë u mblohdh komisioni greko-turk për caktimin e kufijve në bazë të nenit 24 të traktatit dhe protokollit të 13-të të Kongresit të Berlinit, sipas të cilëve Greqia do të përfshinte mjart toka shqiptare në territorin e saj.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit me t'u vënë në dijeni për mbledhjen e këtij komisioni, dërgoi në Prevezë përfaqësuesit e saj, përveç mijëra shqiptarëve që u mblodhën vetë në këtë qytet.

Përparrë kësaj gjëndjeje kryetari i delegacionit turk, Myftar pashai (duke parë shqiptarët të armatosur dhe të zemëruar për këtë padrejtësi të madhe që u bëhej), i propozoi përfaqësisë greke që të zhvillonin bisedimet e tyre në vapor, pasi në qytetin e Prevezës nuk ishin të sigurtë.

Ashtu si në mbledhjen e Janinës e të Frashërit, edhe në Prevezë, djemtë e Çelo Picarit i gjejmë përsëri me Abdyl Frashërin si të deleguar nga dega e Lidhjes së Janinës dhe të Gjirokastrës, për të penguar dorën grabitqare të shovinizmit grek në gllabërimin e Shqipërisë së Jugut.

Përfaqësuesit e Lidhjes Shqiptare në protestën e tyre shtuani: «Në qoftë se Turqia do të premtonte të zgjidhte problemin në dëm të interesave shqiptare, atëherë shqiptarët do të shpallnin pavarësinë e tyre dhe, si pasojë, do t'u kthenin armët edhe vetë turqve».

Pala turke, nën kryesinë e Myftar pashës, e ndodhur para këtij presioni të përfaqësuesve të Lidhjes shqiptare u shpërndi pa dhënë asnje rezultat. Në veprën e tij historiani dhe shovinisti grek Dhimitër Hasioti, nuk le

fyerje dhe shpifje pa bërë kundër përfaqësuesve shqiptarë të ardhur në Prevezë, që me qëndrimin e tyre i hodhën në erë synimet grabitqare të qeverisë greke.

Në këtë kohë agjentura greke edhe kundër djemve të Çelo Picarit përdori po ato mjete që kishte përdorur edhe kundër patriotëve të tjera. Përsëri u vunë në jetë nga agjentura greke armët e tyre të zakonshme, shpifjet dhe komprometimet, për t'i futur në grindje shqiptarët me njëri-tjetrin. Ata synonin në radhë të parë, kundër Rus-tem Çelo Picarit, që banonte në atë kohë në Janinë.

Djemtë e Çelos, jo vetëm i hodhën poshtë shpifjet provokuese greke, që synonin t'i largonin këta trima nga patrioti i shquar Abdyl Frashëri, por të gjithë njerëzit e tyre i vunë në dispozicion të Lidhjes, për çlirimin e Shqipërisë.

Më 23 korrik 1880 Lidhja Shqiptare e Prizrenit mbledhi anëtarët e saj në qytetin e Gjirokastrës. Atje u shtrua çështja e autonomisë dhe u aprovua një program i ri shumë më i përparuar nga programet e mëparshme. Në këtë mbledhje patrioti Abdyl Frashëri kujtoi para delegatëve organizatorin dhe luftëtarin Çelo Picari me shokë. Ja si pasqyrohet ky fakt në folklor:

«*Ngrehu i vdekur nga varri;*
«*Ngrehu, o Çelo Picari...*
Se erdhi prapë behari,
Për liri prapë të dili,
Të dili prapë si ylli,
Ngrehu se vendi lëngon,
Dhe Avduli ju kërkon».¹⁾

Por tashti në mbledhje vendin e Çelos e kishte zënë djali i tij Iljazi, i cili deklaroi përparrë të deleguarve se ishte gati të vinte në ndihmë me një mijë luftëtarë për

1) AIF (Dosja II M.K.)

të vënë në jetë vendimet e marra në këtë mbledhje.¹⁾

Njerëzit e megalidesë shpifjet e tyre nuk i kufizuan vetëm brenda vendit, por dhe jashtë tij. Ata filluan një fushatë të shfrenuar në shtypin evropian, që të siguronin përkrahjen e diplomacisë së Fuqive të Mëdha ndaj kërkesave të tyre. Propaganda greke plot zhurmë mundohej t'i paraqite shqiptarët njerëz barbarë duke përsëritur të njëjtat shpifje, se ata nuk janë të aftë për një jetë shtetërore të pavarur, se janë njerëz pa kulturë etj. Silllogët e Epirit në mjaft gazeta evropiane kishin botuar artikujt e tyre si: «L'Epire et la question grecque. — Mémoire sur l'Epire en général et particulièremment sur l'é-parchie de Janina par un Epirote», etj.

Në këto rrethana «Lidhja» vendosi të dërgonte një delegacion që të takohej drejtpërsëdrejti me diplomatët e Fuqive të Mëdha imperialiste evropiane dhe në mënyrë të veçantë me ata të Francës, të cilët e përkrahnin pa rezerva kërkesën greke.

Delegacioni shqiptar kryesohej nga patrioti Abdyl Frashëri. Në prill të vitit 1879 ata arritën në Berlin. Ja si i këndoi populli patriotit trim Abdyl Frashëri:

*«Avdul prishe pasurinë, një barrë flori,
Hipe vaporit e shkove për në Gjermani,
Te Bismarku ti qëndrove: — Djalë kush je ti?
— Unë jam djal' nga Shqipëria, Avdul Frashëri,
S'jemi grekër e bullgarë, as nga Mali i Zi,
Jemi vetëm shqipëtarë dhe duam liri.
Mos e bëni copë-copë sikur s'ka njeri. »*

Edhe sot këngë e dalë para afro njëqind vjetëve vazhdon të këndohet me ëndje nga bijtë e popullit. Në këngët polifonike labe është një nga më të preferuarat.

Delegacioni shqiptar, mbas Berlinit, shkoi në Paris

1) Lefter Dilo. «Gjirokastra — një nga degët e lidhjes së Prizrenit». Gjirokastër, 1968, fq. 53.

dhe i parashtroi qeverisë franceze ankesën e popullit shqiptar pér padrejtësinë e madhe që i bëhej, njëkohësisht i drejtoi redaksisë së gazetës «Moniteur Universel» të Parisit artikullin e mëposhtëm, i cili u botua në atë gazetë në maj të vitit 1879:

«Zoti redaktor!

Me habi pamë se gazeta e rëndësishme «Republika Franceze» e cila në polemikën e saj të zakonshme kurrë nuk devijon nga rregullat e modestisë, botoi disa pjesë të shkëputura nga memorandumi i Lidhjes Shqiptare dhe poshtëroi e bëri qesharakë atdhetarët tanë.

Atij artikulli nuk i dhamë asnjë përgjigje, por «Republika Franceze», duke u rikthyer prapë në çështjen në fjalë, u orvat të tallë dy të dërguarit e Lidhjes Shqiptare.

Një sjellje të tillë fare pak e pritnim prej një gazete që simpatizon luftën e kombësive.

Franca qan gjithmonë humbjen e krahinave të saj; banorët e Alsasës dhe të Lorenës rënkojnë kur kujtojnë privimin e kombësisë së tyre. Përse një gazetë franceze i gjen qesharakë shqiptarët, të cilët përpinqen të evitojnë rrrezikun e një fatkeqësie të tillë?

Nuk jemi savantë dhe as pretendojmë pér të, por historinë e atdheut tonë e kemi studiuar dhe e dimë më mirë se kushdo tjetër.

Banorët e Epirit i quajnë «Pellazgë». Herodoti, Tukididi dhe Straboni dalin më konkluzion se ky vend nuk ka pjesë të Greqisë. Sipas Strabonit, Greqia nga Veriu kufizohet prej Akarnanisë dhe gjirit të Ambrakisë.

Pasi gjeografia e lashtë greke nuk u vjen në ndihmë grekërvë të sotëm, po pyesim ata që kanë mendime të kundërta, se cila pjesë e Epirit është greke? Ai që pranon argumentet e sillogëve grekë do të besojë se Greqisë nuk i përket vetëm Shqipëria, por edhe Maqedonia, Thraka, Rumania, Azia e vogël, sipas vendeve të Greqisë së madhe, dhe Marseja juaj !!!

Epiri ka 650 mijë banorë. Sa janë vallë grekët që ndo-

dhen në të dhe ku banojnë? Në Korçë? në Berat? në Gjirokastër? apo në Çamëri? Ai që kalon nëpër këto vende takon vetëm epirotë shqiptarë, jo epirotë grekë. Do të sakrifikoheshin pra 650 mijë shqiptarë puro pér të nginjur lakinë e sillogëve grekë dhe lëvizjet artificiale të tyre...

Sjellja e tanishme e Greqisë dëshmon se ajo ka ndërmend të imitojë Rusinë cariste!!! Por kjo (Rusia) i përkrah pretendimet e saj me anën e forcës, e cila pér fat të mirë i mungon Greqisë. Sikur të ishin grekët aq të fortë sa tregohen! ! ! që në fakt janë vetëm miq të zhurmës, Evropa nuk do të kishte kurrë qetësi.

Parimi i ngjashmërisë në gjuhë do ta shpinte Greqinë shumë larg, por në radhë të parë do të na jepej neve e drejta të kërkojmë nga grekët dyqind mijë shqiptarët që banojnë në një lagje të veçuar të Athinës të quajtur «Plakë» dhe krejt ishujt Hidra dhe Speca. Epiri është dhe do të mbetet gjithmonë shqiptar, ashtu si e krijoi natyra dhe historiа.

Mëkat që qeveria greke shpenzon pér sillogët shuma të majme, të cilat mund t'i përdorte në mënyrë më të arsyeshme. Ajo përpigjet të zgjasë një ngatërrresë, e cila s'ka pér të mashtruar asnjë evropian.

Po të nguli këmbë Greqia në aspiratat e lakinë e saj të pangopura, të cilat i kundërvihen drejtësisë dhe të drejtës së kombeve, shqiptarët kanë vullnet të patundur që të mbrojnë atdheun e tyre deri në fund dhe janë betuar të mos lëshojnë asnjë pëllëmbë tokë dhe të vdesin pér të po të jetë nevoja. Këtu manifestojmë mendimin e të gjithë bashkatdhatarëve tanë.

Evropa nuk do të marrë përsipër përgjegjësinë e luftë-rave shkatërrimtare që do të inauguroonte pér aneksimin e shëmtuar të tokave tona nga Greqia.

Shpresojmë, zoti redaktor, se do ta botoni përgjigjen tonë, gjë pér të cilën dhe ju falënderojmë qysh më parë.¹⁾

Abdyl Frashëri...

1) AIH. Dhimitër Hasiotis. «Popullsia greke në Epirin e ri dhe të vjetër», fq. 100.

* * *

Ja çfarë histori të mrekullueshme kemi trashëguar nga e kaluara e lavdishme e të parëve tanë. Ja me çfarë popull heroik, trim dhe liridashës u brumosën idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit në Shqipëri. Nga ky vend i pampostur doli Partia jonë heroike me në krye udhëheqësin e shquar shokun Enver Hoxha, partizanët tanë trima, ushtria jonë popullore, që sot, së bashku me popullin, vigjëlon në kufi për mbrojtjen e Republikës sonë Popullore Socialiste.

Dhe në qoftë se lëvizin përsëri agresorët, ata do t'i presë i njëjti fat si dhe të tjerët:

*«Veç ballin të rrudh Enveri,
Buzët të lëviz Partia,
I rëni shpërthen nga varri,
Nga barku i nënës fëmija. . . ».*

Fund

B I B L I O G R A F I A

- Prof. Aleks Buda.** «Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjet e saj historike» (Referat i mbajtur në konferencën kombëtare të studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Tiranë 12-14 qershor 1978.).
- Ligor Mile** — «Kryengritjet popullore në fillim të Rilindjes sonë» (1830-1877). Tiranë, 1962.
- Panajot Aravantinoi** — «Hronografia tis Ipiru» (1822-1853). Athinë, 1856.
- K. Paparigopoulos** — «Historia tu Helenika Ethnus» vëll. VI. Athinë, 1865.
- K. Mekios** — «Historia e Epirit». Kairo, 1909.
- J. Llambridhis** — «Epirotika meletimata». Athinë, 1888.
- J. Filimon** — «Dhoqimion historikon peri tis Eleniqis epanastases», vëll. IV. Athinë, 1859.
- K. Biri** — «Arvanites...» Athinë, 1960.
- J. Kordhatos** — «Historia tis neoteris Elladhas» vëll. III, (Përkthim pranë arkivit të Institutit të Historisë).
- Dh. Hasiotis** — «Çështja e kufijve të Epirit» (përkthim pranë AIH) «Dizertacione dhe kumtesa përmbi Epirin». (Përkthim pranë AIH).
«Popullsia greke në Epirin e ri dhe të vjetër» (Përkthim pranë AIH).
- Enciklopedia e madhe greke «Pirsoi», vëll. II, faqe 275, 278, vëll. III, faqe 413, 425; Athinë, 1929.
- Gazeta greke «Elenikos Tahidhromos» e viteve 1837, 1838, faqe 313, Athinë.
- S. Pollo.** — «Probleme të lëvizjes kombëtare shqiptare». «Studime historike» Nr. 1, Tiranë, 1965.
- G. Shpuza** — «Lidhja e Prizrenit ngjarje e madhe në historinë e popullit tonë». Gazeta «Mësuesi», Tiranë, 31.5.1968.

- P. Thëngjilli** — «Kryengritjet popullore antiosmane në Shqipërinë e Jugut gjatë viteve 1834-1835».
 «Studime Historike» nr. 3, viti 1977, fq. 157.
- S. Frashëri** — «Kamus ul alami (Enciklopedi turke), vëll. III, IV, Stamboll, 1891.
- I. Qemali** — «Memoirs of Ismail bey». London, 1920.
- Th. Mitko** — «Bleta shqiptare». Vienë, 1924.
- S. Dine** — «Valët e detit». Sofje, 1908.
- L. Dilo** —
- Q. Zaimi** — «90 vjetori i Lidhjes së Prizrenit». Gjirokastër, 1968.
- N. Ksera** —
- M. Koroni** — «Shpata e Labërisë». SHBA, 1917.
- M. Valentini** — **Chirol** — «Twixt greeks and Turks», faqe 74, London, 1881.
- E. Poujade** — «Chretiens et turcs». Paris, 1859.
- C. Robert** — «La péninsule Greco-Slava — et Les Albanais», vëll. II. Paris, 1844.
- D. Urquhart** — «The spirit of the East», vëll. I. London, 1839.
- A. Boue** — «La Turquie d'Europe» vëll. II. Paris, 1840.
- J. G. Hahni** — «Albanesische Studien». Wien, 1853.
- D. Camarda** — «Appendice al saggio di grammaticologia comparata sulla lingua Albanese». Livorno (Itali), 1866.
- A. Galanti** — «L'Albania». Romë, 1901.
- Instituti i Historisë — «Historia e Shqipërisë», vëll. I, II. Tiranë, 1965.
- Gazeta «I foni tis Alvanias». Athinë, 23 gusht 1880.
- Gazeta «L'Albanese d'Italia». Napoli, 1848.

Burime të tjera

- AHSHT (Arkivi Historik i Shtetit, Tiranë).
- AIHT (Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë).
- AIFT (Arkivi i Institutit të Folklorit, Tiranë).
- Këngë popullore mbledhur prej vetë autorit gjatë 25 vjetëve.

P È R M B A J T J A

Faqe
3

Parathënie

Pjesa e parë	
Trimat e kryengritjeve popullore në ditët e fundit të Ali pashë Tepelenës. Prijësi i talentuar ushtarak Marko Boçari	13
Trimi tjetër i vegjëlisë shqiptare i rritur në oborrin e Ali pashë Tepelenës, kordhëtar i Labërisë Çelo Picari.	34
Kuvendi i madh ndërkrashinor i Beratit dhe organizata e fuqishme politike «Lidhja shqiptare»	39
Masakrat turke të Janinës dhe të Manastirit. (5 janar 1829- 9 gusht 1830)	46
Udhëheqës të shqar të kryengritjeve popullore: Tafil Buzi dhe Zlyftar Poda. Lufta e Melesinit më 1831	60
Pushtuesi turk nuk mundi ta mposhtë as me hekur as me zjarr shpirtin liridashës të shqiptarëve. Kryengritjet popullore në krahinën e Gjirokastrës gjatë vitit 1833	69
Kurorëzimi i kryengritjeve popullore me vetëqeverisjen e nëntë krahinave shqiptare	83
Persekutimi i udhëheqësve dhe i mbarë trimave të fshatarës së Shqipërisë së Jugut	101
Shpallja e Tanzimatit dhe zbatimi i saj me forcë në Shqipërinë e Jugut pas vitit 1840	109

1995
1840


Pjesa e dytë

Trimat e kryengritjeve popullore të Shqipërisë në Jugut në ndihmë të malësorëve të Veriut për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut gjatë vitit 1852	167
Trimat e kryengritjeve popullore në luftë për mbrojtjen e krahinave Jugore të Atdheut gjatë vitit 1854	176
Shpirtin liridashës të shqiptarit nuk e mposhtën dot as topat dhe as dekretet e sulltanit (15 shkurt 1856)	200
Lëvizja e kaçakëve ose e hajdutëve një nga format e hershme të luftës klasore	206
Bijtë e Shqipërisë vazhduan luftën e tyre për mbrojtjen e tërësisë tokësore në Jug të Atdheut	226
Lufta e popullit shqiptar hyn në një rrugë të re më të organizuar. «Lidhja shqiptare e Prizrenit» (10 qershor 1878)	237
Veprimtaria patriotike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Jug të Atdheut. Memorandumi dhe projekt i luftarak i ku-vendit ndërkrahinor të Janinës (24 korrik 1878)	250
Trimat e kryengritjeve popullore dinë t'u përgjigjen armiqve jo vetëm në fushën e luftës, por edhe në arenën politike	263
Bibliografia	281
Burime të tjera	282
Përbajtja	283

